

# FJALA E MIRË

Përmban shpiegimin e Ungjijëvet të Shenjta të të Djelavet të gjithmotit me nga një fjalim në çdo të Djelë.

---

Botohet në dy pjesë.

---

## PJESA E PARË

Prej DHIMITËR PËRMETIT

ish Drejtor i Seminarit Kombëtar Orthodhoks

Botuar me ndihmat e disa Fjerakëve Besëmirë



TIRANË

Shtypshkronja "DIELLI"

1943

---

## UNGJILLI PARA LARTËSIMIT

Shpjegimi i ungjillit (Joani 3. 13-17)

«Tha Zoti: Asnjë s' është ngjitur në qiell, përveç ay që zbriti prej qiellit, i biri i njëriut që është në qiell.»

Këto fjalë janë një pjesë të bashkëfjalimit, që bëri Zoti bashkë me Fariseun Nikodhim, sa i nevojshëm është pagëzimi për shpëtimin e njëriut dhe ay s' kuptonte, atëhere Jisuj i tha: Në qoftë se ju nuk kuptoni të dheshmet d.m.th. gjërat që bëhen mbi dhe, sikundër është pagëzimi, qyshë do të kuptoni qielloret d.m.th. lindjen t' ime nga Perëndia dhe ati? Aju që u ngjit në qiell, ay mund të kuptojë ato të Perëndisë. Asnjë tjetër s' është ngjitur në qiell, që të dijë dëshirën e mendimin e Perëndisë dhe t' i zbulojë këto njëzvet për shpëtimin e tyre, përveç një i Biri i Perëndisë, që zbriti nga qielli mbi dhë dhe u mëshirua. Edhe vetëm me hanën e atij mund te njohim të vërtetën dhe dëshirën e Perëndisë dhe të fitojmë shpëtimin.

«Që është në qiell» gjithënjë sikundër edhe mbi dhë sepse edhe kur ishte Krishti mbi dhë si njëri, por si Perëndi ndodhesh gjithnjë në qiell i bashkuar me atin dhe ndodhesh kudo.

«Dhe sikundër Mojsiu lartësoj gjarpërin në shkretëtirë, kështu duhet të lartësohet dhe i biri i njëriut, që kushdo që i beson mos të humbasë, por të ketë jetë të pasosur».

Kur Israilitët duallën nga Egjiptit dhe u ndodhën ne shkretëtirën Edhom, gjarpërinj elmatues i kafshohin dhe vdisnin. Atje pra Mojsiu pas porosisë së Perëndisë, nguli një gjarpër të bakërtë, mbi të cilin shkonin të kafshuarit prej gjarprinjet dhe shpëtonin. Kjo ngjarje symbolizonte lartësimin mbi Kryq të shpëtimtarit, mbi të cilin ne duke mbesuar dhe duke u bindur shpëtojmë nga plagët vdekjeprurëse të mëkatës, që e pruri në botë gjarpri dinak, djalli.

Kësisoj për shpëtimin e botës është nevojë të lartësohet mbi Kryq dhe të vdesë i Biri i Perëndisë, që u mëshirua, që kështu çdo pasuës i tij besnik mos të humbasë, por të shpëtojë dhe të fitojë jetën e amëshuar.

«Kaq e deshi Perëndia botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindur, që kushdo që i beson mos të humbasë, por të ketë jetë të pambaruar».

Kaq shumë e deshi Perëndia botën, sa për shpëtimin t' onë dorëzoi në vdekje, dhe vdekje të tillë, sikurse është vdekja mbi Kryq, Birin e Tij të dashur.

«Sepse nuk e dërgoi Perëndia Birin e Tij në botë që të gjykojë botën, por që të shpëtohet bota me anën e tij».

Nuk e dergoj Perëndia Birin e Tij që të gjykojë dhe të dënojë njëzëit mëkatarë, por që të veprojë për shpëtimin e tyre. Sepse gjyqi i botës do të bëhet me ardhjen e dytë të Krishtit. Në ardhjen e parë Krishti erdhi që të lartësojë njëzëit me mësimin e Tij Hyjnor dhe kështu duke i besuar të shpëtohen; dhe ardhja e mëshirshme për të shëruar lëngatat e popullit. Por në ardhjen e dytë do të vijë me lavdin e Tij, si gjykatës për të gjykuar botën.

MËSIME. - Në fjalimin e Tij me Nikodhimin Zoti lëçit kthjelltas se nuk është njëri i thjeshtë, por i Biri i Perëndisë që zbriti nga qielli dhe u bë njëri. Si i tillë Krishti është Mësuesi i Math i së vërtetës, që na zbulon dëshirën e Perëndisë dhe na udhëheq pa gabim në shpëtimin e përgjithshëm. Po t' i pasojmë Atij me besatari, pasojmë të vërtetën, ecim në dritë, marshojmë udhën e shpëtimit dhe të jetës.

Judhenjtë në shkretëtirë i shpëtoj nga gjarprinjt gjarpëri i bakërtë, që ishte ngulur mbi dru. Por gjithë botën shpëton nga mëkata dhe nga gjarpri dinak, nga djalli, Zoti Krisht, i cili u mvarr mbi Kryq si keqbërës. Ay mori përsipër dhe mbajti mëkatat t' ona. Ay mveshi natyrën mëkatore të njëriut, sado që ishte i shënjtë, dhe u-bë mallkim për neve.

Në qoftë se Perëndia pranoi, që të dorëzojë Birin e Tij, për neve në vdekje; dhe vdekje Kryqi, nga kjo kuptojmë dashurinë e pa treguar të Perëndisë për ne njëzëit. Ma e madhe dhe ma e kurtë provë e dashurisë hyjnore për ne as gjendet as mund të gjendet.

Sado që Perëndia dorëzoi Birin e Tij për shpëtimin e gjithë botës me gjith këtë nuk shpëtohen gjithë njëzëit. Shpëtohen vetëm ata, që shikojnë me besë te i Biri i Perëndisë. Perëndia është e mirë, por është edhe e drejtë. Në qoftë se në mirësin e Tij, na jep mjetin e shpëtimit me anën e Birit të Tij, por në drejtësin e Tij shpëton vetëm ata, që tregojnë me veprat e tyre besën e duhur dhe mirnjohësin te shpëtimtari i Biri i Perëndisë.

Për ata që besojnë është rezervuar jetë e lumtur. Për ata që nuk besojnë tek i Biri i Perëndisë është ruajtur humbje dhe denim i përjetshëm. Janë fjatorë, se nuk ç' muan dashurinë e patreguar të Perëndisë, dhe nuk përítuanë që të shpëtojnë me hanën e Shpëtimtarit Krishtin. Sepse Zoti nuk është vetëm shpëtimtar, por edhe gjykatës.

Shpëtimtari i tërmirë për ata që besojnë dhe pendohen; gjykatës i drejtë dhe i frikshëm, për ata që qëndrojnë në pabesi dhe në mëkatë.

---

## E DJELË PARA LARTËSIMIT

### FJALIM: Për Dashurin e Perëndisë

**"Kaq deshi Perëndia botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlinder, që kushdo që i beson mos të humbasë, por të ketë jetë të përjetëshme",**

Le të thonë ç' të duanë materialistët dhe adhuronjësit e trupit për të zhustifikuar jetën e tyre mëkatore dhe të çregulluar le të mohojnë të pabesët besën e përbotëshme të Perëndia e të shpirti. Me gjithë këto mohime është e sigurtë, se brenda në thellësitat e njëriut fshihet shpirti një shpirt i pavdekshëm dhe qiellor, i cili e fisnikon, e inspiron dhe e udhëheq njërin në udhën e qytetërimit dhe përparimit, dhe i cili e lartëson njërinë në sferat ëtherore dhe e shtynë në vepra fisnike dhe heroike të vetmohimit dhe kështu e tregon njerin bir Perëndie dhe trashëgimtar të mbretëris qiellore.

Për qënien e shpirtit dhe për vlerën e tij e tha vet goja e së vërtetës në Ungjillin e sotshëm «kaq e deshi Perëndija botën, sa dha Birin Tij të vetëm lindur». Këtu nuk flet vetëm për shpirtin, që ekziston, por thekson edhe për vlerën e tij të çmuëshme, sa dërgoi edhe të Birin e Tij të vetëmlindur për shpëtimin e tij. Këjo tregon dashurinë pamasë të Perëndisë për njerzit.

1) Me të vërtetë cilin dha Perëndia? Dha Birin e Tij të vetëmlindur Perëndija kishte me mijera Kryeenjës dhe engjëj, të cilit rinin përpara fronit të madhëris së Tij me shënjtëri, me dashuri, me fuqi të çuditshme dhe të cilët ishin gati të vinin për shpëtimin t' onë. Por nuk, dërgojë engjëjt, por dërgon të Birin e Tij të dashur, që e lindi përpara jetëvet dhe i cili ishte bashkë me Atë i bashkuar dhe i pandarë. Sado që i Biri i Tij ishte Zoti, përpara të cilit gjunjëzojnë Qeruvimet dhe Serafimët dhe të gjitha fuqit qiellore Sado që i Biri i Tij është Ay, prej të cilit u krijua bota. Perëndija për dashurinë e njërvet dërgoi Birin e Tij të dashur, sikundër e quajtën në Jordhan dhe në Thavor, «Ky është biri im i dashur që unë e pëlqeva».

2) Dhe qysh e dha? jo në nderje dhe në lavdi; e dha në përbuzje, në dhëmbje, në vdekje; vdekje Kryqi, që ishte më e ashpër dhe e çndershme. Le të mendojmë ç' ishte Krishti dhe si njëri dhe ç' vuajti lart mbi Kryq, që të kuptojmë në sa ka metro për të matur dashurinë e Perëndisë. Ç' isht me të vërtetë Krishti si njëri? Ishte i shënjtë i shënjetorvet, Jisuj i pamëkatëshmi, «i cili nuk bëri mëkatë dhe në gojën e tij nuk u gjënd dinakëri», i cili «e shkoi jetën e tij duke bërë të mira dhe duke shëruar lëngatat e popullit». Ay i cili ruajti gjithë drejtësinë dhe gjitha porosit e Atit të tij, në mënyrë që «virtuti i tij të mbulojë qiejt» dhe të dashur ta quaj ati i tij qiellor. Ç' nderje dhe lavdi i

kishte hije? Me gjith këtë ati i tij e la mbi dhë të vobekt, të shkretë, e la të vdesë vdekje të frikëshme mbi Kryq me pështytje dhe shuplaka, me fymje dhe katarash. Nuk e la, por e dërgoi vetë dhe e dorëzoi te vdesë Biri i Tij i Tërshënjtë.

3) Dhe qër cilët e dorëzoi? E dorëzoi për botën, jo për të drejtët dhe besëmirët. Kur thotë botën, kupton botën mëkatore, njëzrit të mëkatë dhe të gënjeshtres. Edhe të tillë ishin të gjith njëzrit, jo të bindur e të disiplinuar, sikurse ishte Biri i Tij, por të larguar nga nomi, të liq, fajtorë dhe mëkatorë, me të vërtet armiq të Perëndisë dhe bij të zëmëratës dhe të mallkimit. Me gjith këtë Perëndia, për njëzrit mëkatarë për armiq e tij, që e fyenin ditë e natë në tër jetën e tyre, sakrifikoi Birin e Tij të vetëmlindur, që të shperblehen me gjakun e tij të çmuarë dhe të gjejnë ndjesë të mëkatave të tyre. Cili njëri ndonjëherë, sado njëridashës qoftë, do të bënte të tillë sakrificë? Dhe cili at do therorizonte djalin e tij të dashur për njërës keqbërës dhe kriminelë? Shkronja e shënjtë thotë, që Abrahami pranoi me bindje dhe kënaqësi që therorizoj djalin e tij Isaakun. Por e bëri për hatër të Perëndisë, i cili i a dha dhe për të cilin çdo sakrificë ka hije. Por për armiq nuk është sakrifikuar kurrë asndonjë njëri. Vetëm Perëndia e bëri këtë gjë, sepse Ay ndjen dashuri të pamasë për njëzrit, qofshin mëkatarë.

Për këtë me admirim Shën Pavli thotë, «Na rekomandon dashurin e Tij Perëndia tek ne, sepse me gjith që ishim mekatarë, Krishti për ne vdiq».

4) Qëllimin për të cilin e dërgoi të Birin e Tij. Edhe këtë e shtoi Shpëtimtari në Ungjillin e sotshëm. «Që kushdo që i beson, mos të humbasë por të ketë jetë të përjetëshme». Njëzrit ishin të humbur dhe të larguar nga Perëndia dhe s' kishin prehje e gëzim dhe shpirti i tyre ishte i vdekur ndën zëmërat e drejtë të Perëndisë. Por mëshira e pa kufizuarë e Perëndisë na shpëtoi me gjakun e Birit të Tij, që e pranoi për shpagim të mëkatës stërgjyshore. Na dhuroi jetën, po jo këtë jetë të përkohëshme por jetën qiellore, ku nuk është «as dhimbje as hidhërim, as fsherëtim» por vetëm gëzim afër Perëndisë, vetëm nderje dhe lavdi midis ëngjëjvet.

Vllezër të dashur. Këto ditë do të kemi përpara Kryqin e Zotit t' onë Jisu Krishtit të gjakosur, dhe do të dëgjojmë Ungjillin e Shënjtë të na tregojë prapë pësimet e frikëshme dhe vdekjen jetëdhënëse të Shpëtimtarit t' onë që vërtetojnë dashurinë e pakufishme për ne. Mos të mbetemi të pa mallngjyerë përpara kësaj dashurije, por të kemi besë dhe dashuri, sepse këto kërkone Perëndija prej nesh. Besë të nxehtë dhe dashuri të gjallë, që e sjellin njerin në pendim dhe e udhëheqin në shënjtëri. Po ku ti gjejmë në kët, në qoftë se nuk na i dhuron Ay vetë?

O At qiellor! Zoti i mëshiravet dhe Perëndia e Dashurisë! Dhuro-na besë të nxehtë dhe të patundur te Biri i Yt, që u kryqëzua për ne. Bëj-na që të duam Ty me gjithë zëmër, sikurse ti na dashurove, dhe t' a tregojmë dashurinë t' onë me një pendim të

sinqertë dhe me një jetë të virtutëshme. Po, jep-na këtë besë, që të gjejmë shpëtim dhe jetë të përjetëshme pranë lavdis S' ATE të pavdekëshme. AMIN.

---

## **LARTËSIMI I KRYQIT JETËDHËNËS I SHPËTIMTARIT ZOTIT T'ONË JISU KRISHT**

(Më 11 Shtator)

Në Jerusalem Shën Elena, e ëma e Shën Kostandinit Math, vajti në vitin 326 që të falet në Vëndet e Shenjta dhe të falnderoj atje Perëndinë për triumfet, që dëgnoi të kurorëztoj luftërat dhe veprat e birit të saj. me gjith që ishte 80 vjeçë Augusta, e shpirtëzuar me zell hyjnor, zhvilloi aktivitet të çuditshëm.

Mbasi ndërtoi shumë Kisha, deshi të plotësoj dëshirën e shënjtë, të zbuloj Golgothan, për të cilën interes të math ndjente dhe imperatori i biri saj. Ajo bregore, e cila u shënjtërua me gjakun e çmushëm të shpëtimtarit t' onë, ishte bërë akoma nga shekulli i I vënd falje adhurimi i besnikvet. Imperatori Adrianoj duke kundërvepruar për këtë tërheqje që kishte Golgothaj, vëndosi ta fshehë, dhe ndërtoj mbi atë në vitin 136 pas Kr. një Kishë te Afrodhitës; pandehu se kështu do të zhdukte dhe kuptimin e këtij vëndi të pavdekshëm. Po kjo gjë shkaktoi pikërisht përjetësimin e tij, se kështu me gjithë gërmimet që u bënë në tokën dhe në vëndet e Jerusalem, mbeti vëndi i caktuar. Kisha idhololatrike ishte dishmi e pa gënjeshtërt e vëndit.

Kështu Shën Elena zbuloi Golgothan duke liruar atë nga çdo gjurmë pagane, që ishte afierosur në perëndeshën e dëshiravat të trupit me kundërshtim me spiritën e qartësis dhe vetmohimit, që përhap në botë Ay, i cili sakrifikoj jetën e Tij, për çlirimin e njëzimit nga zgjedhja e mëkatit. Në punërat që bëheshin për këtë qëllim, ku ndodhej shumë herë vetë Shën Elena, u gjendën të thellosur tre Kryqe. Kjartas dy Kryqe ishin, që mbajtën trupat e kusarvet të bashkëkryqëzuar nga çdo hanë me atë. I treti ishte Kryqi, që u shënjtërua me gjakun e Shënjtë të Shpëtimtarit. Njohjtje e Kryqit ishte forma e tij e veçantë me një copë dru e dalë në majë, ku u ngjit mbishkresa I.N.B.I. romanisht, greqisht dhe ebraisht. Por kjo e dalë në majë nuk u gjend, se duhesh të çfaqesh vërtetimi në mënyrë më panigjyrike, dhe më e sigurtë. Ishte e sëmure një zonjë shumë fisnike besëmirë, për të cilën mjekët s' kishin shpresë shpëtimi. Shën Elena dhe Episkopi i atëhershëm i Jerusalem Makarios me shum priftër dhe parësin Krishtere e prekë të sëmurën, gati për vdekje, me çdo Kryq. Dhe çfaqja u bë Panigjyrike. Porsa e preku Kryqi i Zotit në fund, zonja u shërua. "Pas një tradite tjetër gruaja kishte vdekur dhe Kryqi i Zotit e ngjalli. Ose njërën, ose tjetrën të pranojmë vepërimi çudibërës mbetet i pamohushëm."

Lajmi i përhapur at çast në gjithë Jerusalem dhe në rethet shkaktoi entuziazëm dhe

mbledhje të madhe besnikësh, që digjeshin prej dëshire të afroheshin dhe të shikojnë Kryqin e çmuëshëm. Por padurimi ishte i papërmbajtur. Kushdo luftonte t' ia shkonte tjetrit dhe me grumbullimin e asaj turme u bënë shumë fatkeqësira. Atëhere u vëndosë që të bëhet një ceremoni në Kishë, të vihet në atë një vënd i lartë, mbi të cilin të tregohet Kryqi, që t' a shikojnë besnikët dhe t' a adhurojnë. Episkopi Makarios e tregoj që nga lartësija në turmën e mbledhur të besnikëve Kryqin e çmushëm. Për kujtim të kësaj ngjarje u caktua prej Kishës e kremtja e Lartësimi të Kryqit jetëdhënës më 14 Shtator.

Një pjesë të Kryqit të Shënjtëruar e pruri Shën Elena në Kostandinopojë te Kostandini i Math, bashkë edhe peronat, me të cilat ishte ngulur trupi i Shpëtimtarit t' onë. Një nga këto perona e nguli në periqefalen e tij Imperatori besëmirë, i lumtur se s shkëlqeu atë me këtë thesar të çmushëm, si trope të paluftuarshme kundër armiqve.

Imperatori Kostandini i Math u gëzua tepër për gjetjen e Kryqit jetëdhënës të Zotit dhe Shpëtimtarin t' onë Jisu Krishtit dhe urdhëroj të ndërtohet mbi varrin e Krishtit një Kishë madhështore që u quajt Kisha e ngjalles.

---

## E DJELË PAS LARTËSIMIT

Shpjegimi i Ungjillit (Mark 8.34-38 dhe 9.1)

**"Tha Zoti. Kush do që të më aij prapa, le të mohojë vehten e tij, le të ngrerë Kryqin e Tij dha le të më pasojë".**

Nuk shtrëngon, sado që e ka fuqin, as urdhëron, sado që e ka pushtetin, por e lë çdo neri në dashjen e tij. Vetëm thërret, sepse si njëridashës dëshiron shpëtimin e të gjithvet. Prandaj thotë, kush dëshëron që të vijë "prapa meje" d.m.th. të bëhet nxënësi i im dhe të imitojë veprat e mija, ay është nevojë të bëjë tre gjëra: të mohojë vehten, të ngrerë Kryqin e vet dhe të më pasojë.

Vehtja jonë është ajo që e quan Apostol Pavli njëri i vjetër i mëkatës. Këtë pra njëri të vjetër të mëkatës duhet t' a mohojmë, kur largohemi nga dëshirat e liga të trupit dhe përbuzim të gjitha veprat që janë në kundërshtim me porosit e Krishtit.

Kryqi simbolizon të parën vdekësimin e mëkatës sepse vdiq mbi Kryq Krishti, për të vdekësuar dhe për të shdukur mëkatën e botës. Të dytën Krishti simbolizon shtërngimet dhe vuajtjet. Pra të ngrerë Kryqin e vet do të thotë, le të vdekësoj në shpirtin e tij çdo dëshirë të ligë dhe çdo prirje për të ligën dhe le të jetë gati për çdo shtërngim dhe për vdekje qoftë, për besën dhe për dashurin e Krishtit.

I pasojmë Krishtit, kur imitojmë veprat e Tij.

Për të vajtur pra "prapa Krishtit duhen tre gjëra: të urrejmë mëkatën, të vdekësojmë pasionet dhe të imitojmë veprat e Krishtit."

"Ay që do; të shpëtojë shpirtin e tij, do t' a humbasë; dhe kush do të humbasë shpirtin e tij për mua dhe për Ungjillin, ay do t' a shpëtoj atë."

Shpirt kupton këtu jetën. Kush midis reziqevet do të mohojë Krishtin për të shpëtuar jetën e tij, ay do t' a humbasë për jetë, sepse do të vejë për në vëndin e dënimit të përjetshëm. Kurse ay që do të therorizoj jetën e tij për Krishtin dhe për Ungjillin e tij ay do të rroj për jetë me lavdi në mbretërin e qiellit. Kjo u plotësua në kohën e ndjekjevet, kur martyrët derdhën gjakun e tyre për të mos mohuar Krishtin dhe kështu fituan kurorën e martirizimit dhe lavdinë në qiell pranë Perëndisë.

"Sepse ç' dobi do të ketë njeriu, edhe sikur të fitojë tërë botën dhe dëmton shpirtin e tij"? Dhe ç' do të japë njeriu çpagim të shpirtit të tij"?

Përgjigja në këto dy pyetje është asgjë. Edhe sikur të fitojë ndonjë gjithë botën, fitimi është i kotë dhe pa ndonjë vlerë, kur puna është që të humbasë shpirtin e tij të pavdekshëm.

"Sepse ay që do të turpërohet për mua dhe për fjalët e mia në këtë bres kurvar dhe mëkatar, dhe i biri i njeriut do t' a turpëroj, kur të vijë në lavdi te Atit tij bashkë me engjejt e shenjte."

Atë që do të ket turp që të duket përpara botës, se është nxënësi im dhe pason fjalët e mija, dhe unë do t' a turpëroj përpara Atit t' im. Bres kurvar, quan njëzë e mëkatës, të cilët mohojnë Krishtin dhe i shërbejnë dëshiravet të djallit, sikunder një grua kurvare të burrin e saj legal dhe vete prapa të huajvet.

"Edhe u thoshte atyre, me të vërtet po ju them, që janë disa këtu, që nuk do të gjërojnë vdekje, deri sa të shikojnë mbretërin e Perëndis ardhur në fuqi."

Zoti Krisht me fjalët: Disa që ndodhen këtu, kuëton apostojt, të cilët përpara vdekjes tyre, ditën e pentikostis, do të shohin qysh Krishti ka për të themeluar Kishën e tij me lavdi dhe me fuqi hyjnore:

MËSIMI. - "Kush do", Nuk shtrëngon asnjë Zoti i gjithpushtetshëm. Thëret nën flamurin e së vërtetës së tij, ata që duhan të vërtetën. Punon si nxënës, ata që duhanë

të plotësojnë porosit e Ungjillit Tij. Asnjë nuk mbanë pranë Tij pa dashjen e vet.

Në qoftë se duham të vemi prapa Krishtit d.m.th. të jemi të Krishterë me të vërtet, duhet të plotësojmë konditat, që na vë. Këto janë: të mohojmë vehten t' onë mëkatore. Të luftojmë pa pushim kundër mëkatës dhe pasionevet të jemi gjithnjë gati në shtërngime dhe në vdekje për emrin e Krishtit dhe të imitojmë sa të jetë e mundur shëmbullën e tij. Kush pandehë se i pasonë Krishtit pa ruajtur këto kondita, gjendet në gabim të plotë.

Do që të sigurosh jetën e përjetëshme? Duhet të jesh gati të therorizohesh çdo të mirë të dheshme edhe, në është nevojë, edhe jetën t' ende për dashurin e Krishtit. Në qoftë se për Atë sakrifikon të gjitha, fitonë kështu për jetë mbretërin e Perëndisë.

Për njerinë ska asgjë më të çmushme se shpirti i tij. Edhe të gjitha të mirat e botës nuk barazohen me vleftën e shpirtit të pavdekshëm. Mos tadhëto, o njeri, thesarin tënd të pa çmushëm për të mira lëndore dhe të përkohëshme.

Për ne Biri i Perëndisë nuk u turpërua të bëhet njëri dhe të varret mbi kryq, si keqbërës. Edhe ne shërbëtorët e Tij të pa vleftshëm turpërohemi të dukemi përpara njerësvet, se adhurojmë emrin e Tij. Ka marrëzi dhe mosmirënjohësi më e madhe nga kjo? Njëres të tille nuk vlerësohen të hyjnë në lavdin e Krishtit.

---

## **E DJELË PAS LARTËSIMIT**

### **FJALIM: për hidhërimin në botë dhe për vleftën e shpirtin**

**"Kush do, që të më vijë prapa, le të mohojë vehten e tij, dhe le të ncrerë Kryqin e tij dhe le të më pasojë",**

Zëri i Krishtit tingëllon qysh prej shekujsh nër zëmrat e njërvet dhe zgjonë ndjenat më të ëmbla dhe vëndimet më të bukura. Asnjë rrugë s' është aq e bukur, sa rruga e Tij dhe asnjë ftesë s' është aq zyrtare, sa ftesa e Tij. Mbretërit urdhërojnë ushtarët që ti pasojnë, por Ay fton dhe nuk urdhëron asnjë, vetëm kërkon që aji i cili dëshironë t' i vejë pas pikë së pari do të mohojë vet-vehten.

Të mohojmë vall shtëpin t' onë, njerzit t' anë dhe çdo gjë që kemi të dashur në këtë botë? Jo, aspak. Do të mohojmë vehten t' onë mëkatore, d.m.th. çdo gjë që na lidhë me jetën e mekatit, çdo send që na largon prej Zotit. Do të hedhim tej mëkatin, siç hedhim tej robën e vjetër për të veshur një të re dhe të pastër. O! sa a bukurë është kjo këshille e Krishtit: "le të mohojmë vet-vehten". Jeta e mekatit është një jetë e mjerë.

Mundet për një moment t' a gënjejë njerinë me premtimin e lumturisë, por e hethë më vonë në baltë.

Por kjo s' ashtë e mjaftë, që njeriu i cili dëshironë të pasojë Krishtin, të mohojë vet-vehten, të pastrojë zëmrën nga çdo ligësi dhe të mveshnjë roben e bardhë të jetës Krishtërore.

Krishti e këshillonë njerinë që të ngrerë edhe një kryq; "dhe le të ngrerë Kryqin e vet dhe le të më pasojë". Është Kryqi i dhëmbjes, i shtërngimevet, i hidhërimevet. Kurrë s' ka rojtur njëri në botë pa provuar hidhërime. Jeta e njeriut është e shoqëruar me vuajte, vobegsi, mjerime, intriga, ndjekje, sëmundje, vdekje. Kush ka ikur nga kjo botë pa marrë plagë? Do t' a kërcënojnë të Krishterin dallgat e jetës. Por it krishteri do të ndjekë rrugën e ngushtë dhe të përpjetë të të drejtëvet e të shënjtoret, në krye e të cilvet qëndron i kryqëzuari. Mirë por pas Kryqit të Golgotha vjenë triumfi i ngjalles. Ata që do të provojnë vuajtjet e hidhura të jetës dhe do të ngjiten bashkë me atë në Golgotan e dhimbjes, dhe do të gëzojnë dhe triumfin e ngjalles dhe shpëtimitin e shpirtëvet të tyre.

Sepse vlera e shpirtit është e paçmuëshme. Këtë na e thotë Zoti në Ungjillin e sotshëm: "çdobi do të këtë njeriu, edhe sikur të fitojë gjith botën dhe humbet shpirtin e tij?" Fituam shpirtin: fituam të gjitha, humbëm shpirtin t' onë, humbëm të gjitha.

Shpirti i ynë është i paçmuarshëm, se është i pavdekshëm.

Shpirti i njeriut me dhurata hyjnore: me llogjikën, lirinë, mëndjen fjalën e tjera, si korë edhe frymën e Perëndisë, që e bëjnë njerin mbretin e gjithësis. Por nga të gjitha këto dhurata pavdekësija është dhurata më e vlerëshme e shpirtit.

Shikoni çbëhet përçark nesh. Gjithë bota thahet e çduket. Çduken të mirat lëndore; madhështija dhe lavdija, gëzimet dhe dëfrimet. Trupi i ynë vdesë dhe ndryshohet në ushqimin e krimbavet dhe në ndyrësirë. Kështu tregohet që në botë të gjitha janë pluhur dhe hije, vetëm nje pasje mbetet e patundur, shpirti i ynë i pavdekshëm. Nuk vdes, sado që vdekja e ndanë nga trupi. Shpirti ronë edhe përtej varrit, rron i pavdekshëm dhe i perjetshëm. Shpirti pra vlen, sa nuk vlejnë gjithë thesarët e botës, si thotë shpëtimtari i ynë, "çdobi do të këtë njeriu, edhe sikur të fitojë gjithë botën dhe humbet shpirtin e tij".

Të krishterë! ç' gjëra na tërheqin dhe na kënaqin në botë? Pasja, bukurija, dëfrime trupore. Jemi pa mënd, se këto nuk janë thesarë të vërteta. Për ne një thesar është i vyer, shpirti i yne i pavdekshëm.

Të përkujdesemi për shpirtin t' onë t' a edukojmë dhe t' a shpëtojmë. Do t' a shpëtojmë kur largohemi nga mekata, kur e dërgojmë në hirin dhe në mëshirën e Krishtit, i cili është shpëtimtari i shpërveve t' ona.

---

## **E DJELË (18) PAS LUKAJT I**

Shpjegim i Ungjillit (Lluk. 5. 1-11)

**"Në atë kohë duke ndënjur lisuj pranë liqenit Gjenisaret, pa dy lundra që rinin pranë buzës së liqenit. Peshkatarët kishin dalë nga ato dhe lamin rrjetat. Edhe ay hyri mbë njërën nga ato, mb' atë që ishte e Simonit, edhe i u lut atij të largonej pak prej tokës. Edhe si ndënji mësonde gjindjen nga lundra".**

Kjo histori që tregohet këtu, u bë përpara se Apostojt të bëhen nxënësit e Krishtit. Në liqen të Gjenisaretit, që quhet dhe deti i Tiberiades, ishin dy lundra, njëra ishte e Simon Pjetrit dhe tjetra e Jakovit dhe Joanit, bijt e Zevedheut. Pa dhe peshkatarët, që kishin dalë nga lundrat dhe po lanin rrjetat.

Zoti i lutet Pjetrit, që t' a largojë lundrën pak nga toka, sepse kishte ardhur një shumicë e madhe njerëzish për të ndëgjuar mësimin e Tij hyjnor dhe e strëngonin.

**"Edhe si pushoi suke folur, i tha Simonit, sill lundrën ndë ujërat të thella edhe hithni rrjetat t' uaj për peshkim. Edhe Simoni u përgjegj e i tha, Mesonjës, gjithë natën u munduamë edhe nuku zumë gje; por për fjalën t' ende do të heth rrjetën".**

Mbasi mbaroi Krishti mësimin e Tij, i thotë Pjetrit. Shpjere lundrën në një vend të thellë të liqenit dhe hap rrjetat për të peshkuar. Kjo tregon, që më parë duhet të mbarojmë punët e Perëndisë, pastaj të kujdesemi dhe për nevojat e trupit. Pjetri i thotë Krishtit, Mësuës, u munduamë gjithë natën, që është koha e përshtatëshme për peshkim, dhe nuk zumë asnjë, por duke u bindur n' urdhërin t' ënd, do të heth rrjetat. Pjetri tregon nderim dhe bindje të lavdëruarshme në urdhërat e Krishtit, sado që s' ishte akoma nxënës i Tij.

**"Edhe si bënë këtë, mbyllinë brënda një shumicë të madhe pishqesh edhe rrjeta e atyrve po çirej. Edhe u bënë me shënjë shokëvet që ishin në lundrën tjetër, që të vinin e t' u ndihnin. Edhe ata erdhën, edhe mbushën të dy lundrat, kaqë, sa ato zunë të fundosëshin. Edhe Simon Pjetri, kur pa, ra ndër gjunjët të Jisujt, duke thënë. Dil prej meje, Zot, sepse jam njeri fajtuer".**

Kur pa Pjetri shumicën e peshqevet, thërriti shokët e tij, të bijt e Zevedheut, të cilët ishin në lundrën tjetër. Ata erdhën për ndihmë dhe mbashën që të dy lundrat me peshqe aqë plotë, sa po fundoseshin lundrat. E kuptoi Pjetri, se ky peshkim kaq i pasur, u shkaktua nga bekimi i Krishtit. Dhe duke kuptuar nga kjo çudi, se Krishti nuk është njeri i thjeshtë, i ra ndër gjunjët duke i thënë. Zot, dil nga lundra e ime, sepse jam njeri mekatar dhe s' jam i vyer të të kem në lundrën t' ime.

**"Sepse habijte e pushtoi atë edhe ata që ishin bashkë me atë, për gjahun e peshqevet që zunë. Gjithashtu edhe Jakovin e Jovanin, të bijt e Zevedheut, të cilët ishin shokë të Simonit. Mos ki frikë, se paskëtaj do të gjuanç njerës. Edhe si suallën lundrat mbë tokët, i lanë të gjitha edhe vanë prapa atij."**

Pjetri u habit për atë peshkim të jashtzakonshëm. Por gjithashtu u çuditën dhe Jakovi e Joani, bijt e Zevedheut. Krishti i thotë Pjetrit, mos ki frikë, sepse tash e tutje do të peshkoç njerës, d.m.th. do të bën apostoll t' im për të peshkuar njerës, të cilët do t' i nxjersh nga errësira e mëkatës dhe do t' i udhëheqësh në të vërtetën dhe në dritën e virtutit.

Nxuarën lundëat në tokë, i lanë të gjitha sa kishin dhe i vajtën prapa Shpëtimtarit.

MËSIMI. - Peshkatari i Math i shpirtvet vjen tek peshkatarët e peshqevet dhe hap rrjetat e Tij, predikimin e fjalës hyjnore. Nuk përdor ndonjë dinakëri për të tërhequr shpirtet në rrjetat e Tij. Në vend të dinakërisë përdor dashurin dhe në vend të forcës përdor bindjen. Kërkon të tërheqë lirisht ate që duanë në rrjetat e Tij dhe t' i u dhurojë të vërtetën, dritën, jetën. Sa shpëtimtare janë rrjetat e Zotit, t' onë Jisu Krishtit.

Mundimet e një nate të tërë kishin mbetur të padobishme për Pjetrin dhe shokët e tij. Prandaj Pjetri dyshon nashti dhe nuk është i gatishëm për të hedhur prapë rrjetat në det. Por me udhërin e Mësonjësit hyjnor vendosi që të provojë prapë. Me të vërtetë shumë herë puna e çdo njeriu mbetet e pafrytëshme dhe pa ndonjë përfundim të mirë. Mundohemi dhe punojmë, por nuk fitojmë. Mundet që mos suksesi të jetë, që të provohet besa e jonë. Mos u dëshpëro pra, o i krishterë, as mos thuaj si Pjetri, se u mundova më të kotë. Hudhi prapë rrjetat e tua; përsërit prapë punën t' ende duke pasur shpresën tek Zoti, i cili është njeridashës dhe i gjithpushtetshëm.

Çudi e madhe! Atë që nuk fitoj Pjetri për gjithë natën, e fitoi në një orë! Mësoi Pjetri dhe shokët e tij, mësojmë dhe ne, se në çdo punë është i domosdoshëm bekimi i Perëndisë. Ku është bekimi i Perëndisë, atje dhe puna e pakët është e mjaftë që të japë prodhime të kënaqëshme.

Shpirt i përulët Pjetri, jo vetëm nuk kryenaltësohet nga çudija e peshkimit, por ahere

më tepër kujtohet, se është njeri mekatar. Prandaj i lutet Shpëtimtarit, që të dalë nga lundra e tij, duke ndjerë, se nuk është i vjer të ketë pranë Mësuesin hyjnor. Të tillë janë ata, që kanë përlulesi shpirti. Sa më tepër mirësira marin nga Perëndia aqë më tepër përlulen dhe kështu tërheqin dashurin e Tij.

Në atë kohë që Pjetri dhe shokët e tij zunë në rrjetat e tyre shumicën e peshqevet, u zunë dhe vetë në rrjeshtat e Krishtit. Mbasi ndëgjuanë mësimin hyjnor dhe mbasi panë provën e fuqis së Tij hyjnore, lanë me kënaqësi punën dhe dorëzohen me gjithë shpirt tek Shpëtimtari Krishti. Nga ajo minutë marin përsipër punën e madhe të peshkatarit të shpirtëvet.

---

## **E DJELË (18) PAS LUKAJT**

### **FJALIM: për punën sipas porosis së Perëndisë**

**"Dhe mbasi hodhën rrjetat, zunë një shumicë të madhe peshqesh".**

Në qoftë se e quajmë Ungjillin burim dhogmash jo vetëm fetare, por edhe shoqërore (sociale), familjare dhe private, nuk do të themi ypërboli d.m.th. një gjë shumë të madhuar.

Ja pjesa e Ungjillit të sotshëm na paraqit mësimë serioze dhe shumë interesante në detyrën e punës. E tërë pjesa qysh në fillim deri në mbarim tregon punë dhe imponon detyrën e punës. Punon Krishti duke mësuar dhe duke këshilluar turmën e njerëzvet. Punojnë Apostojt duke hedhur rrjetat në det. Më parë punojnë Apostojt pa Krishtin dhe, sado që mundohen tërë natën, puna e tyre del pa sukses. Punojnë pastaj bashkë me Krishtin dhe zunë një shumicë të pashpresuar peshqish. «Mësonjes, tërë natën u munduamë dhe nuk zumë asnjë, por me fjalën t' ende do të heth rrjetat». Dhe, o çudi e madhe! zunë një shumicë të madhe, sa mbushën që të dy lundrat.

Ç' na mëson kjo? Që njeriut i imponohet puna, si një detyrë e shenjtë. Jo çdo punë, por punë në Krishtin, e cila është e vetmja punë e shenjtë dhe e bekuar. Për këtë do të bëjmë fjale sot mbi Ungjillin e sotshëm. Cila pra është puna në Krishtin? Cilat janë njohjet dhe fitimet e saj? Nuk duhet filozofi e madhe dhe mendim i thellë, që t' a gjejë njeriu. Ungjilli më një anë dhe ndërgjegja në tjetër anë na thonë, se është:

1. - Puna e ligjëshme.

Pse janë dhe punë të paligjëshme? Po, Janë ato punë, të cilat edhe ligjet e shtetit i ndalojnë dhe i dënojnë, dhe nomi i Perëndisë na këshillon që të largojmë nga ato. Cilat

janë këto punë i dimë që të gjithë. Tregëti me dinakëri, pasuni dhe fitime, që fitohen me padrejtësira, mjeshtëri, ku gënjeshtër kryeson, sipërmarje, ku shtrëngohet i pafuqishmi, libra, ku mburehet demoralizimi, qëndra emër-dobta dhe shpirt-prishjeje, ku shpërndahen të hollat dhe shtazërohet njeriu. Jo, këto nuk janë punë dritë-dhënëse, por janë punë të errëta. Çdo të bëjë i krishteri? Do të pyes Ungjillin, do të pyes ndërgjegjen.

Nuk do të kërkojë punë, që konsiderohet pa tjetër e denjë dhe e nderçme, as nuk do të largohet nga puna me dorë dhe e randë, që konsiderohet e përbuzëshme nga të marrët e botës. (D.m.th. çdo punë, që ushtrohet me drejtësi, është e shënjtë dhe e nderçme për njerin, vetëm disa të marrë konsiderojnë disa mjeshtëri jo të denja për njerin.

I krishteri pra do të gjejë punë sipas nomit të shënjtë, që e do dhe e pëlqen Perëndia. Dhe bëhet ahëre jo vetëm mjek e avokat, profesor e bankier, tregëtar e nënpunës, por bëhet edhe bujk e bari, punëtor e fshesaxhi, kur vetë Krishti punoi që në vogëli pranë mbrojtësit të Zonjës Shën Mëri Shën Josifit dhe Apostojt ishin peshkatarë. I krishteri bëhet mjek i vërejshëm, avokat i sinqertë, tregëtar i nderçëm nëpunës i ndërgjegjshëm dhe punëtor i gatishëm; dhe ushtron punën e tij me drejtësi, nderje, dashuri, sikundër do Perëndia. Sepse e njehë dhe bindet, që ajo punë është e ligjshme dhe pas porosivet të Krishtit.

2. - Punë me lutje.

Sepse i krishteri nuk besohet kurrë vetëm në fuqit e tija, as në zgjuarësin e tij, as në njoftimet dhe në mjetet që disponon, dhe më tepër as në fatin e verbër dhe e pa qenme, por besohet në përkujdesjen, në mbrojtjen dhe në ndihmën e Atit qiellor. E di, se të gjitha të mirat dhe «çdo dhënie e mirë dhe çdo dhuratë e mbaruar zbret që lartazi nga Ati i dritavet». Ç' bën pra? Falet për punën e tij, falet në fillim dhe në mbarim të punës së tij. Falet kur do të hedhë farën dhe kur do të korrin. Falet në fillim për të kërkuar nga i Tërëfuqishmin për dhuratat, që i fali. Gjithë punën e tij, gjithë jetën e tij dhe gjithë mendimet e tija i endë me faljen e tij të përlulët dhe të përzemërte; dhe ahëre nuk punon i vetëmuar dhe nuk venë mundimet e tij të kota. Ka bashkëpunëtor dhe ndihmës Perëndin e tërë pushtetëshme dhe si përfundim ka fryte të pasura. Është punë pas Krishtit dhe:

3. - Punë e bekuar.

Do të pyësnë një punë e tillë nuk del ndonjë herë pa sukses? Po. Është e vërtetë që nga ndonjë herë lejon Perëndia t' iu vijë besatarëvet dëme dhe të shënohen pasuksese dhe prishje ekonomike; por kjo u ngjanë vetëm, kur kthejnë nga udha e Tij dhe kur përziejnë besën me pabesimin dhe drejtësin me padrejtësin. Dhe herë tjetër Perëndia

lejon për të provuar besën dhe durimin e tyre dhe t'iu japë rasë, që virtuti i tyre të japë fruta më tepër. Por regullisht Perëndia bekon punët, që ushtrohen me drejtesi dhe pasohen gjithnjë me falje. Jep i Tërëmiri sa janë të nevojshme dhe të dobishme. Jep pak, sepse të shumtat dëmtojnë shpirtin.

Të kemi ndër mend të pasurin e paravolisë me Llazarin e vobektë, të pasurin të çmendur dhe të pasurin djalosh, që kërkonte të trashëgojë jetën e amëshuar. Që të tre humbën shpirtin e tyre për të hollat. Prandaj jo të shumtat, por sa gjykon Perëndia dhe sa japin fuqit t'ona.

\* \* \*

Punë pra. Puna është nomi i Perëndisë dhe detyrë e shenjtë. «Kushdo në atë që është thërritur». Në mjeshtërin e tij dhe në punën e tij me besë, me zell, me vetmohim, me falje, me nderje dhe me drejtësi. Është puna e jonë pas Krishtit? Ka shikuës dhe mbrojtës Perëndin dhe nuk do të dalë pa sukses. Shëmbullë kemi Pjetrin dhe shokët e tij. Kur punuanë pa Krishtin, nuk zunë asnjë peshk dhe kur punuanë bashkë me Krishtin, mbushën që të dy lundrat.

Pra punë të ligjëshme, punë pas Krishtit, kurrë nuk dialin pa sukses.

---

## **E DJELË (19) PAS LLUKAJT II**

Shpjegim i Ungjillit (Lluk. 6. 31-36)

**"Tha Zoti, sikundër doni, që t'ju bëjnë njerzit, gjithashtu bëni dhe ju atyre."**

Ky nom, i rrënjosur në natyrën e njeriut, është kaqë i drejtë dhe i llogjikshëm, sa s' mund t' a kundërshtojë asnjë njeri. Të sillemi ndaj njerzit me atë mënyrë, sikundër dëshirojmë të sillen dhe ata kundrejtë nesh. Le të bëjmë pra çdo të mirë të tjeret, gjë që dëshirojmë edhe neve të na bëjnë të tjerët. Dhe të largohemi të dëmtojmë të tjerët, sikundër nuk duamë të na dëmtojnë të tjerët.

**"Edhe në daçi ata që u duanë juve, ç' farë hiri kini ju? Sepse edhe fajtorët - duanë ata që i duanë. Edhe ndë u bëfshi mirë atyreve, që u bëjnë mirë juve, ç' farë hiri kini ju? Sepse edhe fajtorët gjith atë bëjnë. Edhe ndë u dhënçi hua atyreve, prej të cilvet shpresoni t' i merni prapë, ç' farë hiri kini ju? Sepse edhe fajtorët u japin hua fajtorëvet, që të marrin prapë një për një"**.

Ç' pagesë do të kini nga Perëndia, kur të dashuroni vetëm ata, që ju dashurojnë? Nuk do të kini asnjë shpërblim, sepse i doni, me qenë se ju duanë. Kështu dashurija e juaj

ka shpërblim dashurin e tyre. Por çdo virtut që pret shpërblimin nga njerzit, s' ka shpërblim nga ana e Perëndisë.

Mëkataret, që rrojnë në mëkatë, dashurojnë ata, që i dashurojnë. Ç' provohet nga kjo? Që e tillë dashuri nuk është virtut, por interes. Prandaj s' ka shpërblim nga ana e Perëndisë. Në këtë mënyrë s' ka shpërblim nga ana e Perëndisë dhe po të bëjmë të mirë atyre që na bëjnë të mirë. Edhe ne dhënçim hua vetëm atyre, prej të cilëve shpresojmë të marrim fitim ase dobi, edhe për këtë gjë s' ka shpërblim nga ana e Perëndisë. Sepse edhe njerzit mëkatarë, të cilët nuk jetojnë pas dëshirës së Perëndisë, edhe ata japin hua me qëllim, që të kenë po atë dobi prej tyre. Këta të mirën e bëjnë jo për dashurin e Perëndisë, por për dobin e tyre.

**"Por doni armiqt t' uaj, edhe bëni mirë, edhe jepni hua, pa pasur ndonjë shpresë më; edhe atëhere paga e juaj do të jetë e shumë, edhe do të jeni bijt e të Lartit. Sepse ay është i mirë mbë ata që nuk i a njohin të mirën dhe mbë të liqt. Bëhi pra të mëshirshëm, sikundër edhe ati i juaj është i mëshirshëm".**

Të dashuroni edhe armiqt t' uaj dhe të jeni mirëbërës dhe të jepni hua pa shpresuar ndonjë dobi. Vetëm e tillë dashuri dhe mirëbërësi ka vlerë përpara Perëndisë. Në këtë rasë do të merni shpërblim të math dhe të përjetshëm nga ana e Perëndisë, e cila do t' ju shpërblejë në qiell. Do të bëhi kështu imituës dhe bij i të Lartit. Sepse Perëndia dashuron dhe është mirëbërës jo vetëm kundrejt të mirëve, por edhe kundrejt të liqvet dhe mosmirënjohësve.

Plotë dashuri për të afërmin. Perëndia nga natyra është i mëshirshëm, por njeriu, në qoftë se dëshiron, bëhet i dhimsur dhe i mëshirshëm me ndihmën dhe hirin e Perëndisë. Sepse njeriu pa hirin dhe pa ndihmën e Perëndisë nuk mund të bëhet i mëshirshëm. "Pa mua - tha vetë Krishti - nuk mund të bëni gjasendi". (Joan 15.5).

MËSIME. - Për të afërmin na porositi Zoti të kemi sjellje barazimi dhe drejtësi. Çdo gjë që dëshirojmë të na bëjnë të tjerët, duhet edhe ne t' u bëjmë atyre. S' ka më të drejtë nga kjo gjë. Në qoftë se dëshirojmë të na bëjnë të mira dhe të mos na bëjnë ndonjë të keqe dhe të pa pëlqyer, ahëre duhet të këtillë sjellje të tregojmë edhe neve kundrejt atyre. Është sjellje drejtësi dhe barazimi.

S' ka vlerë ndaj Perëndija dashuria dhe mirësija, që bëhet për të pritur shpërblim nga ana e njerzvet. Në qoftë se jep për të marre, në qoftë se dashuron që të dashurohesh, atëhere more prapa çdo gjë që bëre dhe kështu është sikur nuk bëre gjë. Në qoftë se dashuron dhe bënë të mira pa pritur shpërblim nga ana e njerzvet, atëhere këto të mira mbeten të pa shpërblyera dhe quhen si hua, që i a ke bërë Perëndisë dhe ke për të marrë shpërblim të pasur në jetën e ardhme nga ana e Perëndisë.

Dashuri për armiq! Ja heroizëm në të cilën na thërret Zoti. Ay që dashuroi armiq e Tij dhe duroi vdekje për ata, kërkon edhe nga ana jonë dashuri për armiq t' anë. Kjo dashuri është sakrifica më e madhe për të afërmin, vepra më e naltë imitimi të Shpëtimtarit. Dashuri kundrejt armiqvet do të thotë zemërgjërësi, butësi, mirësi dhe përlësi, të vjera përpara Perëndisë për shpërblim dhe lavdërim.

Kjo porosi e lartësoi mësimin Ungjillor dhe këtë porosi admiruan paganët. Asnjë ligjëvënës para Krishtit nuk mësoi, që duhet t' i duamë dhe t' u bëjmë të mira armiqvet t' anë. Edhe Moisiu i porositi Judhenjt "sy për sy" dhe "dhëmbë për dhëmbë", d.m.th. Israilitët të hakmarrin dhe të urrejnë armiq e tyre.

Porosija e Krishtit, që të duamë armiq t' anë, po të zbatohet, pushon të gjitha të ligat në botë, bije paqen e qiellit mbi dhé edhe e ndryshon dheun në qiell. Kjo porosi e ngrëhë njerin në lartësitat e përsosunis dhe e bën njerin një me Perëndin, e cila "lind diellin mbë të liqt dhe mbë të mirët dhe dërgon shiun mbë të drejtët dhe të padrejtët".

Ati ynë qiellor është i tërë mëshirë, dashuri dhe dhimsuri. Në qoftë se duamë të bëhemi bijt e Tij, s' ka tjetër mënyrë më të sigurtë se të bëhemi edhe neve plotë me mëshirë, dashuri dhe dhimsuri.

---

## **E DJELË (19) PAS LLUKAJT II**

### **FJALIM: Për dashurin kundrejtë armiqve**

#### **"Por duani armiq t' uaj".**

Dashuri, që nuk kufizohet vetëm në miqt dhe farosë, por zgjatet dhë në armiq dhe kundërshtarët, është me të vërtetë hyjnore dhe dashuri e përmbibotëshme. Këtë dashuri tregoi i Tërëmiri për neve njerzit. Këtë tregoi Zoti ynë Jisu Krishti për ndjekësit, që e kryqëzuanë. Këtë dashuri kërkon dhe nga neve pasonjësit e Tij, sepse erdhi të sjellë mbretërin e Perëndisë mbi dhé, të zhdukinj armiqësin, të zbutinj zemrat dhe t' i bëjë njerzit t' i përgjanjë Perëndisë. Erdhi të vizojë një jetë të re mbi dhé, jetë perfeksioni krishtere dhe dashurije, dhe për këtë përsosuni na cakton dashurin me armiq t' anë. "Por duani armiq t' uaj" udhëron Shpëtimtari, dhe në duamë të jemi të Tijt dhe të pasojmë besnikërisht shëmbullën e Tij duhet të duamë armiq t' anë.

#### I

Po qysh t' i duamë? Trifishë detyrë përmban dashurija për armiq. 1. - Mos të hakmarim.

Me të vërtetë, na dëmtojnë, na bëjnë padrejtësira, na intrigojnë dhe na kallzojnë me të të rremë. Ç' ndjenjë lind në shpirtin t' onë? Lind ndjenja e hakmarrjes. Zjen pasioni i egër në thellësinë e shpirtit t' onë dhe kërkon, që t' ia shpërblejmë të ligë për të ligën, padrejtësi për padrejtësin "sy për syrin dhe dhëmb për dhëmbin". Kërkon t' a heqim nëpër gjykatoret, t' a goditim, t' a bëjmë të përqeshet armiku i ynë. Kjo gjë na duket e natyrëshme dhe këtë hakmarje e gjejmë të drejtë. Por dashuria krishtere na e ndalon dhe Apostol Pavli na porositi "mos t' i bëjmë asndonjërit të ligë për të ligën". Çdo të bëjmë pra? Do të mbytim pasionin, do të shuajmë armiqësin, do të përmbajmë gjuhën dhe do të ndiejmë me gjith zemër dhe shpirt armikun kundërshtar. Do t' a ndiejmë më gjith zemër dhe shpirt, sado e madhe qoftë e liga që na ka bërë. Por do të qëndrojmë gjër këtu? Jo, duhet:

2. - T' i u bëjmë të mira armiqvet t' anë.

Dashuria s' është mohuëse (negative), por edhe pòhuëse (pozitive). Davidhi në një psalm thotë, "hiq dorë nga e liga dhe bëj të mirën". Duhet t' u bëjmë të mira armiqvet t' anë. Kur vuajnë dhe ndodhen në shtrëngime, kur s' kanë dhe gjenden në rreziqe, kur kanë zi dhe qajnë, me një fjalë kur ndodhen në nevojë, mos të presim ahëre të vijnë ata tek neve, të gjuhëzojnë përpara nesh dhe të kërkojnë përkrahjen dhe ndihmën t' onë. Shpirt-madhësija e kërkon që neve vetë t' i u vemi shpejtë dhe të vet-shtytur për të plotësuar nevojat e tyre dhe t' i nxjerrim nga gjendja e vështirë. T' i ndihmojmë, t' i ngushullojmë, të marrim përsipër mbrojtjen e tyre. Këtë na e thotë Krishti, "bekoni ata që u mallkojnë, bëni të mira atyre që ju urrejnë".

3. - Do të falemi për armiq t' anë.

Mos nuk e bëri Krishti mbi Kryqin e T'ij? Mos nuk na porositi, "faluni për ata që ju dëmtojnë dhe ju ndjekin"? Po, do të falemi për ata dhe do t' i lutemi Perëndisë, që t' i u japë pendim, që të marin ndjesë për të ligën që na bënë, që t' i udhëheqë Perëndia në udhën e shpëtimit, që t' i u japë të mirat e T'ij pasurisht në këtë botë dhe shpëtimin e shpirtit të tyre në jetën e arthme. Këjo është dashuria për armiq të edhe kjo është detyra e jonë, sikurse e porositi dhe e zbatoi Krishti.

## II

Po është e lehtë të ushtrojmë këtë dashuri dhe të sillemi kaqë të butë kundrejtë armiqvet t' anë? E pohojmë që është shumë e vështirë, më tepër kur mërija pushton zemrën t' onë. Valët e pasionit të zemëratës mbytin logjikën. Por edhe ahëre mund të përmbajmë vehten t' onë duke kujtuar dy gjëra:

1. - Shëmbullën e Atit t' onë qiellor.

S' kemi vetëm neve armiq, edhe Perëndia ka armiq. Sepse ne mëkatarët jemi armiq e Tij, sado që na ka bijt e Tij dhe neve e kemi At. Bëhemi armiq e Tij, kur e fyejmë, kur e blasfimisim, dhe kur nuk plotësojmë nomin e Tij, kur shkelim porosit e Ungjillit. Sa mëkata nuk bëjmë përpara Tij dhe sa herë nuk është e drejtë të bjenë mbi neve rufet e zemëratës së Tij? Por nuk e bënë, nuk na dënon, nuk na shpërblen me të këqija për ligësitat t' ona. "Lind diellin e Tij për të mirët dhe për të liqt dhe dërgon shiun për të drejtët dhe të padrejtët" d.m.th. na ndjen dhe na dhuron të mirat e Tij. E pra, kjo shëmbullë e Atit t' onë qiellor duhet të na regullojë ndjenjat t' ona kundrejtë armiqvet t' anë.

2. - Interesi i ynë lëndor dhe shpirtnor.

Po të hakmarim dhe të shpërblejmë të ligën me të liga, do të formojmë armiçësira të rea, që shkakëtojnë frikëra dhe rreziqe. Por në qoftë se u bëjmë të mira armiqvet t' anë, pa dyshim fisnikëria dhe shpirt-madhësija e jonë i çarmatos dhe bëhen miq të dashur dhe mirnjohës.

\* \* \*

Vlezër. Dashurija për armiq është më i larti virtut krishtëror. Kjo dashuri do të na tregojë bij të Perëndisë. Kjo dashuri do të tërheqë dhe armiq t' anë në pendim dhe në ndreqje. Kjo dashuri do të na lartësojë në qiell, që të na dhurojë të mirat e pavdekëshme të dashurisë hyjnore, mbretërinë e Perëndisë dhe jetën e përjetëshme. Amin.

---

## **E DJELË (20) PAS LLUKAJT III**

Shpjegim i Ungjillit (Lluk 7. 11-17)

**"Në atë kohë, vinte Jisuj ndë nje qytet që quhej Nain. Edhe vinin bashkë me atë edhe mjaftë nga nxënësit e tij edhe shumë gjindje. Edhe kur u afërua ndë portët të qytetit, ja tek sillnin përjashta një të vdekur, të cilin e ëma e kishte bir të vetëm, edhe ajo ishte e ve; edhe shumë gjindje prej qytetit ishte bashkë me atë".**

Qyteti Nain ishte afër malit Thavor. Kur doli Jisuj nga qyteti Kapernaum, ku kishte shëruar shërbëtorin e kryeqintësit, po shkonte në qytetin Nain. Prapa Krishtit po vinin shumë nga nxënësit e Tij dhe një shumicë njerzish. Nxënës kupton këtu jo vetëm të dymbëdhjetë Apostojt dhe të shtatdhjetë nxënësit, të cilët i dërgoj më pastaj për të

lëçitur, por edhe ata besatarë që vinin prapa Shpëtimtarit dhe ndëgjonin me respektim mësimin e Tij.

Israilitët i kishin qimitiret jashtë qytetit dhe atje varrosnin të vdekurit. Kur u afërua Krishti në hyrjen e qytetit, nxiresh nga qyteti për varrim një i vdekur, që ishte djal i vetëm i një nëne së vé. Prapa të vdekurit po vinin dhe shumë njerës. Ky zakon që të venë prapa të vdekurit, vazhdon gjer më sot dhe është shënjë dashurije, sepse me këtë njerëzit e të vdekurit ngushullohen dhe i vdekuri nderohet.

**"Edhe Zoti kur pa atë, i erdhi keq për atë dhe i tha asaj, mos qaj. Edhe u afërua dhe zuri shtratin; edhe ata që e mbanin qëndruanë. Edhe tha, djalosh, po të them, ngreu. Edhe i vdekuri u ngrit e ndënji edhe zuri të flasë edhe i a dha s' ëmës".**

Krishti u mallnjye, kur pa që po vajtonte e ëma për vdekjen e birit të saj. Më parë e ngushulloi me fjalët «mos qaj», pastaj vendosi t' i a japë të birin e saj të gjallë. Preku me duart e Tij shtratin e të vdekurit dhe ata që e mbanin qëndruanë. Urdhëron Krishti të vdekurin, që të kthehet prapë në jetë dhe urdhëri i Tij hyjnor plotësohet at çast. Erdhi në jetë prapë i vdekuri, ndenji në shtrat dhe zuri të flasë.

**"Edhe të gjithëve u hyri frikë, edhe lavdëronin Perëndin duke thënë, se profit i math është ngritur ndër ne edhe se Perëndia vizitoi popullin e tij".**

Lavdëronin Perëndin dhe thoshnin, se u duk profit i math midis tyre, sepse nuk e dinin hyjnin e Tij. Perëndia vizitoi popullin e Tij me anën e Krishtit.

MËSIMI. - Plotë me dashuri Zoti njeridashës u interesua për gruan e mjerë, e cila vajtonte për vdekjen e birit të sajë. Nuk mbet i pa interesuar Zoti për ata që ndodhen në shtrëngime. Jo vetëm sympathizonte në hidhërimet e njerësvet, por shpëtonte edhe shumë nga hidhërimet, për të na mësuar kështu, se Ay erdhi të çdukinj çdo hidhërim dhe të vërë paqe dhe gëzim në shpirtet e njerësvet.

E veja e Nainit ishte pushtuar nga një zi e madhe. E vé nga burri pasonte nashti vdekjen e birit të saj të vetëm. Por Zoti që merr përsipër nënë mbrojtjen e Tij të vejat dhe jetimët, tregon dhe nashti mbrojtjen e Tij për këtë grua të mjerë, e cila qan dhe vajton. «Mos qaj» i thotë asaj. Mos qaj, sepse unë jam burimi i gëzimit dhe dhuruësi i paqes.

«Djalosh, ty të them, ngreu». Duket sikur Zoti flet me një njeri, i cili është në gjumë. Por ç' është vdekja përpara fuqis së Tij hyjnore? Në qoftë se me një zë zgjuajmë një njeri në gjumë, Zoti me lehtësi të madhe mund të thëresë prapë në jetë një të vdekur.

Sepse Ay është zotnuësi i jetës dhe i vdekjes, Zoti i të vdekurvet dhe i të gjallëvet. Ay është burimi i pavdekësis dhe i jetës.

Porsa ndëgjoi urdhërin e Shpëtimtarit, djaloshi i vdekur u kthye në jetën. Ligji i përgjithshëm i vdekjes u praps në dëshirën e Atij, i cili dha jetën në fillim dhe i cili lejoi vdekjen tek njeriu që mekatoi. Sikundër ngjalli birin e gruas së vé, kështu ka për të ngjallur një ditë të gjithë të vdekurit në një jetë të re, të pa prishur dhe të pa vdekur.

Frikë pushtoi ata qi panë çudin e madhe te ngjalljes së të vdekurit. E këtillë frikë duhet të hyjë dhe në shpirtet t' ona, frikë përpara pushtetit hyjnor dhe fuqis së Shpëtimtarit. Sepse, në qoftë se ngjallë të vdekurit dhe dhuron jetën, po Ay ashtu me fuqin e Tij do të dorëzojë ne prishje të përjetëshme, ata që rrojnë në pa frikësi të ligjit të Tij dhe shkelin porosit e Tij.

---

## E DJELË (20) PAS LLUKAJT III

### FJALIM: Për ngushullim në vdekje

#### "Mos qaj"

«Mos qaj» i tha Zoti njeridashës s' ëmes së mjerë të Nainit, e cila përcillte djalin e saj të vetëm në varr. Po qysh mos të qajë? E kishte mbështetje të vetme pas vdekjes të burrit saj. Priste ditën t' i rritesh djali i saj, t' i bëhesh mbrojtës i shtëpis së saj, dritë dhe gëzim të jetës saj të shumë-vuajtur. Por nashti ëndërrat dhe shpresat e saj humbasin. Qysh mos të vajtojë për mjerimin e saj të math? Me gjithë këtë duhesh të pushojë vajtimet e saj dhe të ngushullohesh, sepse kishte pranë Krishtin, i cili është jeta dhe drita e njerzvet dhe i cili është ngjallja e të vdekurvet. Dhe prandaj «mos qaj» i thotë Zoti.

Por edhe për neve kështu na thotë Zoti, kur vdekja e pamëshirëshme hynë në shtëpin t' onë dhe na rrëmben të dashurin t' onë. O! ahëre kush mund të masë dhimbjen t' onë dhe rënkimet e zemrës s' onë. Ahëre pra na thotë dhe neve Shpëtimtari me mësimin e Tij mos qani dhe mos hidhërohuni. Dhe duhet të mos qajmë dhe të vajtojmë me dëshpërim, por duhet të përcjellim të dashurit t' onë në varret me durim krishtëror, sepse:

1. - Vdekja nuk është humbje.

Pse qajmë për vdekjen e të dashurve dhe vajtojmë pa ngushullim? Sepse pandehim, se humbi përgjithnjë vllaj i ynë. Por kjo s' është e vërtetë. E vërteta që na siguron Zoti

është, se përtej varrit zgjatet një jetë tjetër, një jetë e përjetëshme dhe e lumtur, ku nuk ka dhimbje, as renkime, por vetëm prehje dhe lavdi e lumtëri. Në atë jetë pra venë të dashurit t' anë. Psa pra, qan për lumtërin e djalit t' ënd? Vajton ti nashti, se ay gëzon dhe prehet? Por ndofta thua, ishte para kohe vdekja e tij dhe iku shpejtë nga kjo botë. Po. Por merr parasysh, se shpëtoi nga vuajtjet dhe nga shtrëngimet dhe hyri në pavdekësi dhe siguri. Po, në siguri, se është rrezik të mbetemi në këtë botë, rreziku i mekatës, e cila vdekëson shpirtin e pavdekshëm. O! sa shpejtë tërhiqemi të gjithë në mekatë. Por pas vdekjes s' është ky rrezik, sepse në atë jetë pranë Perëndisë s' ka botë të ligë. Në qoftë se vdiq i dashuri yt, le të jetë ngushëllimi yt, se nuk do t' a shofish të ndryshojë rrugë dhe të bëjë mekata. Vdekja krishtërore është sigurim dhe jetë dhe lumtëri e përjetëshme.

2. - Vdekja është një ndarje e përkohëshme.

Qajmë ashpërisht dhe me dëshpërim, sepse vdekjen e pandehim humbje dhe nuk do t' i shikojmë mâ përgjithnjë. Por vdekja është një ndarje e përkohëshme. Sikundër erdhi vdekja për të dashurin t' onë, kështu do të vijë vdekja dhe për neve në kohën e caktuar. Edhe neve do të ikim nga kjo botë e përkohëshme. Do të udhëtojmë në qiejt, që është atdheu i ynë i vërtetë dhe i qëndruarshëm, ku do të gjejmë dhe neve gëzimin, sikundër e gjetën ata më parë; ku do të gjejmë Perëndin, Atin t' onë qiellor; ku do të gjejmë të dashurit t' anë, që ikën para nesh. Do t' i gjejmë të gjithë, prindër dhe vëllezër, djemt dhe miqt, që të rrojmë së bashku të pandarë mâ në jetën e pa sosur. Pse të qajmë pra me dëshpërim, si të ishim të pabesë, të cilët s' kanë shpresë? Por edhe tjetër duhet të marrim parasysh, që të mos na tërheqin valat e hidhërimit, që:

3. - Vdekja është gjumë.

Gjumë jo për shpirtin, i cili edhe pas vdekjes rron dhe ndjen. Vdekja është gjumë për trupin t' onë lëndor, që pas vdekjes kalbet dhe tretet. Por sikundër pas dimrit vjen prandvera, kështu dhe pas tretjes vjen ngjallja. Këtë na e thotë simboli i besës s' onë, që është dhogmë kryesore, «pres ngjalljen e të vdekurvet». Këtë na e siguron vetë Krishti, «ay që beson tek mua, edhe në vdektë do të rrojë». Prapë na thotë, «që do të vinjë një orë, kur të vdekurit do të ndëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë, dhe ata që do të ndëgjojnë do të rrojnë». Do të bëhet pra ngjallja e të vdekurvet dhe do të zgjohet trupi nga gjumi i gjatë me fuqin e Krishtit. Do të ngjallet trupi me nderje, që të rrojë me shpirtin jetën e përjetëshme.

\* \* \*

Vllezër. Është e natyrëshme, që të qajmë për vdekjen e të dashurve, por me një farë kufi. Por vajtimet e dëshpëruara dhe hidhërimin i pakufishëm s' kanë hije për

pasonjësit e Krishtit. Detyra e jonë krishtërore është kjo. Përpara se të vijë vdekja e të dashurit t' onë dhe trupi i tij të vdekësohet, t' a përgatim atë për udhëtimin e gjatë. T' a përgatim me pendim, rrëfim dhe me kungimin e Trupit dhe të Gjikut të Zotit t' onë Jisu Krishtin dhe të shkojë me shpirt të pastër në mbretërin e qiellit. Vdekja e të dashurvet t' anë të bëhet burim mësimi, që të na ngrerë nga gjumi i mëkatës dhe të na largojë nga kotësit e botës dhe të na sjellë në pendim. Në këtë rasë vdekja, sado e ashpër dhe e pa pritur që të na sulet, është një triumf, ku do të mbretërojë gëzim dhe paqe.

---

## **E DJELË (21) E ATËRVET TË SHËNJTË PAS LLUKAJT IV**

Shpjegimi i Ungjillit (Lluk. 8. 5-15)

**"Tha Zoti këtë paravoli. Dolli mbjellësi të mbillte farën e tij. Edhe ay tek po mbillte, ca ra pranë udhës, edhe u shkel, edhe shpezet e qiellit e hëngrën. Edhe tjetër ra mbi gur, edhe posa mbiu, u tha, sepse nuk kishte lagësirë. Edhe tjetër ra në mest të drizavet, edhe si mbinë drizat bashkë me atë, e mbytnë. Edhe tjetër ra mbë dhe të mirë, dhe si mbiu, dha pemë për një njëqint".**

Dolli bujku dhe mbolli farën e tij. Bujku është Zoti i ynë Jisu Krishti, i cili u bë njeri për neve për të lëçitur mësimet e shpëtimit. Pastaj dërgoi lëçitës të Ungjillit Apostojt, Jerarkët e shenjtë dhe Mësonjësit hyjprurës dhe çdo tjetër lëçitës besëmirë të fjalës së Zotit.

Një pjesë e farës ra pranë udhës, të cilën e shkelën ata që shkojnë udhës dhe e hëngrën zogjët e qiellit, prandaj s' biu fare. Një pjesë tjetër ra në gurishte, që s' kishte shumë dhe; prandaj në këtë vënd biu fara, por pas puk u tha, sepse s' kishte lagësirë që të zhvillohesh.

Një pjesë tjetër ra mbi drizat dhe, me qënë se u rritën edhe drizat bashkë me farën, e mbytnë farën dhe nuk e lanë që të japë prodhim.

Ajo farë që ra në tokë të mirë, prodhoi një qintfish.

**"Edhe nxënësit e tij e pyetën, duke thënë. Çdo të jetë kjo paravoli? Edhe ay u tha, juve u është dhënë të njihni fshehtësit e mbretëris së Perëndisë; po të tjeret me paravoli, që duke parë të mos shohin dhe duke ndëgjuar të mos kupëtojnë".**

Apostojt e pyetën veçanërisht Krishtin, ç' kuptim ka kjo paravoli? Krishti u tha. Juve është dhënë hiri i math nga Perëndia, që të dini të vërtetat e nalta dhe mysteret e mbretëris së qiejvet, sepse kini zemër që pranoni. Por të tjerët nuk marin dhe nuk pranojnë të vërtetën. Prandaj atyre u flas me paravolira, mbasi sado që shohin me syt e trupit, dhe nuk shohin me syt e trupit, dhe nuk shohin me syt e shpirtit; por nuk dëgjojnë paravolin, kuptojnë pjesërisht të paktën kuptimin e saj. Sepse, në qoftë se u them çveshur të vërtetën, ata nuk do t' a kuptojnë dhe nuk do t' a pranojnë dhe ahëre dam i tyre do të jetë i math.

**"Edhe paravolija është kjo: Fara është fjala e Perëndisë. Ato që ranë udhës, janë ata që ndëgjojnë; pastaj vjen djalli, dhe ngreh fjalën prej zemrës s' atyre, që të mos besojnë e të mos shpëtojnë".**

Udha është vend i shkelur dhe i ashpër dhe, me qënë që s' ka garth, udhëtarët shkojnë lirisht përmes saj. Prandaj fara s' mund të hyjë në të tillë vend të ashpër, por mbetet në sipërfaqen, ku shkelet prej udhëtarvet dhe hahet prej shpezëvevet. Udha pra symbolizon ata njerës, të cilët nga shkaku i pabesimit dhe të mëkatës kanë zemrën të ashpër, që s' pranoni të vërtetën. Prandaj fjala e Perëndisë nuk hyn në të tillë shpirt. Por edhe në qoftë se bënë ndonjë përshtypje të mirë fjala e Perëndisë, ahëre djalli çduk këtë përshtypje dhe humbet prodhimin e fjalës hyjnore, sepse mëkatat dhe papendimi kanë hyrë thellë në shpirtin e tyre.

**"Edhe ato mbi gurt janë ata, të cilët, kur ndëgjojnë, me gëzim e presin fjalën; por këta s' kanë rrënjë, sepsë ata besojnë për ca kohë, po ndë kohët të ngasjes hiqen lark. Edhe ajo që ra ndër drizat, këta janë ata që ndëgjuanë, por nga kujdesjet e nga pasja e nga kënaqjet e kësaj jete mbyten dhe nuk bëjnë pemë. Edhe ajo që ra ndë dhe të mirë, këta janë ata që ndëgjuan fjalën, edhe e mbajnë ndë zemër të mirë e të qëruar edhe bëjnë pemë më durim. Duke thënë këto thërriste, kush ka veshë për të ndëgjuar le të ndëgjojë".**

Toka gurishte symbolizon njerzit, të cilën në një pjesë të vogël pranojnë të vërtetën, por janë të pushtuar prej pasionesh të mëdhenj, që ngjajnë si gurë në shpirtin. Prandaj të tillë, kur ndëgjojnë fjalën, e pranojnë me gëzim. Por kur ngjan ndonjë ngasje dhe ngrihen pasionet në shpirtin, tërhiqen nga pasionet dhe largohen nga e vërteta.

Toka me driza symbolizon njerzit, të cilët janë pushtuar nga dëshirat e jetës, nga argjendahsja dhe nga kujdesjet e rrojtjes. Këta nuk vënë në veprim fjalën e Perëndisë, prandaj nuk prodhojnë pemët e virtutit.

Toka e mirë symbolizon njerzit, të cilët pranojnë fjalën e Zotit dhe e mbajnë në shpirtin e tyre dhe zbatojnë porosit e Perëndisë. Këta e shkojnë jetën e tyre me durim

në çdo shtrëngim dhe kështu prodhojnë pemë të pasura në virtut. Kush ka veshë d.m.th. kush është gati të mësojë të vërtetën, le të ndëgjojë fjalët e mia dhe le t' i mbajë në shpirtin e tij.

MËSIME. - Puna kryesore e bujkut është mbjellja e tokës. Edhe bujku qiellor punë kryesore ka, që të fjalën e shpëtimit në shpirtet e njerëzvet. Mbjell Zoti të vërtetën në çdo shpirt me mjete dhe rasa të ndryshme. Kur do të vinjë dita e madhe e korrjes, ahëre do të kërkojë nga çdo shpirt pemët nga fara e së vërtetës, që ay mbollë dhe shpërndau.

Çdo shpirt s' mund të pranojë farën e së vërtetës. Varret në vullnetin e lirë të njeriut, që t' a bëjë shpirtin e tij të pranojë, ose mos të pranojë fjalën e së vërtetës. Prandaj ndodhen shpirtet që pranojnë të vërtetën dhe kështu prodhojnë pemë; por ndodhen dhe shpirtet, që s' pranojnë të vërtetën dhe përgjajnë me udhë të shkelur, ose tokë gurishte dhe me driza.

Fara hyjnore, fjala e Perëndisë, ka vetiu fuqi dhe gjallni të çuditëshme, që mjafton të prodhojë pemë të pasura të virtutit. Sikundër farët bimore përparojnë vetëm në tokë pjellore, kështu dhe fara e fjalës së Zotit përparon në shpirtet, që kanë mundësi t' a pranojnë. Prodhon më shumë ose më pak simbas dashjes së njeriut dhe simbas punimit, që bën çdo njeri në shpirtin e vet.

Një arë po t' a lemë pa garth, që t' a shkelin udhëtarët lirisht dhe të pa punuar, ahëre kjo arë në udhë është e pamundur të punohet dhe të prodhojë. Kështu dhe një shpirt bëhet në të tillë gjendje i shkelur dhe i pa mundur të pranojë fjalën e shpëtimit, sepse la njeriu atë të pa ruajtur nga çdo mëkatë, të lirë nga çdo veprim të armikut djallit dhe nga influenza e njerzve të liq.

Shumë shpirtet i përgjajnë tokës me gurë dhe driza. Gurët dhe drizat e mbytin farën dhe nuk e lënë të prodhojë. Kështu edhe në një shpirt, në të cilin lihen të pa luftuar pasionet dhe nuk çrënjosen drizat e kujdesjevet të jetës, e dashuris së pasjes dhe së dëshiravet të botës, nuk mund fara e fjalës së Perëndisë të prodhojë pemë.

Duhet të kemi hapur veshët e shpirtit, që të ndëgjojmë dhe të pranojmë të vërtetën. Do, o i Krishterë, të prodhosh pemët e virtutit shpëtimtar e të përjetshëm? Hapë veshët e shpirtit, ndëgjo fjalët e Zotit me besatari dhe nënështro vehten në porosit e fjalës së Zotit.

---

## **E DJELË (21) PAS LLUKAJT IV E ATËRVET TË SHENJTË**

**FJALIM: Për nevojën e fjalës së Perëndisë**

**"Dolli mbjellësi për të mbjellur farën e tij"**

Në të Djelën e sotme të Atërvet të Shenjtë të Synodhit ekumenik të VII, Kisha e jonë e Shenjtë këndon paravolin e kujkut që mbjell. Një regullim shumë i mirë; sepse kaqë paravolija, sa dhe kujtimi i Atërvet, po atë çështje theksojnë. Nevojën e fjalës së Perëndisë. Edhe Zoti në paravolin e sotshme prezantohet si bujk dhe mbjellës, i cili "dolli për të mbjellur farën e Tij" dhe mbjell në të djathtë e në të majtë në arën e shpirtëvet njerëzore Fjalën e Perëndisë. Por ç' ishin dhe Atërit e Shenjtë të Kishës s' onë? Ishin lëçitës dhe mbjellës, të cilët duke imituar Kirshtin dhe Apostojt, si pasardhës të tyre të vërtetë, mbuallën dhe ata me radhë dhe predikuanë fjalën e Perëndisë. Por pse kaqë me shumicë mbuallën? Sepse ishte nevojë e madhe dhe e ngutëshme. Ishte nevojë të mbillesh dhe të mbillet në gjithë brezat e njerzvet fjala e Perëndisë. Dhe përse është e nevojëshme fjala e Perëndisë do të bëhet sot fjalë.

### I

Me të vërtetë është e nevojëshme për njerin fjala e Zotit, sepse:

1. - Është dritë e shpirtit, dritë hyjnore dhe qiellore.

Është e mundur të rrojë, të punojë dhe të përparojë njeriu pa dritë? Është e pamundëshme? Prandaj edhe kur mungon drita e djellit e natyrëshme, njeriu vë në veprim dritën mjeshtërore të shpikjevet. Kështu edhe shpirti është i pamundur të rrojë, kur mungon drita e fjalës së Zotit. Po, kur mungon fjala e Zotit dhe lëçitja e Ungjillit, ahëre mbretëron errësisë dhe pabesim dhe djalli triumfon. Shikoni ç' bëhet sot? Kaqë dituri dhe përparim, por aqë edhe ligësi e mëkatë. Nuk njohin njerëzit Krijuesin e tyre hyjnor, as misionin e tyre të lartë, as qëllimin e jetës së tyre të shenjtë. Përse? Sepse nuk dinë fjalën e Perëndisë dhe ligjin e Tij. Por ligji i Tij është dritë, sikundër thoshte profiti "ligji i yt është lihnar në këmbët e mia dhe dritë në rrugët e mia". Është dritë dhe ndriçon prapa dhe na tregon Krijuesin hyjnor. Ndriçon përpara dhe na çfaq misionin t' onë të lartë. Ndriçon poshtë dhe na zbulon kotësi të gjëravet të dheshme. Ndriçon lartë dhe na dëftën jetën e pavdekëshme të qiellit. Ndriçon në të majtë që të shikojmë mëkatën dhe armikun e padukshëm. Ndriçon në të djathtë dhe na tregon Krishtin, kryetarin e luftës s' onë, i cili bashklufon me neve, që të mos humbasim në shtrëngimet, të mos frikësohemi në ngasjet, të mos hedhim armët armikut, por të luftojmë trimërisht, të mohojmë të përkohëshmet, të fitojmë të

përjetëshmet. Të gjitha këto vetëm fjala e Zotit i çfaq. Kush pra, që kërkon të vërtetën dhe dëshiron shpëtimin, s' ka nevojë për fjalën e Zotit? Por fjala e Zotit s' është vetëm dritë, por është dhe:

2. - Fuqi dhe jetë shpirtërore.

Prandaj dhe barazohet me farën. Ç' është fara? Është një kokër e vogël dhe pa rëndësi, por mban mbrenda jetën e fuqin. Shikoni-e qysh bin dhe rritet dhe bëhet kalli ose pemë e lartë. Edhe fjala e Zotit këto përfundime ka: mbillet në shpirtet e njerëzvet. Por mjerisht nuk janë gjith shpirtet të pastëri janë disa plotë me gurë të pasionëvet, tjerë mbytyr nga drizat e kujdesjevet të jetës; ka dhe shpirtet të vdekur nga goditjet vdekjeprurëse të mëkatës. Por fjala e Zotit është e fuqishme dhe bën çudira; pijaneci bëhet hesull dhe i urtë, i ndyri bëhet i pastër, zemëraku bëhet i butë dhe lakmuësi bëhet i mëshirshëm. Sa shëmbulla të përditëshme kemi, që vërtetojnë këto. Po kush i bëri këto çudira dhe u dha jetën e pendimit. Fjala e Zotit që është e shenjtë dhe fuqishme. Dhe sa njerës ndodhen në pasione dhe ligësira, për të cilët është e nevojëshme fjala e Zotit, që t' i ndriçojë, t' i rilindin dhe t' i lartësojë nga dheu në qiell.

## II

Por që të prodhojë toka nuk mjafton vetëm të mbillet fara, por duhet dhe toka të pranojë farën. Kështu dhe në fjalën e Zotit, që të shikonjë shpirti dobi dhe të gjejë shpëtim, është nevojë të ketë:

1. - Dijen (gnosin e fjalës e Zotit).

Që t' a dimë fjalën e Zotit duhet t' a studijojmë dhe t' a ndëgjojmë. T' a studijojmë, së është shkruar në shkrimin e Shenjtë dhe është zhvilluar në libra dhe revista fetare. T' a ndëgjojmë në predikimet dhe në udhëzimet e atërvet shpirtënorë dhe në këshillat e njerëzvet pijetozë. Në qoftë se kërkojmë të vërtetën dhe dëshirojmë dritën e shpirtit t' onë, mos të largohemi nga kisha dhe nga predikimet dhe të interesohemi për Ungjillin e Shenjtë. Studim dhe ndëgjim me vërejtje dhe regullisht do të sjell dijen e fjalës së Zotit. Por duhet edhe:

2. - Zbatim dhe përmbushje të porosivet të Zotit.

Sepse mjerë në mbetet dija teori osa fjalë e thjeshtë. Ahere në errësirë do mbeten shpirtet t' ona. Plotësimi do të sjellë edukimin dhe shpëtimin e shpirtit. Prandaj Zoti tha "të lumtur ata që ndëgjojnë fjalën e Perëndisë" edhe "ruajnë atë". Ndofta zbatimi është i lodhshëm, por duhet përpjekje dhe durim.

\* \* \*

Vllezër. Le të mendojmë çdo të ishim sot, në se Zoti nuk na dhuronte fjalën dhe porosit e Tij. Do të ishim të verbër dhe të vdekur brenda në varret e mëkatës. Na bëri i Tërëmiri një mirësi të madhe. Mos të gjejmë gjithnjë shkaqe të qëndrojmë në errësirën, që sjellë mos dija e ligjit të Zotit. Interesi i ynë është të banojë pasurisht fjala e Perëndisë në shpirtet t'ona, që t'a kemi dritë dhe udhëheqës për të vërtetën dhe fuqi në luftën kundër mëkatës dhe ngushullim në shtrëngimet e jetës dhe të na sjellë pas vdekjes në jetën e lumtur të qiellit. Amin.

---

## **E DJELË (22) PAS LLUKAJT V**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 16. 19-31)

**"Tha Zoti. Një njeri ishte i pasur dhe vishesh me porfir dhe rrobe të kuqe duke dëfryer me shkëlqim. Ishte dhe një i vobektë, që quhesh Llazar, i cili ishte vënë afër derës me plagë dhe dëshironte të ginjesh nga thërrimet, që binin tryeza e të pasurit. Por dhe qent vinin dhe lëpnin plagët e tij".**

I pasuri mvishesh me rrobe të çmueshme dhe dëfrente me ngrënje dhe çdo lloj kënaqësirash.

Llazari ishte shtritur afër derës së shtëpis të të pasurit. Ishte mbushur trupi i tij me plagë dhe i urishëm kaq, sa dëshironte të ginjesh me thërrimet, që binin nga tryeza e të pasurit. Nga kjo duket, se i pasuri nuk tregonte ndonjë mëshirë për Llazarin. Qent vinin dhe lëpnin trupin e Llazarin. Nga kjo tregohet, se Llazari ishte i çveshur, që dukeshin plagët e tij dhe se ishte i pafuqishëm, që nuk largonte dot qent.

**"Vdiq i vobekti dhe engjejt shpunë shpirtin e tij në gji të Abraamit. Vdiq dhe i pasuri dhe u varros. Në ferr i pasuri ngriti syt e tij, duke qenë në mundime, dhe pa që lark Abraamin dhe Llazarin në gjit, afër e tij, dhe thiri: O at Abraam, mëshiro-më dhe dërgo Llazarin, që të ngjyjejë majën e gjishtit të tij me ujë dhe të freshkojë gjuhën t'ime, sepse po vuajnë në këtë flagë. Abraami i tha: Bir, kujto, se ti gëzove te mirat në jetën t'ënde dhe Llazari të ligat; nashti këtu ai ngushëllohet, dhe ti vuan".**

Shpirti i Llazarit vajti në parajsë në gjit' e Abraamit, sepse e shkoi jetën e tij me durim dhe me shpresë te Perëndia.

Shpirti i të pasurit vajti në Ferr, sepse nuk tregoi mëshirë për Llazarin dhe përgjithësisht për të vobektët.

I pasuri kërkon nga Abraami t' i dërgojë Llazarin, i cili, mbasi të lyejë gjishtin e tij me ujë, t' i freskojë gjuhën e tij. Me këto fjalë Zoti tregon, sa të paduruarshme janë vuajtjet në Ferr. O bir, kujto të mirat, që gëzove në jetën e dheshme, pa pasur dhimsuri për të vobektët. Llazari hoqi vuajtjet me durim.

**"Me gjith këtë midis nesh dhe jush është një gropë e madhe, që kështu nuk mundën të shkojnë që këndeje te ju, as ata që andej të vijnë te në. I pasuri tha: Të lutem, o at, që të dërgosh Llazarin në shtëpin e t' im ati, që kam pesë vlezër, që t' i këshillojë, që mos të vijnë dhe ata në këtë vend të mundimit. Adraami i thotë. Kanë Moisin dhe profitët, le të ndëgjojnë ata. I pasuri tha. Jo, at Abraam, në qoftë se ndonjë nga të vdekurit vete te ata, do të pendohen. Abraami i thotë. Në qoftë se nuk ndëgjojnë Moisin dhe profitët, ahëre edhe në qoftë se ngjallet ndonjë nga të vdekurit, nuk do të binden".**

Një gropë e madhe është midis Ferrit dhe mbretëris së qiejvet d.m.th. mëkatarët dhe të drejtët janë të ndarë midis tyre.

MËSIMI. - Edhe lumtërit e kësaj jete dhe kënaqësit, sikundër dhe fatkeqësit dhe mjerimet janë të përkohëshme. I pasuri i paravolis kishte të gjitha të mirat e dheut, por për një kohë të shkurtër, sa kohë të rronte mbi dhe, sepse kur vjen vdekja, të gjitha i lëmë këtu. Edhe i vobekti Llazar kishte mjerime, por vetëm sa kohë rrojti në këtë botë. Prandaj s' është e llogjikëshme as të pasurit t' i quajmë të lumtur për një të mirë kaq të përkohëshme, as të vobektit dhe të mjerët t' i konsiderojmë fatkeq për mjerimin e përkohëshëm në këtë jetë.

Të pasurvet u jep Perëndia pasjen për të bërë vepra dashurije te i afërmi i tij, që kështu të vlerësohet për të mirat në jetën e ardhme. Të vobektëvet Perëndia u lejon vobegsin, që me anën e durimit të fitojnë lumtërin e përjetëshme.

Qysh e përdori pasjen i pasuri i paravolis? Me padrejtësi dhe marrëzi. Njeri i huaj ndaj Perëndia harroi se pasja është dhuratë e Perëndisë dhe kështu e përdori vetëm për mirëshkuarjen e vet dhe për Llazarin dhe për të vobektët aspak nuk u interesua. Llazari besatar te Perëndia i shkoj mjerimet e tij me shpresë dhe me durim. I pasuri u tregua ikonom i lik dhe përdorues i padrejtë. I vobekti u tregua atlet trim dhe durimtar.

Sa ndryshohen konditat në jetën qiellore! I pasuri në botë nashti vuan dhe mundohet në Ferr, kurse Llazari, i mjerë në botë, nashti gëzon në lavdi. Lumtërija e të parit është për pak kohë në botë, por mundimi në qiell është i përjetëshëm. Mjerimi i të dytë është i përkohëshëm mbi dhe, por gëzimi dhe lumtërija është në qiell i pambaruar dhe përgjithmonë. Prandaj me të vërtetë i pasur dhe i lumtur është ay, që do të jetë i pasur

në jetën e ardhme.

Në mbretërin e qiellit s' ka ndreqje, as pendim as ndonjë ndryshim. Gropë e madhe i ndan ata, që janë në Ferr, nga ata që janë në mbretërin e qiejvet; d.m.th. nuk ndryshohet as dënimi i mëkatarvet të papenduar, as lumtëria dhe gëzimi i të drejtëvet. Atje të gjitha janë të qëndruara dhe të pandryshuara dhe të përjetëshme, dhe jo si në këtë jetë, që të gjitha janë të përkohëshme dhe të ndryshueshme.

---

## **E DJELË (22) PAS LLUKAJT V**

Ungjilli Lluk. 16. 19-31

**FJALIM: Për të pasur në kujtim vdekjen.**

**"Vdiq dhe i pasuri dhe u varros".**

Kjo ishte e sigurtë, sado që bëri çdo gjë për të harruar vdekjen. Rrojti si materialisht dhe adhuruës i trupit në gjith jetën e tij i pasuri i Ungjillit të sotshëm. I shpenzoi të hollat e tij në ushqime dhe në llukse dhe nuk bëri asnjë të mirë për shpirtin e tij të mjerë. Këto i bëri, se dëbonte me insistim nga mendja e tij vdekjen. Ideja e vdekjes e ngiste, i mërziste mendimet e tij dhe i përmbyste planet e tij mëkatore. I binte ndër mënd gjykatoren e frikëshme të Perëndisë, ku do të jepte dhe ay llogari të veprave të tij. Të gjitha këto ishin të pakënaqëshme për të pasurin. Vdekjen nuk donte t' a mendonte, që të vinte pendimi në shpirtin e tij; edhe kjo e shpuri në humbje. Të kundërtën bëri i vobekti dhe i shumëvujturi Llazar. Ay rrojti me iden e vdekjes. Në se nuk keqfoli për fqinjën e tij të pasur, në se nuk pati smirë (haset) për të mirat e tij, në se nuk u zemërua kundër Perëndisë, por tregoi në mjerimet e tij durim të çuditshëm, kjo i detyrohet, se kishte ndër mënd vdekjen; edhe kjo e shpëtoi. Kjo e shpuri me përcjellje engjellore në gjirin e Abraamit.

Është e mirë dhe e dobishme të mendojë i kirshteri shumë herë vdekjen. Se ç' do bira sjell kujtimi i vdekjes?

1. - Na shpëton nga kotësija e botës.

Ç' bën kotësija? Na gënjen me fuqin e saj, na tërheq si rrobër me premtimet e saj. Ç' farë kotësi. Pasunira dhe lavdi, lluksi dhe tregimet në mvëshje, dëfrimet dhe dëshirat e mishit. Ç' janë të gjitha këto? Janë tym dhe hije dhe ëndërra, që zhduken dhe gënjejnë. Nuk janë zjarr dhe thikë për shpirtin t' onë të pavdekshëm? Me gjith këtë sa bëjnë njerzit që t' i fitojnë? Vjedhin dhe bëjnë padrejtësira; gënjejnë dhe shpenzojnë kohën e

tyre të vlerëshme të jetës së tyre; shkelin ndërgegjen dhe shesin nderjen e tyre. Ç' them? Edhe shpirtin e tyre shesin të Satanaj për të përmbushur ëndërrat dhe dëshirat e tyre të kota. Ç' barrë do të shërojë të ligën? Ç' frë do të na qëndrojë nga kjo e tatpjetme e dëmëshme: Vetëm kujtimi i vdekjes. Le të kujtojmë vdekjen, kur ngasja pasjes na pushton zemrën, kur manija e lluksit rrobëron vullnetin t' onë, kur flaka e dëshirës trupore ndizet dhe djeg trupin t' one. Ahere le të mendojmë vdekjen, që shpejti a vonë do të na vinjë. Vdekjen që shpërndan pasunit, fishk bukurin, shuan madhështirat dhe dorëzon trupin në prishje dhe në tretje. Dhe kështu shpirti i liruar nga lidhjet e kota, do të mbetet besnik te Perëndia dhe në dëshirën e Tij. Ja dobija e parë nga kujtimi i vdekjes.

2. - Na ngushëllon nga shtrëngimet e jetës.

Vobeksi dhe mjerime, uri dhe mungesë, ndjekje dhe kallzime, sëmundje dhe vdekje, janë shokët e pandarë të jetës s' onë. Sa dhimbje, sa agoni, sa dëshpërim shkaktojnë. Ndryshojnë jetën t' onë të dheshme në Ferr të vërtetë, ku nuk ndriçon dielli, nuk nënëqesh shpresa dhe gëzimi, por vetëm dhëmbja e ashpër mbretëron. Kush do të na inspirojë kuxim dhe do të na japë durim dhe shpresën e çlirimit. Besa në ndihmën dhe në mëshirën e Perëndisë, por dhe kujtimi i vdekjes. Vdekja jep fund jo vetëm jetës, por dhe vuajtëvet të jetës. Është çliruesi i dhimbjes; është dera dhe fillimi i jetës tjetër, ku s' ka dhimbje, as lotë, as fshërtim, por gëzim dhe prehje. Kur shtrëngime dhe ngasje të përfaqojnë, kujto vdekjen, d.m.th. do të vijë dita, kur do të pushojnë përgjithënjë vuajtjet e tua edhe do të gjesh gëzimin e përjetshëm në vënd të vuajtujevet. Edhe ahere nuk do të shtrëngohesh, as nuk do të zemërohesh kundër Perëndisë dhe njerëzvet, se ke vuajtur padrejtësisht, po të bësh durim, si Llazari i sotshëm dhe do të gjesh lehtësim në vuajtjet e tua.

3. - Na çliron nga urrejtja dhe hakmarrja.

Urrejtja dëndur na ha dhe na djeg shpirtin t' onë. Po të na shajnë, po të na përbuzin dhe na përdorin keq drejtësisht ose padrejtësisht, armiqësija e ngrehë kokën duke kërkuar hakmarje. Armatosim gjuhën për të përfolur, për të bërë padrejtësi, që të shpërblejmë me atë mënyrë armikun. Po pse vetëm armikun? Edhe vllan dhe mikun. Mjafton të kujtojmë vdekjen dhe ato pas vdekjes. Me të shpejtë dije zemërata dhe zjarri shuhet. Pse t' a hidhërojmë; le të mendohemi, kur nesër do të vdesë dhe do të vete përpara Perëndisë. Dhe i krishteri e ndjen, sado e madhe që të jetë e liga, që na është bërë. O! sa të mira bije kujtimi i vdekjes dhe është i nevojshëm dhe shpëtimtar për shpirtin t' onë të sëmurë dhe mëkatar.

Të dashur vlezër. Njerëzit e botës mëkatare nuk duanë të kujtojnë vdekjen. Largohen nga varrimet dhe nga qimitiri dhe bëjnë çdo gjë, që të largojnë nga mendja e tyre

vdekjen. Le mos të pasojmë mendimet e tyre, sepse janë shërbëtorë të pasionëve dhe të kotësiravet të kësaj bote. Le t' a kujtojmë, që të gjejmë shërim në shtrëngimet t' ona. Le t' a kujtojmë, që mos të mekatojmë dhe të përgatitemi për udhëtimin në qiell. Është i lumtur ay njeri që do të gjendet i përgatitur në orën e vdekjes. Për atë gjiri i Abraamit dhe mbretërija e Perëndisë do të jetë trashëgim. Amin.

---

## **E DJELË (23) PAS LLUKAJT VI**

Shpjegim i Ungjillit (Lluk. 8. 26-39)

**"Në atë kohë kur erdhi Jisuj ndër vend të Gadharinevet, i doli përpara një njeri prej qytetit, që kishte djaj prej shumë vjetve, edhe rrobë nuk vishte edhe ndër shtëpi, nuk rrinte, por ndëpër varret. Edhe kur pa Jisun, bërtiti e i ra ndër këmbë, e me zë të math tha. Ç' ke me mua, Jisu, i biri i Perëndisë së Lartë? Të lutem, mos më mundo. Sepse ay urdhëroi frymën e ndyrë të dalë nga njeriu; sepse prej shemë vjetve e kishte rrëmbyer, edhe lidhej me vargje edhe ruhej me hekura këmbësh; por ay i këputte të lidhurat edhe sillej prej djallit ndëpër shkretëtirat".**

Ky ishte pushtuar prej frymash të liga, të cilat e zotnonin dhe vepronin me anën e atij. Nga ky shkak arratisesh i çveshur jashtë qytetit duke pasur për banim varret.

Ç' lidhje është midis nesh dhe ç' erdhe të bësh këtu? Këto thonë me frikë djajt, që ishin mbrenda njeriut, sepse kuptonin gjithpushtetin e Zotit. Të lutem mos mundo mua d.m.th. mos më dërgo në mundim të përjetshëm.

Fryma të ndyra quhen, sepse mungon prej tyre çdo virtut dhe ndodhen lark Perëndisë dhe në mëkatë, e cila i bëri nga fryma të ndriçme, në fryma të errëta.

Prej shumë vjetësh e kishin pushtuar njerin frymat e liga dhe njeriu kishte ardhur në këtë gjendje marrëzije, sa këputte zinxhirat dhe shkonte në shkretëtirë.

**Edhe Jisuj e pyeti, duke thënë. Ç' ta thonë emrin? Edhe ay i tha Legjeon, sepse kishin hyrë tek ay shumë djaj. Edhe i luteshin të mos i urdhëronte të shkonin në abysë. Edhe atje ishte një tufë e madhe derrash duke kullotur ndër mal. Edhe i luteshin t' i lerë të hynin ndër ata. Edhe ay i la. Edhe djajt si duallën prej njeriut, hynë në derrat. Edhe tufa e derravet u sul prej shkëmbit në liqen edhe u mbyt".**

E pyeti Zoti për emrin, që t' a shpallij, se jo një, por shumë djaj e kishin pushtuar të djallosurin. Legjeon quanin Romakët një trup ushtarësh prej 7 mij.

Me qënë se Zoti nuk i \*joi të rinë tek njeriu, djajt kërkuan leje që të hyjnë në derrat. Sepse frymat e liga kënaqen gjithnjë të shkaktojnë dëme. Dhe derrat u mbytën, që të dënohen zotërit e derravet, të cilët ushqenin derra kundër urdhëravet të ligjit të Moisiut.

**"Edhe ruajtësit kur panë, se ç' u bë, ikën edhe vajtën e dhanë zë ndë qytet e nëpër arat. Edhe duallën të shifnin, se ç' u bë. Edhe erdhën te Jisuj edhe e gjetën njerin, prej të cilit kishin dalë djajt, duke ndënjur pranë këmbëvet të Jisujt, të veshur e të urtësuar. Edhe u frikësuan. U treguan edhe ata që e panë, qysh shpëtoi i djallosuri. Edhe e gjithë shumica e vëndeve rrotull Gadharinevet i luteshin të ikinj nga ata, sepse i kishte zënë frikë e madhe. Edhe Jisuj hyri në lundër dhe u kthye. Edhe njeriu, prej të cilit kishin dalë djajt, i lutesh të jetë bashkë me atë; Po Jisuj e lëshoi duke thënë, ktheu në shtëpi t' ende edhe rrëfe gjithë sa bëri Perëndia mbë ty. Edhe ay shkoi duke lëçitur nëpër gjithë qytetin sa bëri Jisuj mb' atë".**

I djallosuri mbasi u çlirua nga frymat e lia, u mvesh dhe rinte pranë këmbëvet të Jisujt plotë me mirnjohësi.

MËSIME. - Në një shkretëtirë buzë deti të qarkut të gadharinejvet del Jisuj me nxënësit e Tij. Vjenë të çlirojë një të djallosur të mjerë. Zoti nuk lë pa mbrojtje qoftë dhe një shpirt të vetëm. Edhe atyre që aratisen lark, u-zgjat dorën e tij dhe vjen ndihmës i pa thëritur.

Djajt pohojnë me gojën e të djallosurit, se Krishti është i Biri i Perëndisë të Lartit. Po nga ky pohim nuk fitojnë sympathinë e Jisujt. Duhet pra të vërtetën mos t' a mëkojmë nga burime të dyshimta, por vetëm nga fjala e Perëndisë dhe nga puntorët e Kishës.

Frymat e liga mbasi tyranizuan njerin, tash humbën derrat sepse kënaqen gjithmonë të bëjnë të ligën. Kështu dhe njerzit e liq, kurse bijt e Perëndisë bëjnë të mirën.

Banorët e qarkut të gadharinejvet i luten Krishtit, që të largohet nga vëndi i tyre, sepse të huaj prej Perëndisë kanë frikë nga ndodhja e Zotit. E ndjejnë Atë si gjykatës të drejtë për t' i dënuar më pushtetin e Tij. Të tilla ndjenja duken atje, ku mbretëron mëkata. Po të plotësojmë porosit e Tij, ahëre Krishti është miku i ynë.

Një mirësi gëzoi nga Zoti i djallosuri dhe e lëçiti të gjithve emrin dhe veprat e mirëbërësit.

U-tregua mirnjohtës.

---

## **E DJELË (23) PAS LLUKAJT VI**

**FJALIM: Për dënimin e përkohshëm e të pa drejtëve.**

**"Dhe u sul tufa e derravet nga mali në det".**

Një ankim i zakonshëm i njersvet pietozë është, se të pa drejtët mbeten të pa dënuar nga Perëndia dhe pasunohen me mjete të pa ligjëshme. Por kjo s' është e vërtetë. Përveç dënimit të përjetshëm, shumë herë zemërata e Perëndisë vjen e tmershme mbi ata, që bëjnë padrejtësira, dhe në këtë jetë. Dëshmi Gadhari i Ungjillit të sotshëm. Gadharinejt ishin të paligjëshëm. Sado që ligji i Moisiut i ndalonte të hanin mish derri, gadharinejt ruanin derra, që t' u a shisnin fqinjëvet idhololatrë për të fituar të holla. Ç' bënin pra? Bënin një tregëti të paligjëshme, që e ndalonte ligji i Perëndisë. Ja, në një minutë i humbasin të gjitha. Sepse frymat e liga, mbasi duallën nga njeriu i djallëzuar, hyjnë me lejën e Zotit në tufën e derravet; dhe "u sul tufa e derravet nga mali ne liqen dhe u mbyt". Afër dy mijë derra, d.m.th. një prishje e madhe dhe e papritur ishte një dënim i drejtë i Perëndisë për paligjësin e tyre. Kjo dishmon, se Perëndia dhe në këtë botë të përkohëshme dënon padrejtësin. Për këtë bëhet fjala sot.

### I

Gjith urtësia e Perëndisë ka shumë mënyra dënimi. Të zakonëshme janë:

1. - Prishjet lëndore dhe ekonomike.

Mos janë të ralla këto ngjarje? Janë të dëndura dhe të përditëshme dhe i vërejmë me syt t' ona. Njerës nga pallate të mermerta gjenden të mjerë në udhë. Njerës të pasur bëhen në gjendje, që të kërkojnë ndihmë. Të këtilla prishje mund të ngjajnë dhe nër njerzit e drejtë, që i dërgon rrallë Perëndia për t' i provuar. Por dëndur u ngjajnë të padrejtëvet. Mund të qëndrojnë një ndërtesë pa pasur themele të shëndosa? Mundet një pasuni të qëndrojnë, që e dha jo Perëndia, por djalli? Pasuni që e ka fituar jo me djersë, por me fitime të dyshimta? Në një minutë rrëzohen, kurse i mblodhi me vjetë: rrëzohen, se e dënon e zemërata e Perëndisë. Dhe vërtetohet ajo që ka thënë profiti, «pash të padrejtën të lartësohet si lisat e Libanit; u ktheva prapë dhe ja nuk ishte dhe e kërkova dhe nuk u gjënd vendi i tij». Po. As vëndi, ku rinte, nuk gjendet shumë herë, sepse prishja grumbullohet e përgjithëshme. Por në mos ngjaftë ngandonjëherë kjo, ngjan një gjë tjetër.

2. - Qortimi i ndërgjegjes dhe thirrja e opinionit publik.

Ç' bën ndërgjegja? Thërret në thellësinë e shpirtit të fajtorit, «je kusar dhe ke bërë padrejtësira dhe abuzime». E frikëson, sikundër ligji frikëson fajtorin; e shpon, si thikë me dy presje. Edhe opinionin e popullit thërret kundër tij «je grabitës, vjedhës». E përbuzë dhe e shikon me sy të keq, dhe kërkon të hakmarrë. Qetësohet ndonjëherë i këtyllë njeri? Kurrë, Ka për të ngrënë dhe për të pirë dhe për këtë e pandehin të lumtur. Por ç' lumtëri është kjo, kur nuk shehë qetësi, kur ka frikë, se mos zbulohet dhe dënohet, kur qortimi i pafjetur i ndërgjegjes e tyranizon? Jo, kjo nuk është lumtëri. Është zemërate e Perëndisë, që e dënon përkohësisht dhe e paralajmëron me këtë dënim, që e pret një dënim tjetër i frikshëm dhe i përjetshëm, në qoftë se nuk pendohet.

## II

Le të vemë re këtë, se Perëndia dënon drejtësisht dhe jo për të hakmarrë dhe për prishje. Në qoftë se lejon prishje lëndore dhe vë ndërgjegjen t' a qërtojë, këtë e bën me qëllim filantropik dhe shpëtimtar:

1. - Për të urtësuar.

Me gjithë se vuajtjet janë pemët e mëkatave t' ona dhe dënim i drejtë, por i Tërëmiri e kthen të ligën në të mirë dhe kërkon të nxjerë të ëmbël nga e hidhura. Është pendimi dhe shpëtimi i shpirtit t' onë, sepse pësimet na bëhen mësim. Sepse kur ndjejmë dhimbje dhe rrezikohemi dhe poshtërohemi për paligjësit t' ona, që bëjmë, ahëre vijmë në vehte dhe kuptojmë, se mëkata është një e ligë e dëmshme. Kur prodigu erdhi në vehte dhe u kthye te i ati? Ahëre kur e pa vehten e tij në një gjendje të vajtuëshme. Sa e sa njerës detyrojnë shpëtimin e tyre nga një sëmundje dhe strëngim! Ato na zgjojnë dhe na kthenjë në udhën e shpëtimit. Mos të zemërohemi dhe të ankojemi, se drejtësisht vuajmë, për të çfajosur. Pendim kërkon Perëndia dhe pendim t' i tregojnë, sepse na dënon për ndreqjen t' onë.

2. - Për të dhënë shëmbullë të tjeret.

Sikundër shumë tërhiqen në mëkatë nga shëmbulla e ligë e të tjeret, kështu dhe shumë vijnë në vehte dhe pendohen, kur shikojnë të tjerët të dënohen. Do të pyes, është e drejtë të dënohem unë, që të ndreqen të tjerët? Me qënë se jam një njeri mëkatar, është shumë e drejtë të dënohem, sepse mëkata do të dënohet ose këtu përkohësisht, ose në jetën tjetër që është pambarim. Por duhet të jemi të kënaqur të dënohem këtu për pendim të shpirtit t' onë, se sa në jetën tjetër, ku s' ka dobi pendimi dhe dënimin është i përjetshëm.

\* \* \*

Por sigurisht mâ e mira është të largohemi nga mëkata. Le të na premtojë fitime dhe mirjetesë dhe prehje. Gënjeshtër dhe vjedhje, padrejtësi dhe çdo mënyrë tjetër pasunimi të paligjëshëm, është zjarr dhe mallkim, katarë Perëndije. Është vullkan, që një ditë do të marrë zjarr dhe do të na dërmojë. Në qoftë se nuk pësuam né, pësimet e të tjervet të na bëhen mësimë shpëtimtare.

---

## **E DJELË (24) PAS LLUKAJT VII**

Shpiegimi i Ungjillit Lluk. 8. 41-56

**"Në atë kohë erdhi te Jisuj, një njeri, që quhesh Jair; dhe ay ishte kryetari i sinagogjis. Ky duke i rënë në këmbët e Jisujt, i lutesh që të hyjë në shtëpin e tij, sepse çupa e tij e vetëmlindur, afër dymbëdhjetë vjeçë, po i vdiste. Kur po shkonte Jisuj, gjindja po e shtrëngonte. Edhe një grua, që kishte rrjedhje gjaku qysh prej dymbëdhjetë vjetësh, e cila kishte shpenzuar gjithë pasunin e saj në mjekësit dhe nuk u shërua prej asnjërit, erdhi prapa dhe preku cepin e rrobes dhe përnjëheresh qëndroi rrjedhja e gjakut. Jisuj tha, cili më preku? Mbasi të gjith mohonin, Pjetri i tha dhe ata që ishin bashkë me atë. Mësonjës, gjindja të përqarkon dhe të shtrëngon dhe ti thua, kush më preku? Jisuj tha, më preku njeri, se unë kuptova që dolli fuqi prej meje. Duke parë gruaja, që nuk mundi të fshihesh, erdhi duke u dridhur dhe i ra në këmbët dhe tregoi përpara gjith popullit, për ç' shkak kishte prekur rroben dhe qysh u shërua përnjëheresh. Jisuj i tha asaj. Kij kurajo, o bijë, besa jote të shpëtoi, shko në paqe".**

Kryetari i sinagogjis të atij qyteti. Jisuj e pranoi lutjen e tij, duke parë besën e nxehtë.

Kur po shkonte Zoti në shtëpin e kryesinagogut, gjindje e madhe e përqaqoi dhe e shtrëngonte.

Një grua vuante nga gjak rrjedhja qysh prej dymbëdhjetë vjetësh. Kjo kishte shpenzuar gjith pasunin e saj në mjekësit, por s' kishte gjetur shërim. Kjo prapa gjindjes preku rroben e Jisujt, me besë të nxehtë, që kështu do të shërohesh. Dhe u shërua.

Kush më preku pyet Zoti, jo se nuk e dinte, por që të bëjë të duket sheshazi besa e gruas për të mësuar gjindja.

Mësonjës, gjindja të ka në mes dhe të shtrëngon, dhe pyet kush më preku? Jisuj thote, më preku njeri, se ndjeva fuqi, që dolli prej meje.

Gruaja fshihesh dhe heshte, se kishte turp të tregonte sëmundjen e saj. Mbasi pa që s' mund të fshihesh, pohoi shërimin e saj.

Nga besa e jote more shërimin t' ënd.

**"Kur akoma Jisuj po fliste, vjen një nga kryesinagogu kryetari i mbledhjes dhe i thotë. Çupa jote vdiq, mos mundo mësonjësin. Dhe Jisuj kur ndëgjoi, i tha, mos ki frikë, vetëm beso dhe do të shpëtojë. Jisuj mbasi hyri në shtëpi, nuk la asnjë të hyjë, veç Pjetrin, Jakovin dhe Joanin dhe atin e vajzës dhe nënen. Po qanin të gjith dhe po vajtonin. Jisuj u tha, mos qani, se vajza nuk vdiq, por po fle. Dhe e përqeshnin të gjithë, mbasi e dinin që vdiq. Jisuj mbasi i nxori të gjithë jashtë dhe duke e mbajtur atë prej dore, thërriti: Vajzë, ngreu. Dhe u kthye fryma e saj dhe u ngjallë përnjëherësh. Dhe urdhëroi t' i japin të hajë dhe u çuditën prindërit e saj. Jisuj i porositi, që të mos thonë asnjërit ngjarjen".**

Mos mundo Mësonjësin, se vdiq vajza. Ay njeri i thotë kryesinagogut këto fjalë, se besonte që Krishti mund t' a shëronte, por jo dhe që t' a ngjallte.

Nuk vdiq, por po fle. Vdekjen Zoti e quan gjum, sepse vdekja është një ndarje e përkohëshme të shpirtit nga trupi, që prapë do të ngjallet. Nga tjetër anë, sepse në fuqin hyjnore të Shpëtimtarit është kaq e lehtë t' a bjerë në jetë prapë të vdekurin, sa lehtë është për ne të zgjojmë një njeri në gjum.

MËSIMI. - Pranë Jisujt mblidheshin jo vetëm njerës nga populli, por edhe njerës nga klasat e larta shoqërore, sikurse kryesinagogu Jairo. Kush nuk ka nevojë për të tillë Shpëtimtar njeridashës dhe gjith pushtetshim? Ay është Shpëtimtar i të gjithve, ndihmësi dhe mbrojtësi, ngushullimtari dhe udhëheqësi. Të gjithë kemi nevojën e Tij. Prandaj të gjithë duhet të përikim të Ay, me besë të vërtetë për të marrë përdëllimin e Tij dhe ndihmën e Tij.

Jisuj është mjekësi i shpirtëvet dhe i trupëvet. Jo vetëm çliron nga mëkata, por shëron dhe sëmundjet. Ngrëhë shpirtet nga mëkata, por edhe trupa të sëmura shëron. Dhe gruaja që vuante nga rrjedhje e gjakut, me qënë se e kuptoi këtë vjen pranë Tij midis gjingjes, plotë me besë dhe shpresë, dhe prek cepin e rrobes së Shpëtimtarit. Sado që shumë nga gjindja shtrëngonin Zotin, vetëm ajo grua mori prej Atij të mirën, që kërkonte, shërimin e trupit.

Gruaja e shëruar pandeu, se mund të fshihesh nga vërejtja e Shpëtimtarit. Por Zoti midis shumicës pa me syrin e Tij hyjnor jo vetëm gruan, por dhe besën e saj, nga shkakut e së cilës i kishte dhënë dhe shërimin asaj. S' ka asgjë të fshehur dhe të

padukur te Ay. Shikon si Perëndi në thellësirën e zemrës njerzore dëshirat dhe disponimet t' ona. Sikundër di ligësirën në shpirtin e njeriut, kështu di dhe besën e besëmirëvet dhe shpërblen atë.

Përpara tërë popullit lëçit Zoti besën e gruas, e cila shkaktoi shërimin e sëmundjes. Edhe kryesinagogut pak më pastaj, kur i lajmëruan, që vdiq vajza e tij, i rekomandon besën dhe bashkë me atë shpresë dhe kuxim. Dhe kështu mëson, se vetëm ata kanë vënd pranë Tij dhe janë të vyer për të mirat e Tij, që kanë besë të fortë dhe të padyshimtë në shpirtin e tyre. Perëndia është i gatishëm, që të na japë çdo të mirë dhe shpërndan pasurisht të mirat e Tij. Besa është dora, me anën e secilës marrim nga Perëndia dhuratat që shpërndan.

Në urdhërin e tërë pushtetshëm të Shpëtimtarit t' onë u kthye shpirti i së vdekurës. Më parë me vdekjen kishte kur nga trupi shpirti i palëndshëm dhe trupi kishte mbetur i vdekur dhe pafrymë dhe i palëvizshëm. Nashti kthehet prapë shpirti në trupin dhe lidhja prapë stabilizohet; trupi gjallëzohet dhe vajza ngrihet e gjallë dhe e shëndosh. Të tilla punë kush tjetër mund t' i bëjë, veç se Perëndia që krijoi shpirtin dhe trupin?

---

## **E DJELË (24) LLUKA VII**

Ungjilli Lluk. 8. 41-56

**FJALIM: Për ngjalljen e të vdekruset.**

**"Dhe u kthye fryma e saj dhe u ngjall at çast".**

Pushojnë vajtimet dhe zija e madhe, që kishte nxirë shtëpin e lairit zhduket pernjëheresh. Vajza e tyre ngjallet prej së vdekurish. E ngjalli Kryetari i jetës të gëzuar, siç ishte para vdekjes. Tash në shtëpin e arqisynagogut mbretëron vetëm gëzim, dhe ngazëllim, vetëm besë dhe mirënjohje. Të këtille besë dhe gëzim duhet të mbretërojë dhe në shpirtet t' ona, sepse dhe neve presim ngjalljen e të vdekurve; ngjalljen e miqvet t' anë, që vdiqën deri sot, ngjalljen t' onë, që do të vdesim pas ca kohe. Në se Zoti ngjalli, si kur se ndëgjuam sot, vajzën e lairit, në se ngjalli djalin e së vesë të Nainit, në se ngjalli më pastaj mikun e tij Llazarin; bëri këto çudira jo vetëm për të gëzuar prindërit e helmuar, as vetëm për të treguar gjithë fuqin e Tij. Ngjalli këta të vdekur, që të na japë një vërtetim të sigurtë për ngjalljen e të gjithëve në kohën e ardhme. "Pres ngjalljen e të vdekruset" themi në symbolin e besës s' onë. Dhe është një e vërtetë e madhe kjo, sepse:

1. - E thotë shkrimi i Shenjtë.

Si në Dhjatën e Vjetër Profitët paralajmërojnë ngjarjen gazmore, ashtu dhe në Dhjatën e Re Apostojt thonë, se do të bëhet ngjallja e të vdekurvet, të drejtë dhe të liq. "Që Zoti me urdhër dhe me zë krye engjëlli dhe me trumbetë Perëndije do të zbresë prej qiellit dhe të vdekurit do të ngjallën të parë". Vetë Krishti e thotë në Ungjillin pas Joanit: "gjithë ata që janë në varret do të ndëgjojnë zërin e Tij dhe do të shkojnë, ata që kanë bërë të mira në ngjallje jetë dhe ata që kanë bërë të liga në ngjallje gjyqi". Pse është e pamundëshme të Perëndia? Ay që krijoi botën pa pasur ndonjë lëndë, do mund tash të ngjallë trupin nga hiri i tij. Po. I tërë fuqishmi do të ndezin lihëtarin, që e shoji era e tërbuar e vdekjes. Do të ngjalli Krishti trupat t'ona të pavdekshëm dhe të nderçëm. Sepse:

2. - E kërkon mirësija e Perëndisë për lumtërin t'onë të plotë.

Perëndia i dha njeriut shpirt, që të dallohet nga shtazët, të fluturojë lartë, të kërkojë qiellin. Por i dha jo vetëm shpirt, por edhe trup, që mos të jetë i huaj në natyrën lëndore, për të citët u caktua udhëheqës dhe mbret. Këtu gjendet plotësimi i jetës së njeriut, që të gëzojë me shpirt dhe trup jetën. Në qoftë se rron vetëm duke ngrënë dhe pirë, pa përmbushur dëshirat e shenjta të shpirtit, është fatkeq, sepse barazohet me shtazët. Në qoftë se rron prap në jetën e ardhme i ndarë nga trupi, do t'a ketë përgjysëm gëzimin dhe të paksuar lumturin. Do t'a ngjallë pra i Tërëmiri njerinë që të gëzojë gëzimin e jetës s'amëshuar. Akoma:

3. - Këtë e kërkon dhe drejtësija e të Lartit.

Po. Drejtësija. Njeriu që rron në këtë botë, punon ose të mirën ose të ligën. Dhe punon jo vetëm me shpirtim, por edhe me trupin. Shpirti vendos dhe ardhëron, por trupi ndëgjon dhe vepron. Kështu gjuha shan dhe përflet, ose falet dhe ymnon dhe ngushëllon t'afërmin. Dora rrëmben duke vjedhur, ose ndihmon duke dhënë lëmoshë. E drejtë pra të ngjallen trupat, që të marin shpërblimin ose dënimin, sepse bashkëpunuan me shpirtin. Këtë e thotë dhe Apostol Pavli: "Duhet ne të gjithë të çfaqemi përpara fronit të Perëndisë, që të marrë cilido me trupin për sa punoi ose të mirën, ose të ligën". Do të bëhet pra ngjallja e të vdekurvet. Këtë e vërteton dhe ngjallja e Krishtit t'onë. Vdiq dhe u varros, por të tretën ditë u ngjallë së vdekurish. U ngjallë triumfuës dhe trupi i Tij hyri me nderje në jetën e përjetëshme. Por ç'është Krishti për neve, dhe ç'jemi né për Atë? Një trup i pandarë. Ay kryet dhe né pjesët. Kryet u ngjallë, qysh pra është e mundur të rijë trupi në varr? Kur Krishti u ngjallë, ashtu dhe né me atë mënyrë do të ngjallemi të lidhur me atë. "Krishti u bë fillimi i të vdekurvet". Vdiq dhe u ngjallë pikërisht për të hapur varret dhe t'i ngjalle të gjithë nga kalbësira e varrëvet.

\* \* \*

Le të mos frikohemi nga vdekja, sepse nuk është humbje dhe ndarje përgjithmonë. Vdekja është gjum dhe ndarje e përkohëshme. E vemë trupin përkohësisht në varr dhe do t' a marim të lavdishëm dhe të paprishëm. Tash mbillet në prishje, por ngrihet në paprishje: mbillet në sëmundje dhe mishërisht, por ngrihet në fuqi dhe shpirtërisht. Nga një vetëm të kemi frikë dhe të largohemi me gjithë fuqit t' ona, nga mëkata, sepse do të ngjalljen jo vetëm të drejtët, por edhe të liqtë të papenduarë. Do të ngjallen që të gjykohen dhe të dënohen në fundet e Ferrit. O Zot, shpëto-na nga mëkata dhe dhuron-na jetë pietoze, fundje krishtërore, ngjallje të lavdishme dhe apologji të mirë në Fronin T' Ent të frikshëm. Amin.

---

## **E DJELË (25) LLUKA VIII**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 10. 25-37)

**Në atë kohë erdhi te Jisuj një ligjbërës ose avokat, duke ngarë atë dhe duke i thënë. Mësonjës, ç' të bëjë që të trashëgojë jetë të amëshuar? Jisuj i tha. Në ligjit ç' është shkruar? Qysh këndon: Ay u përgjegj: Të duash Zotin Perëndinë t' ende, me gjith zemrën t' ende, dhe me gjith shpirtin t' ënd, dhe me gjith fuqin t' ende, dhe me gjith mendjen t' ende, dhe të afërmin t' ënd si vehten t' ende. Jisuj i tha drejtë u përgjegje, këtë bëj dhe do të rrosh. Ay duke dashur të dalë i drejtë, i tha Jisujt. Dhe kush është i afërmi im"?**

Ligjëtarë ose shkronjës quheshin ata, që kishin për punë shpiegimin e ligjit të Moisiut. Ishin d.m.th. theologët e asaj kohe. Ky ligjëtar erdhi te Jisuj me dinakëri, që të provojë Shpëtimtarin dhe të gjejë shkak nga fjalët e Tij për të akuzuar. Pyet ç' duhet të bëjë, që të trashëgojë jetën e amëshuar, duke pandehur, se Krishti do t' i thoshte të kundërta, se ç' thotë ligji i Moisiut.

Të duash Perëndin me gjithë zemrën t' ende, e cila duhet të jetë e dhënë e tërë te Perëndia. Me gjith shpirt, i cili të jetë i nënshtruar në dëshirën e Perëndisë. Me gjithë fuqi d.m.th. fuqit trupore dhe fuqit shpirtnore, të cilat të punojnë porosit e Perëndisë. Me gjithë mendjen, e cila të jetë e kthyer gjithnjë nga Perëndia.

Ligjëtari për të zhustifikuar vehten e tij, që nuk e pyeti për ndonjë qellim tjetër, por që të mësojnë, pyeti cili është i afërmi im? Krishti i përgjegjet duke treguar një paravoli të tërë, me të cilën i tregon jo vetëm kush është i afërmi ynë, por edhe në ç' shkallë duhet t' a duam.

**"Një njeri zbriste nga Jerusalemi në Jeriko dhe ra në duart e kusarëve, të cilët mbasi e çveshën dhe e plagosen, ikën duke e lënë gjysëm të vdekur. Rastësisht një prift zbriste në atë udhë, i cili sado që e pa, iku. Kështu bëri dhe një levit fetar i cili, duke ardhur në atë vend dhe duke parë, iku. Një Samaritan duke udhëtuar, erdhi afër tij dhe mbasi e pa, u mëshirua. Samaritani u afërua dhe i lidhi plagët e tij duke shtyrë vaj dhe verë; mbasi e ngjiti në kafshët e tij, e pruri në një han dhe u kujdesua për atë. Të nesërmen, kur dolli nga hani, i dha të zotit të hanit dy dhinarë duke i thënë kujdesu për këtë dhe sa më tepër do të shpenzosh, unë në kthyerjen t' ime po t' ju paguej. Cili nga këta rë tre të duket, se u bë i afërmi i atij që ra në duart e kusarëve? Ligjëtari tha, ay që tregoi mëshirë për atë. Jisuj i tha, shko dhe bëj edhe ti ashtu".**

Jeriko ishte një qytet i Judhesë, që ishte larg nga Jerusalemi afër 8 orë.

Kusarët jo vetëm që e kusaruan, por e çveshën dhe e plagosën e lanë gjysëm të vdekur.

Shkoi një prift, i cili e pa, por tregoi pa interesim për të plagosurin. Shkoi dhe një fetar dhe ay nuk u interesua. Levitët ishin një nga të dymbëdhjetë racat të Jakovit dhe shërbenin në kishën dhe në nevojat fetare të popullit të Judhenjvet.

Samaritanët ishin një popull i përzjerë prej Judhenjvet dhe paganëve. Prandaj Judhenjt i u-rrenin dhe nuk shoqëroheshin me Samaritanët.

I plagosuri symbolizon Adhamin, i cili u gënjye prej djallit dhe shkeli porosin e Perëndisë dhe kështu mbeti i plagosur në mëkatat dhe i kusaruar nga dhuratat hyjnore.

Por Adhamin nuk e shpëtoi nomi i Moisiut (prifti dhe Leviti), por e shpëtoi Samaritani, i cili symbolizon Jisu Krishtin, sepse kështu Samaritan e quanin me të përbuzur Judhenjt Krishtin.

**MËSIME.** - Ligjtari i sotshëm pyeste qysh fitohet jeta e amëshuar. Por pyeste me ligësi dhe dinakëri, dhe jo me qellim të mirë. Sado që pyeste për jetën e amëshuar, por ishte larg nga udha që shpie në shpëtim. Të gjithë duhet të kërkojmë jetën e përjetëshme, por me sinjeritet, me dëshirë të vërtetë, duke vepruar ato që kërkon Perëndia, të cilat janë të domosdoshme për udhëtimin t' onë në jetën e ardhme.

Për të ardhur keq është njeriu që ra në duart e kusarëve. Por më tepër i mjerë është njeriu mëkatar, që bije nënë pushtimin e djallit, i cili e kusaron. Djalli është kusar i padukshëm, që kërkon të pushtojë shpirtin e çdo njeriu duke e shtytur në mëkata. Jo vetëm e çvesh njerin nga dhuratat e Perëndisë, por i shton në shpirtin, po si plagë,

ligësira dhe pasione të ndryshme. Këto plagë të mëkatës tyranizojnë mëkatarin dhe i heqin nga shpirti i tij paqen dhe gëzimin.

Njeriu që ra në duart e kusarvet, nuk e shpëtoi as prifti, as Leviti, por vetëm Samaritani i i mirë. Dhe tërë njerzimin nuk e shpëtoi nga mëkatat ligji i Moisiut dhe theroret Judhaike, por Zoti ynë Jisu Krishti, të cilin hasetqarët Farisenjt e përbuznin si Samaritan. Zoti shëroi plagët e njerëzimit mëkatar me vdekjen e Tijë mbi kryq dhe pastron e shenjteron me mysteret e Tij dhe mjekon çdo mëkatar në Kishën e Tij për shërimin e shpirtëvet.

Cili nga këta të tre, prifti apo Leviti apo Samaritani u bë i afërmi i njeriut që ra në duart e kusarvet? As ndonjë tjetër veç Samaritanit, Zotit Jisu Krishtit. Ay u bë njeri dhe erdhi në botë dhe u bë i afërmi i vetëm i ynë. Prandaj dhe në duhet t' a duamë me gjith shpirt Shpëtimtartin t' onë.

"Shko dhe bej edhe ti ashtu, si Samaritani". Pra shembullë dhe masë dashurije për të afërmim duhet të kemi Samaritanin e mirë, Zotin Jisu Krishtin. Sikundër Samaritani shpëtoi një njeri, pa betuar cili dhe nga ç' vend ishte, dhe sikundër, Krishti u mishërua dhe vdiq për gjithë botën, kështu dhe ne duhet të duamë çdo njeri. Këtyllë dashuri, sikundër tregoi dhe Zoti, i cili pranoi dhe vdekje për ne; dashuri me çdo sakrificë, në rasë nevoje, për të afërmin t' onë.

---

## **E DJELË (25) PAS LLUKAJT VIII**

Ungjilli Lluk. 10. 25-37

**FJALIM: Për trashëgjinin e jetës s' amëshuar.**

**"Këtë bej dhe do të rrosh".**

Një ligjtar (nga ata që shpiegonin ligjin e Moisiut) me ligësi pyet Krishtin "ç' duhet të bëjë që të trashëgojë jetën e amëshuar?" Qellimi i tij ishte për të ngacmuar, por çeshtja, që vuri, ishte e lartë dhe serioze. Zoti, që është i mirë për të gjithë, donte dhe atë t' a urtësonte edhe gjindjes t' i mësonte mënyrën për fitimin e jetës s' amëshuar. E pyet pra ligjtarin: Ti që studjon ligjin e Perëndisë, ç' është shkruar për këtë çeshtje? Dhe ligjtarin i përgjigjet, që mjetet për të trashëguar jetën e amëshuar është dashurija te Perëndia dhe te i afërmi. Edhe Krishti i thotë: "mirë u përgjegje, këtë bëj dhe do të rrosh". U gjet pra d' akord, që dashurija te Perëndija dhe te i afërmi hap dyert e parajsës. Kjo çeshtje na intereson dhe neve të krishterët dhe le t' a hetojmë, jo duke

ngacmuar, si ligjtari, por duke dëshiruar jetën e lumtur, dhe le të pyesim ç' suhet të bëjmë, që të trashëgojmë jetën e amëshuar.

## I

Dashurin caktoi dhe Zoti, si kyç të çuditshëm për të hapur dyert e parajsës. Dashuri të plotë dhe me gjith zemër te Perëndia, që e bën njerin të mendojë gjithnjë Perëndin dhe të rrojë me Atë i bashkuar shpirtërisht. Sepse:

1. - Është e natyrshme dhe e nevojshme.

Sepse Perëndia përgatiti jetën e amëshuar dhe i thërret njerzit për trashëgimin e saj. Perëndia është Ay që shpërndan gëzimin ndër të thërriturit, se jeta e amëshuar është shtëpia dhe lavdia e Perëndisë. Mund të rijsh në një tryezë miqësore, kur je i huaj? Është e mundur të ndjesh ndonjë kënaqësi në gëzimin e atij, që s' e ke njohur kurrë, as e ke dashur, por mâ tepër e ke përbuzur? Djali, që të rijë në shtëpin e atit tij dhe të gëzojë të mirat e atit tij, duhet t' a dojë atin e tij. Kështu ngjanë dhe me Perëndin. Do të bëhemi bijt e Tij, do të quhemi trashëgimtarët e Tij, do të rrojmë në shtëpin e Tij të bekuar, por është e drejtë dhe e nevojshme t' a duamë Perëndin me gjith shpirtin t' onë, me gjith fuqin t' onë. E deshën Perëndin Profitët, Apostojt dhe Martirët, të cilët për dashurin për Atë edhe jetën e tyre sakrifikuanë. Qysh shfaqet kjo dashuri?

2. - Kjo dashuri çfaqet në falje të nxehtë dhe të regulshme, ku shpirti derdhet në fjalë e ndjenja mirnjohje dhe lavdërimi. Çfaqet në studjimin e Shkrimit të Shenjtë, ku besniku kërkon të njohë më mirë Perëndin dhe dëshirën e Tij. Por çfaqet më tepër në ruajtjen e porosit të Tij. Sepse e tha vetë Krishti: "jo ay që më thotë o Zot, Zot, do të hyjë në mbretërin e qiejvet, por ay që bën dëshirën e Atit t' im qiellor". Edhe shtoi "ay që ka porosit e mij dhe i bën ato, ay është që më do". Ç' bënë Shenjtorët? Porosit e Tij ruajtën për të treguar dashurin e tyre. Çdo të bëjmë dhe né? Do të ruajmë porosit e Tij, që të tregojmë dashurin t' onë të Plotë. Dhe porosit e Tij na imponojnë si detyrë kryesore dashurin te i afërmi ynë.

## II

Pas Perëndisë duhet të duamë të afermin t' onë, "do të duash të afërmin t' ënd". Kjo është konditë e dytë për të trashëguar mbretërin e qiellit, porosi e madhe e dytë. Por qysh do t' a duamë.

1. - Sikundër duamë vehten t' onë.

Vehtja e jonë është masa e dashuris kundrejtë të afërmit t' onë. Ç' bëjmë për vehten t' onë? Të gjitha për t' a kënaqur. Kur ka uri, e ushqen: kur sëmuret, shpejton te mjekësi

për shërim: kur rrezikon, e mbron. Kështu vepro dhe për të afërmin t' ënd. Ka uri, jep-i të hajë: është i sëmure dhe në rrezik, jep i ndihmën dhe mbrojtjen t' ënde; është hidhërim, ngushullo-e; të nget dhe të mërzit, mos i verë vesh: të bën ndonjë padrejtësi dhe të ndjekë, mos kujto t' i bësh padrejtësi, por përkundrazi t' i bësh të mira, sikurse do t' i kishe bërë vehtes t' ënde. Këtë bëri dhe Samaritani i mëshirshëm, atij që ra në duart e kusarvet, sikundër e ndëgjua në Ungjillin e sotshëm: Këtë do të dërgojë dhe ndaj ne Zotin në ditën e gjyqit, sepse është e nevojshme kjo dashuri:

2. - Për jetën t' onë të ardhme.

Atje në qiell do të formojmë një familje dhe do të rrojmë sëbashku. Po qysh do të rrojmë me armoni, kur nuk është zhvilluar dashuria ndërmjet nesh? Edhe qysh do të ndjejmë gëzim, kur do të kemi pranë vllan t' onë, që e lamë lakuriq dhe të urishëm? Kur do të shikojmë t' afërmin t' onë, të cilin e hoqëm nëpër gjykatoret dhe nëpër gjyqet për të vënë në vend ndonjë padretësi? Kur do të kemi shokë, ata që i fyemë dhe i damtuamë? Jo, Jo. Dashuria e bën parajsën me të vërtetë parajsë dhe armiqsija e bën Ferrin m' tepër të frikshëm. Prandaj u dënua i pasuri, i cili nuk tregoi dashuri për Lllazarin e vobektë, dhe i pasuri i çmendur, i cili depozitoi për vehten e tij drithnat e aravet, që i a bekoji Zoti, sepse s' kishin dashuri për të afërmin e tyre.

Por nuk ka hije, nuk mund të rrojë i pamëshirshmi dhe njeriu i pabesë në kopshtet e parajsës, ku fryn ajri i besës dhe i dashurisë krishtere, ku dashuria bashkon Perëndin, engjejt dhe njerzit.

Të kishterë të dashur. Zemra e jonë është gatuar, që të dashurojë, të dashurojë Perëndin dhe njerzit. Vetëm mëkata e ndryshoi dhe e bëri të ashpër. Le t' a pastojmë me gjakun e dashurisë të Krishtit t' onë, që të vijë në gjendjen e saj të natyrshme, të mësojë prapë të dashurojë. Të mos dëshirojë pasunira dhe lavdira dhe madhështira të kësaj bote. Të mos dëshirojë mëkatën dhe poshtërsin. Por të dashurojë Perëndin dhe njerzit, që janë vllazërit e saj të përjetshëm. Kjo dashuri do të na japë paqe dhe gëzim mbi dhë dhe do të na hapë dyert e jetës qiellore, të cilën dashuria e Perëndisë ka përgatitur për neve. Amin.

---

## **E DJELË (26) LLUKA IX**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk.) 12. 16-21

**"Tha Zoti këtë paravoli. Një njeriut të pasur prodhuan shumë arat. Dhe mendohesh në vehten e tij duke thënë. Ç' të bënj, sepse s' kam ku të mbledh drithnat e mia? Edhe tha, këtë do të bënjë; do të rrëzojnë grunaret e mia dhe**

**do të ndërtonjë më të mëdhaja dhe do të mbledh atje të gjitha drithnat e mia dhe të mirat e mia".**

Këto mendohesh i pasuri lakmimtar dhe shtrëngohesh. Sepse nga lakmimi i tij dëshironte të mbante për veten e tij të gjitha të mirat dhe s' mendohesh aspak të jepte ndonjë pjesë nga tepërica të vobektëvet. Duke u menduar i pasuri lakmimtar e gjeti me në fund ç' duhesh të bënte. Do të prish të gjitha magazirat e mia të vogla dhe do të ndreq tjera të gjëra dhe atje do të depozitonjë të mira e mia.

**"Edhe do t' i them shpirtit t' im. O shpirt, ke shumë të mira të ndodhura për shumë vjete, prehu, ha, pi dhe dëfre. Edhe Perëndia i tha. I çmendur, këtë natë kërkojnë shpirtin t' ënd nga ty; ato që bëre gati, kujt do të jene?"**

I pasuri tregohet egoist, sepse vetëm për "egon" e tij mendohet, pa menduar, se Perëndia i bekoj arat e tija dhe dhanë shumë prodhime për të ndihmuar edhe të vobektët.

E la Perëndia që të plotësojë planet e tij. Mbasi depozitoi të gjitha të mirat në depot e gjëra dhe përgatitësh të gëzojë të mirat e tij, ahëre Perëndia vendosi kundër këtij dënimit e drejtë.

Perëndia të çmendur e quajti të pasurin, sepse harroj, që Zoti i bekoj arat e tija për të ndihmuar, ata që ndodhen në mjerime: pastaj harroi, që s' jemi zotër të jetës s' onë dhe vdekja na vjen e papritur.

Në këtë natë djajt kërkojnë shpirtin t' ënd dhe do t' a rrëmbejnë atë. E kërkojnë djajt, sepse nga lakmimi dhe nga largimi prej Perëndisë, shpirti i të pasurit nuk është i Perëndisë, por i djajvet, të cilët kishin pushtetin dhe të drejtat mbi atë.

**"Kështu për atë që mbledh tresare për vehten e tij dhe nuk pasunohet te Perëndia. Duke thënë Jisui këto theriste. Ay që ka veshë për të ndëgjuar, le të ndëgjojë."**

Këfillë fund do të ketë ay që mbledh thesare me lakmim, që t' i gëzojë vehtë, dhe nuk ndihmon të vobektët, që të ketë thesar në qiejt.

Kush dëshiron të mësojë të vërtetën dhe ka veshë për t' a ndëgjuar, le të ndëgjojë fjalët e mia dhe le t' i vërë mbrenda në shpirtin e tij.

MËSIMI. - Perëndia jep të mirat e dheshme, jo vetëm njerëzve besëmirë dhe të drejtë. Jep ato dhe njerëzve, që janë të huaj te Ay, sikundër ishte dhe i pasuri

lakmimtar i paravolis së sotshme. Edhe këtu duket zemërgjerësia dhe mirësija e Perëndisë. Sepse lind diellin e Tij mbi të mirët dhe mbi të liqt dhe dërgon shiun mbi të drejtët dhe të pa drejtët. Të gjithve u jep mjetet, të që çmojnë mirësin e Atit qiellor dhe të nënështrohen në ligjin e Tij me kënaqësi.

Po ja kundërshtimi i ligësisë njerëzore. I pasuri kur pa prodhimin e jashtzakonshëm, as Perëndin mirëbërësin kujtoi, as të vobektit, as nevojtarët për ndihmën e tij kujtoi. Për ata s' ka as Perëndi, as detyrë dashurije për të afërmin. Vetëm është interesi i tij privat dhe ego-ja e tij personale. Për atë vetëm interesohet, atë vetëm adhuron, për atë vetëm kujdeset që të depozitojë të mirat e tij.

Brëzon lakmuësi grunaret e tij të vjetra dhe ndërton të rea mâ të mëdha dhe mâ të gjëra, për të mbledhur në ato të gjitha të mirat e tij. Merr përsipër kaq mundime; shton kaq kujdesje në vehten e tij dhe kaq çqetshime. Kjo është jeta e lakmuësit. Duke kërkuar gjithnjë të grumbullojë pasunira dhe vetëm për vehten e tij, punon dhe mundohet si mâ i vobekti njeri dhe çqetsohet e mjerohet pa gëzuar ndonjë gëzim dhe prehje. Sado të mira që të ketë lakmimi e bën mâ të mjerë se të vobektit.

I pasuri shtron gjithnjë planë për ngrënje, pirje dhe dëfrime. I dhënë pas pasjes harron, që nuk është zot i jetës së tij; harron që mund t' i vijë vdekja pa pritur. I verbuar pas pasjes, nuk shehë drejtë, as nuk gjykon me urtësi. Provohet më të vërtetë i marrë dhe marrëzija e tij i detyrohet, sepse nuk rron pas porosivet të Perëndisë.

Midis ëndërrave mâ të bukura dhe mâ të ëmbëla i erdhi pa pritur vdekja, dhe i pasuri lakmimtar ikën nga bota i çveshur. Nuk merr me vehte as pasje, as magazira. Merr vetëm pasionin e lakmimit dhe e pret dënimi i përjetshëm. Ky është fundi i jetës së njerzve, që rrojnë në mëkata dhe largohen nga Perëndia.

---

## **E DJELË 26 OSE LLUK. IX**

Ungjilli Lluk. 12. 16-21

**FJALIM: Për marrezin e lakmimit.**

**"O! i marrë! këtë natë kërkojnë shpirtin t' ënd; ato që përgatite, kujt do të jene?"**

Nuk është i rreptë dhe i pa drejtë gjykimi i Perëndisë. Ky njeri u tregua me të vërtetë i marrë dhe i çmendur. U mundua si shërbëtor dhe vuajti e u dërmua për të depozituar të gjitha drithnat dhe të mirat e tij dhe përnjëherë vdiq në triumfin e tij; vdiq i lodhur, i

coptuar i mjerë: vdiq me shpirt të zi dhe të ndytë.

I Këfillë është lakmimi. Le të pyesim pse njerzit bëhen lakmimtarë? Përse kujdesen gjithnjë të mbledhin dhe nuk thonë kurrë "mjafte"? Sepse kanë dëshirën e jetës dhe të lumturis; sepse kujtojnë, se me pasjen sigurojnë jetë të gjatë dhe të lumtur. Me këtë këngë i përkëdhel lakmimi dhe me këtë qëllim shkojnë ata. Po këtu është gabimi dhe marrëzija, sepse pasja nuk siguron jetën dhe lakmimi nuk krijon gëzim dhe kënaqësi. Përkundrazi lakmimi vret jetën dhe shpirtin. Qysh vret jetën?

1. - E bën jetën tyranike. Lakmimtari kërkon gjithnjë pasje dhe për t' i arritur qëllimit mbledh papushim. Në arat, në vreshtat, në magazirat, në bankat, në gjykatoret, për të blerë, për të shitur, për të fituar gjyqet, për të dhëne me interes të hollat për të plotësuar punërat e tij të pa mbaruara. Demi më i vogël e dëshperon, e fundos në mendime; shtron plane për të fituar sa më tepër. Kurrë nuk prehet dhe nuk qetësohet. Ha me shqetësim dhe fle me mendime dhe agoni. I lëmë me një anë vrasjet që bëhen nëpër malet dhe qytetet prej kusarëve për të rëmbyer të hollat dhe për të trashëguar sa më shpejtë prindërit dhe farosët e tyre. Lakmimi prish shëndetin dhe rënon pak nga pak jetën. E dijmë të gjithë fjalën e urtë të popullit punë e shumtë ha të Zotin. Po këtu s' kemi punë; kemi frikëra dhe mendime, kemi dalldira dhe pagjumësi. Ç' bëjnë të gjitha këto? Dërmojnë organizmën dhe shkaktojnë sëmundje dhe vdekjen më të shpejtë, se sa shpresonin. Shpërndan ahëre pasjen e tij, thërret mjekët më të ndëgjuar nga qëndrat, kërkon ndihmë kudo, po me të kotë; vdekja e rrëmbem pa mëshirë, se pasja nuk zgjatë, po përkund\* shkurton jetën.

Por lakmimi vret edhe shpirtin. Qysh e vret?

2. - E ndanë nga Perëndia. Për shpirtin Perëndia është krijuësi i tij, është drita dhe jeta e tij; prandaj shpirti duhet të jetë i bashkuar me Perëndinë, sikundër dega me rëzën që mos të thahet. Por shpirti i lakmuësit nuk njehë Perëndinë; as falje, as predikim, as pendim, as kungim hyjnor, as gëzim dhe kënaqësi, që krijon në shpirtin dashuri dhe adhurimi të Perëndia. Lakmuësi kërkon të holla dhe vetëm të holla; për shpirtin dhe për Perëndinë s' ka kohë. Mbetet pra shpirti larg Perëndisë, i pa pastër, që të hidhet në abysën e dhëmbjes. Jo vetëm që e largon nga Perëndia por:

3. - Nga çdo punë e mirë. Vdes njeriu, por nuk pushon duke rrojtur. Shpirti i tij është i pavdekshëm dhe vete të Perëndia, që të rrojë bashkë me Të jetën e gjatë të përjetëshme dhe të lumtur. Por me ç' vepra? Dhimsuri dhe meshira, mbrojtja e jetimëve dhe e të vejavet, që i ka dënuar jeta, veprat e vllazëris dhe dashuris këto ndriçojnë shpirtin dhe i japin të drejtën, që të hyjë në mbretërinë e qiellit. Por lakmuësi e ka shpirtin lakuriq nga këto; sepse lakmuësi nuk dhimsërohet, nuk mëshiron, nuk jep se ka frikë që të mos bëhet i vobektë. Lakmuësi vetëm të vjedhinj, të falsifikojë, të pijë

gjakun e të vobektit dhe të bëjë çdo padrejtësi për të grumbulluar thesare dhe të tjerët le të kënë uri. Qysh mos të dënohet shpirti i këtill njeriu? Qysh mos t' a rrëmbejnë djajt dhe t' a heqin në mbretërin e skëterës.

Mos kërkojmë prove të tjera. Kur vdekson shpirtin dhe trupin, kur na shkatëron jetën e tashme dhe të ardhme, ç' tjetër më të keqe duamë? Lakmimi s' është lumturi, nuk siguron jetën, lakmimi është sëmundje e keqe sepse ngadalë e pushton njerinë, nga dale hapet oreksi dhe shtohet pasioni. Le të largohemi nga lakmimi për sigurin t' onë dhe për të mirën t' onë. Jeta e jo në dhe gëzimi i ynë nuk mvaret nga pasja; gjëndet në duart të Perëndisë dhe mvaret nga kujdesja dhe nga bekimi i të Lartit. Te Perëndia te i tërëmiri. At ynë le të kemi jetën t' onë dhe gjithë shpresën t' onë dhe Ay nuk do na lerë. Do të na japë dhe bakën e përditëshme që të rroj më dhe mbretërin e Tij qiellore. Amin.

---

## **E DJELË (27) PAS LLUKAJT X (13. 10-17)**

Shpiegim i Ungjillit

**"Në atë kohë Jisuj mësonte në një sinagogji të Shtunë. Dhe ja një grua, e cila kishte frymë sëmundje tetëmbëdhjetë vjetë. Kjo kishte kurrizin të ulur dhe s' mund të ngrihesh fare".**

Sinagogjit ishin dhoma të mëdha dhe të gjata, ku çdo të Shtunë mblidheshin Judhenjt për të kënduar ligjin e Perëndis dhe për të falur. Jisuj mësonte në sinagogji të Shtunavet, se në atë ditë mblidheshin shumë Judhenj.

Ajo grua ishte pushtuar nga një sëmundje kronike, prej së cilës vuante qysh 18 vjetë. Kurizi i saj ishte kaq shumë shtrëmbëruar, sa ajo e mjerë ulesh gjithnjë poshtë dhe shikonte në dhé, pa mundur që të drejtojë trupin e saj dhe të qëndrojë drejtë. Këtë sëmundje, si thotë më poshtë Zoti, e kishte nga veprimi i djallit. Si duket, e lejoi Perëndia për të provuar gruan në durimin dhe besimin e sajë.

**"Kur e pa atë Jisuj, e thëriti dhe i tha. Grua, je e zgjidhur nga sëmundjae jote, dhe vuri mbi atë duart. Dhe përnjëheresh u drejtua dhe lavdëronte Perëndin".**

E pa Zoti gruan dhe, si zemërnjohtës e kujtoi besën dhe virtutin e saj, si edhe shkakun e sëmundjes saj.

Jisuj e tha. Grua je e lirë nga sëmundja jote. Dhe mbasi vuri duart mbi atë, i bëri trupin e saj të shëndosh.

**"U përgjigj Kryesinagogu, i cili u zëmërua, se ditën e Shtunë shëroi Jisuj, dhe i thoshte gjindjes. Gjashtë ditë janë, në të cilat duhet të punoni; në këto ditë pra të vini dhe të shëroheni, dhe jo ditën e Shtunë".**

Kryetari i sinagogjis u zemërua, se ditën e Shtunë shëroi Jisuj. Shërimin e quajti si punë. Dhe me qenë se ditën e Shtunë ishte e ndaluar puna, u zemërua kundër Krishtit, se gjoja shkeli pushimin e së Shtunës.

Kryesinagogu kthehet te gjindja dhe e qerton, sepse nuk kuxon të qertojë drejt-përdrejtë Krishtin. Qerton gjindjen, por terthorazi qerton Shpëtimtarin.

Qerton njerzit, se erdhën të shërohen në ditën e Shtunë. Por shërimi i të sëmurevet, si dhe përgjithësisht mirëbërësija, nuk konsiderohesh prej ligjit punë, as që ndalohesh ditën e Shtunë.

**"U përgjigj Zoti dhe i tha. Ypokrit, cilido prej jush nuk zgjith kaun e tij ase gomarin dhe e shpije për t' i dhanë ujë? Këtë, që është bijë e Abrramit, të cilën e lidhi Satanaj tetëmbëdhjet vjetë, nuk duhesh të zgjidhesh nga kjo lidhje ditën e Shtunë?"**

Ditën e Shtunë lejohesh që të zgjidhnin kaun ase gomarin nga grashti dhe t' i shpinin që t' i ipnin ujë. Kur pra lejohesh kujdesja për shtâzët të Shtunavet, sa më tepër lejohet mirëbërësija kundrejtë një njeriut të sëmure, i cili është Kreatyrë dhe shemelltyra e Perëndisë.

Zoti gruan e quan bijë e Abraamit, jo vetëmse ishte nga raca e Patrikut Abraam, por edhe se i përngjante atij nga besa dhe nga virtutet e tjera.

E lidhi Satanaj, d.m.th. veproi mbi atë Satanaj, që t' a ketë kaq vjetë këtë sëmundje. Nuk duhesh të lirohesh nga kjo sëmundje ditën e Shtunë?

**"Mbasi tha këto Jisuj, turpëroheshin gjith kundërshtarët e tij. Gjith gjindja gëzohesh për këto gjëra të lavdëruara, që bënte Jisuj".**

Në këto fjalë të Krishtit s' kishte ç' të thoshte kryesinagogu dhe u turpërua bashk me rrethin e vet kundërshtar në punën e Krishtit. Kurse gjindja, duke njohur fuqin hyjnore të Shpëtimtarit, gëzonte për gjërat të çuditshme dhe të lavdishme, që bënte Krishti.

MËSIMI. - Puna e djallit nuk kufizohet vetëm në dëmin shpirtnor të njeriut, por

zgjatet dhe në dëmin e trupit tij. Gruaja kurize ishte bërë e këtillë nga veprimi i të ligut dhe sëmundja e saj ishte punë e djallit. Nga kjo kuptojmë, që shumë sëmundje, sado që kanë shkaqe natyrale, vijnë nga veprimi i djallit, i cili përdor shumë herë shkaqe natyrale për të shkaktuar sëmundje të dhimbëshme njeriut. Sepse në ligësinë e tij kërkon të na dëmtojë jo vetëm shpirtnisht, por edhe trupërisht.

Çudi të madhe bëri shpëtimtari përpara kaq gjindjes dhe gruaja e shëruar ishte dishmi e pakundërshtuar e fuqis hyjnore dhe e mirësis së Zotit. Me gjith këtë Kryesinagogu nuk shehë çudin, por ve re se u bë kjo në ditën e Shtunë, kur ishte e ndaluar çdo punë trupore. Karakterizon shërimin e gruas si punë trupore, pra si shkelje të ligjit Mosaik dhe si vepër mëkatore! Nuk ishte as i pa ditur, as i pa kuptuarshëm kryesinagogu. Po këtu tregohet i pa logjikshëm nga smira (haseti) që kishte kundër Shpëtimtarit. Smira i errësoi mendjen e tij, në këtë shkallë sa nuk mendohet drejtë dhe logjikisht.

Kryesinagogu kujton, se nomi i Moisiut vetëm gjashtë ditë lejon punën, në këto ditë pra lejohet shërimi i të sëmurëvet! Pasioni e ka errësuar kaq, sa jo vetëm prish kuptimin e vërtetë e porosis së Perëndisë, por kërkon edhe të kallzojë Krishtin që nuk respekton porosin hyjnore, Smira e udhëheq Kryesinagogun, që të kallzojë Krishtin, si shkelës e porosivet të Moisiut.

Zoti qerton kryesinagogun si njeri Ypokrit dhe i a provon, që fjalët e tij janë të pa logjikshme. Ishte ypokrit ai i mjerë, se tregonte veten si zellar për ruajtjen e porosis hyjnore. Por nën zellin e tij fshihesh smira. Në në interesimin për njerëzit, fshihesh ligësija.

Qërtimi i drejtë i Shpëtimtarit i a zuri gojën dhe e turpëroi kryesinagogun Ypokrit. Kështu edhe çdo ligësi dhe mëkatë, ka përfundim të sigurtë dënimin dhe turpjen. Në qoftë se nuk turpërohet nga ndonjë herë mëkata dhe në jetën e tashme, sigurisht do të korrin turpjen në ditën e ardhme të gjyqit, kur lakuriq do të duket çdo ligësi dhe mëkatë përpara Perëndisë, gjykatsit të drejtë.

---

## **E DJELË 27 OSE LLUKA X**

Ungjilli Lluka 13. 10-17.

### **FJALIM: Për shënjtërimin e së Djelës**

**"Gjashtë ditë janë, në të cilat duhet të punoni. Në këto pra të vini të shëroheni dhe jo ditën e shtunë".**

Dit' e madhe dhe e shënjtë për të krishterët: dit' e caktuar për të lavdëruar dhe për të adhuruar Perëndinë dhe ditë për punëra më tepër shpirtnore është dita e Djelë. Të Djelë Krishti mundi vdekjen dhe u ngjallë nga të vdekurit. Të Djelë duke u ngjallur na dhuroi dritën, jetën, ngjalljen. Të Djelë na dërgoi Shpirtin e Shënjtë për rilindjen e shpirtëve t' onë. E djela pra është dit' e shënjtë, dit' e Perëndisë dhe dit' e shpirtëve t' onë. Na imponohet për këtë ditë nderim dhe lavdi dhe shënjtërim. Por mjerisht për të shumtët e Djela e humbi kuptimin e saj, e humbi misionin e saj. Nga shkak i ynë u bë ditë dëfrimi, më e poshtme nga ditët e tjera të javës. Për këtë protestojmë? Po jo si i pari i synagogjis i ungjillit të sotshëm "gjashtë ditë janë, në të cilat duhet të punoni dhe jo ditën e shtunë" nga ligjësia e tij. Neve me besatari le të bëjmë fjalë sot për ditën e Zotit dhe le të themi qysh shënjtërohet e Djela dhe me ç' punëra e detyra do të shënjtërojmë ditën e shënjtë:

1. - Me pushim nga puna. Pushim nga punët e përditëshme, që punon cilido për rrojtjen e jetës së tij. Pushim pune e urdhëron Perëndia: "gjashtë do të punojsh dhe do të bësh gjitha punët e tua: dila e shtatë është sabbat (preh je) te Perëndia, Zoti i yt." Pas këtij urdhëri, të Djelë do të mbyllsh magazin t' ende, do të jet mbyllun tregu dhe zyrat, do të pushojnë bujqrit të punojnë tokën, do të prehen të mëdhenj dhe të vegjël. Kështu prehet trupi dhe merr kohë shpirti, që të shikojë punrat shpirtnore dhe hyjnore. Por disa nuk ndëgjojnë dhe thonë: "duhet të punojmë se janë shpenzimet të shumta"; dhe të tjerë thonë: "do të humbasë klientët e mij, duhet të hapë". Puna, e së Djelës nuk është dobi, është katarë dhe zemëratë. Puna e së Djelës është përbuzje e ditës së Perëndisë. Qysh do të na bekojë Zoti dhe qysh do të bëjmë prokopi? Po qysh do t' a shënjtërojmë të Djelën?

2. - Të vajturit në Kishë është detyra kryesore ditën e Djelë. Besojmë që Krishti është Perëndija dhe Zoti i ynë; e pranojmë që Ay vuajti për ne dhe u ngjall dhe është Shpëtimtari dhe mirëbërësi i ynë. Kemi pra detyrë të hapim thellësitat e shpirtit t' onë dhe t' i dërgojmë lavdi, adhurim dhe mirënjohje. Pastaj kemi shpirt dhe pranojmë që shpirti i ynë ka edhe mëkata edhe ngasje dhe reziqe; detyra e jonë është të kërkojmë ndjesë nga Njeridashësi dhe ndihmë dhe mbrojtje. Po ku? Jo në shtëpi t' onë, si kundër gjithnjë dhe ditë për ditë. Të Djelën në shtëpin e Tij, ku dërgohen lutje dhe falje dhe ndëgjoen predikim dhe bëhet therorja e pa gjakëshme. Atje të gjithë së bashku, si një familje, me një shpirt, me një zë do t' i falemi Perëndisë, do të ndëgjojmë Fjalën e Tij, do të marim bekimin dhe dhuratat e Tij. Po pse do të largohemi nga Kisha dhe ç' shkak do të gjejmë? Gruaja kurize e ungjillit të sotshëm, që vuante kaq vjetë, vinte në kishë dhe do të mungojmë neve: Të Djelë të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, burra e gra, të pasur e të vobegët me besë dhe shpresë do të vemi në kishë dhe do të marim pjesë në adhurimin e përbashkët të Krishtit t' onë. Pastaj:

3. - Studjimi i Librave të shënjtë. Të Djelavet mos t' a humbasim kohën nëpër rrugët,

në vizita dhe në kafenera e pijetore. Studjimi i Librit të Shënjtë është një detyrë e shënjtë, që nuk e plotësojmë ditët e tjera, do t' a plotësojmë të Djelavet. Jo pra romanera dhe këndime të papërshtatëshme, që molepsin shpirtin dhe prishin moralin. Ungjilli në duart dhe libra fetare dhe këndime morale, prej të cilavet shpirti ndriçohet, mëndja pastrohet, zemra qetësohet, vullneti forcohet dhe ndërgjegja zgjohet. Dhe kështu ecën njeriu në vepra mëshire dhe mirësi. Më në fund kemi detyrën:

4. - E mëshirës. Sa fatkeqë gjenden. Të vobegtë, të sëmurë, jetimë, të helmuar. Kush do t' i ngushëllojë këta dhe kush do t' i ndihmojë, veç se ne të vëlleznit e tyre të krishterët? Do të vemi atje ku mbretëron dhëmbja, mjerimi dhe shtrëngimi, burgimi që t' i u shpejmë ndihmën, ngushullimin dhe lehtësimin. Ay që fillon të Djelën me kishën dhe mbaron me bâmirësina, ay është me të vërtetë i krishterë dhe shënjtëron ditën e Djelë.

\* \* \*

Por është për të vajtuar: sepse jo vetëm të shumët nuk vemi në kishë, jo vetëm nuk e studjojmë Ungjillin, jo vetëm nuk bëjmë ndonjë bâmirësi, por mjerisht e poshtërojmë ditën e Perëndis s' onë. Sharjet dhe blasfemit ndëgjohehen më tepër të përfolurat dhe intrigat shtohen, dëfrimet e damëshme dhe imoralizimet bëhen më shumë në këtë ditë të shënjtë dhe kështu e ndryshojmë ditën e Zotit, në ditë të djallit, ditën e jetës në ditë vdekje. O Zot, bëhu i mëshirshëm! Ndjena dhe jepna vendim dhe ndreqje. Bëna të respektojmë ditën T' ende të shënjtë me vepra të mira Amin.

---

## **E DJELË (28) PAS LLUKAJT XI (14. 16-24)**

Shpiegim i Ungjillit

**"Tha Zoti këtë paravoli. Një njeri bëri një darkë të madhe dhe thëriti shumë. Dhe dërgoi shërbetorin e tij në orën e e darkës, që ti u thotë të ftuarvet. Ejani, se të gjitha tash janë gati".**

Me njerin paravolija kupton Perëndin. Darkë, që përgatiti Perëndia, është mbretënia e qiejvet, të cilën e ka përgatitur qysh në fillim të shekujvet për ne dhe në të cilën thëret gjith njerzit.

Mbretërin e qiejvet e përgjan me darkë të madhe, edhe për vlerën dhe shumicën e të miravet të mbretnis qiellore, dhe për shumicën e pa numëruar e të ftuarvet. Sepse në darkë thëret Perëndia pëgjithësisht gjithë njerzit.

**"Edhe gjithë zunë të mos duanë që të vijnë. I pari i tha atij. Bleva një arë, dhe kam nevojë të dal që t' a shohë. Të lutem, të mos më prisni. Edhe tjetri tha. Bleva pesë palë qee, dhe po vete për t' i provuar. Të lutem, të mos me prisni. Tjetri i tha, u martuash, prandaj s' mund të vijë".**

Zunë të gjith me një mendje, të mos duanë të vijnë në darkën. Ky mohim tregon dredhitë e atyre njerzve, që s' duanë të punojnë dhe të pregatisin shpirtet e tyre për darkën qiellore, në të cilën i theret Perëndia.

Bleva një arë, dhe kam nevojë të vete që t' a shohë. Për këtë, të lutem, mos më prisni në darkën. Këtë shkak gjen një nga të ftuarit, i cili përgjan ata njerës, që janë ngjitur në të mirat të dheshme dhe në kujdesjet lëndore, dhe për këtë gjë nuk interesohen dhe nuk përgatiten për darkën qiellore.

Këtilla shkaqe gjen dhe i dyti, duke thënë se bleu pesë palë qee dhe vete për t' i provuar.

U martova prandaj nuk mund të vijë. Ky i treti gjen shkak kujdesjet familjare, nga shkak i të cilavet s' mund të vejë në darkën qiellore.

**"Erdhi shërbetori dhe i lajmëroi të zotin e tij këto. Ahere u zemërua i zoti i shtëpis dhe i tha shërbetorit të tij. Dil shpejtë nëpër sheset dhe rugët e qytetit dhe bjerë këtu të vobektit, të çalë dhe të verbër. Edhe shërbetori tha. O zot, u bë sikundër urdhërove, dhe akoma vend ka".**

Zemërata e të zotit të shtëpis tregon dënimin, që ruan Perëndia mbi ata që nuk binden në thëritjen e Tij, dhe që nuk duanë të vijnë në darkën qiellore.

Dil, i thotë shërbetorit i tij, nëpër sheset dhe nëpër udhët kryq, dhe fut këtu të vobektit, sakatët (ata që kanë të prerë ndonjë pjesë të trupit tyre), çalët dhe të verbërit, të cilët çmojnë të mirat dhe darkën dhe thëritjen e zotit të shtëpis. Kësisoj Perëndia, duke përjashtuar nga Mbretnija e Tij ata që nuk u interesuan në thirjen e Tij; thëret njerës që kanë përrulësi dhe çmojnë të mirat e Tij. Kështu përjashtoi Perëndia Judhenjt, që nuk u bindën, dhe thëriti në shpëtimin në vend të tyre kombet e tjerë.

Shërbetori i tha Zotit tij. U plotësua urdhëri yt, por shumë vende tepërojnë në darkën. Me këto tregohet shumica e të miravet të mbretëris qiellore, e cila mund të nxërë miliona dhe biliona të ftuarësh.

**"Edhe i zoti i shërbëtorit tij. Dil në udhët dhe në gardhët dhe shtrëngo-i të hyjnë, që të mbushet shtëpia ime. Se po ju them, që asnjë prej atyre burrave të**

**ftuarve, do të gjërojnë nga darka e ime. Sepse shumë janë të ftuar, por pak janë të zgjedhur".**

Shumë janë të thëriturit prej Perëndisë, por pak janë ata, që përgatiten për darkën dhe të zgjedhur të Perëndisë. Vetëm ata do të hyjnë në mbretërinë e qiejvet.

MËSIME. - Me darkë të madhe barazon Zoti mbretërinë qiellore. Në atë janë gati jo të mira të dheshme dhe lëndore, por të mira shpirtnore dhe qiellore. Të mirat e lavdis, lumtëris dhe gëzimit të përjetshëm, që ka Ati qiellor në një shkallë të pakutizuar, këto do të japë trashëgim dhe në njerzit. Dhe është kaq dashurija e Tij për ne, sa nuk pushon të na thëresë, që të përgatitemi të marim pjesë në atë darkë të pa çmuar, që nuk do të ketë mbarim në jetë të jetëve.

Kjo gjë është e çuditshme dhe e pabesuarshme! Shumë njerës nuk interesohen për atë darkë qiellore, as nuk ndëgjojnë në thirjen e Perëndisë. Luftojnë për të mirat e dheshme, që janë për një kohë të shkurtër, dhe tregojnë mos interesim për të mirat qiellore, që janë të pavdekshme. Pranojnë ftesat për darkat e njerëzvet, dhe bëjnë veshin shurdh për thirjen e Perëndisë. Cili është shkaku? Pabesimi në fjalët dhe në premtimet e Perëndisë, akoma edhe dashurija e madhe për gjërat e dheshme.

Zakonisht gjithë ata, që shkelin porosit e Perëndisë, gjejnë zhustifikime. Edhe të ftuarit e paravolis, duke mos dashur që të venë për darkë gjejnë zhustifikime. Njëri gjoja ka punëra bujqësore, tjetri kujdesje për qetë dhe tjetri kujdesje familjare. Me të gjitha këto kërkojnë të fshehin mos interesimin e tyre dhe mos bindjen e tyre të paszhustifikuese, dhe duke dijtur që Perëndia nuk lozet as nuk gënjehet.

Zemërohet i zoti i shtëpisë. Sa e madhe ishte mirësija dhe bujarija e tij, kaq e madhe është nashti zemërata e tij kundër të ftuarve të pa vyer. Nuk është vetëm i tërëmirë, por është dhe i drejtë. Është i tërëmirë për ata që njohin dashurinë e Tij dhe binden në thirrjen e Tij. Por për ata që nuk binden dhe përbuzin madhësitin e Tij dhe mirësinë e Tij, Perëndia është gjykatës i drejtë dhe i fortë.

Në vënt të të ftuarve të parë u thërritën të rinj të këtillë. Por ka akoma vënt në darkën. Nuk është e ngushtë dhe e kufizuar mbretërija e Perëndisë. Sa e madhe është dashurija e Tij për ne, kaq e madhe dhe e gjërë është mbretërija e Tij, që mund të nxerë shumica të pa numërta. Sepse të gjithë pa përjashtim do që t' i shpëtojnë Ati qiellor dhe të gjithë t' i bëjnë trashëgimtarë e të miravet e Tij qiellore.

---

**E DJELË 28 PAS LLUK. XI**

**FJALIM: Për kungimin hyjnor**

**"Një njeri bëri një darkë të madhe dhe ftoi shumë".**

E dyfishme është darka që, simbas parabolis së sotshme, na shtron Perëndia neve njerzvet. Darka e parë është mbretëria e qiejvet e pavdekëshme, ku janë vallet e Apostojvet dhe e shenjtorëvet, ku janë psalmmodhit e engjejve, ku është froni i Perëndisë. Darka e dytë është Mysleri i Kungimit hyjnor, që bëhet mbi dhé, dhe të ngrehë në qiejt, darka misterioze dhe hyjnore, që është garancia e shpëtimit të shpirtvet t' onë dhe siguria e hyrjes për në mbretërin qiellore?

1. - Cila pra është darka? Është trupi dhe gjaku i Shpëtimtarit t' onë. E tha vetë Krishti në Darkën Mystike: «merni, hani, ky është trupi im» edhe: «pini prej këtij të gjithë: ky është gjaku im». Dhe Apostoll Pavli më letrën mbi Korinthianët thotë: «Potiri i bekimit që bekojmë na, nuk është kungimi i gjakut të Krishtit?» «E bukën që thyejmë nuk është kungimi i trupit të Krishtit?»

Ç' cudi e shenjtë! Buka dhe vera bëhen Trup dhe gjak i Krishtit dhe kungimi i tyre na bashkon me Perëndin t' onë të pakufishëm!

Për ç' qellim? «Për ndjesë të mëkatavet dhe për jetë të përjetëshme». Ç' dhurëti, ç' mirësi e Perëndisë çër njerin mëkatarë. Na ushqen me Trupin e Tij, na gjallëzon me Gjakun e Tij, si mëma djalin e saj. Po qysh bëhet kjo? Qysh ndryshohet buka dhe vera në Trupin dhe Gjakun e Krishtit? Ky është myster i madh dhe i pa kuptuarshëm: dhe mysteret nuk i bisedon, as mund t' i shpiegojë njeriu, vetëm i beson. Mjafton t' i thotë Perëndia dhe njeriu i logjikshëm i beson dhe i falet. Dhe kungon Trupin me Gjakun e Krishtit «për ndjesë të mëkatave dhe jetë të përjetëshme».

2. - Po kur është koha e kungimit të shenjtë? Sa herë të jemi gati, sa herë që ati shpirtnor na e lejon. Por medoemos katër herë në vit me rasë të kreshmëvet, kur bëhet pregatitja e duhur. Por mjerisht ka të krishterë, që janë larguar nga kungimi me vjete disa nga frika dhe disa nga një indiferencë të plotë. Përse kaq ligësirë dhe mëkatë ndërmjet nesh? Sepse djalli na zotnon dhe na ka pushtuar. Por, vllëzër, kungimi hyjnor është ushqimi i shpirtit, është fuqija dhe jeta e tij. Ç' i duhet trupit që të rrojë dhe mos të vdesë? Duhet të hajë gjithnjë dhe rregullisht. Kjo ngjanë dhe me shpirtin. Që të rrojë dhe të mos vdesë vdekjen e përjetëshme, që të jetë i shëndoshë dhe i fortë për t' u larguar nga mëkata, duhet gjithnjë të hajë bukën e jetës dhe të pijë gjakun e jetës, d.m.th. Trupin dhe Gjakun e Krishtit, i cili është burimi i jetës. Prandaj Zoti thot: «ay që Trupin t' im dhe pi Gjakun t' im» d.m.th. ay që ha rregullisht dhe gjithnjë nga Trupi

im dhe pi nga gjakun im, ay ka jetë të amëshuar.

3. - Por duhet më përpara të jemi pregatitur mirë. Kur kemi për të pritur një person me rëndësi, përgatitim shtëpinë t' onë, e pastrojmë dhe e zbukurojmë. Por ka më të lartë se Krishti? Ay është mbreti i mbretërve, Zoti i zotnuësve, Perëndia mbi të gjithë. Me të këtillë përgatitje na thërret prifti, që të na kungojë: «me frikë Perëndije, besë dhe dashuri afërohuni». 1) Me frikë Perëndije, d.m.th. me heshtje frike Perëndie dhe me ngjethje të thellë; kështu që të mungojnë të shtytyrat dhe zërat. Me agjërim dhe falje dhe përujje të madhe, por më tepër me pendim të thellë dhe me rrëfim të sinqertë e durim duhet të kungohemi. Në këto udhëheq frika e vërtetë, dhe dashuria për njani tjetrin sepse me rrëfimin e pendimin pastrohet shpirti për të pritur Krishtin. 2) Me besë. me besë të nxehtë dhe jetëprurëse. Ç' të besojmë? Që ato që marim, është Trupi dhe Gjaku i Krishtit të kryqëzuar. Le të shikojnë sytë bukë e verë, po shpirti do të shikojë në ato Zotin Perëndinë e tij. Dhe do të vejë pa dyshime, me bindje të plotë, që pas kungimit shenjtërohet dhe mer ato që i duhen për të hyrë në mbretërinë qiellore. Larg, larg të pabëset dhe ata që dyshojnë për mysteret e jetës; vetëm besatarët le të afërohen. 3) Me dashuri. Dashuri të Perëndia më parë, i cili kaq dashuri tregon për neve, kur na thëret në kungimin hyjnor. Dashuri të i afërmi t' onë së dyti, i cili është blerë me gjakun e Krishtit dhe është vllaj i ynë. Çdo padrejtësi që të ka bërë, larg urrejtja; ndjeje përpara, se të marrish kungimin e shenjtë. Mysteri na tregon dashuri, edhe neve duhet të tregojmë dashuri.

«Me frikë Perëndije, besë dhe dashuri afërohuni». Shumë drejtë, se i shenjtë është kungimi, i shenjtë është edhe qellimi i tij. E shenjtë duhet të jetë edhe mënyra, me të cilën afërohemi. Sepse duhet të dimë: kungimi nxehtë, dhe jep gjallni shpirtit, por edhe e djeg. Është zjarr dhe flakë, që djeg të pavyerin dhe mëkatarin, i cili kuxon të afërohet pa besë, pendim dhe dashuri. Le të përgatitemi, kur të kungojmë. Krishti na pret me dashuri, që të na ushqejë me Trupin dhe Gjaku të Tijë të Tërshenjtë dhe të na tregojë mundësinë të mëkatës dhe pastaj të na presë në darkën qiellore të jetës së përjetëshme, në të cilën dëshiroftë Zoti të hyjmë të gjithë. Amin.

---

## **E DJELË 30 PAS LLUKAJT 13 (18. 18-27)**

Shpiegim i Ungjillit

**"Në atë kohë erdih te Jisuj një njeri duke rënë ndër gjunj dhe duke thënë. Mësonjës i mirë, ç' të bëjë që të trashëgojë jetë të pa sosur. Jisuj i tha, pse më thua i mirë, asnjë s' është i mirë, përveç një, Perëndija".**

Një njeri e pyet Jisun, ç' punëra të mira duhet që të bëjshë për të trashëguar jetën e

përjetëshme. Ky njeri e konsideronte Krishtin si njeri të thjeshtë. Prandaj Zoti i thotë, ç' më quan "i mirë", kur më pandeh njeri të thjeshtë? Vetëm Perëndia është i mirë. Sepse fjala "i mirë" në kuptimin e saj të plotë tregon atë njeri, që ka përsosuri nga ç' do pikpamje.

**"Porosit i di. "Mos kurvëro" "mos vrit" "mos vith" "mos jep dishmi të rremë" "ndero atin dhe mëmën t' ende". Ay i tha, këto i kam ruajtur qysh prej djalëris s' ime".**

Me qenë se ay njeri nuk ishte akoma i përgatitur, që të besojë te Krishti, prandaj Zoti e porositi që të ruaj porosit e nomit të Moisiut si mjet për të fituar jetën e amëshuar. Sepse po të ruante këto porosi lehtësisht do të udhëhiqesh edhe në besën e Shpëtimtarit.

Të gjitha porosit i ruajta qysh prej djalëris s' ime. Këto thotë ay njeri. Por, si duket më poshtë, nuk kishte ruajtur gjitha porosit me pikëri, sado që pandente, se i kishte ruajtur. Sepse më poshtë duket, që kishte një dashuri të madhe për pasjen. Sepse i këtillë njeri është e vështirë të ruajë detyrat e tij kundrejtë të afërmit.

**"Mbasi ndëgjoi Jisuj këto, i tha. Një vetëm të mungon; të gjitha sa ke shiti, dhe shpërnda-i të vobektëve, dhe do të kesh thesar në qiell, dhe eja të më vish prapa".**

Me qenë se Zoti pa, që ay njeri dëshironte një gjë më të lartë, i tha atij; akoma një gjë të mungon, që të bëhesh trashëgimtar i jetës së pa sosur. Shiti të gjitha sa ke dhe shpërnda-i të vobektëve. Këtë porositi Zoti atij njerin, sepse e dinte që ishte pushtuar nga pasioni i argjenddashjes, e cila i bëhesh pengësë për shpëtimin e tij. Mohimi i pasjes është e detyruar, kur ajo bëhet pengësë në shpëtimin e shpirtit.

Në vend të pasjes lëndore, që do të lësh, do të kesh thesar shpirtnor në qiell. Këtë i tha Zoti, se ay njeri, duke pasur ndër mend thesarët e vërtetë në qiell, të çqitet më lehtë nga dashurija e thesarëve të kësaj bote.

Dhe eja të më vish prapa, që të mësosh udhën e virtutit dhe të jetës së përjetëshme.

**"Edhe njeriu, kur ndëgjoi këto, u bë i helmuar. Sepse ishte tepër i pasur".**

U helmua, sepse, sado që dëshironte të vinte prapa Krishtit, nuk donte të ndahesh nga pasja.

**"Kur e pa Jisuj, që u bë i helmuar, tha. Sa me të vështirë pasanikët do të hyjnë**

**në mbretërin e Perëndis. Ma lehtë është kamilja të hyjë në vrimën e gjylypërës, se të hyjë i pasuri në mbretërin e Përëndisë".**

Më e lehtë është të hyjë kamilja nga vrima e gjylypërës, se i pasuri të hyjë në mbretërin e Perëndis. Qysh mund të bëhet e para? Vetëm me çudi, me fuqin e Perëndisë. Edhe i pasuri pra mund të shpëtojë me atë prapë mënyrë, me fuqin dhe me ndihmën e Perëndisë.

**"Ata që ndëgjuan thanë. Dhe kush mund të shpëtojë? Jisuj tha, të pa mundëshme përpara njerëzve, janë të mundëshme përpara Perëndisë".**

Dëgjuësit u habitën për këtë fjalë të Shpëtimtarit. Sepse pandehin që pasanikët mund të shpëtojnë më lehtë, me qenë se kanë të gjitha mjetet për të bërë të mira. Prandaj pyesin. Kush vallë mund të shpëtojë, kur puna është e vështirë edhe për ata që janë të pasur?

Ato që nuk bëhen me fuqin e njeriut, ato bëhen shumë lehtë me fuqin dhe ndihmën e Perëndisë.

MËSIMI. - I mirë pikërisht dhe plotësisht është vetëm një Perëndia. Ajo përmbledh në Vetën e Tij me përsosuri gjitha cilsi të mira, gjithë shenjtërin dhe është burimi i çdo të mirë dhe çdo shenjtërie. Për këtë bij të vërtetë të Perëndisë janë vetëm ata, që mundohen dhe luftojnë, për të imituar, sa të jetë e mundur, cilsi të mira të Atit qiellor, që të bëhen të plotë në virtut dhe shenjtore, sikundër dhe Ati ynë është i plotë dhe i shenjtë.

Djaloshi i pasur kishte ruajtur porositë e Perëndisë vetëm në sipërfaqe, dhe jo pikërisht. Sepse ndryshe nuk do t' i ishte ngjitur kaq më dashurimin e pasjes. Adhuronte jo vetëm Perëndinë, por edhe Mamonan. Adhuronte Perëndinë vetëm me disa vepra të përjashtme, kurse zemra e tij shërbente në dashurimin e pasjes. Prandaj midis Perëndisë dhe pasjes, preferoi pasjen. Këtyllë janë njerëzit, të cilët përjashta duken, sikur plotësojnë porositë e Perëndisë, por zemrën e tyre u a kanë dorëzuar tjerë zotërve dhe jo Perëndisë.

Me qenë se i pasuri donte pasjen, Zoti i tregon thesaret në qiell, që as prishen, as çmohen. Ç' barasim mund të kenë të gjitha të mirat e botës, me ato të mira të përjetëshme dhe qiellore? Me gjithë këtë s' është i pa mundshëm fitimi i tyre. Jep pasjen të vobektëvet dhe zemrën të Perëndisë, dhe bëje trashëgimtar i të mirave qiellore. Por i pasuri beson ato gjëra, që shikon. Në vend që të dojë të ardhmet, do të tashmet. Në vend që të dojë të mirat shpirtnore, do të mirat lëndore. Prandaj u bë i pa vyer për thesaret e qiellit.

Kush mund të shpëtojë? Ja një porblemë e madhe. Në qoftë se, ata që kanë gjith mjetet për të punuar virtutin, me të vështirë hyjnë në mbretërin e Perëndisë, qysh do të hyjmë të tjerët? Me gjith këtë mbretëria e Perëndisë blihet më lehtë me vobegsin dhe me mos pasjen, se me pasjen dhe me shumicën. Çdo njeri mund t' a fitojë duke vepruar virtutin me ato mjete që ka dhe që mori nga ana e Perëndisë.

Me të vërtetë lufta e virtutit është me shumë mundime dhe me shumë vështirësi, dhe nuk fitohet dot shpëtimi i shpirtit, po të bazohemi në fuqit t' ona. Por nuk jemi vetëm në këtë luftë. Ati qiellor, i cili na ka therritur në shpëtimin, Ay na premtonte dhe na jep ndihmën e Tij. Në qoftë se ne jemi të pa fuqishëm, me hirin e Perëndisë bëhemi të fuqishëm dhe fitojmë me lehtësi shpëtimin e përjetshëm.

---

## **E DJELË 30 OSE LLUK. 13**

Ungjilli Lluk. 18. 18-27

### **FJALIM: Për shpëtimin e njeriut**

**"Ato që janë të pa mundëshme përpara njerëzvet, janë të mundëshme përpara Perëndisë".**

Të pa mundura! thërresin shumë nga njerëzit, të pa mundura sa kërkon Ungjilli dhe kanë të drejtë nga një pikpamje; sepse njeriu, siç është dhe ndodhet, është e pa mundur me fuqit e tij të fitojë virtutin dhe shpëtimin. Vetëm Perëndia është fillimi dhe mbarimi i shpëtimtarit t' onë shpirtnor. Por prapë shpëtimi nuk vjen vetë dhe pa pandehur, por duhet dhe njeriu të punojë dhe të mundohet. Ç' të bëjë? I a tregoi Zoti të pasurit në Ungjillin e sotshëm, i cili u duk, që sikur kërkonte shpëtimin e tij; gjitha sa ke shiti dhe shpërnda i të vobektëve dhe eja prapa meje; d.m.th. i rekomandoi dy gjëra: të luftojnë pasionin e argjenddashjes, që kishte dhe të afërohet te Perëndia. Këto të dyja duhet të bëjë dhe çdo mëkatar për të gjetur shpëtimin e tij.

### **I**

Të luftojmë pasionet t' ona mëkatore.

1. - Ç' janë këto pasione? Janë një fuqi e madhe e frikëshme dhe e paluftuarshme, që e mban njerin shërbëtor të mëkatës. P.sh. e shojmë fatkeqësin e tjetrit, urin, mjerimet e tij: Duamë dhe mundohemi t' i vijmë për ndihmë, por nuk e ndihmojmë. Kush na ndalon. Pasioni i argjenddashjes, që lidh me zinxhira duart dhe këmbët t' ona, që mos të bëjmë të mirën. Ndalim tjetër për shpëtimin e shpirtit t' onë janë shpërdorimet e

djalëris. Përballojmë urtësin dhe pastërsin e shpirtit dhe të trupit. Ç' virtut engjëllor! E pranojmë bukurin e saj morale, vlerën e saj të lartë, madhësitin e saj të ndritëshme. E dëshirojmë dhe kërkojmë dhe për vehten t' onë, që të shdukim çdo ndyrësi të shpirtit dhe të trupit; por shpërdorimet mbytin dhe shuajnë çdo dëshirë të shenjtë për jetën ideale. Ç' thotë zakonisht i riu? «Jam i ri, do të gëzojë jetën». Dhe ç' kupton me këtë? Që si i ri, duhet të lojë, të rij natën, të dëfrojë me pije alkoolike, që i dëmtojnë shëndetin, të gëzojë në qendra të shëmtuara, që i rëzojnë çdo dignitet; me një fjalë të zhytet në ndyrësitat e mëkatës. Kaq është fuqija e ligësisë dhe pushteti i mëkatës. Skllavëri e frikshme dhe zgjedhë tyrnike. Dhe kështu largohen nga kisha, nga predikimet, nga falja, nga kungimi.

Tjetër ndalim për shpëtimin e shpirtit. Duamë të jemi të butë dhe të harrojmë padrejtësin, që na bëjnë, dhe mos të hakmarrim. Por vjen një orë e ligë dhe shajmë dhe kërkojmë t' i a kthejmë padrejtësin. Ç' ngjau. Pasioni i zemëratës u vërsul dhe na turbullojë shpirtin dhe na përmbysi çdo mendim të mirë.

2. - Ç' duhet të bëjmë? Duhet luftë për çlirim; luftë e rreptë dhe kundështim pa pushim; goditjet duhet të jenë vendimtare kundër mëkatës dhe masat të jenë të plota. Mos bisedo, kur je i zemëruar, ndjeje atë, që të ka bërë padrejtësira, bëj të mira atij, që e urren, jep të vobegtëbet, mos kujto skenat e turpëshme të mëkatës. Ndofta këto na duken të pa mundëshme, por vjen ndihma e Perëndis, që na thotë në Ungjillin e sotshëm "të pamundëshme te njerzit janë të mundëshme te Perëndia".

## II

Ç' do të bëjmë që të shpëtojmë?

1. Do të përikim te Perëndia, i cili është i Tërëmirë dhe do të na shpëtojë. Për këtë dërgoi dhe Birin e Tij në botë, që të shpëtojë botën. Perëndia është i Tërëfuqishëm dhe mundet të na shpëtojë. Dridhet fuqija e armikut, kur përballon fuqin e Perëndis. Se Zoti tha: "pa mua nuk mundni të bëni asgjasendi". Edhe kur është Zoti bashkë me ne, dërmohet fuqija e mëkatës, çrenjosen pasionet, shërohen ligësitat, pastrohen zemrat dhe shenjtërohen shpirtet.

2. Qysh dotë përikim? Me pendimin, me faljen dhe me kungimin. Ç' është pendimi: Pendimi është bari që pastron shpirtin, është goditja e vdekëshme kundër mëkatës dhe hapa kryesore e shpëtimit: po me një konditë, që pendimi të jet i singertë, dhe rrëfimi i thellë. Ç' është falja? Është drita i të errësuarit dhe fuqija e të pa fuqishmit. Po. Errësirë dhe pa fuqi të mëkata, edhe kur ikën. Dhe falja e regullë, e nxehtë, e përlulët dhe e përzemërtë lidh njerin me burimin e dritës, që t' a ndriçojë dhe t' a fuqizojë në luftë kundër mëkatës. Ç' është kungimi? Jeta e besnikut jeta e shenjtë. Kungimi

bashkon njerin me Krishtin dhe me anën e atij qëndron Krishti te njeriu, që t' i dhurojë jetën e shënjtë, që t' armatosë me kuxim dhe fuqi hyjnore për të luftuar trimërisht dhe për të dërmuar armikun dhe për të ecur me hapa të sigurta udhën e shpëtimit. Fuqin e kungimit e ndjejnë ata që "afrohen me frikë Perëndije, besë dhe dashuri" në këtë myster.

\* \* \*

Vllezër, le të vijmë në vehte. Lartë nga kjo jetë e përkohëshme dhe përtej varrit të ftohtë zgjerohet jeta e përjetëshme, e pa anëshme dhe e lumtur. Nuk është krijes e fantazis s' onë, po është e vërtet. Na e çfaq fjala e Perëndis, na e vërteton shpirti ynë i shqetësuar, i cili dëshiron një prehje të plotë në jetën e amëshuar. Po pengimet janë të mëdha dhe armiqt përçark nesh të shumtë. Mjerë, në qoftë se kotësirat e kësaj jete, na bëjnë të humbasin lumtërin e jetës të pavdekëshme. Të vërejmë mos t' i përngjasim djaloshit të sotshëm. Le të largohemi nga çdo mëkatë dhe abuzim; le të largohemi nga mendimet e rrotjes në kotësirat e jetës. Le të ngrejme lartë zemrat t' ona, sepse atje është atdheu i ynë i vërtetë. Atje na pret Perëndia, Ati ynë qiellor, që të na dhurojë pasje të pa vdekësme e gëzim të përjetshëm. Amin.

---

## **E DJELË PARA LINDJES-KRISHTIT**

Shpiegim i Ungjillit (Math. 1. 1-25)

**"Libri i lindjes së Jisu Krisht, biri Dhavidhit, biri Abraamit ...".**

Lindja e Jisu Krishtit trupërisht nga fara e Dhavidhit dhe Abraamit është kjo.

Krishtit quhet i biri Dhavidhit dhe i biri Abraamit, jo vetëm se e ka origjinën trupërisht nga fara e këtyre të drejtëvet, por edhe se këtyre ishin dhënë prej Perëndisë premtime të mëdha për ardhjen e Shpëtimtarit në botë. Abraamit i ishte premtuar prej Perëndisë, se me anën e Krishtit, që do të lindej nga fara e tij, do të vijë bekimi i Perëndisë dhe shpëtimi në gjith kombet. Mbretit Dhavidhit i ishte premtuar, se nga fara e tij Perëndia do të ngjallte mbret të përjetshëm dhe shpëtimtar të botës.

Në atë kohë që Judhenjtë u shpunë rrobër në Babylioni prej mbretit Navukodhonorit.

**"Lindja e Jisu Krishtit u bë kështu: Kur u fejua e ëma e tij Maria me Josifin, përpara se të bashkoheshin, u gjend e mbarsur me fuqin e Shpirtit Shenjtë. Josifi burri i saj, me qenë se ishte i drejtë dhe nuk donte t' i nxirte emër të ligë, donte t' a dëbonte fshehurazi".**

Josifi quhet burri i gjithmonë Virgjërës Mari, jo se e kishte atë grua, por vetëm se ishte fejuar me atë. Sepse nër Judhenjt edhe i fejuari quhej burr. Virgjërësha Mari ishte fejuar me Josifin për këto shkaqe. Të parën, që të duket Josifi si burr i Maries. Sepse po të pillte Shpëtimtarin pa dukur e lidhur me burr, lindja do të dukesh jo ligjore, dhe atëhere pas nomit Mosaik duhej të vritet Virgjërësha. Të dytën që të tregohesh Krishti prej origjinit nga fara e Abraamit dhe Dhavidhit dhe të tretën që të shërbejë Josifi në mysterin e math të trupësimit të Birit të Perëndisë, dhe kështu Virgjërësha e Shenjtë të ketë ndihmës dhe mbrojtës në peripetirat e ndryshme të Lindjes së Shpëtimtarit.

Përpara se të vijë në bashkim. Këtë thotë Ungjillori, që mos të pandehet, se ishte lindja natyrale.

Josifi dyshoi për mbarsjen e Virgjërësës së Shenjtë. Por tue mos dashë, që t' a dëbonte botërisht, u mendua se më e urtë do t' ishte t' a dëbonte fshehurazi.

**"Kur po mendonte Josifi këto, ka, engjëlli i Zotit i u duk në ëndërr duke thënë: Josif, biri i Dhavidhit, mos ki frikë të marrish gruan t' ende Mariam; atë që ka zënë ajo është nga Shpirti i Shenjtë. Do të lindin dhe djal dhe do t' a quash emërin e tij Jisun; ay do të shpëtoj popullin e tij nga mëkatat e tyre. Gjith kjo u bë, që të mbushet e thëna prej Zotit me anën e profitit, i cili tha: "Ja Virgjërësha do të mbarset dhe do të lindin bir dhe do t' a quajnë emrin e tij Emmanuil" që përkthehet, me neve Zoti. Mbasi u ngrit Josifi nga gjumi, bëri si e urdhëroi engjëlli i Zotit. Dhe mori gruan e tij dhe nuk e njohti atë, deri sa lindi birin e saj të paralindurin dhe e quajti atë Jisun".**

D.m.th. nuk është i vërtetë dyshimi yt, prandaj mos ki frikë aspak të mbash afër teje Virgjërësën e Shenjtë. Sepse djalin, që ka ajo në barkun e saj, është me fuqin dhe veprimin e Shpirtit Shenjtë.

Me zënien e Krishtit në barkun e Virgjërësës së Shenjtë u mbush parathënia e profitit Isaia, i cili paratha lindjen sipërnatyrale e Shpëtimtarit nga Virgjërësha.

Emri Emmanuil është nga kuptimi një me emrin Jisu. Emmanuil përkthehet, bashkë me neve Zoti. D.m.th. Perëndia është në mes t' onë me anën e të mishëruarit Birit dhe Fjalës së Perëndisë, prej të cilit miqësohemi dhe bashkohemi me Perëndin, dhe kështu bëhet Perëndia e jonë dhe neve bëhemi populli i Tij.

Josifi aspak nuk erdhi në bashkim me atë, Këtë e përsëriti Ungjillori, që mos të pandehet, se Lindja e Shpëtimtarit u bë natyrale. Dhe jo vetëm përpara lindjes së Shpëtimtarit, por edhe më pastaj Mëma e Shenjtë e Zotit mbeti gjithmonë Virgjërësë.

Në qoftë se thotë këtu Ungjillori «deri sa lindi birin e saj», këtë e thotë, se interesohet kryesisht të tregojë, se lindja ishte sipërnatyrë.

MËSIME. - Si Perëndi Krishti u lind pa kohë prej Atit. Si njeri u lind në kohë të caktuar dhe ka shtërgjyshër nga fara e Abraamit dhe Davidhit, dhe u lind nga Virgjëresha e Shenjtë Mari. Tue qenë Perëndi e vërtetë, u bë dhe njeri i plotë. Zbriti nga lartësija e lavdis së Tij hyjnore dhe u bë njeri, që të na lartësojë neve njerzit në lavdi dhe lumturi hyjnore.

Shumë e përlutë lindja e Shpëtimtarit. E ëma e Tij nuk është e pasur dhe fisnike pas botës me titull të math, por një Virgjëreshë e vobektë nga Nazareti. Vetëm stolija e saj është virtuti i saj i lartë dhe pasunija e saj e vetme është shenjtëria dhe përlulja e saj. Këfillë mëmë zgjodhi Zoti për të treguar, se Ay zgjedh dhe konsideron të vyer ata që kanë cilësira shpirtnore, pasunin e virtutit.

Sado që fenomenet janë njerzore, por me gjith këtë lindja e Shpëtimtarit bëhet midis ngjar jesh të çuditëshme. Mëmë virgjëreshë lind çuditërisht me hirin dhe veprimin e Shpirtit Shenjtë, simbas profitisë të profitit Isai. Engjëlli i Perëndisë ndriçon Josifin për lindjen e çuditëshme dje e bën shërbetor dhe ndihmës të qëllimit hyjnor. Edhe foshnja hyjnore merr emrin nga vetë Perëndia simbas misionit Tij të math në botë.

Jisu është emri, që i dha Perëndia Birit Tij të mishëruar.

Jisu d.m.th. Shpëtimtar, sepse do të na shpëtojë nga mëkata dhe nga vdekja dhe do të na udhëheqij në jetën e përjetëshme. Do të shpëtojë jo të gjithë pa përjashtim, por popullin e Tij. D.m.th. ata që njohin origjinën e Tij hyjnore dhe misionin e Tij dhe pasojnë me devotesë fjalët e Tija.

---

## **E DJELË E PARALINDJES KRISHTIT**

Ungjilli Math. 1. 1-25

**FJALIM: Për stërgjyshërit e Krishtit**

**"Libri i lindjes Jisu Krishtit, i biri Davidhit, i biri Abraamit".**

Cilët nderon dhe lavdëron Kisha duke parakremtuar lindjen e Krishtit? Stërgjyshërit e Shpëtimtarit. Shikoni, një shumicë emerash, por sipër të gjithëve: më të mëdhenj të stërgjyshëve Abraami, Dhavidhi dhe Josifi. Abraami në fillim, Dhavidhi në mest dhe Josifi në fund. Ç' nderje për ata, i biri Perëndis dhe biri i tyre dhe lëçitet në gjithë

brezat e njerëzvet. «Libri i lindes të Jisu Krishtit, të birit Dhavidhit, të birit Abraamit». Këta zgjodhi Perëndia të bëhen stërgjyshërit e Birit të Tij, se këta e vyenin. Abraamin për besën e tij, Dhavidhin për dashurin e tij dhe Josifin për shenjtërin e tij.

1. - Abraami për besën e tij. Cili është Abraami? Abraami është Patriku i Israilitëvet, po është dhe Patriku i besës, se beson ç' i thotë Perëndia dhe ato që duken të pakuptuara dhe të pamundura. Perëndia i tha: nga gjenija jote do të lindij Shpëtimtari i botës: «do të bekohen në farët t' ende gjith kombet e dheut». Shkojnë vjetet dhe ay s' kishte djalë. Por Abraami nuk e humbet shpresën dhe e pret me bindje të plotë. Dhe me të vërtetë fjala e Perëndisë plotësohet, se Abraami lindi Isaakun, kur ishte 100 vjeçë dhe gruaja e tij 90 vjeçe dhe nga natyra beronjë. Prapë Perëndia kërkon të provojë besnikërin e Abraamit. E urdhëron të marrë djalin dhe t' a therorizojë në mal. Po ahëre ku është stërnipi, që do të shtojë farën e tij? Po këto nuk i mendon Abraami; një vetëm di, që i Tërëfuqishmi të gjitha mundet t' i bëjë. Pa ankime plotëson urdherin e Perëndisë. Kjo do të thotë besë; pa dyshime, pa mendime, por besim të plotë në fjalët e Perëndisë. Shkëmb bese Abraami fenomen për kohën e tij, shëmbullë për kohën t' onë, prandaj u vlerësua të bëhet stërgjyshi nga mishi i Shpëtimtarit.

2. - Dhavidhi për dashurin tij. Në Dhjatën e Re nxënësi i dashurisë është Joani Ungjillori, por në Dhjatën e Vjetër kryeson Profiti dhe Mbreti Dhavidh. E dashuron Dhavidhi Perëndin. Ditë e natë dëshiron Perëndin; psal e lavdëron Perëndin. Në psalmet e tij të pavdekshëm derdhet gjith shpirti i tij. Nuk ka për atë tjetër gjë më të dëfryëshme nga ajo, se të çfaqë te Perëndia thesarët e dashurisë së tij dhe t' a psalë me lyrën e tij ëmbëlzëshme. Psal Perëndin nëpër male dhe kodra, kur ishte bari, por e psal dhe në pallatet e tij, kur u bë mbret. Psal madhështin e perëndisë së pakufishme dhe shenjtërin e Tij. Por mjerisht Dhavidhi mëkatoi dhe ra njerin i zgjedhur i Perëndisë. Ra, por u ngrit, se u pendua edhe qau me hidhërim edhe derdhi lumenj lotësh. Përse? Sepse hidheroi Perëndin me mëkatën e tij, sepse fyeu atë që dashuronte. Shkaku i pendimit të tij, prap ishte dashuria. Për këtë duhet të pendohemi dhe ne, kur mëkatojmë dhe të qajmë me hidhërim; jo se poshtërsohemi në syt e botës, por se hidhërojmë Atin t' onë qiellor dhe fyejmë e Tij të Tërëshenjtë. Këtille pendim tregoi Dhavidhi te Perëndia dhe dashuroi Perëndin më tepër pas pendimit të tij. Qysh mos t' i çmojë Perëndia dëshirat dhe ndjenjat e tij? Dashuria e tij te Perëndia e vlerësoi të bëhet dhe ay stërgjysh i Shpëtimtarit dhe të quhet «i biri Dhavidhit» i përmbiqënushmi i Biri i Perëndisë.

3. - Josifi për shenjtërin e tij. Ungjilli e quan «i drejtë» dhe engjëlli i thërret «Josif, i biri Dhavidhit». Edhe i drejtë dhe i shenjtë me të vërtetë ishte. Dhe prova është qëndrimi i tij kundrejtë Virgjëreshës Mari. E shikon shtatzënë dhe ku të imazhinojë, se të mbarsurit e sajë është nga Fryma e Shenjtë. Hidhërohet pa masë, por nuk pranon ndërgjegja e tij të mbajë një fajtores, si e mendonte. T' a dorëzojë në gjyq dhe t' i nxirte

emër të lig, nuk e pranonte zemra e tij e mirë. Vendosi që t' a dëbojë fshehurazi pa çfaqur ndonjerit shkaqet. Por engjëlli i Zotit ndërhyri: «Josif, i biri Dhavidhit, mos ki frikë të marrish Marien gruan t' ende, se të mbarsurit e saj është nga Fryma e Shenjtë». Josifi ndriçohet dhe me gëzim në shpirtin e tij dhe me mirënjohtje te Perëndia që i bëri këtë nderje të lartë, merr përsipër të mbrojë dhe të ndihmojë Virgjëreshën dhe të bëhet ati i adoptuar i Krishtit, i cili pandehesh i biri Josifit nga Nazareti.

Po. Ju kishte hije kjo nderje e madhe, o stërgjyshër të lavdëruar të Zotit. Ju kishte hije për madhësitin e shpirtëvet t' uaja. Edhe ne tash admirojmë virtutin t' uaj dhe atë dëshirojmë. Besën e patundur t' ende, o at Abraam; dashurin t' ende të pashterëshme te Perëndia, o Dhavidh i lavdëruar; Shentërin t' ende, o i drejtë dhe i bekuar Josif. Lutuni Atij, që u foshnjerua për ne dhe u lind në shpellë, që të forcojë besën t' onë, të pastrojë shpirtet t' onë dhe kështu të jemi të vyer të kremtojmë Lindjen e Tij Shpëtimtare. Amin.

---

## 25 DHJETOR LINDJA E KRISHTIT

Shpiegim i Ungjillit (Math. 2. 1-12)

**Mbasi lindi Jisuj në Vithleem të Judhesë, në ditët e mbretit Irodhi, Ja magë nga lindja mrritën në Jerosalim, duke thënë. Ku është mbreti i Judhenjvet, që lindi. Sepse pamë Yllin e tij në lindje dhe erdhëm që t' i falemi."**

Magët ishin shkencëtarët e asaj kohe, që merëshin më tepër me astrologjin. Magët që shënohen këtu, ishin njerës besëmirë; prandaj Perëndia u tregoi një Yll të ndriçëm, që ishte dukur jashtzakonisht, prej të cilit kuptuan që një mbret i math nga Perëndia lindi në Judhe. Prandaj duke ikur nga vëndi i tyre, erdhën në Jerosalim, që t' a gjejnë dhe t' i falën.

**Kur ndëgjoi mbreti Irodhi u tromaksë dhe gjith Jerosalim me të. Dhe mbasi mlodhi gjith kryepriftërit dhe shkronjësit e llauzit, pyeste për të marrë vesh prej atyre, ku lindet Krishti".**

Ardhja e magëvet në Jerosalim dhe vërtetimi i tyre, që lindi një mbret i math, e tromaksi Irodhin, i cili kishte frikë, se mos humbiste fronin. Ngriti dhe Judhenjt, të cilët me dëshirë të gjallë prisnin, kur do të vijë Messia.

Donte të mësonte nga kryepriftërit, cili do të ishte vendi, ku do të lindte Krishti. Dhe ata simbas profitit u përgjegjën, që në Vithleem të Judhesë.

**"Edhe ata i thanë. Në Vithleem të Judhesë. Sepse kështu është shkruar prej profitit. Edhe ti, Vithleem, vend Judha, s' je aspak ma e vogla ndër egjemonirat Judha. Sepse nga ty do të dalë egjemon, i cili do të kullosë llauzin t' im Izrail".**

Këtë profiti e tha Miquea, që nga Shpirti i Shenjtë para tha, që Vithleemi nuk do të jetë e vogël dhe pa rëndësi në Judhe, se prej asaj do të dalë kryetar i math, i cili do të kullosë llauzin Israil.

**"Ahere Irodhi thërriti fshehurazi magët dhe mësoi pikërisht prej tyre kohën e yllit të dukurit dhe mbasi i dërgoi në Vithleem u tha. Shkoni dhe hetoni pikërisht për djalin, dhe mbasi t' a gjeni, lajmëroni dhe mua, që të vijë t' i falem".**

Irodhi pyeti magët, kur u duk pikërisht Ylli në Lindje, që të gjejë, kur lindi Krishti. Me ipokrizi Irodhi u thot magëvet, që t' a lajmërojnë, sepse do dhe ay që t' i falet mbretit të lindur, kurse qëllimi i tij ishte që të vrasë Ate.

**"Magët duke ndëgjuar mbretin shkuan. Dhe ja, Ylli, që panë në lindje, shkante përpara atyre, deri sa erdhi dhe qëndroi sipër ku ishte djali. Kur panë Yllin u gëzuan me gëzim të math".**

Kur djalin magët nga Jerosalimi, u duk prapë Ylli, që ishte dukur të parën herë në lindje. Ay shkante përpara dhe i udhëhiqte deri në Vithleem dhe qëndroi sipër shtëpis, ku ndodhesh djali bashkë me t' ëmën e Tij.

**"Dhe mbasi hynë në shtëpi, gjetën djalin bashkë me t' ëmën e tij Marien. Dhe ranë dhe u falën atij. Dhe mbasi hapën thesarët e tyre, i prunë atij dhurata, ar, liban dhe smyrnë. Dhe mbasi u urdhëruan në endër prej engjëllit, që të mos kthehen prapë te Irodhi, nga tjetër udhë shkuan në vendin e tyre".**

I prunë Krishtit dhurata, ar, liban dhe smyrnë për të treguar adhurim dhe respektim. Engjëlli në ëndërr u duk dhe u thot, mos të kthehen prapë në Jerosalim tek Irodhi, dhe ata nga një udhë tjetër shkuan në vendet e tyre.

MËSIMET. - Shumë lark ishin magët nga Judhea dhe asnjë lidhje nuk kishin me atë. Por, me qenë se ishin njerës, që respektonin hyjnin, Perëndia me anën e Ylli i lajmëroi, se lindi drita e vërtetë, djelli i drejtësisë. Mâ vonë po ay lajmërim me anën e Apostojvet lëçitet në gjith botën, dhe kështu gjithnjë Përsëritet lajmërimi gazmor në gjitha brezat. Ç' apologji do të kenë ata që nuk tregojnë interesim për këtë lajmërim, kurse magët erdhën që lark për të parë dhe për t' i falur mbretit të lindur?

Ndëgjon Irodhi lindjen e një mbreti të ri dhe turbullohet. Ka frikë për fronin dhe mendon çdo mjeshtëri për çdukjen e të lindurit. Pandehë se i linduri do të themelojë një fron të dheshëm. Dhe pandehë, që ay është i zoti të çdukë foshnjën hyjnore, me gjith që beson, se Perëndia është me atë foshnje. Po Irodhi frikësohet më të kotë. Sepse Zoti është me të vërtetë mbret, por mbretërija e Tij nuk është e dheshme në këtë botë, por shpirtnore dhe qiellore. Është mbretëri hyjnore, që asnjë fuqi njerzore s' mund t' a dërmojë.

Kërkojnë magët të mësojnë, ku është mbreti i lindur, që t' i falen Atij. Kërkon të mësojë dhe Irodhi, por për të vrarë foshnjën hyjnore. Ja, që në fillim kundërshtimi i math midis adhuruësvet të Krishtit, dhe të pabesëvet. Vjen Krishtit dritë në botë dhe drejtësi dhe shpëtim. Dhe shpejtë formohen dy partira. Ata që duan dritën dhe drejtësin dhe shpëtimin shpejtojnë t' i falen Zotit dhe Shpëtimtarit. Por njerzit errësirës dhe të mëkatës armatosin gojën dhe duart, që t' a luftojnë dhe të prishin punën e Tij.

Ku është mbrojtës dhe ndihmës Perëndia, nuk përparojnë atje planet dinake dhe qëllimet e liga. Magët duke kërkuar me besë Zotin e lindur, udhëhiqen nga Perëndia edhe e gjejnë dhe i falen. Irodhi duke studijuar vrasjen e foshnjës hyjnore, nuk fiton përmbushjen e planit tij keqberës.

---

## 25 DHJETOR LINDJA E KRISHTIT

Ungjilli Math. 2. 1-12.

### **FJALIM: Në lindjen e Krishtit**

**"Kur erdhi të mbushurit e kohës, dërgoi Perëndia të Birin e Tij ... që të bëhemi bij Perëndije".**

Ja një e kremte e përbashkët. Ja një panagjir i ndriçëm. Ja një gëzim dhe dëfrim i përbotshëm. Sot bëhet rikrijimi i botës, sot është çlirimi i Evës dhe shpëtimi i gjith njerzvet. Ç' shpirt nuk qau? Ç' racë nuk dëshiroi? Ç' gjuhë nuk kërkoi Çlirimtarin dhe Shpëtimtarin? Adhami dhe Eva tek Ay mbështetën shpresën. Judhenjt dhe paganët Atë ëndërronin. Profitët Atë profitepsën. Atë dëshironte Lindja. Atë kërkonte Perëndimi. Ç' të thërresim në ditën e sotme: dëfreni të drejtë, le të gazëllohen qiejt. Na vizitoi që lartazi Shpëtimtari i ynë. Sepse erdhi të mbushurit e kohës, dërgoi Perëndia të Birin e Tij.

Tre gjëra na çuditën në këtë myster të shpëtimit: Mirësija e Atit, dërgimi i Birit,

pabesim i njerzvet.

1. - Mirësija e Atit. Sepse ç' tjetër është lindja e Birit T'ij, veç se një dashuri e pakufishme, një mëshirë e pamasë të Atit t' onë qiellor. Njerzit ranë, sado që i Tërëmiri na pajosi me gjith cilsit, që të na ruajë, sado që na paralajmëroi dënimin e drejtë, që të na ndalojë; ranë në kotësi, në prishje, në mëkatë. E mohuanë, po Ay nuk na mohoi. Sado që ndjen urrejtje për ligësirën dhe për mëkatën, nuk ktheu fytyrën nga mëkatarët dhe u dhimserua për rënien t' onë. Drejtësija e T'ij thërriste «me vdekje do të vdisni», por dashurija e T'ij përgjigjesh «nuk dua vdekjen e mëkatarit deri sa të kthehet dhe të rrojë». Drejtësija e T'ij e internonte nga parajsa fajtorin dhe porosi-prishësin, por dashurija merte përsipër shpëtimin e porosi-prishësit. Priste të mbushurit e kohës për të thyer zinxhirat e robëris, për të shtypur pushtetin e mëkatës, që t' a ngrerë Adhamin, që të çlirojë robërit e satanajt dhe t' i tregojë bij të Perëndisë, t' i ngjijtj në qiell dhe t' iu dhurojë të mirat e përjetëshme. Kjo tregon mirësi dhe meshirë të madhe. Po, Ati dëgnoi dhe «Fjala u bë mish».

2. - Degnimi i të Birit. Perëndia bëhet njeri. Për ç' qellim? Që të shpëtojë njerin, që t' a shërojë nga plagët, që t' a ngrerë në qiell nga Ferri, ku kishte rënë. Për neve la madhështin e hyjnis së T'ij dhe mveshi vobeksin t' onë. Në shpellë lindet, në grazhtë shtrihet. Nuk është përulje e çuditëshme? Nuk duhet t' a duamë dhe t' a adhurojmë pa pushim degnimin e T'ij hyjnor?

3. - Pabesimi i njerëzvet. Sado që e prisnin dhe kërkonin shpëtim, sado që ishin të paralajmëruar nga Profitërit, kur erdhi dhe u lind midis tyre, kur engjejt dhe barinjat dhe magët lajmëruan Lindjen e T'ij, kur vetë i thëriti në shpëtim, ata nuk pranuanë Shpëtimtarin. E përbuzën, e ndoqën si foshnje akoma. E mvarrën më në fund në kryq. «Erdhi në të tujt dhe të tujt nuk e pranuanë». Më parë Irodhi, pastaj Farisenjt dhe Kryepriftërit, pastaj Judhenjtë dhe Romakët. Më pastaj gjithë ata të pabesë, që pa pushim përbuzin Ungjillin e T'ij dhe ndjekin Kishën e T'ij. Ja përpara është Shpëtimtari dhe i u jep dorën dhe ata e mohojnë t' a pranojnë.

\* \* \*

Po pse përshkronj pabesimin dhe nuk rrefenj besën? Sepse Krishti ka besnikët e T'ij. Janë me mijëra breza pas brzësh, miliunëra besnikët e T'ij. E besojnë si Perëndi, e adhurojnë si Shpëtimtar. Le të vërejmë nga thellësitat e shekujve milionërat e Martyrëvet dhe të Drejtëvet, që e pranuan si Zot dhe Perëndi të tyre, që mohuan dëfrimet e jetës dhe derdhën gjakun për Foshnjën e Virgjëreshës.

Le të shikojmë edhe sot qysh gjithësija vallëzon, qysh turma e besnikëvet mblidhen nëpër kishat me besë dhe me adhurim, që të marin mëshirë dhe shpëtim. O Zot, o

Zot! Me këta jemi edhe ne. Me gjith pakbesimin t' onë, me gjith mëkatat t' ona Ty të besojmë si Zot dhe Perëndia e jonë. Të falemi, të adhurojmë dhe të pranojmë si Shpëtimtarin t' onë. Eja të banojsh në shpirtet t' ona, të pastrojsh zemrat t' ona, të shenjtërosh gjith jetën t' onë. Eja të bëhesh Shpëtimtari i ynë dhe të na tregojsh bij të Atit t' End qiellorë dhe trashëgimtarë të Mbretëris s' Ate qiellore. Amin.

---

## 1 KALLNOR RRETHPRESJA E ZOTIT T' ONË JISU KRISHTIT

Ungjilli Lluk. 2. 20-21 dhe 40-52.

**FJALIM: Mbi Rrethpresjen e Zotit t' onë Jisu Krishtit.**

**"Kur u mbushën tetë ditë, u rrethprehë djali dhe u quajt emri i Tij Jisu".**

Prapë e kremte e re, Panagjir i ri Dhespotik dhe ditë gazëllimi; Rrethpresja e Krishtit është çeshtje gëzimi për ne, sepse u bë për shpëtimin t' onë. Por është edhe çeshtje helmi për Zotin, sado që Ay me gëzim e pranoi barën e çlirimit t' onë. Pse çeshtje helmi? Sepse është në radhën e pësimevet të Shpëtimtarit. Tregoi thellësin e përljes dhe madhësin e dhimbjes dhe degnimin që zbriti i Biri Perëndisë. Dhe ky është qëllimi kryesor e çdo dite të madhe të Besës s' onë të lëçitet në gjith botën, ç' pësoi Zoti i lavdis për shpëtimin t' onë. Të mblidhen njerzit, të pendohen mëkatarët, të shenjtërohen në pësimet e Krishtit të Krishterët pietozë. Kjo u bëftë dhe për ne duke kremtuar Rrethpresjen e Shpëtimtarit t' onë Zotit Jisu Krishtit.

### I

1. - Krishti tregoi një përlje të thellë. Përlje për të Birin e Perëndisë është Lindja në shpellë. Përlje është Rrethpresja, sepse kjo është bindje në nomin e Moisiut; kjo bindje është për shërbetorët, për mëkatarët. Por Krishti s' është shërbetor, po është Zoti; nuk është mëkatar, po është Biri i Vetëmlindur i Atit i panishëm. Ky pra rrethpritet si shërbetor, si fajtor. Nuk është përlje për madhështin e Tij hyjnore? Po, është përlje, por Krishti prandaj erdhi të përulet, që të shpëtojë njerin që e përuli mëkata. Erdhi që të përmbushë gjithë nomet ndën të cilët nënshtroheshin mëkatarët, ndën çdo nom që parashikonte pastrimin e mishit njerzor. Prandaj nuk u vështirë në rrethpresjen e mishit. Tash rrethpritet, nesër do të shpihet si foshnje në kishë me zoq pëllumbash për thellore; pastaj do të pagëzohet si mëkatar i pamëkatëshmi. Do të shahet nga kundravajtësit si kundravajtës, do të dënohet si gënjeshtar, do të kryqëzohet si kriminel dhe fajtor, do të durojë pa kundërshtim dhe ankim të gjitha pësimet e Tij.

2. - Në rrethpresjet ndjen një dhëmbje. Qysh mos ndjenë një foshnjë e vogël? Vetëm

pas tetë ditësh nga lindja e Tij ndjen thikën, që t' i plagosë trupin e Tij të Tërëshenjtë. Filloi dhimbjet nga Vithleemi dhe do të mbarojë jetën e Tij me dhëmbje të frikëshme në Golgotha. Por prandaj erdhi të vuajë me të mjerrët, të përbuzët me të përbuzërit, të qajë me të vajtuarit, të ngarkohet me plagët dhe mjerrimet e tyre. O Zot! Për mëshirën T' ende të patreguar!

## II

Këto i pranoi Krishti për shpëtimin t' onë, që të heqim dhe ne pasionet t' ona, që janë: Kryelartësija dhe egoizma, lakmimet dhe padrejtësitat, instinktët t' ona shtâzore dhe ndjenjat t' ona mëkatore, armiqtë dhe dinakërit t' ona. Këto janë thesari ynë i zemrës s' onë së ligë. Le t' i çrënjosim; kjo është rrethpresje shpirtnore dhe këtë simbolizon rrethpresja e Krishtit. Por është e mundur t' i presim pasionet? Për të pabesët është e pamundur, por për ne besnikët e Tij është e mundur, sepse na dha fuqin Krishti, që të mundim pasionet ligësirat dhe gjith fuqin e armikut. E thotë Shën Pavli: «Ju pastroi Krishti, ju dha fuqi të prisni pasionet, të vdekësoni dëshirat e dobta, që mos të shërbenj trupi juaj në mëkatën». Kjo u bë në orën e pagëzimit, ku pastrohet shpirti nga faji dhe shpëton nga dënimi. Pastaj bëhet ne faljet, në pendimin, në kungimin e shenjtë, ku armatoset i krishteri me fuqin dhe me hirin e Krishtit, për të mbytur ligësirat dhe për të mundur armikun.

Të krishterë! Lamë dhe vitin e vjetër dhe hymë në vitin i ri! Po qysh do të vazhdojmë njerin e vjetër? O! duhet rrethpresje, sepse rrethpresja e Zotit na thëret në presjen e pasionëve t' ona. Krishti na do që të jemi të pastër në shpirtin dhe kërkon të na japë armët mundëse, të rrethpresim zemrën, që të hymë në lavdin e Mbretëris së Tij.

---

## **JETA DHE VEPRIMET E SHËN VASILIT TË MATH**

Ditën e parë të vitit i ri, në të cilën kremtojmë Rrethpresjen e Zotit t' onë Jisu Krishtit, kremtojmë dhe kujtimin e Jerarkut të Math. Ky me diturin e tij të gjërë filozofike dhe me virtutet e tij të rrallë luftoi trimërisht kundër armiqtë të mbrendshëm të Kishës s' onë.

Ky lindi në vitin 329 pas Kr. në Qesari të Azis së Vogël prej prindërve të pasur dhe fisnikë, por edhe besatarë në fen Krishtere. I ati, që quhesh dhe ay Vasil, dhe e ëma, që quhesh Emilia, i dhanë një edukatë të lartë krishterore dhe Shën Vasili qysh prej vogëlis se tij tregoi një dashuri të madhe për fen e Krishtit.

Mësimet e para i mori në vendin i tij. Por shpirti i tij kishte etje për studime të larta, prandaj shkoi në Konstandinopojë pranë filozofit dhe oratorit të famshëm pagan Libanit dhe pastaj shkoi në Athinë, ku ishte qendra e filozofisë dhe oratorisë.

Si mbaroi studimet erdhi në Qesari, ku më parë ushtroi profesionin e avokatit, por me influencën e motrës së tij Makarinë, e la këtë profesion, sepse ishte destinuar t' i shërbente Kishës.

Shën Vasili bëri udhetime në Syri, Palestinë dhe Egjyptë, ku erdhi në kontakt me theologë të shquar me Shën Thanasin e Math dhe me Shën Antonin e Math, prej të cilit mësoj dhe jetën e asqetizimit. Pastaj shkoi në Pont në çiflikun e ti, ku larg zhurmës botore në studimin e thellë të Shkrimit të Shenjtë. Atje thirri dhe mikun e tij të ngushtë, Shën Grigorin Nazianzinon, me të cilin ishte njohur në Athinë. Kështu që të dy me ideale të përbashkëta studiojnë dhe shkruajnë duke u përgatitur për mbrojtjen e Kishës.

Veprimtaria e tij heroike filloi nga viti 370, që u bë episkopi i Qesarisë. Shën Vasili bashkë me dy Jerarkët e tjerë (Shën Grigori dhe Shën Krisostomi) mbrojtjen e drejtë kundër eretikanëve. Erezija kryesore në këtë kohë ishte arianizma. Arianët duke pandehur Fjalën e Perëndisë krijesë, rikrijuan një Perëndi të dytë dhe kështu ishte frikë të bjerë krishtërimi në politheizmë. Arianët përkraheshin prej imperatorit Valentit, i cili kishte përqafuar këtë erezi.

Vasil i Math, Mitropolit i Qesarisë habiti të gjithë me qendresën e tij heroike, me të cilën qëndroi kundër imperatorit. Veprimet e këtij imperatori duallën pa përfundime në Azin e Vogël nga qëndresa e Shën Vasilit, i cili duke mbetur si shkëmb i pa tundur, jo vetëm ay nuk u përkul, por me shembullën e tij inkurajtoi dhe episkopët e tjerë të Azisë së Vogël dhe i bashkoi ata për Orthodhoksin duke siguruar kështu triumfin e saj definitiv.

Kush mundi të këndoje pa mallëngjim përgjegjen që i dha përlufar i math, Shën Vasili, nënsunduësit të imperatorit Valent, Modestit më 372 pas Kr.? Modesti tue thërritur pranë tij Jerarkun e Math i tha: «Qysh kuxon ti vetëm t' i kundërshtosh mbretit, që është i gjithpushtetshëm?»

Shën Vasili i thotë: «Ç' kupton me këto fjalë?»

Modesti i thotë: «Kuptonj që ti vetëm kundërshton në urdhënat e imperatorit, që i pranuan të gjith të tjerët».

Në këto fjalë Jerarku përgjegjet:

«Me qenë se ay është kriaturë e Perëndisë, kurrë nuk do t' i falem kriaturës, as nënsunduësit të tij as mbretit vet».

Ahere u hodh me zemëratë Modesti dhe bëriti:

«Çë pra, s' ka frikë nga pushteti i tij?»

Shën Vasili u përgjegj:

«Po përse t' i frikësohem? Ç' mund të bëjë?»

Modesti i thotë:

«Konfiskim, internim, mundime, vdekje».

Shën Vasili me butësi i thotë:

«Tjetër gjë më frikso, sepse prej këtyre që më frikësove, prej asnjë gjëje s' kam frikë, ç' gjë do të konfiskosh prej njeriu, që s' ka veç dy robe të vjetra dhe pak libra? Internim nuk mund të pësojë, se në çdo vend që të internohem, quhem udhëtar pa atdhe. Mundime nuk mund të durojë trupi im i pafuqishëm, i cili me një plagë do të vdesë. Vdekjen e dëshironj, se do të më shpjerë sa më shpejtë pranë Perëndisë» I habitun Modesti nga ky kuxim i thotë:

«Shumë të kuximshme janë fjalët e tha dhe të këtilla asndonjë, askurrë s' ka shqiptuar».

«Por ndofta - i thotë Shën Vasili - s' ke takuar ndonjë herë me episkop të vërtetë të Kishës. Ne jemi të butë dhe të përlulët jo vetëm kundrjetë mbretit, por edhe kundrjetë njeriut më të vogël. Por kur është puna për besën ndaj Perëndia, zjarr dhe shpatë dhe bisha dhe thonj, që shqyejnë mishin, këto janë për ne gëzim më tepër se habitje. Këto le t' i ndëgjojë dhe mbreti.»

Pra modesti dhe mbreti u shtrënguan të hiqen duke lënë të qetë Jerarkun e Shenjtë.

Përveç këtyne veprimevet Shën Vasili u bë bâmires i Kishës s' onë, sepse me jetën e tij të lartë dhe të shenjtë i dha popullit të krishterë shëmbulla të vyera virtuti. Kisha krishtere mburet, se në çdo epokë tregoi midis gjith popujve njerës me virtut të lartë. Me mijëra të krishterë të çdo sekti dhe të çdo moshe, sikurse dishmon historija, rrojtën një jetë me moral dhe shenjtëri. Një nga mjetet, me të cilët krishtërimi tërhoqi paganët në besën e re, ishte dhe pastërija e jetës të krishterëvet. Virtuti i të krishterëvet të ahershëm ishte i këtillë, sa thërrisnin paganët, sipas dishmis të Tertulianit: «Shikoni sa duhen midis tyre të krishterët dhe qysh janë gati të vdesin njeri për tjetrin».

Por më tepër mâ të nalta shembullat e virtutit i dha Shën Vasili i Madh. Për t' u çuditur është, se, sado që kishte episkopatën e Qesaris, shumë të pasur, rojti një jetë me ngrënie të paktë dhe me mveshje shumë të thjeshtë, por të gjitha të ardhurat e episkopatës i ndante në njeridashje. Ndërtoi një azilë për të vobektit. Vasiliadha, që ishte mâ i famshmi në Qesari në atë kohë, dhe që u bë më pastaj tip i ndërtesavet filantropike. Njeridashja e tij u lëçit në gjith botën.

Pra triumfi i besës se drejtë, lavdia e Kishes, edukimi moral dhe shpëtimi i besnikëvet ishte kujdesja e vetme e Shën Vasilit, i cili kishte dhënë gjith fuqit e tij për grigjen e tij, për të cilën si një bari i mirë, ishte gati dhe jetën e tij të therrorizojë.

Shën Vasili i shërbeu Kishës dhe me predikimet, që bënte gjithnjë dhe kudo dhe me shkrimet e tij theologjike, që hartoi ky Jerark i shquar dhe i palodhur. Nga veprat që na kanë arrirë duket gjerësija dhe thellësija e tij theologjike dhe zotësija e tij oratorike.

Nga kujdesjet dhe lodhjet, që përshkruamë, për mbrojtjen e Kishës dhe të grigjes së tij dhe nga shëndeti i tij i dobët u sëmurë dhe vdiq para kohe më 1 Janar 379. Për vdekjen e tij u hidhëruan jo vetëm të krishterët, por edhe paganët dhe judhenjt, sepse Jerarku shpërndante të mira dhe jepte mbrojtjen e tij atnore pa përjashtim në të gjithë njerzit, sipas porosis së Krishtit që na detyron dashurin edhe në armiqt t' anë. Dhe hidhërimin e tyre e çfaqën tue marrë pjesë në varrimin e tij, në të cilin ishte mbledhur kaq shumicë populli, sa nga shtrëngimi mjaftë veta kanë gjetur vdekjen e tyre.

Kisha e jonë drejtësisht sot panagjirizon kujtimin e atit t' onë Shën Vasilit të Math, i cili me përpjekjet e ti, me vetmohimin e tij, me diturin dhe virtutin e tij, bëhet shëmbullë për neve, që të imitojmë besatarin dhe virtutin e tij. Sepse ay luftoi për besën t' onë të shenjtë kundër armiqtvet të saj të ndryshëm; me diturin e tij na ndriçoi dhe me shkrimet e tij na udhëheq në rrugën e së vërtetës. Me jetën e tij tepër të shejtëruar u bë shëmbull e virtutit për ne. Gezohu në qiejt dhe gazëllohu dhe ndërmjetso të Krishti Perëndia jonë për shpëtimin t' onë.

---

## E DJELË PARA THEOFANIS

Shpiegim i Ungjillit (Mark 1. 1-8)

**"Fillim i Ungjillit të Jesu Krishtit, birit të Perëndisë; sikundër është shkruar nër profitët. Ja, unë dërgonj engjellin t' im përpara teje, i cili do të ndreqij udhën t' ende përpara teje. Zë që thërret në shkretëtirë, pregatitni udhën e Zotit, të drejta bëni rrugët e tija".**

Jo vetëm punën e Shpëtimtarit paralajmëruan profitët, por edhe punën e Joanit Pagëzorit, i cili përgatiti njerzit, që t' i besojnë Krishtit.

Profitija e para është e Mallaqiut. Me anën e asaj Perëndia dhe Ati i parathotë Birit Tij, se përpara se të duket midis Judhenjvet do të dërgojë dërguës Joanin Pagëzorin; edhe ay do të përgatisin shpirtet e njerëzvet, që të pranojnë predikimin e Shpëtimtarit.

Profitija e dytë është Isaias. Me atë profiti Isaija parathotë, se do ndëgjohet zëri i një njeriu (Joanit), i cili në shkretëtirë të Judhesë do të thërsin njerëzvet dhe do t' i shtyjë të përgatiten me anën e pendimit për të pranuar Zotin.

**"Erdhi Joani duke pagëzuar në shkretëtirë dhe duke lëçitur pagëzim pendimi për ndjesë mëkatash. Dhe vinin te ay gjithë Judhea dhe banuësit e Jerosalimit dhe pagëzoheshin prej atij të gjithë në lumin Jordhan, mbasi rrëfenin mëkatat e tyre".**

Joani Pagëzori, biri i Zaharias dhe Elisavetës, lindi me premtim. Plotë me Frymë të Shenjtë nga barku i s' ëmës tij, doli në moshë te re në shkretëtirë dhe rojti i devotuar ndaj Perëndia. Në moshë tridhjet vjeçë erdhi pas porosis së Perëndisë në anët e Jordhanit dhe atje filloi lëçitjen e tij. I thërriste njerzit për pendim dhe për tregim pendimi, i pagëzonte në lumin Jordhan, ata që vinin.

Shumë vinin te ay, dhe mbasi bindëshin në predikimin e Joanit, pagëzoheshin në Jordhan, mbasi përpara rrëfenin mëkatat e tyre.

**"Joani ishte mveshur me robe prej leshi kamilesh dhe me brez lëkure në mezin e tij dhe hante karkaleca dhe mjaltë t' egër. Dhe lëçiste duke thënë. Vjen prapa meje ma i forti se unë, të cilit s' jam i vyer duke ulur t' i zgjidh ripin e sandalëvet të tij; unë ju pagëzova me ujë, por ay do t' ju pagëzojë me Shpirtin e Shenjtë".**

Joani ishte mveshur me robe, të endur prej leshi kamilesh dhe mbante një brez prej lëkure. Hante karkaleca, që ishin me shumicë në ato vende dhe mjaltë të egër.

Joani parathoshte ardhjen e Shpëtimtarit për së shpejti. Thoshte që Krishti është pa barazim më i lartë se ay. Pohonte që ay përpara Krishtit ishte kaq i vogël, sa nuk ishte i vyer të ulesh për të zgjidhur ripin e sandalëvet të tij.

Joani dhe lartësin e veprës së Shpëtimtarit. Pagëzimi i Joanit bëhesh me ujë të thjeshtë për tregim pendimi. Por pagëzimi i Zotit, nuk bëhet vetëm me ujë, por edhe me Shpirt të Shenjtë, prej të cilit pastrohet shpirti nga mëkata.

MËSIMI. - Perëndia jo vetëm dërgoi Birin e Tij në botë, por veprimi me të gjitha mjetet, që njerzit të besojnë, se Krishti është Shpëtimtari dhe çlirimtari i botës. Pas parathaniës e profitëve duket pak para Krishtit Joani Pagëzori. Paralajmtar i Krishtit dhe profit, erimit i nderuar prej Judhenjvet, parathoshte ardhjen e shpejtë të Shpëtimtarit dhe përgatiste Judhenjt me predikimin dhe pagëzimin e tij.

Predikimin e pendimit e lidhi Joani me pagëzimin në lum. Kështu ata që pagëzoheshin duke ndëgjuar predikimin e Joanit dhe duke u penduar, pohonin dhe e ndjenin, se kishin nevojë për banjo shpirtore, që të pastroheshin nga mëkati. Pra sikundër predikimi i Pagëzorit ishte parathënie në pagëzimin e Shpëtimtarit, kështu edhe pagëzimi në Jordhan ishte përgatitje në pagëzimin krishtëror, i cili me të vërtetë pastron nga mëkati, atë që pagëzohet me besë.

E habitëshme thjeshtësia e Joanit. I thjeshtë në mvëshje, i thjeshtë në ushqimin. I devotuar të Perëndia nuk jepte rëndësi në mvëshjen dhe në ushqimin e trupit. Rronte një jetë shpirtore, një jetë adhurimi ndaj Perëndia, si një engjëll i dheshëm. Rronte si shpirt më tepër se si trup. Kaq vetëm përkujdesesh për trupin, sa ishte mjaftë për përmbajtjen e jetës së dheshme.

E habitëshme dhe përlulja e pagëzorit. Sado që ishte dërguar prej vetë Perëndisë, nuk i jep vehtes së tij vlerë të madhe. Tue pasur njohtje të plotë të lartësis dhe të madhëris së Krishtit, e njehë vehten e tij si shërbëtor i Atij dhe si shërbëtor pa ndonjë vleftë. Sepse nuk e konsideron vehten e tij të vyer, që t' i bëjë Shpëtimtarit shërbim të vogël, të tillë që bënin shërbëtorët e asaj kohe zotrinjvet të tyre. Kështu mësonte ndëgjuesit për lartësin e Krishtit jo vetëm me fjalë, por edhe me shëmbullën e tij të përlulët.

---

## **E DJELË PAS THEOFANIS.**

Shpiegim i Ungjillit (Math. 4. 12-17)

**"Në atë kohë kur ndëgjoj Jisuj, që Joani u dorëzua, iku në galile. Dhe mbasi la Nazaretin, erdhi dhe banoi në Kapernaun anë deti në kufit midis Zavulon dhe Nefthalim".**

Joani Pagëzori u arrestua nga egjemoni i galiles Irodhit, se qertonte këtë për jetën e tij jashtë nomit. Sepse Irodhit kishte marrë gruan e vllajt tij Filipit, kurse ky ishte gjallë. Për këtë paranomi e qertonte Joani nuk është e lejuar të kesh për grua, gruan e vllajt t' ënd. Prandaj Irodhi e burgosi dhe pastaj i preu kryet.

Iku Jisuj nga Judhea në galile. Sepse mbasi mbaroi puna e Joanit e pregatitjes, vendosi të fillojë punën e Tij shpëtimtare.

Krishti u lind në Vithleem, por mbasi u kthye nga Egjypti, ndejti dhe u rrit në Nazaret. Nashti për punën e Tij lë Nazaretin dhe stabilizohet në Kapernaum, Këtë e zgjodhi Zoti, se nga vendi i saj ishte si qënder për të lëçitur Ungjillin e Tij shpëtimtar.

**"Që të mbushet e thëna nga ana e profitit Isaia që thot: dhë Zavullon dhe dhë Nefthalim, udhë deti përtej Iordhanit, galilea e kombeve, llauzi që rrinte në erësirë pa dritë të madhe, dhe lindi dritë atyre, që rinin në vend dhe hije vdekje."**

Profiti Isaia përpara qindërave vjetve paratha dukjen dhe punën e Krishtit në ato vende. Më përpara cakton vendet, ku do të veprojë Shpëtimtari. Këto vende janë Zavullon dhe Nefthalim dhe më tepër vendet që janë afër detit Tiberiades, si dhe vendet përtej Iordhanit, galilea e kombëvet. E quan kështu galilen, se ishin përzjerë dhe rinin shumë paganë.

Pastaj profiti tregon gjendjen shpirtnore të popullit të këtyre vendëve. Thot që këta popuj gjendëshin në erësirën e mëkatës dhe tregon që Shpëtimtari do t' i nxjerë në dritën e së vërtetës.

**"Që atëhere Jisuj filloj të lëçitinj dhe të thotë. Pendouni, se u afërua mbretërija e qiejvet".**

Lëçitja e Shpëtimtarit na shtyn në pendim dhe na parathot, që u afërua mbretërija e qiejvet. Mbretërin e qiejvet kupton Kishën. Sepse në atë, mbas shëmbullës e engjejvet në qiejt, do të plotësohet dëshira e Perëndisë, dhe me anën e saj do të bëhen nënshtesat besëmirë të vyer për mbretërin shpirtnore, për të gëzuar të mirat të pavdekshme.

MËSIME. - Pararëndësi dhe Pagëzori Joani, duke qenë mik i virtutit dhe i së vërtetës, e këshillonte dhe e qertonte Irodhin për jetën e tij të poshtër dhe skandalloze. Por Irodhi në vend që të ndreqesh, u zemërua. Prandaj e burgosi Joanin dhe pastaj i preu kryet. Kështu Joani Pagëzori u bë martir i së vërtetës dhe i detyrës. I këtillë është mjerisht fati i përluftarve të virtutit dhe të së vërtetës midis shoqërive të demoralizuar. Dritën s' mund t' a shohin ata që rrojnë në errësirën e gënjeshtres dhe ligësirës. Sepse ligësira duke ndjerë pamjen e saj të vështirë, ndjekë mortalisht virtutin, se turpërohet, kur sheh bukurin e tij. Prandaj shën Joanit i pritet kryet prej Irodhit të demoralizuar dhe pas Prodhromit dhe Ay, Zoti ynë Jisu Krishti, që ishte vetë drita hyjnore e së vërtetës, Shpëtimtari i njerzimit, kryqëzohet prej Farisenjvet të verbuar nga smira. Dhe

të gjithë ata që duan të rrojnë pas dëshirës së Perëndisë, do të provojnë shtrëngime dhe ndjekje.

Por me gjithë ndjekjet dhe martirizimet për të vërtetën, mos pushojmë duke dashur virtutin me gjithë shpirt. Sepse ndjekjet në vend që të ngjyrosin ndriçimin qiellor të së vërtetës dhe t' atit, përkundrazi e bëjnë atë më të ndriçëm.

Predikimin e Tij e filloi Krishti me pendimin duke thënë "pendouni". Sepse sikundër me ujë pastrojmë ndyrësirën e trupit, kështu me anën e pendimit pastrojmë mëkatat e shpirtit dhe kështu fitojmë shëndetin dhe shpëtimin e shpirtit. Vetëm ata që duan të kenë shpirtin e tyre gjithnjë të ndyrë, nuk pendohen askurrë. Por ora e vdekjes e paditur vjen përnjiherësh, dhe dera e mbretëris qiellore mbetet përgjithnjë e mbyllur përpara atyre që e shkojnë jetën e tyre pa penduar.

Le të ndëgjojmë zërin e Krishtit, i cili në Ungjillin e sotshëm na thërret për pendim, që të mbretërojë në shpirtin t' onë Krishti, i cili është drita e madhe e së vërtetës. Ku nuk është Krishti, atje sigurisht mbretëron errësirë dhe mëkata dhe vdekje e përjetëshme.

Kisha symbolizon mbretërin qiellore dhe pregatit besnikët për atë. Cila është vepra e parë, që të pregatitet i krishteri? Është pendimi i sinqertë, i cili bije në shpirtin pasurisht hirin dhe përdëllimin e Perëndisë.

---

## E DJELË PAS EPIFANISË

Ungjilli Math 4. 12-17.

**FJALIM: Për pendim.**

**"Që atëhere Jisuj filloi të lëçitë dhe të thotë: pendohuni, se u afërua mbretëria e qiejvet".**

Tridhjetë vjete e shënjtë dhe e përmbibotëshme, por private, mori fund në valat e Jordhanit. Atje Krishti me dishmin zyrtare e Atit Tij qiellor, me zbritjen e Shpirtit Shenjtë, me pagëzimin që merr përpara popullit nga duart e Pararëndësit, merr përsipër veprën e tij të lartë dhe shpëtimtare. Nuk është më puntori i padukshëm i Nazaretit. Është mësuesi dhe udhëheqsi i popullit. Do të predikoj të vërtetën, do të ndriçojë njëzrit, duke u çfaqur njersvet Perëndin e vërtetë.

Fillon predikimin e Tij duke kërkuar pendim: «Pendohuni, se u afërua mbretëria e qiejvet». Pendimin vë si fillim dhe si themel të jetës së re dhe në pendim na therët të

gjithë mëkatarët.

Po ç' është pendimi?

1. - Pendimi është kthyerje drejtimi nga udha e shtrëmbërt në udhë të drejtë. Në njërin natyrale që nuk e ka rilindur hiri i Perëndisë, nuk mbretërojnë ndjenja dhe mendime fisnike, as dëshira të pastërta, as vepra të nderçme; por mbretërojnë, mendime të dheshme dhe ndjenja të poshtërta, dëshira shtazore dhe jetë e çthurur. Këto molepsin njerin dhe e bëjnë mëkatarë dhe e largojnë nga Perëndia, që mos të shikojnë fytyrën e Perëndis, mos të gjejnë shpëtim dhe mos të bëhen pjestarë të mbretëris së qiejvet. Pendim pra d.m.th. kthyerje nga mendimet, kthyerje nga ndjenjat, kthyerje nga dëshirat dhe nga veprat, në mënyrë që të vëvëndësohen me ndjenja të shenjta dhe me vepra të pëlqyera te Perëndia.

2. - E dyta është hidhërim i thellë i shpirtit. Mëkata, ose e mundon, ose e dëshiron, ose e mbaron njeriu me trupin e tij, është gjithnjë fyemje dhe përbuzje te Perëndia. Sepse Perëndia nuk i mohoi asgjë njeriut, por na i dha të gjitha, edhe lëndore e shpirtnore, edhe të dheshme e qiellore. Birin e Tij të vetëmlindur e kryqëzoi për shpëtimin t' onë, që të na provojë se është Ati ynë i dhimsur. Kur mëkatojmë, kur bëjmë kundër porosive të Perëndisë, kur shkelim Ungjillin e Tij, përbuzim dhe fyejmë Atin t' onë qiellor e të dashur. Edhe nashti, ç' bën një djalë i mirë, që vjen në vehte nga një vepër të dobtë dhe e kupton fajin e tij? Qan e vajton, se me sjelljen e tij të dobtë palgosi zemrën e atit të tij të dashur. Kështu bën edhe mëkatarin; kur pendohet me sinqeritet, kur peshon barën e fajit të tij, dergjet në lote, jo për tjetër gjë, po se me jetën e tij mëkatore, helmoi Perëndin, mirëbërësin e tij.

Le të kemi ndër mënd vajtimet e Davidhit, lotët e hidhura të Apostoll Petros, kthyerjen e birit prodig që të kuptojmë, se pendimi i vërtetë është hidhërim i thellë i shpirtit.

3. - Vendim ndreqjeje për gjithnjë. Pendim nuk është të kthejmë sot, të helmohemi nashti, dhe nesër të kthehemi prapë në veprat e përparëshme. Merr një vendim të premë dhe preferon vdekjen, se sa të kthehet në ato vepra, për të cilat derdhi lotë të hidhura. Edhe me qënë se mëkatat e tij të vjetra lanë gjyrma dhe plagë, përpiqet dhe lufton i mjeri që te mbahet dhe të mos bjerë prapë në mëkatën e mallkuar. Ky pra është pendimi. Kthyerje e njeriut e plotë dhe në gjith jetën e tij.

Ç' mendime na shpjen në udhën shpëtimtare të pendimit?

1. - Mendimi që mëkata është vdekje. Na e thotë Ap. Pavli: «Të psonisurit e mëkatës është vdekje» (Rom. 6. 23). E vërteton jeta e përditëshme, e cila na tregon një shumicë

njerzish në gjendje shëndetësore të vajtuëshme nga përfundimet e mëkatës. Sa të rinj të verdhë, të thatë, nevrasthenikë hyjnë në spitalet me sëmundje të pashëruara, nga shkakut se e kanë shkuar jetën e tyre në mëkata. Ç' tronditje të shëndetit? Sa pranon varri pa kohë! Sa përpim Ferri që t' i tyranizojë përgjithmonë në vdekje të pavdekëshme? Vetëm këtë të mendojmë do të na pushtojë të dridhur dhe një urrejtje do të na vijë kundër mëkatës dhe do të pendohemi me të shpejtë.

2. - Mëshira e Perëndis është burim i pashtershëm.

Perëndia nuk kujton mëkatat t' ona, as i shpagon ligësirat t' ona, por na ndjen gjithnjë në këtë botë. Na e thotë libri i shenjtë: «I mëshirshëm dhe i dhimsur është Zoti, zëmër gjërë dhe shumë përdelluës, nuk do të zemërohet deri në fund, as do të mbajë mërrë për jetë» (psalm 102. 8). Dashurija pra e Zotit është det i pa kufishëm. Nuk do t' i besojmë djallit, kur na thotë, që mëkatat t' ona janë të pandjera. Por plot me shpresë do të nxitojmë te Krishti dhe do t' i themi: «O Zot! shpëto-na».

3. - Edhe mendimi i vdekjes ndihmon shumë pendimin. Sot dhe jo nesër, sepse nuk dijmë orën e vdekjes. Mendimi pra që vdekja fluturon lartë nesh dhe përnjëherësh mund të na rrëmbejë, do të na bjerë pendimin e shenjtë. Le të ndëgjojmë zërin e Shpëtimtarit t' onë dhe le të pranojmë thirjen e Tij për rilindjen e shpirtit t' onë dhe trashëgimin e mbretëris së qiejvet.

---

## **E DJELË E DHJETË TË KROMOSURVET**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 17. 12-19)

**"Në atë kohë, mbasi hyri Jisuj në një fshat, e pritën atë dhjetë burra të kromosur, të cilët qëndruan larg. Dhe këta ngritën zë duke thënë. Jisu kryetar, mëshiro-na. Edhe Jisuj duke i parë u tha atyre. Shkoni dhe tregoni vehten T' uaj priftërinjvet. Dhe duke shkuar këta, u pastruan. Një nga ata, kur pa që u shërua, u kthye me zë të lartë duke lavdëruar Perëndin; dhe ra mbi fytyrë nër këmbët e tij duke falënderuar atë. Dhe ay ishte Samaritan. Jisuj u pergjegj dhe i tha, nuk u pastruan të dhjetët? Po të nëntët ku janë? Nuk u kthyen që të lavdërojnë Perëndin, veç ky prej tjetër kombi? Edhe Jisuj i tha atij, ngrehu dhe shko, se besa hote të shpëtoi".**

Në Ungjillin e sotshëm tregohet shërimi i dhjetë të kromosurve, që takoi Shpëtimtari duke shkuar midis Samarisë dhe galilesë.

Këta të zgjebosur, midis tyre ishte dhe një Samaritan, ndënjën që larg dhe thërritën: O

Zot, mëshiro-na. Edhe Jisuj i mëshiroi përnjëherë dhe i porositi të venë te priftërit dhe të tregojnë trupat e tyre dhe priftërit duke u vërtetuar, së të zgjebosurit, që të vinin te priftërit, udhës u gjendën të pastruar dhe të shëruar.

Me këtë shërim na tregon Ungjillori gjithpushtetin njeridashës të Zotit t' onë Jisu Krishtit dhe për të themelosur në zemrën t' onë Besën, dashurin dhe shpresën, na kujton, se përveç zgjebes natyrale, që është mjerisht shumë ngjitëse, janë shumë zgjebe morale, të cilat hanë dhe shkatërojnë jo trupat të papastër, por shpirtet t' onë të ndytë, dhe të cilat përhapen lehtësisht përqark nesh nër njerzit duke dëmtuar dhe duke bërë ata të mjerë.

Të tilla zgjebe janë: të urrejtjes, të keqfoljes, të kryenallësis, të egoizmës etj. Nga shërimi i të dhjetë të zgjebosurvet, le të bindemi se, sikundër Shpëtimtari shëroi ata nga sëmundja e tyre, kështu mund të na largojë sëmundjet e ndryshme të shpirtit t' onë. Por për këtë duhet të pasojmë dhe neve sjelljen e urtë të të zgjebosurvet.

Pra sikundër ata të dhjetë të zgjebosur plotë me besë dhe devotesë erdhën afër Jisujt dhe me gjith zemër i thanë Atij "O Zot, mëshiro-na, kështu dhe neve le të afrohemi me falje të përzemërtë përpara Zotit t' onë dhe le të kërkojmë mëshirën e Tij hyjnore.

---

## **E DJELË E TË KROMOSURVET**

Ungjilli Lluk. 17. 12-19

### **FJALIM: Për mirënjohtjen kundrejtë Perëndisë.**

**"Një nga ata duke parë, se u shërua, u kthye me zë të math duke lavdëruar Zotin".**

I kromosuri i dhjetë nuk u përngjan të nëntë Jo mirënjohtësvet. Ay Samaritani e ndjeu kaq thellë mirësin, që i bëri Krishti dhe u derdhën në shpirtin e tij kaq ndjenja mirënjohtësije, sa u kthye te Shpëtimtari duke thërritur me zë të kartë: O Zot! bekonj Perëndin që të dërgojë mbi dhe: me shpëtove, më pastrove, të falnderojë; e njohë të mirën, që më bëre, mirëbërësi i përjetshëm i jetës s' ime. "Një nga ata duke parë, se u shërua, u kthye me zë të madh duke lavdëruar Perëndin edhe ra me fytyrë në këmbët e tij duke falënderuar atë ...

I

Atë që bëri Samaritani jemi të detyruar t' a bëjmë edhe ne, sepse Perëndia është mirëbërësi më i madh i jetës s' onë.

1. - Perëndia na ka dhënë të gjitha lëndoret dhe shpirtoret, jetë, frymë dhe shpirt. Nuk jemi nga vehtja jonë, as nga prindërit, por nga Perëndia, i cili na ka dhënë qënjen t' onë që rrojmë. Rrojmë jo se e duamë neve, po se e do Ay. Dhe me qënë se e do Ay, na jep ajir, që të marim frymë edhe djell që të ngrohemi, edhe shëndet që të punojmë, edhe shiun që të prodhojë toka për të ushqyer. Ç' do të bëheshim, në qoftë se i mbante të mirat e T'ij dhe na dërgonte i Lartimi ordhit e egra të vdekjes? Por edhe shpirtoret Perëndia na i dhuroi, shpirtin. Të kromosur ishim edhe neve; lepra e mëkatës na kishe pushtuar. Ay na pastroj me gjakun e T'ij të çmuëshëm Jetë të re na dha, jetë qiellore. Ka më të madhe mirësi nga kjo? Një vetëm do të thoshim: "se çdo dhënje e mirë dhe çdo dhuratë e mbaruar që lartazi zbret nga Ati i dritave (Jak. 1. 17).

2. - Por akoma çdo të na japë? "Sa syri nuk ka parë dhe veshi s' ka ndëgjuar dhe në zemërën e njeriut nuk ka hipur" (1 Kor. 2. 9). Perëndia do të na dhurojë mbetërin e qiejvet me bukurit të patreguara të parajsës. Për këtë qëllim pikërisht dërgoj Birin e T'ij të vetëmlindur në botë të pësojë dhe të kryqëzohet që "kushdo që i beson mos të humbasë, po të ketë jetë të pasosur" (Joan 3. 16). Jetë pa hidhërime, e lumtur dhe e përjetëshme! Ka mirëbërës nga Perëndia i Tërëmirë? Për këtë ne nat' e ditë të derdhim ndjenjat t' ona të mirënjohtësis.

## II

Por me ç' mjete duhet t' i çfaqim mirënjohtësin t' onë?

1. - Dy janë mënyrat. Me fjalë. Prandaj Zotina fali gjuhën, jo për të sharë dhe për të blasfemi sur, por për të falënderuar mirëbërësit t' anë. Edhe ne të vërtetë këtë e bëjmë, kur njerzit na bëjnë ndonjë të mirë dhe na dhurojnë gjëra të parëndësishme. Por ç' duhet të bëjmë ahëre për Perëndin mirëbërësin mâ të math të shpirtëvet t' onë. Gjuha e jonë duhet të blatojë papushim ymne falënderimi burimit të pashtershëm e të miravet. Apostoll Pavli duke patur parasysh dhuratat që shpërndau Zoti gjith të kishterëvet thotë: "në çdo gjë falënderoni Perëndin tue kënduar dhe psalur në zemrën t' uaj Zotit" (Efes. 5. 19).

2. - Me vepra të mira, që janë simbas dëshirës se T'ij. Krishti thotë: "Ç' më thërisni o Zot, Zot, dhe nuk bëni, sa ju them?" (Lluk. 6. 16). Dhe në tjetër vend "mëshira dua dhe jo therore." (Math. 9. 13). D.m.th. dhimsuri, mirësi, zemër të pastër, jetë të shenjtë. Në qoftë se veprat t' ona janë të liga, si padrejtësira, lakmime, smirë, armiqësira, ndyrsira, ç' ti dojë atëhere Perëndia ymnet dhe adhurimet t' ona. Vepra drejtësisje dhe dashurije kërkon Zoti. Të këtilla vepra kënaqin Zotin.

\* \* \*

Vllëzet! Perëndia s' ka nevojë nga falënderimet t' ona, ne kemi nevojë. Kur ndjejmë mirësit e Tij dhe e falnderojmë, japim prova, që jemi të vyer për mirësit e Tij hynjore. Japim siguri, që edhe më tepër në qoftë se na jep, nuk do të bjemë në duart të pa vyera t' i mbajmë dhe t' i përdorim. Atëhere do të na japë më tepër, se sa na ka dhënë; sepse në mirnjohtësin t' onë do të bazohet Mbreti i jetëvet, që të na besojë dhe mbretërin e qiejvet, në të cilën u bëftë që të hyjmë të gjith me hirin e Shpëtimtarit Zotit t' onë Jisu Krishtit. Amin.

---

## **E DJELË E TË VERBËRIT TË JERIKOSË**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 18. 35-43)

**"Në atë kohë kur po afërohesh Jisuj në Jeriko, një i verbër po rinte afër udhës dhe lypte. Kur ndëgjoi, se po shkonte gjindje, pyeste ç' është kjo. I thanë atij, se po shkon Jisuj Nazoreasi. I verbëri thërriti duke thënë, Jisu, i biri Dhavidhit, mëshiro-më. Ata që ishin përpara, e qertonin që të heshtij, po ay më tepër thërriste, I biri Dhavidhit, mëshiro-më. Mbas ndenji Jisuj, urdhëroi, që t' a bjenë atë te ay. Mbas u afërua, e pyeti atë Jisuj, ç' do që të bëjë? Ay tha, o Zot, që të shohë. Edhe Jisuj i tha, shih, besa jote të shpëtoi. Dhe atë çast pa dhe i vinte atij prapa duke lavdëruar Perëndin. Dhe gjithë gjindja, mbasi pa, lavëronte Perëndin."**

Ungjillori Lluka duke treguar sot sherimin e të verbërit, kërkon që të na ngulij në mendjen t' onë dhe në zemrën t' onë mësimet shpëtimtare, që na dhe në shërimin e të dhjetë të zgjebosurvet.

Kur Jisuj shkonte në Jeriko, një i verbër, i cili rinte afër udhës dhe lypte, ndëgjoi zhurmën e një gjindje që shkonte nga udha dhe pyeti; ç' është kjo? I thanë, që po shkon Jisuj, i cili pasohesh gjithnjë nga një shumicë populli. Përnjëherësh i verbëri thërriti: Jisu, i biri Dhavidhit, mëshiro-më. Por disa e qertonin, që mos të thërrisë, por ay vazhdonte më tepër, duke kërkuar më me forcë mëshirën e Zotit.

Krishti qëndroi dhe e thirri të verbërin afër Tij dhe e pyeti atë, ç' dëshiron? Dhe i verbëri kërkoi me besë të qëndruëshme dritën e syvet të tij. Edhe Krishti i tha: shiko, besa jote të shpëtoi. Dhe at çast u hapën syt e të verbërit, i cili i vinte prapa Krishtit duke lavdëruar Perëndinë dhe duke treguar mirnjohtësin e tij ndaj mirëbërësi.

Le të lavdërojmë dhe neve Shpëtimtarin t' onë, i cili hapi syt t' onë në dritën e së vërtetës, që të shohim dhe të ecim udhën e shpëtimit të shpirtëvet t' onë.

Nga Ungjilli i sotshëm mësojmë, se, ne qoftë se duamë edhe neve ndihmën e të lartit, nuk duhet të jemi të ftohtë kundrejtë fesë s' onë të shenjtë të atërvet t' anë: por duhet me nxehtësi t' i lutemi dhe ne, sikundër i verbëri duke kërkuar mëshirën e Tij, po të me besë, dashuri dhe shpresë.

Në qoftë se disa të çmendur ose moralisht të prishur, kërkojnë të na largojnë nga Zoti i ynë me fjalët ose me shëmbullën e tyre, neve duhet të qëndrojmë pa tundur, sikundër i verbëri, në besën t' onë dhe mos të pushojmë me faljen t' onë të përzemërtë duke kërkuar mbrojtjen dhe ndihmën e Shpëtimtarit t' onë.

---

## **E DJELË E TË VERBËRIT TË JERIKOSË**

Ungjilli Lluk. 18. 35-43

**FJALIM: Për faljen Pemëprodhuese.**

**"Jisu, i biri Dhavidhit, mëshiro-më".**

I pamundur është insistimi i të verbërit të Ungjillit të sotshëm. Në kohë që Krishti ecën i përçarkuar nga populli, ay nuk pushon. Edhe kur të tjerët e qërtojnë që të pushojë, ay vazhdon të thërresë me zë të lartë: «Jisu, i biri Dhavidhit, mëshiro-më». Ç' tregon ky insistim i tij? Dhimbjen e shpirtit të tij për fatkeqësin e tij, sepse ishte fundosur në errësirën përgjithmonë. Por tregon edhe besën e shpresën e tij në mëshirën dhe në dhimsurin e Zotit. Edhe ja se fitoi. Lutja e tij u ndëgjua. Zoti qëndron dhe e thëret afër tij; e pyet ç' dëshiron dhe i shëron sytë. I gëzuar dhe i gallëzuar i verbëri i vete pas Krishtit duke falnderuar Krishtin dritëdhënësin. Kjo çudi, që është përfundimi i lutjeve të nxehta e të verbërit të Jerikos, na jep shkak të bëjmë sot fjalë për fjalën prodhimtare, sepse ç' do falje nuk sjellë bekimet dhe dhuratat e Perëndisë. Sikundër çdo gjë e mirë, që të jetë e mirë, duhet të bëhet me mënyrë të mirë, kështu dhe falja, duhet të bëhet mirë, që të sjellë prodhim.

1. - Falja me besë. Edhe natyrisht ay që kërkon një gjë nga Perëndia: në faljet nuk hyjnë dyshime. Falem; por rreziku është i math, mëkatat e mija janë të shumta. Do të bëjë çudin e Tij Perëndia? Sepse Perëndia është i mëshirshëm dhe i Tërëfuqishëm, nuk duhet as pak të kemi dyshim, që do të ndëgjojë lutjen t' onë dhe do të bëjë çudinë e Tij. Është dhe i Tërëmirë dhe nuk do të mbajë mërrin, për ato që i kemi bërë. Nuk është hakmarrës, por dashuron dhe dhuron pasurisht të mirat e Tij. Mos të dyshojmë po me besë t' i falemi dhe t' i kërkojmë. Të na shpëtojë nga një fatkeqësi, që ka rënë në shtëpin t' onë. Të na japë bukë, mveshje dhe ato që janë të nevojshme për rrojtjen e jetës s' onë. Të na çlirojë nga pasionet dhe nga ligësirat, që tyranizojnë shpirtin t' onë.

Të na bëjë trashëgimtarë të lavdëruar të jetës së Tij të amëshuar. Të gjitha do të na i japë, vetëm t' i falemi me insistim dhe me besë, sikundër bëri sot i verbëri. Sepse vetë e tha Krishti: «të gjitha sa do të kërkon, po të besoni, do t' i mirni» (Math. 21. 22).

2. - Falje me insistim. Perëndia shumë herë e shtyn, që të na japë atë që kërkojmë. Shkaqet kryesore janë: që të provojë besën t' onë dhe koha jo e volitshme. Të na japë atë çastë, është frikë, se mos na dëmtojë, sikundër dëmtohet i sëmuri, kur merr ushqim pa u shëruar mirë. Do që të na provojë tash që kemi nevojë. E shtyn të dhënit për të provuar besën t' onë. Çdo të bëjmë ne, do të dëshpërohemi dhe do të pushojmë së kërkuari? Por kjo tregon pak besim ose pabesim. Jo, do të insistojmë dhe do t' i lutemi mâ nxehtësisht. Këtë na rekomandon dhe Apost. Pavli «në lutje, qëndroni me durim» (Kol. 4. 2). Edhe vetë Zoti na porositi: «lypni, dhe do t' ju jepet, kërkon dhe do të gjeni, trokitni dhe do t' ju hapet» (Math. 7. 7). Përfundimi është që insistimi duhet në faljen, sepse insistimi nuk është mëkatë. Insistimi e shpëtoi të verbërin, ky do të na shpëtojë edhe neve.

3. - Falje e përlëshme. Në kohë kur falemi, duhet të kemi në mend, cili është Perëndia që po i adresohemi, dhe cilët jemi ne që falemi. Perëndia është Zoti i ynë i gjithpushtetshëm, dhe i tërëshenjtë, dhe ne jemi mëkatarët dhe shërbetorët e Tij të pavlefshëm. Këtë gjë nuk duhet t' harrojmë kurrë, por më tepër në kohën e faljes. Nuk do të prezantohemi me të drejta dhe pretendime, sikundër Fariseu; do të falemi të përlulur me dhimbje në shpirt, me lotë në sytë, si fajtorë dhe mëkatarë, sikurse Telloni i parabolisë: mëkatova, mëshiro-më.

4. - Falje e shenjtë. Psa ka dhe falje mëkatore? Po. E thotë Apost. Jakovi: «Kërkon dhe nuk merni, se kërkon me mënyrë të dobtë, që të shpenzoni në dëfrimet t' uaja». Ç' kërkon nga Perëndia? Shum pasje, lavdëra dhe nderime, që të tregohesh dhe të ecish në ligësi. Ose ç' dëshiron? Të fitosh gjyqin e padrejtë dhe të humbasë armiku yt. Lutja jote është mëkatore dhe je në gabim, se nuk do të ndëgjohet lutja e jote. Perëndia është i shenjtë dhe të shenjta jep. Kërko pra të drejta dhe të shenjta, «të mira dhe të dobishme për shpirtet t' ona», sikundër thotë Kisha e jonë.

Të kërkojmë në lutjen t' onë: besë dhe pendim, përlulje dhe dashuri, pastrin zemre dhe shenjtëri shpirti. Mund të kërkojmë shëndet dhe të drejtën t' onë, kur kërkojnë të na i heqin, dhe ato që janë të domosdoshme për rrojtjen t' onë. Sepse vetë e thotë Krishti «e di Ati juaj qiellor, që keni nevojë për të gjitha këto; por kërkon më parë mbretërin e Perëndis dhe drejtësin e tij, edhe të gjitha këto do t' ju shtohen» (Math. 6. 32-33).

\* \* \*

Vllezër. Apostol Pavli në letrën e tij nër thesalonikasit thekson nevojën e faljes, «faluni pa pushim». Shumë herë i Krishteri ndodhet në shtrëngime dhe kemi nevojë t' i lutemi Zotit. Sëmundje na shtrëngojnë, vobeksija na mbyl, vdekje na përquarkojnë, pasionet ndizen, jeta jonë ndodhet në rreziqe. Ku do të gjejmë pra strehë, ngushllim, fuqi, që të qëndrojmë dhe të luftojmë? Vetëm tek Perëndia dhe në falje. Falja është shpëtimi i ynë, ruajtësi i shpirtit t' onë. Ajo që nga kjo botë e kotë do të na shpjerë në qiell, në vendim e prehjes dhe të gëzimit të përjetshëm. Amin.

---

## E DJELË E ZAKQEUT

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 19. 1-10)

**"Në atë kohë shkante Jisuj në Jeriko. Edhe ja, një njeri që quhesh Zakqeo, dhe ay ishte kryekumerqar. Ky ishte i pasur. Edhe kërkante të shikonte Jisun, cili ishte, dhe nuk mundesh nga gjindja, se ishte i shkurtër nga shtati ..."**

Jisuj shkante në Jeriko, që ishte qytet i Judhesë. Zakqeu ishte kryetari i kumerqarëve të atij qyteti. Kumerqarët mernin me qira doganat dhe mblithnin taksat. Me qenë se mernin taksa zakonisht jashtë nomit dhe shtrëngonin popullin për këtë konsideroheshin si njerës mëkatarë. Edhe Zakqeu, si duket nga këta poshtë kishte punuar shumë padrejtësira.

Zakqeu kishte ndëgjuar famën e Jisujt dhe dëshironte t' a shikonte, jo nga një kureshtje të thjeshtë, por se kishte në thellësi disponim të mirë dhe çmonte të mirën.

Zakqeu ishte i shkurtër nga shtati dhe kështu nga gjindja, që vinte prapa Krishtit kurdoherë, nuk mundesh të afërohesh dhe të shikonte Krishtin.

**"Dhe duke shkuar përpara, hipi në një mënë, që të shikonte Jisun. Sepse do të shkante nga ajo udhë. Edhe kur erdhi në atë vënd, ngriti Jisuj syt lartë dhe e pa dhe i thote. Zakqe zbrit me të shpejtë, se dot duhet që të ri në shtëpin t' ende."**

Zakqeu hipi në një dru mēni nga deshira e tij që të shikonte Jisun, se e dinte që do të shkante nga ajo udhë. E pa Zakqeon Zoti. Dhe si zemër njohtës pa dhe disponimin e tij të mirë.

Duhet të qëndrojë në shtëpin t' ende. Këtë bëri njeridashësi Zoti për të tërhequr Zakqeon në pendim.

**"Zakqeu me të shpejtë zbriti dhe e priti Jisun me gëzim. Dhe mbasi e panë, të**

**gjithë zemëroheshin duke thënë, që erdhi të qëndrojë pranë një njeriu mëkatar".**

Njerëzit tregonin mos kenaqesin e tyre dhe ankoheshin, se Zoti hyri në shtëpi të një njeriu mëkatar. Këtë gjë e konsideronin si të pa vlerëshme për shpëtimtarin, dhe Zakqeu, që nuk ishte i vyer për këtillë nderje.

**"Mbasi qëndroi Zakqeu i tha zotit. O Zot, Ja, gjysmën e pasjevet të mia, u jap të vobektëvet, dhe në qoftë se ndonjerit i mora pa drejtësisht, i a kthej katërfish. Jisuj u tha. Sot u bë shpëtim në këtë shtëpi, sepse dhe ky është i biri i Abrahamit. Sepse i biri i njeriut erdhi për të kërkuar dhe për të shpëtuar të humbrin".**

Me të shpejtë Zakqeu, me qënë se u pendua me gjith zemër premtonte që të ndajë të vobektëvet gjysmën e pasjes së tij. Dhe kujt i kam hequr të holla pa drejtësisht, do t' i a kthejë katërfish. Pas këtillë pendimi dhe vendimi Zakqeu hyri në udhën e shpëtimit.

Ahere shpëtimtari tha, se shpëtimi hyri në këtë shtëpi. Sepse duke përaqfuar drejtësin dhe mëshirën, u bë dhe ay i biri i Abraamit. Tha Krishti, se unë erdha të kërkojë dhe të shpëtojë mëkatarët, që kanë marrë udhën e humbjes. Pra për këtë shkak hyra në shtëpin e mëkatarit Zakqeu!

**MËSIMI.** - Mos të kritikojmë asnjë mëkatar, sepse një minutë pendimi mund t' a ndryshojë dhe t' a bëjë bir Perëndije. Zakqeu shumë vjetë ishte mëkatar, por ja në një ditë u ndryshua dhe shpëtimi hyri në shtëpin e tij.

Poshtë nën hirin fshihet shumë herë një shkëndi e vogël, e cila mund të ndezin një zjarr të math. Kështu edhe Zakqeu, me gjith mëkatarat e tij të shumta, kishte në thellësinë të shpirtit të disponim të mirë, dhe ky e shtyti te Shpëtimtari.

Dëshironte Zakqeu të shikojë Zotin. E pa edhe përnjëherësh u ndryshua. Sa njerës e shikonin Shpëtimtarin dhe nuk linin jetën e mëkatës? Dhe as nga ne sot shikojmë veprat e Tij dhe ndëgjojmë mësimin e tij dhe të gjitha këto nuk na mallnejnë dhe nuk na kthejnë?

Jo, nuk pranon Zoti të banojë në shtëpi mëkatarin, që nuk pendohet. Banon atje, ku, me gjith që ndodhet akoma mëkatar, është disponimi i mirë i pendimit dhe i ndreqjes. Për këtë Zoti pranoi të hyjë në shtëpin e Zakqeut.

Zoti erdhi për të kërkuar dhe për të shpëtuar të humburin. Sa ngushëllimtare janë këto fjalë për çdo mëkatar. Në qoftë se ne largohemi nga Krishti me anën e mëkatës, por

Ay kërkon, që të na gjejë. Kërkon që të na gjejë, për të na dhënë ndjesën dhe për të na udhëhequr në rugën e virtutit dhe të lumturis.

---

## E DJELË E ZAKQEUT

Ungjilli Lluk. 19. 1-10

### **FJALIM: Për ndreqjen e padrejtësiravet.**

**"O Zot, në qoftë se ndonjerit i rëmbeva padrejtësht ndonjë gjë, i a kthej katërfish".**

I papandehur është ndryshimi, që na tregon sot i pari i doganës Zakqeu. Ç' është ky? Një shkelës i paturpshëm i nomit të Perëndisë, rembyës i padrejtë, vjedhës, i pari i kusarëvet zyrtar. Po nashti? Posa përballoi Krishtin në shtëpin e tij, vjen në vehte dhe pendohet. Bije përpara shkuarjen e tij dhe shikon gjendjen e tij. Shikon lakmimin e tij dhe padrejtësirat e tij të panumërta. Kujton të vobegtit që i vodhi, jetimët që i zveshi, bashqytetarët e tij që i hëngri. I sheh të urishëm, të zveshur, të hidhëruar, me dhëmbje në zemër, me mallkim në gojë. Shikon Shenjtërin e ndriçsis këtë imponon, shpërblimin e dëmevet që u shkaktuan.

2. - E kërkon pendimi. Pendim s' është mallngjim i thjesht i minutës, as lotë dhe rrënkime të kohëshme, as vetëm rrëfim. Pendim është urrejtje në tërë jetën kundër mëkatës dhe largim me të vërtetë nga ajo. Po qysh mund të jetë i penduar njeriu, kur mban pasunin e huaj? Qysh mund të urrenj njerin mëkatën, kur fjalët e tij të hidhta sharjet dhe intrigat e tij e mbajnë vllan e tij të plagosur? Jo, pendimi i sinqertë njihet nga shpejtësija e të penduarit, që tregon për të pastruar plotësisht të kaluarën, për të shdukur qërtimet e ndërgegjes duke i kënaqur me çdo mënyrë ata që i dëmtoi. Ne qoftë se nuk bëhet kjo, ahëre lotët dhe rrëfimet dhe lutjet t' ona te Perëndia s' janë tjetër gjë, veç se gënjeshtër, ipokrizi dhe tallje me Perëndin.

3. - E kërkon dhe interesi i jonë, Sendet e pa drejta janë zjarr, helm, zëmëratë Perëndie dhe katarë. Të dëmtuarit kanë të drejtën me anën e tyre dhe kështu ankimet e tyre dëgjohen nga Perëndia. Prandaj s' kanë rëndësi lotët dhe rënkimet, por vetëm të ndrequrit e pa drejtësiravet, sikurse bëri sot Zakqeu.

\* \* \*

Por shumë nuk duan të dëgjojnë zërin e së vërtetës dhe nuk konformohen me kushtet e pendimit të vërtetë. Edhe ç' bëjnë? I ëmosha nër të vobegtët dhe dhurata nëpër Kishat bëjnë me të vjedhurat, me qëllim që të zbutin Perëndin, të qetësojnë

ndërgjegjen e tyre dhe të fitojnë parajsën. D.m.th. ç' bëjnë? I japin dhe Perëndis pjesë! Po jo. Perëndija s' behët bashkë fajtor. Perëndia me të vizitorit të math dhe errësirën e shpirtit të tij. Dhe me një vendim të premë dhe trimëror e hedh larg shkuarjen e tij mëkatore. Jo vetëm fjalë, por edhe me punëra. Nreq me të shpejtë padrejtësitat e tij, i kthen sendet e huaja, që pushtonte edhe katërfish i u jep atyre, të cilët i kishte dëmtuar padrejtësisht. «O Zot, në qoftë se i kam bërë ndonjerit padrejtësi, i a kthej katër herë më tepër», i tha Krishtit për të fituar shpëtimin e shpirtit të tij. Edhe e fitoi shpëtimin, se ndëgjoi nga goja e Krishtit fjalët: «sot shpëtim u bë në këtë shtëpi». Ç' vërteton kjo? Që për ndjesën e shpëtimin e mëkatarit kusht i domosdoshëm është ndreqja e padrejtësitave. Dhe për këtë gjë do të bëjmë fjalë.

Sigurisht që të marrë ndjesë mëkatarit duhet pendim, hidhërim i thellë dhe rrëfim i sinqertë. Por janë dhe mëkata, që duhen diçka të tjera për të marrë ndjesë. Janë takimi i nderjes dhe i pasuris. E shave? E vodhe? E grabite? Nashti që u pendove, duhet t' i japësh satisfaksion, t' i kthesh sendet e tija. Kjo është e nevojshme, sepse:

1. - Kërkon drejtësia e Perëndisë. Sepse me sharjet, me intrigat, me padrejtësitat, me vjedhjet, me abuzimet shkele drejtësin e Perëndis. Vendose tash të rrojsh me nderje, me drejtësi, me dashuri, nomi kërkon satisfaksion, kërkon të pastrojsh të kaluarën. Sepse nuk mund të bazojsh drejtësin sipër padrejtësis, nuk mund të bëjsh tregëti me kapitale të vjedhura nuk mund të hash bukë të bekuar, kur punon arën, që e ke fituar me paranomi. I drejtë është Zoti dhe drejtësira deshi, me qenë se njeriu vendosi të bëhet i tij, kërkon më parë drejtësi. Edhe nomi i drejtë s' kërkon lëmosha me mjete të pa drejta, as dhurata, as aferoma, por kërkon ma tepër drejtësi.

Kujdesu pra të gjejsh ata që dëmtove, përulu përpara tyre dhe kërko ndjesë prej tyre dhe vër në vënt emrin e tyre duke i u kthyer sendet e pasurin e tyre. Në qoft se nuk gjenden të dëmtuarit as trashëgimtarët e tyre, vetëm ahëre është e lejuar ndihma nër të vobegtit, nëpër Kisha dhe institute bamirësije. Kjo do të na sigurojë ndjesën dhe shpëtimin nga goja e shpëtimtarit që të na thotë, sikundër Zakqeut: «Sot shpëtimi u bë në këtë shtëpi» Amin.

---

## **E DJELË E GRUAS KANANEASE**

Shpiegim i Ungjillit Math. 15. 21-28

**"Në atë kohë doli Jisuj në vendet e tiros dhe sidhones. Dhe ja një grua Kananease duke dalë nga ato kufi i thërriti duke thënë. Mëshiro-më, Zot, biri i Dhavidhit, vajza e ime është djallosur ligisht. Jisuj nuk i u përgjegj asnjë fjalë. Dhe nxënësit e tij duke ardhur i lutëshin dhe i thoshnin. Lësho-e atë, se thërret**

**prapa nesh. Jisuj u përgjegj, se nuk jam dërguar veç se për dhent e humbura të shtëpis Israilit".**

Dolli një herë Jisuj nëpër vendet e Tيروس dhe Sidhones, që nuk ishin qytete të Judhenjvet, por të Finikasvet. Atje dolli një grua Kananease, e cila i lutet që t' i shërojë vajzën e saj, e cila ishte pushtuar prej djallit.

Jisuj nuk i përgjegjet fare gruas, që të vërtetohen, ata që i venë prapa, për besën e nxehtë të gruas, dhe që kjo grua vliente për mëshirë, sado që ishte nga një komb tjetër.

Nxënësit i lutëshin që të dëbojë gruan, që vinte prapa, për të mos vazhduar të thërresë prapa tyre. Dhe Jisuj i tha, gruas, së është dërguar vetëm për të shpetuar dhent e Israilit, dhe jo për Finikasit. Por grua Kananeas as nga heshtje e parë, as nga fjalët e Krishtit, nuk u dëshpërua; por e qëndruar dhe e pa tundur në besën e saj dhe në lutjen e saj, i ra ndër gjunjët të Jisujt duke i thënë: «O Zot, ndihmo-më».

**"Gruaja mbasi erdhi afër, i falet duke i thënë, o Zot, ndihmo-më. Jisuj u përgjegj dhe i tha. Nuk është mirë të marrë bukën e bijvet dhe t' u a hedh qenvet. Gruaja i tha, po, o Zot, sepse edhe qent hanë nga thërrimet, që bjenë nga tryeza e zotërinjvet të tyre. Atëhere u përgjegj Jisuj dhe i tha. O grua, besa jote është e madhe, le të të bëhet sikundër do. Dhe u shërua vajza e saj që në atë orë".**

Jisuj për të bërë mâ të kjartë besën e gruas Kananease dhe për të provuar durimin dhe butësin e saj, i thotë. «Nuk është mirë të marrë ndonjë bukën prej fëmijvet të tij dhe t' i a hudhi qenvet». Këto fjalë të ashpëra nuk shkaktojnë zemëratën as largimin e gruas Kananease, por me durim dhe butësi i thotë Krishtit. «Po, o Zot, por edhe qent hanë, nga thërrimet, që bjenë nga tryeza e zotërve të tyre.

Por, kur nga kjo përgjegje provoi gruaja qëndrimin e saj në besën dhe në lutjen. Krishti tha, «O grua, besa jot është e madhe, le të bëhet simbas dëshirës s' ate». Dhe qysh prej asaj minute u shërua vajza e saj: sado që s' ishte Izrailite, por nga Kanaani.

Besa, e cilan në botën morale është kaq e domosdoshme, sa drita në errësirë, duhet të jetë e gjallë në zemrën t' onë, që të fitojmë me anën e besës mbrojtës dhe udhëheqës Shpëtimtarin t' onë Krishtin. Sepse besa e tundur, lutja dhe virtuti i pa qëndruar. s' është as besë, as lutje, as virtut. Dhe gruaja nga Kanaani në qoftë se s' kishte besë të fortë dhe nuk insistonte në lutjen e saj, nuk kishte për të fituar shërimin e vajzës së saj.

---

# E DJELË E GRUAS KANANEASË

Ungjilli Math 15. 21-28

**FJALIM: Për besën.**

**"O grua, besa jote është e madhe".**

Nuk është Isarilitëse Kananea e Ungjillit të sotshëm, që të dijë nga profetit e Dhajtës së Vjetër, fuqin e mirësin e Krishtit Messia. As nuk u bind nga predikimet e Shpëtimtarit. As nuk e ka parë të bëjë çudira, që të formojë bindjen se Ay është i Biri Perëndisë dhe Shpëtimtari i njerëzvet. Të tjerë ndëgjoi që të tregojnë madhështirat dhe veprat e Shpëtimtarit hyjnor. Edhe beson, beson thellë. me gjith që Zoti bën, sikur nuk ndëgjon lutjet dhe thirjet e dhimbëshme të saj, po ajo insiston. Edhe me gjith që ndigjon fjalë të përluta për veten e saj dhe përbashkombësit e saj, ajo më tepër insiston duke kërkuar ndihmën e T'ij. Kaq besë mbyll në thellësitat e shpirtit të saj, sa e shtrëngon të Birin e Perëndisë t' admirojë, t' a lavdërojë dhe të lëcisë besën e saj në turmën që i vinte prapa. Por në qoftë se ajo, që ishte idololatre, e mendoj të nevojëshme të besonj të marrë dhuratat e Krishtit, qysh neve të krishterët do të mbetemi prapa? Qysh do e marim të tanishme e të ardhme pa besën te Shpëtimtari e Zoti? Duhet pra besë. Prandaj do të bëjmë fjalë për besë dhe do të shikojmë ç' është besa dhe përfundimet e saj.

## I

Ç' është besa?

Ashtu si e kupton dhe ç' do Krishti e Ungjilli i T'ij. Është:

1. - Besim në fjalët e Perëndis pa dyshime dhe mendime. Ç' thotë fjala e Perëndisë? Që Perëndia krijoi botën. Dhe ç' mëson ungjili? Që nga dashuria e pa treguar Ati qiellor dërgoi të Birin e T'ij shpëtimtar dhe çlironjës të njerëzvet, i cili vdiq dhe u ngjall, që ka një jetë të ardhëshme, ku do të jetë gëzimi i të drejtëvet dhe dënimi i mëkatarëvet: ku do të shikojmë lavdin e të Lartit. Këto janë të sigurta e të vërteta. Të parat u bënë në të kaluarën, të tjerat do të bëhen në të ardhmen. Perëndia i thot, dyshim nuk hynë. Kjo është besë. E kemi parë ndonjë herë Perëndin, shpirtin, jetë e ardhme? Jo, janë të pa dukëshme: është e pamundur t' i shikojmë me sytë e trupit. Për neve janë të gjitha dhe i shikojmë me sytë e shpirtit, me sytë e besës. Sa i lumtur është besniku dhe sa fatkeq është i pabesi. Në dritë lundron besniku, në errësirë fundoset i pabesi. Besë pra e padyshimte, besim i tërë në fjalët e Perëndis. Por besa kërkon.

2. - Jetë të shenjtë dhe të pelqyer te Perëndia. I krishteri që beson në Perëndin dhe në jetën e ardhme, i ngjitet Perëndis me mish e me shpirt. Jetën e ardhme, e dëshiron dhe e pret me padurim, si një i huaj dhe i përkohëshëm në këtë botë. Rron si njeriu i Perëndis dhe nuk njehë padrejtësira dhe lakmime dhe poshtërsit e botës. Veprat e tij janë vepra dashurije dhe drejtësie. Bën ato që e urdhëron Perëndia dhe punon ato që do t' i sigurojnë mbretërin e Perëndisë. Në qoftë se nuk rron në këtë mënyrë, s' është besnik.

Besa e tij është e vdekur, si thot Apost. Jakovi (2. 4). «Ti ke besë? Trego-më besën t' ende nga veprat e tua».

## II

Edhe nashti përfundimet e besës. Ç' fiton njeriu, i cili me gjith zemrën dhe shpirtin e tij beson në Krishtin dhe në Ungjillin e Tij? Shumë të mëdha janë fitimet e atij që beson.

1. - Gjen mbështetje dhe durim në furtunat e jetës. Kurrë nuk rrojti njeri mbi dhe pa prova. Jeta e çdo njeriu është e shoqëruar me vuajtje dhe shtrëngime, si deti me dallga të shumëzuar. Vobegsira, sëmundje, intriga, ndjekje, vdekje. Kush shpëtim nga këto furtuna të jetës? Prandaj Zoti tha: «në botë shtrëngime do të kini». Ahere turbullim, frikë, dëshpërim pushton shpirtin e njeriut. Por kujt njeriu? Vetëm të pabesit. Ay i shehë të errëta dhe të zeza të gjitha. Por i krishteri kujton fjalët e Krishtit: «mos të turbullohet zemra e juej, besoni te Perëndia dhe te mua besoni». Nuk tronditet pra çdo gjë e ligë, që t' i ngjajë. Ka Perëndin me anën e tij ndihmës dhe mbrojtës. Bën durim dhe pranon pa zemërim vuajtjet e jetës.

2. - Bëhet trashëgimtar i jetës së përjetëshme. Sepse besa e bën bir të Perëndisë qiellore. «Ata që e pranuan, i u dha pushtet që të bëhen bij Perëndije». Por bijtë trashëgojnë atin.

Na e thot Apost. Pavli: «në qoftë se jemi bij, ahere jemi edhe trashëgimtarë të Krishtit». D.m.th. trashëgimtarë të jetës të Perëndis, të gëzimit, të lavdis dhe të lumturis, në të cilën rron dhe mbretëron Zoti dhe Shpëtimtari Ynë Jisu Krishti. Gjenden fitime më të pasura nga këto? Enderroi ndonjë herë lumturinë më të madhe nga kjo? Ja ç' është besa për njerin.

\* \* \*

Vlezër. Besa e jonë nuk është e djeshme. Është e provuar. Si ujqër të tërbuar u sulën kundër saj gjith fuqit e errëta të antikrishtit. E luftuan me tërbim. Po ajo qëndroi e patundur. Dy mij vjetë me gjith sulmet e armikut qëndroi si një shkëmb i fortë dhe i

patundur. E pranuan me mijra shpirta. E ardhuruam mëndjet më të shkëlqyera të botës, më të mëdhej të ditur të shekujvet. Çe do të qëndrojmë prapa neve?

Jo, na duhet besa. Ajo është ngushëllimi ynë, është fuqija e jonë, është shpëtimi i shpirtit t' onë. Besa e gjallë dhe e patundur le të jetë fuqija lëvizese e jetës s' onë, që të bëhemi bij të shpëtimtarit t' onë Jisu Krishtit dhe trashëgimtarë të mbretëris së Tij. Amin.

---

## **E DJELË E KUMERQARIT DHE E FARISEUT**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 18. 10-14)

**"Tha Zoti këtë paravoli. Dy njerës i ngjitën në ierore për të falur. Njëri ishte Farise dhe tjetri Kumerqar".**

Kisha e Judhenjvet në Jerosalim përqarkohesh nga tre ndarje. Përqarkimi i mbrëndshëm, shërbente për priftërit. Përqarkimi i dytë ishte caktuar për Israilitët. Ky i dyti ishte nëndarë në dy pjesë, një për burrat dhe tjetra për gratë. Pas këtij ishte përqarkimi i tretë, ku mund të hynin edhe paganët.

Në përqarkimin e dytë hynë dy njerës, që të falen.

Farisenjt formonin një klasë të veçantë midis Judhenjvet. Ishin njerës të pasur dhe tregonin zell për nomin e Moisiut, dhe pandeheshin prej popullit si njerës të drejtë dhe të dhënë te Perëndia. Me gjith këtë ishin shumë lark nga virtuti i vërtetë. Kufizoheshin më të shumtën në disa vepra të përjashtme, si agjërime, falje, të cilat i bënin jo për lavdi të Perëndisë, por për të dukur ndër njerzit.

Kumërqarët ishin ata, që mernin me qira dhe mblithin taksat. Bënin shumë padrejtësira, prandaj konsideroheshin si më të liqt të mëkatarëvet.

**"Fariseu duke ndëjtur në veten e tij, falesh këto. Perëndi, të falnderoj, se nuk jam, si njerëzit e tjerë. Rrëmbyës, të padrejtë, kurvarë, ase si ky Kumërqari. Agjëroj dy ditë në javë, jap të dhetën e pasjes që kam ..."**

Duke ndëjtur në veten e tij, d.m.th. duke marrë qëndrim faljeje. Qëndrimi i Fariseut ishte alazonik, sikundër duket dhe nga fjalët e faljes së tij.

Fariseu jo vetëm nuk konsideron veten e tij mëkatar dhe fajtor përpara Perëndisë, por dhe lëçit, që nuk është një lloj me njerzit e tjerë dhe me Kumërqarin. Por gënjehet.

Sepse është e mundur të mos kishte ndonjë fajë përpara Perëndisë? Qysh është i bindur, që ay nuk i përgjan njerzvet të tjerë dhe Kumëerqarit, kur nuk mundet të dinte jetën e çdo njeriu? Edhe falnderimi i tij te Perëndia, ishte mburje. Sepse, në qoftë se njinte me të vërtetë, që ruan porosit hyjnore me ndihmën e hirit të Perëndisë, nuk do të kritikonte as do të përbuzte njerzit e tjerë dhe Kumerqarin.

Numëron virtutet e tij. Agjëronj dy ditë të javës, dhe jap një dhjetënnga të gjitha të hyrat e mia të vobektëvet. Edhe me të vërtetë agjëronte dhe jepte lëmoshë, Por i bënte këto për të dukur dhe që të mburehet. Kufizohesh vetëm në virtutet e përjashtme, dhe nuk shikonte që shpirti i tij ishte pushtuar nga egoizma, nga shkak i së cilës përbuzte njerzit e tjerë.

**"Kumerqari duke ndënjur lark, nuk donte as syt t' i ngrinte në qiell. Por i binte krahorit tij duke thënë. Perëndi, mëshiro mua mëkatarin. Them juve, që zbriti ky i ndjerë në shtëpin' e tij, se sa ay. Sepse ay që lartëson veten e tij do të përlulët, dhe ay që përlulë veten e tij do të lartësohet".**

Kumërqari qëndron në fund dhe nuk shikon vehten të vyer që të ngrerë syt në qiell. I binte karhërorit të tij për të treguar që është i vyer të dënohet për mëkatat e tij. Për këtë thërret mëshirën e Perëndisë duke thënë. O Zot, bën i mëshirshëm te mua mëkatarin dhe ndjemë në mëshirën t' ende.

Kumërqari u kthye në shtëpin e tij i ndjerë, por jo dhe Fariseu, i cili u fal me kryenaltësi.

MËSIMI. - Detyrë shumë e lartë dhe vepër shumë e dobishme është falja. Por nuk pranon Perëndia çdo lloj falje. Këtë shohim edhe në faljen e Fariseut.

Fariseu falnderon Perëndinë me buzët, por me të vërtetë mburën veten e tij. Përpara shenjtëris të pakufishme të Perëndisë, lartëson pa turp shenjtërin e tij, siç pandehë. Qëndron përpara Gjykatësit të lartë, dhe ndëshkon pa mëshirë njerzit e tjerë.

Fariseu mburehesh për agjërimet dhe lëmoshat. Por mjerë! Këto vepra kishin për qëllim, që të tregohesh dhe të kryenaltësohesh. Për këtë përpara Perëndisë ishin një monedhë fallse dhe pa vlerë.

Shikoni qëndrimin e Kumerqarit. Ndjen mëkatat e tij dhe fajën e tij. Pendohet, hidhërohet, tregon mëkatat e tij dhe kërkon përdëllim dhe ndjesë. I këtillë është pendimi i vërtetë, që prodhon mëshirën dhe hirin e Perëndisë.

U dënua Fariseu dhe u drejtua Kumerqari. I pari me të rreme lartësoi veten dhe për

këtë u turpërua. I dyti përuli veten me të vërtetë, për këtë mori ndjesë dhe mëshirë. Kryenaltësia të rrëzon në Ferr, kurse përulësia të ngrehë në qiell.

---

## **E DJELË E KUMERQARIT DHE FARISEUT**

Ungjilli Lluk. 18. 10-14

**FJALIM: Për farisaizmën.**

**"Nuk jam, sikundër janë njerëzit e tjerë".**

Kurrë nuk do të priste njeri fjalët e rënda dhe egoistike të dërgohen në kohën e faljes, sepse falja është koha e mallngjimit të thellë dhe strëngimit shpirtnor. Duhesh të ishte Farisë që të tregonte këtyllë sjellje dhe të përdorte të këtyllë fjalë në kohën e faljes. Nuk respektoi vendin e shenjtë të Kishës, nuk u turpërua nga njerëzit, nuk pati frike nga Perëndia i lartë. Zgjodhi kohën e faljes që të përflasë të tjerët dhe të lartësojë egon e tij dhe të reklamojë veprat e tij: «nuk jam si njerëzit e tjerë».

Farisaizma, pasion i verbër dhe dëmprurës i shpirtit, (Farisaizma nuk ishte njohje karakteristike vetëm në kohën e Krishtit) nuk mungoi kurrë nga klasat e njerzvet. E gjejmë kudo, e gjejmë mjerisht edhe në vehten t' onë. Le të hetojmë pra më thellë sëmundjen, që të largojmë përfundimet shkatëruëse të këtij pasioni. Ç' është farisaizma? Farisaizma është një sëmundje e komplikuar e shpirtit.

1. - Kryelartësi dhe egoizmë. Atë që karakterizon çdo të krishterë dhe besëmirë është ndjenja e mëkatave të tij dhe përnija në mendimet, në fjalët dhe në veprat. Ngjan kështu me Fariseun? Jo. Ay mendohet dhe beson, që është i pamëkatshëm dhe i shenjtë. Ç' gjë nëse është njeriu plotë me ligësira dhe me vese? Ç' gjë në se Shkronja e Shenjtë na vërteton që: «asnjë s' është i pastër nga mëkatat, sikur edhe një ditë të rrojë mbi dhe» (Job 14. 5). Ay nuk i shikon këto; një gjë vetëm shikon edhe çmon: virtutin e tij të vobegtë dhe tipik. Nuk shikon i mjeri më të rëndat e nomit, «gjqin, mëshirën dhe besën» (Math. 23. 23), d.m.th. drejtësin, mëshirën dhe besën e vërtetë, që kërkon Perëndia. Fariseu i sotshëm, sikundër Fariseu i kohës së Krishtit, kufizon besëmirësin dhe virtutin në faljet, në agjerimet, në të pakta të holla që jep me dorë të shtrënguar dhe pa dhimbje si lëmoshë të vobegtëve. Ju jep këtyre një vlerë, sa nuk e kanë. Bazon mbi këtyre thërimeve të virtutit të tij shenjtëri të madhe e fantastike. Fariseu nuk ka «gnodhi safton» njohtjen e vehtes së tij: dhe nuk përjashtohet, që të jetë fundosur në thellësitat e Ferrit nga shkak i mëkatave të tij; ay beson, se është i pamëkatshëm.

2. - Admiruësi dhe reklamuësi i vehtes. Nuk e admirojnë të tjerët? Nuk e lavdërojnë?

Fariseu admiron, lavdëron dhe përgëzon vetë vehten, reklamon veprat e tij akoma edhe përpara Perëndisë. Sikundër Fariseu i sotshëm, që të shtrëngoj të tjerët t' a shikojnë dhe të çuditen për shenjtërin dhe për virtutin e tij. Largohet nga veprat e mira fariseu? Jo, merr pjesë në ndihmat.

Ndihmon shoqëritë bamirëse, jep lëmoshë të vobegtëvet, por me një kusht që të shkruhet emri i tij nëpër gazetatat, të shkruhet emri i tij me shkronja t' arta në shtyllën e mirëbërësve, të ndëgjohej, t' a marrë vesh gjithë bota. Zoti na porositi: «Kush bën lëmoshë, mos trumbeto përpara teje edhe mos të dijë e majta jote, ç' bën e djathta jote» (Math 6. 2-3). Fariseu trumbeton nëpër sinagjit dhe nëpër rrugët, që t' a shëkojnë njerzit.

3. - Përfolje dhe kritikim. Natyrisht me qenë se për vehten e tij formon iden më të mirë, për të tjerët formon iden më të keqe. Ç' janë të tjerët përpara tij «grabitës, të padrejtë, kurvarë», sikundër theret fariseu i sotshëm. Fariseu nga lartësia e shenjtëris së tij, i shikon të tjerët të rrukullisur në baltën e ndyrësis dhe ligësis. Ndofta ndjen hidhërim dhe shpejton t' i këshillojë dhe t' i \* Aspak Fariseu nuk ndjen \* përflet dhe kritikon, që t' i reklamojë shenjtërin e vet. Zoti na porositi: «mos gjykoni që të mos gjykoheni». Farisenj bëhemi dhe ne, kur kritikojmë dhe mbajmë në gojë për të ligë të tjerët.

4. - Dinakëri dhe ipokrizi. Farisenjtë janë me të vërtetë besëmirë dhe kanë frikë nga Perëndia? Farisenjtë janë atdhetarë të pastër dhe mirëbërës pa interes? Kurrë. Farisenjtë janë Ypokritë dhe njerës interesantë të pandërgjegjshëm. Bërtasin për fen, kurse nuk kanë asnjë lidhje me fen. Thërresin për moralin, kurse nuk njohjnë moralin. Kërkojnë zbatimin e nomit, kurse janë shkelësit më të paturpëshëm të nomit. Ç' janë pra? E tha goja e palajthitur e Krishtit t' onë, «përngjajnë me varre të lyer me gëlqere, të cilët përjashta duken të bukur, por mbrenda janë plotë me eshtra të vdekurish dhe me çdo ndyrësi. Kështu dhe ju përjashta dukeni tek njerzit të drejtë, por përmbrenda jeni të mbusur me ipokrizi dhe paligjësi» (Math. 23. 27-28).

\* \* \*

Vllezër. Farisaizma është sëmundje më e dobtë e shpirtit; pasion më i vështirë dhe i urrejtshëm përpara Perëndisë. Zoti i goditi rreptësisht Farisenjtë. Tetë herë i qortoi me fjalën «mjerë ju Farisenjtë ipokritë». Le të largohemi nga farisaizma, le të mbyllim shpirtin t' onë nga kryelartësia e mallkuar. Lutje, agjërime, dhe lëmoshë, sado që të jenë, nuk na japin të drejtën të mburremi dhe të kritikojmë të tjerët.

Pendim, falje dhe lartësim shpirti kërkon Triodhi i shpirtthekshëm, që fillon sot. Le të

kemi jo kryelartësin e Fariseut, por faljen e përlutë të kumerqarit «O Perëndi! ndjeje mua mëkatarin».

---

## **E DJELË E PRODIGUT**

Shpiegim i Ungjillit (Lluk. 15. 11-32)

**"Tha Zoti këtë paravoli. Një njeri kishte dy djem. Tha mâ i riu t' et, o At, jep më pjesën e \*, që më takon \* ditësh mbasi mbloodhi të gjitha ma i vogli, shkoi në një vënd të lark, dhe atje e shpërndau pasurin e tij duke rrojtur jetë të çthurur".**

Njeri kupton Perëndinë dhe Atin qiellor, të cilët njerzit janë bij dhe kreatyra. Mâ i vogli tregon njerin mëkatar, që largohet nga Perëndia.

Ati ndau pasurin dhe i dha mâ të voglit pjesën që i binte. Pjesa e pasunis tregon dhuratat e ndryshme trupore dhe shpirtnore, me të cilat ka pajosur Perëndia njerin dhe e lë të lirë në përdorimin e tyre.

Mbasi mbloodhi të gjitha të mirat, sa mori nga i ati, u largua në një vënd të larkë, dhe atje rrojti një jetë plot me dëfrime dhe çdo demoralizimi.

**"Mbasi i prishi të gjitha, u bë një zi e madhe në atë vënd, dhe zunë t' i mungojnë atij të gjitha. Dhe mbasi shkoj, u mgjit te një qytetar të atij vëndi. Dhe ai e dërgoj në arat për të kullotur derrat. Dhe dëshironte të mbushte barkun e tij nga harupet që hanin derrat, por asnjë nuk i jepte atij".**

I vogli mbasi mbaroi pasurin, u bë një zi e madhe në atë vënd. Ky u shtrëngua të bëhet shërbëtor në një qytetar, i cili e dërgoi për të kullotur derrat. Atje s' kishte për të ngrënë dhe për të mbushur barkun kërkonte të hante, ç' hanin derrat.

**"Mbasi erdhi në veten e tij tha: Sa shërbëtorë te ati im kanë bukë me tepëricë dhe unë po humbasë nga uriya. Do të ngrihem dhe do të vete te ati im dhe do t' i them. O at, mëkatova në qiell dhe përpara teje dhe nuk jam më i vyer të quhem bir i yt. Më bëj si një nga shërbëtorët e tu".**

U kujtua prodigu që shërbëtorët e t' et kishin bukë me shumicë, kurse ay po vdiste uriye. Pendohet për sjelljen e tij dhe për largimin nga shtëpia atnore dhe i penduar vendosi të kthehet te ati i tij.

**"\* Edhe kur ishte akoma lark, e pa i ati dhe u mëshirua dhe me të shpejtë ra në shpatullën e tij dhe e puth. I biri i tha. O at, mëkatova në qiell dhe përpara teje dhe s' jam më i vyer të quhem bir i yt. I ati tha shërbetorvet të tij. Bini stolin e parë dhe mvisheni atë, dhe jepni unazë në dorën e tij, dhe sandale në këmbë. Dhe thorni viçin e majmë dhe mbasi të hamë të defrejme. Sepse ky biri im ishte i vdekur dhe u ngjall prapë, ishte i humbur dhe u gjend. Dhe zunë të dëfrejnë".**

I ati prodigut, kur e pa që u kthye i biri, nuk mendoi jo vetëm sjelljen e tij të parë, por mbrodhi plotë me dashuri, e përqafoi dhe e puthi. Edhe të gjitha këto përpara se të tregojë i biri pendimin e tij.

Të gjitha këto tregojnë, që prodigu i penduar u bë prapë djali i atit të tij, me gjitha të \*rejtat si bir i dashur.

**"I biri i tij më i madhi ishte në arë. Dhe kur erdhi dhe u afërua shtëpis, ndëgjoi muzikë dhe valle. Dhe mbasi thërriti një nga shërbetorët e tij, pyeste për të marrë vesh ç' janë këto. Shërbetori i tha, që erdhi vllaj yt dhe therri ati yt viçin e majmë, se e pa atë të shëndosh. U zemërua dhe nuk donte të hynte. Mbasi dolli i ati, i lutej ati te hynte por i madhi duke u përgjegjur i tha. Ja, kaq vjetë po të punoj dhe asnjë porosi s' kam shkelur, dhe mua s' më ke dhënë askurrë ndonjë kedh, që të dëfrejë bashk me miqt e mi. Por kur erdhi ky biri yt, që hëngri pasunin t' ende me kurvat, there për atë viçin e majmë. I ati i tha atij. Bir, ti gjithnjë je me mua, dhe të gjitha të mijat janë të tuat. Por duhesh dhe ti të dëfrejshe dhe të gëzojshe. Sepse vllaj yt ishte i vdekur dhe u ringjall, ishte i humbur dhe u rigjent."**

Djali më i math, i cili rinte gjithnjë me atin e tij, tregon ata njerës, që kufizohen vetëm në besëmiresi të përjashtëme, sado që janë besatarë të Perëndia. Njerës të këtillë s' kanë virtut dhe më tepër s' kanë dashuri. Të këtillë ishin Farisenjt.

Duke ardhur i madhi nga arat dhe duke u afëruar në shtëpim ndëgjon këngë e valle. Është gëzimi, që ndjejnë engjejt dhe shenjtorët për kthyerjen dhe pendimin e një mëkatari, Në vend që të gëzohet dhe ky, u zemërua, se i ati pranoi dhe destonte kthyerjen e prodigut. Kjo tregon, se s' kishte dashuri, e cila është njohja kryesore e njeriut me të vërtetë virtuozë. Të këtillë ishin Farisenjt, të cilët zemëroheshin, se Zoti shoqëronte dhe pranonte mëkatarët që pendoheshin, në vend që të gëzoheshin për pendimin dhe shpëtimin e tyre.

I madhi flet me përbuzje dhe me zemërim kundër vllajt të tij, të cilin as pranon t' a quaj vlla. Kritikkon edhe sjelljen e t' et plotë me dashuri, në vend që të imitojë atë.

Gëzimi ishte i duhur, sepse djali produg ishte i vdekur në mëkatë dhe i humbur. Me anën e pendimit u ringjallë dhe u gjend, d.m.th. gjeti shpëtimin e tij.

Paravolija nuka na tregon, nëse më i madhi u bind më në fund të hyjë dhe ay, dhe të marrë pjesë në gëzimin. Këtë e heshti Zoti me qellim për të treguar, se të këtillë njerës, në qoftë se pendohen dhe ndreqen, do të shpëtojnë. Ndryshe përjashtohen nga ajo.

MËSIMI. - Po të qëndroje njeriu pranë Perëndisë me bindje në nomin e Tij, ka vendin e tij të nderçëm, si bir pranë atit tij, duke gëzuar mbrojtjen atnore dhe gjitha të mirat e Perëndisë.

Njeriu mëkatar i prëgjan djalit të vogël. I çmendur dhe i pa logjikshëm, si ay, duke mos pasur provën e çkatërimit nga mëkata, largohet nga Perëndia dhe kërkon lumtërin e tij në jetën e mëkatës.

Cila janë \* gjith dëfrimet e demoralizimit, ndjen një zi të madhe në shpirtin e tij. D.m.th. mungesën e çdo të mire dhe virtuti, mungesën e paqes dhe të lumtëris. Sikundër djali prodig, kështu dhe mëkatarin bëhet shërbëtori i Satanajt dhe kullot derrat e pasionëve dhe të dëshiravet shtazore. Gjeron gjithnjë mëkatën dhe gjithnjë e dëshiron. Për këtë është i mjerë dhe pëson dhe vuan.

Prodigu më në fund erdhi në vete. Kështu dhe shumë nga mëkatarët vijnë në vete nga marrëzija e mëkatës. Një rreze e hirit hyjnor hynë mbrënda në shpirtin e tyre. Kuptojnë gjendjen e tyre mizore, shikojnë mjerimin e tyre dhe vendosin që të kthehen te Perëndia. O vendim i shenjtë dhe i bekuar!

Shikon ati djalin e tij prodig, që po vjen. E pret, e përqafton dhe e puth. E proklamon prapë djali të tij, e mvsh me stolin e parë, urdhëron të bëhet panagjyr. Sa dashuri ka Perëndia! Kështu Perëndia pranon ata që pendohen. I ndjen, i pastron nga luca e mëkatës, i bën bijt e Tij, i nderon, i lavdëron. Panagjir gëzimi bëhet në qiell, frymat qiellore gazëllohen për shpëtimin e atyre që pendohen.

Cili është viçi i majmë? Është Zoti, që u mishërua për ne, Ay që u therrorëzua për shpëtimin e botës. Për ne u therrë viçi i majmë dhe jemi të thërritur të marim pjesë në këtë darkë të shenjtë dhe misteriozë.

Ja dhe djali më i math. Merrë vesh kthyerjen e vllajt të tij. Por sa nuk i përngjan atit tij! Shtrëngohet, zëmërohet, flet me përbuzje për vllan e tij, dhe murmuris kundër atit tij. Smira ha shpirtin e tij. Kryenaltësija e tij plagoset nga prtija e prodigut. Të këtillë të

krishterë dhe në qoftë se duken që mbeten pranë Perëndisë, por me të vërtetë janë shumë lark!

---

## **E DJELË E PRODIGUT LLUK. 15. 11-32**

**FJALIM: Për pemët e mëkatës.**

**"Edhe atje shpërndau pasurin e tij duke rrojtur në dëfrime".**

Nuke e priste këtë gjendje djali i vogël i paravolis së sotshme. Ay kishte ndëgjuar, se mbishikimi atnor dhe votra familjare dhe tradita stërgjyshore janë gjëra të vjetëruara (anakronizëm), që s' kanë vlerë për një njeri të edukuar dhe të mirë-rritur. Kishte ndëgjuar, që larg atit të tij atje ndodhet liria e njeriut, gëzimi dhe dëfrimi ideal. Kishte ndëgjuar, që jeta e botës, me bukurit e saja djaloshare, me dëshirat tërheqese, është parajsë plotë me kënaqësira. Kishte ndëgjuar, që duhet të bejë kryengritje në shtëpin e tij dhe t' a heqë zgjedhën atnore, në qoftë se dashuron të rrojë i lumtur dhe i lirë. Edhe e bëri dhe iku dhe mori udhën e ligë, udhën e jetës së botës, të demoralizimit, të dëfrimit të shkatërimit. "Atje shpërndau pasjen e tij duke rrojtur në dëfrime". Ç' kishte marrë nga i ati, i shpërndau në të katër anët dhe u gjend i mjeri i urishëm, lypës, i zveshur dhe ruajtës i derravet.

E këtillë është mëkata. Të premtos kënaqësi dhe të sjellë hidhërim. Të premtos të gjitha dhe t' i merr të gjitha. Ç' more nga Perëndia, nga Ati qiellor? Pasje, shëndet, jetë, nderje, shpirt të pavdekshëm. I prish, i shkatëron, i zdhuk. Le të shikojmë sot ç' prish mëkata.

1. - Pasunin e njeriut. Shëmbull djali prodig, arakat. Iku nga i ati i ngarkuar me pasuni. Kush i a hengri? Jo të vobegtët, por lodrat, pijet, dëfrimet tërë natën, vallet e tjera ndyrsira trupore. Kështu prishen të hollat e pasanikëve dhe leku i të vobegtëve, që të mbeten të zveshur fëmija dhe gruaja dhe gërmadha shtëpija. Kjo është plaga e parë.

2. - Prish jetën dhe shëndetin. Shëndeti dhe jeta janë dhurata të çmuëshme të Perëndis. Kur na bëhet ndonjë fatkeqësi ekonomike, miqt t' anë na urojnë: «shëndet të kesh, pa pasunija vihet prapë në vend», d.m.th. shëndeti është i paçmuëshëm. Por mëkata edhe shëndetin e prish. Shikoni ata djelmossa me zemër luani, trupa të çelnikta, faqëkuq, që ecin në punë plotë me gjallin. I shikojnë dhe gëzohet zemra e jonë. Janë shpresa e së ardhmes. Është e mundur, që këta të bjenë, të thyen? Me gjith këtë mjerisht shikoni at atje që janë të verdhë, të thatë, sqeletë si fantazma, me sytë futur dhe me kollë të thatë në gojë? Shikoni dhe të tjerë që smund të mendojnë, të

veprojnë dhe të mbarojnë punën e tyre. me mijëra mbredhin në doktora, në spitalet me turp në fytyrë. Me mijëra idiotë, anormalë mbyllen në çmendore dhe në psikiatrija. Me mijëra djelmosha kalben nga sëmundja për emër. Abuzimet, marrëzit e djalëris, dëfrimet e tërë natëshme, shpërdorimet e ndryshme i kanë sjellë në këtë gjëndje shkatërimtare. Kaq e tmershme ishte mëkata. Krishti kur shëroi ulokun e Vidhesdas, që vuante 38 vjetë, i tha: «shiko, u bërë i shëndosh, mos mëkato me», se, si Perëndi, e dinte që ishte bërë ulog nga mëkatat e rinis së tij (Joan 5. 14).

3. - Vdes shpirtin. Sa është vlera e shpirtit e kuptojmë lehtë, po të mendohemi, se Perëndia u bë njeri, pësoi dhe u kryqëzua dhe derdhi gjakun e tij jetëdhënës, që të shpëtoi shpirtet t' ona. Ahere nuk do na duken yperbolike fjalët e ungjillit: «Ç' dobi do të ketë njeriu, edhe sikur të fitojë botën e tërë, në qoftë se dëmton shpirtin e tij». (Mark. 8. 36). Shpirti është thesar i paçmuëshëm, se shpirti është kora e Perëndis d.m.th. i përngjanë nga të gjitha cilsit shpirtnore. Shpirti i pa vdekshëm dhe i përjetshëm na lidh me Perëndin qiellore.

\* \* \*

Këto janë përfundimet e mëkatës. Këto janë pemët e saj, që i provuan të parëkrijuesit, i provoi prodigu i sotshëm, i provojnë dhe të gjith ata, që ndjekin udhën e gjërë dhe shkatërimtare të mëkatës. Vobegsija, urrija, zjarri, sëmundje e tjera s' janë aq të këqija, kur nuk takojnë shpirtin. Por dëmi që sjellë mëkata është shumë i math dhe i pa ndreqshëm. Mëkata është e liga më e madhja, që pjell dhe ushqen të gjitha të ligat. Asaj duhet t' i trëmbemi dhe t' i kemi frikë dhe asaj t' i largohemi. Vetëm urrejtja kundër mëkatës do të n' a ruajë pasjen dhe shëndetin dhe jetën dhe shpirtin dhe do të n' a shpëtojë në mbretërin qiellore. Amin.

---

## E DJELË E MISHIT

Shpiegim i Ungjillit (Math. 25. 31-46)

**"Tha Zoti. Kur të vijë i biri njeriut në lavdin e tij, dhe gjith engjejt e shenjtë bashkë me atë, ahere do të rijë mbi fronin e lavdis së tij. Dhe do të mblidhen përpara tij gjithë Kombet, dhe do t' i ndaj nga njeri tjetri, si bariu ndan dhënt nga kendhrat. Dhe do t' i vërë dhënt nga ana e djathtë e tij, dhe kedhrat nga ana e majtë".**

Këtu Krishti flet për ardhjen e Tij të dytë, në të cilën do të vijë si mbret dhe gjykatës me gjith lavdin e hyjnis së tij për të gjykuar botën.

Kur do të ngjallen të gjith të vdekurit, qysh prej fillimit të jetës, me urdhërin e

gjithpushtetshëm e Krishtit, dhe do të marrë kushdo trup të paprishur dhe të pavdekur, ahëre do të mblidhen përpara Krishtit gjithë njerzit, që kanë rruar mbi dhé, që të japin fjalë të vepravet të tyre.

Do t' i ndaj njeri prej tjetrit, duke marrë para sysh jetën e cilido, dhe më tepër në qoftë se ka rruar me besë te Ay, me bindje në porosit e Tij dhe me pendim të vërtetë.

Të drejtët i quan dhën, se janë të urtë dhe pa ligësirë, sikundër ato. Mëkatarët i quan kedhra, se janë të ashpër nga shpirti dhe të pa ndëgjuar te Perëndia, sikundër ato.

**"Ahëre do t' iu thotë mbreti qytire, që janë në të djathtë. Ejani, të bekuarit e atit t' im, trashëgoni mbretërin, që është bërë gati për ju qysh nga krijimi i botës".**

Mbretëri, kupton të gjitha të mirat, që do të fitojnë të drejtët pranë Perëndis, bashkë me të cilin do të gjenden lidhur ngushtë dhe do të përbëjnë një familje dhe një mbretëri. Këto të mira janë bërë gati qysh nga krijimi i njeriut. Sepse që ahëre destinoi Perëndia njerin, që të rrojë bashkë me Atë me lavdi dhe me lumtëri.

**"Sepse pata uri, dhe më dhatë të ha. Pata etje, dhe më ujitët. Ishja i huaj, dhe më mbështollët. I çveshur, dhe më mveshët. U sëmura, dhe më vizituat. I burgosur, dhe erdhët te mua. Ahëre do të përgjigjen të drejtët duke thënë. O Zot, kur të pamë të urishëm, dhë të ushqyemë; me etje, dhe të ujitëm; kur të pame të huaj, dhe të mblodhëm: ase të çveshur, dhe të mveshëm; kur të pamë të sëmurë, ase në burg, dhe erdhëm te ty. Dhe mbreti do t' iu thotë. Me të vërtetë po ju them juve, sa bëtë te një nga këta vlezërit e mi të vobektë, te mua i keni bërë".**

Zhustifikon përse shpërblehen të drejtët. Dhe tregon rasa të ndryshme, në të cilat bënë vepra dashurije.

Të drejtët, se as Krishtin personalisht kishin parë, as kujtonin të kishin bërë të këtilla vepra dashurije. Në përlësin e tyre kujtonin vetëm mëkatat, që kishin çdukur me anën e pendimit, dhe harronin veprat e mira.

Vlezër të Tij konsideron Krishti të vobektit dhe më tepër ata që janë besnikë në dëshirën e Tij, të cilët bota i përbuzë. Çdo mirësi që u bëhet atyre, i bëhet Krishtit, sepse Krishti urdhëron t' iu bëjmë mirë të vobektëve.

**"Ahëre do t' iu thotë dhe atyre që janë në të majtë. Ikni nga mua të mallkuarit, në zjarr të përjetshëm, që është bërë gati djallit dhe engjejvet të tij. Sepse kisha uri, dhe nuk më dhatë të ha. Kisha etje, dhe nuk më ujitët. Isha i huaj, dhe nuk**

**më mblodhët. I çveshur, dhe nuk më mveshët. I sëmurë dhe në burg dhe nuk më vizituar".**

I dëbon mëkatarët, sepse ata, duke qëndruar deri në fund të ligësisë, janë të pavyer të rrojnë bashkë me Krishtin. I quan të mallkuar, sepse nga mos bindja e tyre në dëshirën e Perëndisë mbajnë mbi vehten e tyre mallkimin dhe zemëratën e Zotit.

Zjarr të përjetshëm, quan dënimin dhe mjerimin, që do të dënohen për jetë mëkatarët lark Perëndisë. Ky dënim ishte bërë gati për djallin dhe për engjejt e tij të liq. Por u bënë dhe mëkatarët të vyer për atë dënim, sepse e shkuan jetën e tyre simbas dëshirës të djallit. Dhe nuk treguan mëkatarët vepra dashurije.

**"Ahere do t' i përgjigjen dhe mëkatarët duke thënë. O Zot, kut të pamë të urishëm, me etje, ase të huaj, ase të çveshur, ase të sëmurë, ase në burg dhe nuk të shërbyem? Ahere do t' i u thotë: Me të vërtetë ju them, sa nuk u bëtë njerit nga këta të vobektit, as mua s' më keni bërë. Edhe do të shkojnë këta në skëterë të përjetshëm, dhe të drejtët në jetë të përjetëshme".**

MËSIMI. - Në këtë jetë as e mira shpërblehet, as ligësira dhe paligësia dënohet. Por Perëndia është e drejtë. Dashuron virtutin, sa urren ligësinë. Prandaj ka caktuar ditë gjyqi për tërë botën, në të cilën do të shpërblejë të mirën dhe do të dënojë të ligën.

Përpara Krishtit, gjykatësit dhe mbretit të gjithpushtetshëm, do të mblidhen pa përjashtim të gjith njerzitet. Asnjë nuk do të përjashtohet nga gjyqi dhe nga shpërblehen dhe mëkatarët do të dënohen.

Në ardhjen e parë Krishti u duk si njeri i përlulët, kurse tash prezantohet në lavdi të hyjnis së Tij. Edhe pasuesit e Tij besnikë rruan në botë të përbuzur, të përlulët dhe me shtrëngimë. Kurse tash lartësohen dhe lavdërohen. Nuk ndoqën të mira lëndore dhe tash trashëgojnë mbretërin e qiejvet, që besonin, dëshironin dhe shpresonin.

Dashuria është pasja me e madhe për njerin. Ay që dashuron, shërben të tjerët, sakrifikohet për ata, por me anën e dashurisë merr shpërblim të përjetshëm dhe të paçmueshëm nga Perëndia.

Do që të shikosh Krishtin dhe t' i bësh mirë Atij? Shikoe Atë ndër të vobektët, ndër jetimet dhe ndër të vejat. Çdo të mirë që u bënë atyre i a ke bërë Krishtit.

Të mallkuarë. Fjalë e frikëshme, dhe më tepër kur del nga goja e këtyllë gjykatësi. Tregon gjithë urrejtjen, që ndjen Perëndia e Shenjtë kundër mëkatës.

Sa nuk kanë dashuri për të afërmin, janë të pavyer të dashurisë së Perëndisë. Sa kanë zemër të ashpër për mjerimin e të tjerëve, nuk gjejnë mëshirë pranë Perëndisë dhe janë të vyer të dënohen dhe të mjerohen ashpërisht.

Dënimi i mëkatarëve, që s' pendohen, është i përjetshëm, dhe jeta e lumturisë për të drejtët është e përjetëshme. Dhe njera dhe tjetra e përjetëshme dhe e pambaruar, pa fund, pa pushim, e qëndrueshme dhe e pandryshuar. Në cilën vallë nga të dyjat do të vemë? Në atë që do të zgjedhim vetë dhe që do të pregatisim me veprat t' ona mbi dhé.

---

## **E DJELË E MISHIT**

Ungjilli Math. 25. 31-36

**FJALIM: Për gjyqin e ardhshëm.**

**"Edhe do të shkojnë këta në skëterë të përjetëshme, dhe të drejtët në jetë t' amëshuar".**

Është një gjë e keqe në jetën e njerzve, kur s' kanë interesim, që të studiojnë librat e shenjta. Jo, nuk duhen sot këngë dhe gëzime. Ungjilli i sotshëm dërgon gjemine dhe shkrepime. Është Ungjilli i gjyqit. Na tregon një gjykatës të drejtë dhe të frikshëm. Një gjykatore të përgjithëshme për të gjithë njerzit. Një vendim gazmor për ata në të djathtë dhe tjetër vendim të vajtuarshëm për ata në të majtë: «Dhe do të shkojnë këta në skëterë të përjetëshme, dhe të drejtët në jetë të amëshuar». Duhet në këtë ditë të sotshme mendim i thellë dhe frikë në shpirt dhe pendim e kthyerje e shpejtë dhe e preme te Perëndia. Këtë do t' a fitojmë, jo duke parë pamjet nëpër rrugët, as duke ndenjur nëpër tryezat për të ngrënë dhe për të dëfryer, por kur të qendrojmë mendjen \*onë në gjykatoren e madhe dhe e pamëshirëshme. Gjyqi i ardhshëm, le të jetë thema e sotshme.

### I

Po, do të bëhet gjyqi i përgjithshëm dhe i përbotshëm, ku do të gjykojë Krishti, ku do të gjykojnë njerzit, ku do të marrë kushdo pas veprave të jetës së tij mbi dhé. Kjo është e sigurtë, sepse e kërkon:

1. - E vërteta e Perëndisë. E tha Perëndia dhe i tërë Shkrimi i Shenjtë është plotë me këto vërtetime. Apostol Pavli, kur lëçiti në Athinë, u thot: «Perëndia caktoi një ditë, në të cilën do të gjykojë gjithësin me drejtësi» (vepr. e Apost. 17. 31). Prapë ky u shkroi Korinthianvet: «Do të dukemi përpara fronit të Krishtit, që të marrë kushdo ato, që

punoj me trupin, ose të mirën ose të ligë» (II Kor. 5. 10). Po vetë Krishti, sikundër ndëgjuam në Ungjillin e sotshëm, na vërteton që: «Kur të vijë i biri njeriut në lavdi të tij, ahëre do të rijë në fron të lavdis së tij, dhe do të mblidhen përpara tij gjithë kombet». Edhe simboli i Besës thotë: «Edhe prapë do të vijë të gjykojë të gjallët e të vdekurit». Perëndia s' është njeri, tjera të të thotë dhe tjera të bëjë. Perëndia është e vërteta dhe s' mund të kthejë fjalën e Tij. Tha pra dhe lëçiti, që do të gjykojë botën, sepse e imponon:

2. - Drejtësija e Perëndis. Drejtësija kërkon gjyqin e përbotshëm. Sepse nuk shikoni ç' bëhet mbi dhé? Virtuti dhe drejtësija ndiqet dhe mbytet në një mënyrë të ashpër dhe të paturpshëm. Përkundrazi triumfon dhe zotnon paligësija, gënjeshtria, ligësija dhe padrejtësija. Lakmuesit dhe grabitësit kanë fituar të zotnojnë, të përqeshin besëmirët, të shtrëngojnë të pafuqishmit, të pijnë gjakun e të vobegtëvet, të shkelin me këmbë nomin hyjnor dhe njerzor. Do të mbeten pra këta pa marrë dënim dhe do të triumfojë përgjithnjë paligësija? Kurrë. Gjaku i atyre që janë vrarë padrejtësisht bërtet dhe zërat e të dëmtuarvet ngjiten në fronin e Perëndisë duke kërkuar drejtësi. me qënë se Zoti është «i drejtë dhe drejtësira dashuroi» do të vijë të gjykojë për të goditur të ligën, të marrë satisfaksion drejtësija, e cila kaq u godit mbi dhé nga ana e njerzvet, që të gjejë cilido të drejtën e tij.

## II

Edhe pikërisht kjo do të bëhet. Vetëm veprat e njerzvet - të mirat ose të ligat - dhe drejtësija absolute e gjykatësit do të rregullojë vendin e cilido nga ne. Vendimin e ndëgjuamë sot.

1. - Dënim për mëkatarët. Dënim i padruarshëm dhe i papërshkruarshëm. Ungjilli përdënim. E quan: «zjarr i papushuar», «krymbë i pafjetur», të «kërcëlliturit e dhëmbëvet», «liqen i zjarrit që digjet». Me këto do që të na rrëfejë dhëmbjen dhe tmerrin, që do të dënohen mëkatarët; sepse do të kenë zemëratën e Perëndis, qertimin e ndërgegjes, shoqërimin e Satanait me engjejt e tij. Nuk do të kenë kurrë shpëtim dhe lehtësim, sepse dënimi nuk do të jetë për një kohë provizore, por i përjetshëm pa mbarim. Mos kjo gjë duket e ashpër? Jo, se Perëndia e paratha dhe i thëriti njerzit për pendim. Po mëkatarët të papenduar nuk besuan dhe qeshnin me fjalët e Perëndis duke thënë, se «këtu është xheneti dhe xhenemi». Përbuzën hirin e Perëndis dhe kjo është mëkata mâ e madhe e mëkatarit. Kur pra s' deshën të pendohen dhe të shpëtojnë, marin nashti pagën e paligjësisis së tyre nga Perëndia gjykatësi i drejtë.

2. - Jetë për të drejtët. Jo jetë e dhemshe, lëndore, provizore dhe me vuajtje: por jetë qiellore, e lumtur. S' ka atje vdekje, dhëmbje, vajtime: atje është gëzim, prehje dhe lumturi. Pse atje do të jenë ndodhja e shenjtorëvet, psalmodhit e engjejvet, lavdija e

pavdekëshme e Perëndis. Të gjitha këto do të jenë shpërblimi i të drejtëvet, sepse ata besuan në fjalët e Perëndisë, ata u ndoqën për Besën, ata luftuan kundër mëkatës, ata shpërndan të mirat e tyre të vobegtëvet dhe ëmbelsuan dhimbjen, fshin lotët, ngushulluan të helmuarët. Gjykatësi i drejtë i shpërblen nashti dhe paga e tyre është jetë e lumtur dhe e përjetëshme.

\* \* \*

Ky është gjyqi. Në atë gjykatore të frikëshme do të mblidhen gjithë kombet. Qysh do të vemi përpara? Ç' vendim të Krishtit do të ndëgjojmë? Do të na thëresë në mbretërin e Tij qiellore, a po do të na dërgojë në skëterë të përjetëshme? Këtë mund të pësojmë, në qoftë se vazdojmë jetën mëkatore. Le të vijmë në vehte, le të përgatitemi që të përballojmë gjykatoren me gëzim, me shpresë, që të japim apologji të mirë dhe të pranushëm.

---

## E DJELË E DJATHIT

Shpiegim i Ungjillit (Math. 6. 14-21)

**Tha Zoti. Në qoftë se ndjeni njerëzvet fajët e tyre, do t' u ndjejë dhe juve Ati juaj qiellor. Por në qoftë se nuk ndjeni njerëzvet fajet e tyre, as ati juaj do t' ju ndjejë fajët t' uaja".**

Në qoftë se ndjeni. Ay që ndjen fajtorët e tij, shpërblehet pasurisht prej Perëndisë, sepse merr ndjesën e mëkatavet të tij. Dhe tregohet në këtë mëshira e pakufizuar e Perëndisë.

Në qoftë se nuk ndjejmë të afërmin t' onë, as Perëndia nuk do të ndjejë mëkatat t' ona. Në këtë rasë vepron drejtësija e Perëndisë. Në qoftë se ne, që jemi njerës dhe fajtorë, nuk ndjejmë të afërmin, është e drejtë të mos ndjejë mëkatat t' ona Perëndia, ligjëbërësi i lartë.

**"Kur agjëroni, mos u bëni, si ipokritërit, të vrërrët. Se prishin fytyrat e tyre, që të dukën njerzve, se agjërojnë. Me të vërtetë ju them juve, se e kanë, marrë pagën e tyre. Po ti kur të agjërosh, lyej kryet t' ënd, dhe laj fytyrën t' ënde. Që mos të dukesh njerzve, se agjëron, por atit t' ënd, që është fshehur. Dhe ati yt, që shehë fshehtazi, do t' a shpërblejë haptazi".**

Ipokritër kupton Farisenjt, që agjëronin për të dukur. Dhe prandaj rinin pa larë dhe të vrërrët dhe prishnin fytyrat e tyre, që të duken, se agjëronin. Dhe kështu të merrëshin si njerës të drejtë. Këta e kanë marrë pagesën e tyre nga njerzit, të cilët i admironin

dhe i mburenin. Pra këta nuk marin ndonjë pagesë nga Perëndia.

Në kohën e Krishtit kishin zakon të lyenin kryet e tyre me vaj ase me myro. Me këto fjalë kupton Zoti, që në ditët e agjërimit duhet të lahemi dhe të pastrohemi, si në ditët e tjera, pa treguar ndonjë shtrëngim, që të dukemi, se agjërojmë.

Perëndia shikon dhe ato, që bëhen në fshehuri, dhe i shpërblen sheshazi në ditën e gjyqit.

**"Mos mblithni thesarë mbi dhé, ku krymbi dhe molja i prish dhe ku vjedhës rrëmojnë dhe vjedhin. Mblithni thesarë në qiell, ku as krymbi, as molje nuk i prish dhe ku vjedhës as rrëmojnë as vjedhin. Sepse atje ku është thesari juaj, atje është dhe zemra juaj".**

Mos mblithni thesarë lendorë, se nuk kanë ndonjë sigurim. Por mblithni thesarë në qiell, që janë të mirat shpirtnore, të cilat i ka përgatitur Perëndia për të zgjedhurit e Tij. Këta thesarë janë të sigurtë, se as prishen, as vidhen. Këta thesarë fitohen duke bërë vepra dashurije në këtë botë.

Shpiegon, përse të ndjekim thesarët e qiellit dhe jo thesarët e dheut. Sepse mendja dhe zemra jonë de të jenë atje, ku është dhe thesari ynë. Po të mbledhim pra thesarë mbi dhé, do të ngjitemi në gjëra të dheshme, dhe ahëre nuk mund të punojmë dëshirën e Perëndisë. Po të mbledhim thesarë në qiell, atje do të jetë mendja dhe zemra jonë edhe do të jemi të dhënë te Perëndia dhe të pëlqyer përpara Tij.

MËSIMI. - Ndjeni, që të jeni të ndjerë nga Perëndia. Mjafton të ndjejmë fajtorët t' anë, dhe do të marim ndjesën e mëkateve t' ona, sado që të jenë ato.

Agjëron ase bën ndonjë punë të mirë për të dukur përpara njerzve? Mburjen e njerzvet e fiton me lehtësi. Por s' është e mundur të gënjesh Perëndinë dhe të marish shpërblim nga Perëndia. Ato vetëm vepra shpërblen i Larti, që bëhen si Ay do dhe vetëm për Atë.

I di Perëndia dhe ato punëra që bëhen fshehurazi, si të mirat, ashtu dhe të ligat. Në ditën e gjyqit, do t' i shpërblejë njerzit simbas veprave të tyre.

Duamë thesarë? Edhe Perëndia do, që të mbledhim thesarë dhe të jemi të pasur. Por duhet të vërejmë në zgjedhjen e thesarëve. Mos mbledhim për thesare gurë, dhe thingjill dhe dru. Dhe të këtilla janë thesarët e dheut, që s' kanë sigurim dhe lumtëri të vërtetë. Thesarët e vërtetë janë në qiell pranë Perëndisë. Kush kërkon dhe fiton thesarët shpirtnorë, ay është me të vërtetë i pasur dhe i lumtur.

---

## E DJELË E DJATHIT

Ungjilli Math. 6. 14-21

### **FJALIM: Për kreshmën e vërtetë.**

**"Po kur të agjëroni, mos u bëni të mvrejtur, sikundër bëhen ipokritërit".**

Dy llojë kreshma, vllazër të dashur, na porosit Zoti i ynë në Ungjillin e sotshëm. Një kreshëm lëndore dhe një kreshëm shpirtnore. Tue pasur parasysh porosin e Perëndisë dhe agjërimet e të drejtëve të Dhjatës Vjetër, na porosit kreshmën e ushqimevet; kjo është kreshma lëndore. Tue marrë shkak nga mënyra e agjërimit të Farisenjvet, porositi agjërimin e pasionëve dhe të mëkatës. Kjo është kreshma e shpirtnore. Këto dy lloj kreshma përbëjnë kreshmën e vërtetë dhe e pëlqyeshme pasionesh, janë detyra e çdo të krishteri. E dyta jep vlerë dhe jetë së parës, dhe e para ndihmon punën e së dytës. Me qënë se nesër fillojmë kreshmën e Madhe dhe kemi detyrë të mbajmë kreshmë, le të shikojmë, cila është kreshma e vërtetë dhe e pëlqyer te Perëndia.

### I

Kreshma është detyrë për dobin e shpirtëve t' onë. Kjo rëzon sulmet, kjo na ndihmon në vdekësimin e pasionevet. Kjo pastron njerin, i forcon vullnetin dhe e përparon në virtutin. Prandaj dhe Perëndia më parë bëri në parajsë nomin e agjërimit: «nga të gjitha pemët të hani, vetëm nga pema e njohtjes të së mirës dhe të së ligës mos hani» (të Berat 2. 17). Prandaj Profitët dhe Apostojtë dhe të Drejtët dhe Patriarket dëndur mbanin agjërim. Prandaj edhe ne duhet të mbajmë kreshëm. Por kur?

1. - Koha e kreshmës. Kur është koha e kreshmës? Na e caktoi Krishti. Kur e pyetën, pse nxënsit e tu nuk agjërojnë? Zoti i u përgjegj, që do të vijnë ditë helmi, kur do të dërgohet nga ata dhënderi, edhe do të agjërojnë. Me këto fjalë kuptonte kryqëzimin e Tij. Edhe thoshte pra, që koha e zisë dhe e helmit, ajo është koha e agjërimit. Edhe kreshma e madhe është periudha e helmit math. Sepse na thëret Kisha e jonë e Shenjtë të mendohemi dhe të ndjejmë thellë nga një anë pasionet t' ona dhe nga ana tjetër pësimet e Krishtit t' onë. Pasionet t' ona ma parë edhe ligësirat t' ona dhe mëkatat t'ona, që u bënë shkak të mvaret mbi kryqt i Biri i Perëndisë i pamëkatashëm. Pësimet e Krishtit së dyti të Shenjta, me dhëmbjet e Tij, me gjakun e Tij, me vdekjen e Tij të çnderçëm dhe të ashpër, që shëruan pasionet t' ona dhe na shpëtuan nga vdekja e përjetëshme të shpirtit. Këto duhet të studjojmë këto ditë. Por fajtori që ndjen ndërgjegjësin e tij, nuk qesh, nuk shikon në ngrënje dhe në pirje, por helmohet dhe qan. Edhe ay që mendohet dhe ndjen vuajtjet e Krishtit, helmohet dhe agjëron, që të

tregojë mirënjohtje të vogël te Shpëtimtari që vuajti. Ja përse është detyrë e shenjtë të mbajmë kreshëm në Kreshmën e Madhe.

2. - Të mbajmë kreshëm të gjithë. Po, detyra e kreshmës është për të gjithë pa përjashtim. Bashkë me dobin e shpirtit t' onë do të mbrojmë dhe shëndetin t' onë. Pikërisht mbrojtja e shëndetit imponon në disa rase prishjen e kreshmëvet për disa njerës. Cilit janë këta? Të sëmurët, të pa fuqishmit. Për këta është nevojë të prishin Krishmët. Ju jep të drejtën Kisha e jonë e Shenjtë. Edhe kanonet e shenjtë bëjnë përjashtimin, «në qoftë se nuk ndalohen nga sëmundja». Je i shëndosh, mbaj kreshmën, se është detyra e jote dhe dobia e shpirtit t' ënd; je i sëmurë, mos mbaj kreshmën, është e drejta jote.

## II.

Kjo kreshëm s' është kurrë e vërtetë dhe e pranueshme te Perëndia, në qoftë se nuk pasohet dhe nga kreshma e brendëshme, shpirtnore. Kur Zoti thoshte: "kur të agjëroni, mos bëhuni të mvrejtur, sikundër Ypokritët", këtë kreshëm kuptonte. Thoshte: agjëroni nga ushqimet, por agjëroni dhe nga pasionet dhe nga ligësitrat.

1. - Kreshma e pasionevet. Kjo është kreshëm e vërtetë dhe e dobishme për shpëtimin e shpirtit dhe kjo jep vlerë në kreshmët e ushqimevet. Sepse ç' kreshëm është ajo, kur nuk ha mish, por ha nderjen dhe prish emrin e mirë e tjetrit me gjuhën t' ënde të keqe? Ç' kreshëm është ajo, kur agjëron vajt, por mbyl tjetrin me padrejtësin dhe me lamimin t' ënd? Kjo nuk është kreshëm, është tallje dhe ypokrizi. Kreshëm e vërtetë, thotë Triodhi, është përmbajtja e gjuhës, largimi i zemëratës, i dëshiravet, e përfoljes, e gënjeshtërisë. Pusho sharjet, përmblihd gjuhën dhe kritikimet, ruaj buzët nga gënjeshttrat, përmbaj dorën nga padrejtësitrat, pastro zemrën nga armiqësija, nga urrejtja, nga ndyrësitrat e dëshiravet të trupit. Ahere agjëron një kreshëm të shenjtë, shpëtimprurëse dhe të pëlqyeshme te Perëndia.

2. - Koha e kreshmës shpirtnore është përgjithmonë deri në mbarim të jetës. Gjithnjë do të agjërojm nga pasionet e mëkatës. Por veçanërisht nashti në kreshmën e Madhe duhet të shtojmë fuqit t' ona. Në këtë do të na forcojnë në luftën pësimet e të kryqëzuarit Shpëtimtar.

\* \* \*

Le të agjërojmë pra kreshmën të pranuar dhe të pëlqyer te Perëndia. Udhë e virtutevet që nesër hapet; le të hyjmë, sa besnikë, sa dëshiruës të virtutit, përpara në luftë, në lavdi. Le të mos na rëzojë armiku. Krishti është yni, lufta është jona, edhe mundja, e lavdia e mbretërisë së qiejvet, të cilën t' a fitojmë të gjithë. Amin.

---

## **E DJELË E ORTHODHOKSISË**

Shpiegim i Ungjillit (Joan. 1. 44-52)

**"Në atë kohë, donte Jisuj të dalë në Galile. Dhe gjen Filipin dhe i thotë. Eja prapa meje. Filipi ishte nga qyteti Vithsaidha, nga qyteti i Andreas dhe Pjetrit. Gjen Filipi Nathanailin dhe i thotë. Atë që shkroi Moisiu në nom dhe profitët, gjetëm Jisun, të birin e Josifit nga Nazareti".**

Këto kohë u bënë pak kohë pas pagëzimit të Jisujt në Jordhan, kur Zoti nga Judhea erdhi në vendet e Galilesë.

Si zemërnjohtës Zoti e dinte disponimin e Filipit; prandaj e thërriti t' i vejë pasë dhe të bëhet nxënës i Tij. Edhe Filipi u bind me shpejtësi.

Vithsaidha ishte qytet i Galilesë dhe prej këtij qyteti ishin Andrea dhe Pjetri.

Nathanaili quhesh dhe Bartholomeu dhe ishte mik i Filipit. Prandaj Filipi, mbasi u bë nxënës i Krishtit, donte të bjerë edhe Nathanailin pranë Krishtit.

Filipi kishte dije të nomit të Moisiut dhe të profitëve. Kështu që posa u bë nxënës, e kuptoi, që Krishti ishte Mesia, për të cilin kishin folur Moisiu dhe profitët.

**"Edhe i thot Nathanaili, nga Nazareti mund të dalë ndonjë e mirë? I thot Filipi, eja dhe shiko. E pa Jisuj Nathanailin të vijë te ay dhe i thot. Ja, Izrailit me të vërtetë, në të cilin s' ka ndonjë dinakëri. Nathanaili i thot, ku më njehë. Jisuj u përgjigj dhe i tha. Përpara se të thërresë Filipi, unë të pashë që ishnje nënë fik. Iu përgjigj Nathanaili dhe i tha. Ravi, ti je i Biri Perëndisë, ti je mbreti i Izrailit".**

Nazareti ishte një qytet i vogël dhe pa rëndësi, për të cilin profitët s' kishin thënë ndonjë gjë, prandaj Nathanaili dyshon që Krishti është Mesia. Sepse profitët thoshin, që Krishti do të lindin në Vithleem. Judhenjt e pandehin që Zoti u lind në Nazaret, se atje u ritë.

Zoti e dinte zemrën e mirë të Nathanailit, si Perëndi zemërnjohtës. Dhe për të bindur Nathanailin për këtë, i thotë që e pa më përpara nënë një fik. Zoti e pa jo me syt e trupit, por si Perëndi, që ndodhet kudo.

Nathanaili me qënë se e dinte, që Krishti nuk e pa nënë fik, kuptoi që e pa si Perëndi. Prandaj pohon besën e tij dhe e quan Krishtin Mësonjës, Bir të Perëndisë dhe mbret

të Izrailit.

**"U përgjegj Jisuj dhe i thot. Që të thash, se të pash nënë fik, beson? Më të mëdha nga këto do të shohish. Dhe i thot, me të vërtetë ju them. Që nashti do të shikoni qiellin të hapur, dhe engjejt e Perëndisë të ngjiten dhe të zbresin mbi të birin e njeriut".**

MËSIME. - "Eja prapa meje ... Është thërritja e Jisujt për Filipin, por dhe për çdo njeri. Eja pasë, me vullnet, me zemër, me vepra dhe me fjalë me plotë bindje. Ata që i venë pasë kështu Shpëtimtarit, ata vetëm do t' arrijnë atje, ku mrriti dhe Ay.

Filipi, jo vetëm ay i vajti pasë Shpëtimtarit, por i pruri Atij dhe tjerë, edhe më parë mikun e tij Nathanailin. Kështu tregoi dhe estimin e tij për Mësuesin hyjnor, edhe dashurin për të afërmin. Sa vallë nga të krishterët, që kanë njohur Shpëtimtarin dhe Zotin, interesohen të udhëheqin edhe të tjerë pranë Shpëtimtarit t' onë hyjnor?

Për ata që dyshojnë dhe nuk besojnë prova më e mira është "Eja dhe shiko ... Po, afro, o njeri, Krishtin. Ndëgjo mësimin e Tij, shiko jetën e Tij dhe shëmbullën e Tij. Shiko dashurin e madhe e Tij. Mëso urtësin e hyjnore. Admiro shënjtërin e Tij. Shiko pësimet dhe vdekjen e Tij, që pranoi edhe për ty. Dhe mos u bëj i pabesë, por thërriti si Thomaj «Zoti im dhe Perëndia ime».

Si Perëndi Krishti ndodhet kudo. Edhe atje ku nuk hynë sy njeriu, hynë syri i Tij hyjnor. Të gjitha i shikon, të gjitha i di, ndodhet kudo. Shikon me dashuri zemrat që s' kanë ligësi, por shikon dhe shpirtet, që janë plotë me ligësi. Përpara syvet të Tij të gjitha janë të hapura dhe të njojtura, dhe mbi ato do të bjerë një ditë gjykim të drejtë si gjykatës i lartë dhe shpërblenjes.

Nathanaili pohon Krishti si Bir Perëndie dhe mbret të Izrailit. Dhe është me të vërtetë mbret Krishti, i përjetshëm dhe i fortë. Mbretëria e Tij nuk është e dheshme dhe lëndore, por qiellore dhe shpirtnore. Nënshetasit e Tij janë ata që ndëgjojnë me dashje nomin e Tij. Të gjithë këta do të trashëgojnë mbretërin qiellore, e cila përmbledh çdo lavdi dhe lumturi dhe është e përjetëshme dhe e pambaruar.

---

**E DJELË E I E KRESHMËVET**  
**ose**  
**E DJELË E ORTHODHOKSIS**

(Joan. 1. 44-52)

## **FJALIM: Për triumfin e Kishës.**

### **"Eja dhe shiko".**

Ku janë ndjekësit e Besës zemër liq, që profitepsin rënien, që përqeshnin atë dhe prisnin me padurim zhdukjen e saj? Ku janë ata besëpak, që dyshonin dhe kërkonin çudira e prova të sigurt për të besuar. Le të vijnë sot të shikojnë çudin e historis shumë të madhe. Të shikojnë dhe të habiten e të besojnë-nëse janë miq të së vërtetës-fuqin e mundjen e Kishës Krishtere. Sot është përkujtimi i luftravet të Kishës, por edhe të triumfit të saj, përkujtimi i mjerimevet, por edhe të lavdis se saj, përkujtimi i tundjevet, por edhe të fuqis së saj të paluftuëshme, të rëzimit të armiqëvevet të saj dhe të triumfit të djemvet të saj. E Djelë e Orthodhoksis! Është mundja dhe lavdija e Besës dhe mburrja e Orthodhoksvet. Sa besnikë, le të nderojnë këtë ditë. Dhe le t' i themi atyre që dyshojnë dhe nuk besojnë "eja dhe shiko". Këto fjalë i tha Filipi Nathanailit që t' a bindënj. Këto fjalë thot dhe Kisha të gjithëve, që të binden për mundjen dhe triumfin e saj «Eja dhe shiko».

Kisha Krishtere mundi të gjitha fuqit e errëta të Ferrit, por veçanërisht mundi:

1. - Botën e forcës dhe të vdekjes. Kujtoni ç' u bë, posa filloi lëçitja e Ungjillit dhe vijon të bëhet deri sot. Luftë dhe përpjekje për shkatërimin dhe zhdukjen e Kishës. Farisenj dhe shkronjës në fillim, mbretër të fortë dhe imperatorë të fuqishëm bënë fushatë kundra Kishës. Dhe me armë në duart, me internime dhe me mundime martyrike, kërkuan prishjen e saj. Kryqëzuan Apostoj, therën Martyrë, mvarën priftërinj, munduan Omologjitë, vdiqën mijëra besnikë pasuës të Krishtit. Fituan? Po, fituan humbjen e tyre dhe lavdin e Kishës. Nuk është ëndërr, është një e vërtetë historike. Ku janë kryepriftërinjt dhe Farisejt? Irodhët dhe Neronët dhe gjith ordhija e ndjekësvevet të Kishës? Humbën, u zhdukën, u shua emrdhe lavdia e tyre. Po, Kisha e Krishtit? Ajo mbeitet në jetët. Ajo qëndron duke fituar, triumfar, duke shtuar pushtetin e saj, që kështu sot numëron miliona besnikësh në gjithë racat dhe gjuhërat, në gjithë vendet e botës. Vërtetohet panigjirisht, që as shpada, as bomba, as luftëra dhe ndjekje, as mundime dhe vdekje mund t' a rëzojnë. Nuk është mundje e lavdishme dhe e famshme?

2. - Botën e gënjeshtërs dhe të gabimit. Këta nuk janë të paktë nga të parët. Që nga shekujt e parë deri sot janë një ushtëri e madhe. Nuk mbajnë në duart armë dhe bomba. Filozofë dhe shkencëtarë mbajnë pendën, këtë armë të tmerrshme, që luan gjuhën për të derdhur helmin e gënjeshtërs në zemrën e Krishterimit. Intrigat e Kelsit kundër Besës, dredhirat dhe ndryshimet e Porfirrit dhe të tjerve paganëvevet, përqeshjet e Volterit, dinakërija e Renanit. Gjith djallëzirat e këtyre gjoja shkencëtarë të ditëvevet të

fundme ishin arqet e zjarrta të armikut. Nuk kishin - dhe nuk kanë tjetër - qëllim, por qysh t' a prezantojnë mësimin e Krishtit si të gënjeshtër. Shtoni pastaj dhe erëtikët, armiq të brëndshëm të Kishës, me Arios in në krye, me ikonomakët pastaj, me qiliastenjt dhe rozelistet sot, të cilët kërkonin dhe kërkojnë të falsifikojnë doktrinën e Krishtit, të shpërndajnë grigjen, të tërheqin prapa tyre nxënësit, të shkatrojnë Kishën. Kisha nuk u tund. Luftoi trimërisht me apologjit e Atërvet, me predikimet e Mësonjësvet, me Sinodhet Ekumenikë të Atërvet të Shenjtë, me librat e të diturve luftëtarë të Besës. Dhe fitoi! Themeloi hyjnin e Kryetarit të saj, ruajti të pafalsifikuar Besën e saj Apostolike. Fitoi Athanaset, Vasilet, Krisostomet, Avgustinet në kohën e Mesme, Neftonet, Galilejt, Paskalet, Pasteret, Markonet, në kohërat e reja, kryetarët e dituris dhe të shkencayet. I fitoi për t' i treguar mbrojtës të Besës së saj. Nuk është një mundje më e ndriçme se e para? Por Kisha mundi dhe armik të tretë.

3. - Botën e Mëkatës. Cila është kjo? Është jeta njerëzore me ligësitat, me pasionet, me dëshirat e saj të poshtërtë, me zakonet e saj mekatore. Kush mund t' i përshkruajë turpësitat e botës idololatrike? Ligësitat e burravet, poshtërsimet e gravet, demoralizimet e të rijvet, ashpërsin e të fuqishmëve, skllavërin e të vobegëve, rëzimin e vlerës njerëzore. Jo fshehurazi, po haptazi njerëzija vepronte dhe i pranonte me duartrokitje turpësitat e saj.

Këtë botë gjeti Kisha dhe këtë thëriti në gjirin e saj. Jo me premtime dhe me përkëdhelje, por me qertime, me gjemime e me këshilla. Edhe fitoi. Atë botë mekatore e rilindi, e edukoi, e shenjtëroi. Anulloi shkllavërin, ngriti gruan në shkallë të meritueshme, predikoi dashurin, instaloi filantropin, pastroi zemrat, fisnikoi shpirtinat. Nga balta e ligësisë mori njerzit dhe i tregoi fallangë Shenjtorësh. Oshënarë, të Drejtë, Martyrë, gjigant të durimit, heroj të vetmohimit e të sakrificës, kështu që dëshirat e mëkatës nuk mundën fuqin dhe hirin e Kishës. Kjo është lavdia e Kishës. Edhe qysh mos të thëresim "kjo është mundja që mundi botën. Besa e jonë".

\* \* \*

Njeri, "eja dhe shiko": shiko qysh luftoi dhe qysh mundi Kisha të tre këta armiq. Jo me armë dhe ushtëri. Jo me mjeshtëri dhe diturin e oratorëve të mësonjësvet, por me fuqin e Perëndisë. Sepse të pa ditur dhe të pa fuqishëm ishin Apostojt e saj. Dymbëdhjetë vetëm, pa miq dhe mbrojtës, me gjithë këtë mundësi. Kisha mundi me të vetëm armë, me fjalën e Krishtit dhe me predikimin e Ungjillit. Kjo është çudija e madhe e shekujvet, që thëret, se nuk është Kisha e Krishtit ndërtesa qiellore: që Kryetari i Saj nuk është njeri i thjeshtë, por Biri i Perëndisë i mishëruar. Këtë besë dhe bindje le t' a mbajmë të gjithë dhe le të jemi të sigurtë, që të gjitha ndjekjet dhe luftërat kundër Kishës do të dalin për fitim të saj; kurse të gjithë armiqt e Saj shtypen njeri pas tjetrit. Ajo do të mundij gjithnjë dhe do të triumfojë. Dhe do të marshojë nga lavdia

në lavdi, deri sa në emrin e Themeluesit të Saj. Shpëtimtarit Krishtit do të gjuhëzojë çdo gjuhë të qiejvet, të dheshmëvet dhe të nëndheshmëvet dhe çdo gjuhë do të omologjisë, se Zoti është Jisu Krishti për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

---

## **E DJELË E II E KRESHMËS**

Shpiegim i Ungjillit (Mark. 2. 1-12)

**"Në atë kohë hyri Jisuj në Kapërnaum. Dhe u ndëgjue që është në një shtëpi. Dhe me të shpejtë u mbledhën shumë, sa nuk nxinte as nëpër dyert. Dhe u fliste atyre fjalën. Edhe vijnë te ay duke prurë një ulok, që e mbanin katër njerës. Edhe me qënë se s' mundnin të afroreshin pranë atij, zbuluan pullazin, ku ishte, dhe duke shpuar zbresin shtratin, mbi të cilin ishte shtritur uloku".**

Kaq shumë ishin mbledhur, që të ndëgjojnë mësimin e Zotit, sa u mbushën dhe nuk nxinin as pjesët e shtëpis në dyert.

Prunë një njeri, që vuante paralizija e këmbëve. Edhe me qënë se ay nuk mund të ecte, e mbanin katër njerës mbi një shtrat. E prunë te Shpëtimtari që t' a shërojë.

Me qënë se s' mundnin të afrohen nga shkaku i gjindjes, hipën në pullazin e shtëpis, hoqën një pjesë të atij dhe duke shpuar atë zbritën shtratin me litarrë përpara Zotit.

Shpëtimtari shpërbleu besën e ulokut dhe atyre që mbanin.

Besa e tyre te shpëtimtari, u duk nga ato që vepruan. Sepse po të mos ishin bindur në fuqin hyjnore dhe në mirësin e Zotit, nuk do të bënëin kaq mundime, që t' a bjenë ulokun përpara Tij.

**"Mbasi pa Jisuj besën e tyre, i thot ulokut, o bir, janë të ndjera mëkatat e tua. Ishin dhe disa nga shkronjësit ndënjur, të cilët mendonin në zemrat e tyre. Çar ky flet kështu blasfimir? Kush mund të ndjejë mëkata veç një, Perëndia"?**

Shkronjësit ishin nga klasa e të diturve, të Judhenjvet dhe merrëshin me shpiegimin e nomit të Moisiut. Ishin pra theologët e asaj kohe. Shkronjësit bashkë me Farisenjt kundërshtonin veprën e Shpëtimtarit.

Ndjesën e mëkatavet prej Krishtit e konsiderojnë si blasfemi. Sepse e pandehin, që Krishti ishte njeri i thjeshtë dhe s' ka të drejtë të ndjejë mëkata.

Zoti si zemërnjohtës kuptoi, ç' mendonin në mendjen e tyre.

**"Jisuj kuptoi atçast në shpirtin e tij, që kështu mendonin në veten e tyre, u tha atyre. Ç' mendoni këto në zemrat t' uaja? Ç' është më lehtë, t' i them ulokut, janë ndjerë mëkatat e tua, apo t' i them, ngreu dhe merr shtratin t' ënd dhe ecë? Po që të dini, se ka urdhër i biri i njeriut të ndjejë mëkata mbi dhé (i thot ulokut). Ty të them, ngreu dhe merr shtratin t' ënd dhe shko në shtëpin t' ende. Dhe u ngrit atçast, dhe duke ngritur shtratin dolli përpara të gjithve, sa u habitën të gjithë dhe lavdëronin Perëndin duke thënë. Që as kurrë s' kemi parë kështu".**

Ma lehtë. Gjykoni ju, u thotë, në qoftë se kam të drejtë të ndjejë mëkata. Ç' është pra me e lehtë, ndjesa e mëkatavet, apo shërimi i ulokut? Sigurisht që të dyja s' janë të lehta, dhe vetëm te Perëndia janë të lehta. Ndjesa e mëkatavet nuk duket përjashta, prandaj unë do të shërojë ulokun. Nga shërimi i trupit të ulokut, do të bindeni, se kam pushtet të ndjejë mëkata.

U ngrit shëndosh dhe dolli nga shtëpia përpara të gjithve. U çuditën të gjithë, kur panë çudin dhe duke lavdëruar Perëndin thoshnin, që nuk kishin parë kurrë të këtilla çudira.

MËSIMI. - Kudo që mësonte Krishti, mbledhesh një gjindje e madhe dhe vëndet me të gjërë tregoheshin të ngushtë. Shpirtet, që kishin etje, vinin në burimin jetëdhënës, zemra të hidhëruara vinin për të marrë ngushullim, ndërgjegje të rënduara kërkonin ndjesë, dhe mendje të errësuara afëroheshin në dritën e së vërtetës. Në fytyrën e Krishtit gjenin mësonjësin, ngushullimtarin, Shpëtimtarin dhe dritëdhënësin.

Ç' ishte uloku, që e zbritën përpara këmbëvet të Krishtit? Ishte një gërmadhë e mjerë. Nuk vuante vetëm nga trupi, por më tepër nga shpirti. Gjendja e trupit dukesh përjashta, por po të dukesh dhe gjendja e shpirtit përjashta, ahëre pamja do të ishte me të vërtetë shumë e mjerë.

Ata që e mbanin ulokun, hodhën shumë pengesa për t' a prurë atë përpara Krishtit. Edhe që të kthehet një shpirt mëkatar te Krishti, ka shumë pengesa për të hedhur. Kritikimet e botës, zakoni i gjatë në mëkatat, kundërveprimi i padukshëm i djallit edhe tjera pengesa. Por jo! Në qoftë se është nevojë të afërohemi te Shpëtimtari ynë, asgjë nuk duhet të na ndalojë. Vendim dhe përpjekje duhet dhe do të gjendemi shpejtë pranë Zotit njeridashës.

«O bir», me këtë fjalë e quan Krishtin ulokun. Përpara se t' i japë ndjesën, e quan bir! Dhe ishte me të vërtetë bir i Jisujt uloku, qysh nga minutat që vendosi të vijë me

pendim afër Tij! Edhe çdo mëkatar, qysh nga minutat që ndjen fajet e tij dhe merr vendimin e pendimit dhe të ndreqjes, njihet si bir i dashur prej të mëshirshmit Shpëtimtar.

Uloku kërkon më tepër shërimin e trupit, por Zoti i jep më përpara shërimin e shpirtit tij. Kur shpirti pëson, shumë herë dhe trupi është i sëmurë. Por edhe i shëndoshë qoftë trupi, prapë njeriu është i mjerë, kur shpirti ka sëmundjen e mëkatës. Shëroni, o vllazër shpirtin t' uaj nga mëkata, që të bëheni me të vërtetë të lumtur.

Në mendimet e liga të shkronjësvet Zoti përgjegjet me çudi të haptë. I jep shëndetin ulokut dhe e ngrehë atë me plotë fuqi. Deri ahëre shtrati e mbante ulokun, por tash uloku mban shtratin. Kështu edhe njeriu deri sa qëndron në jetën e mëkatës, mbahet i lidhur prej asaj, por kurr merr me pendimin ndjesën, merr fuqi shpirtnore dhe kështu është zot kundër mëkatës.

---

## **E DJELË E II E KRESHMËVE**

Ungjilli Mark. 2. 1-12

### **FJALIM: Për mysterin e Rrëfimit.**

**"O Bir, janë ndjerë mëkatat e tua".**

Ç' të mirë tjetër donte Uloku i Ungjillit të sotshëm? Edhe më në fund në qoftë se nuk i dhuronte shëndetin e trupit i tij, ndjesa e mëkatavet, që i fali, ishte mirësija më e madhe, dhurata më e lartë, që i bëri. Edhe qysh jo? Kjo pastron shpirtin, i jep të drejtë fajtorit, shpëton mëkatarin dhe e tregon njerin bir të dashur të Perëndisë dhe trashëgimtar të lavdishëm të jetës s' amëshuar. Le të jetë i lavdëruar emri i Perëndisë, sepse ndjesën e mëkatavet e bëri të përdorëshme dhe të mundëshme për çdo fajtor dhe mëkatar, me anën e Rrëfimit të shenjtë. Për këtë do të bëjmë fjalë sot, se e kërkojnë ditët e shenjta. Dhe kjo përikje e përulët e ulokut te Zoti, është një njohtëje e sigurtë e mëkatavet të tij dhe na dëftën nevojën dhe mënyrën e Rrëfimit.

### I

Rrëfimi është shumë i nevojshëm, sepse:

1. - E kërkon Perëndia. Pikërisht e kërkon, se me anën e profetit Isaia thot: «thuaje ti paudhësit e tua, që të dalish i drejtë» (43. 26). Edhe ungjillori Ioan shton: «në qoftë se rrëfejme mëkatat t' ona, është besnik dhe i drejtë, që të ndjejë mëkatat t' ona dhe të pastrojë nga çdo padrejtësi». Kështu bëjnë të gjithë, që pendohen. Pendohet Dhavidhi dhe rrëfehëhet te profiti Nathan (II mbreter 2. 13). Rrëfehëhet Zakqeu te Zoti. Rrëfehëhet

kumerqari përpara të gjithëve. Rrëfëhet prodigu te atij i tij. Rrëfëhet turma e Iudhenjve në Iordhan përpara Ioanit pagëzor. Rrëfëhen të parët të Krishterë përpara Apostojvet. Po neve ku do të rrëfëhemi? Jo drejte te Perëndia, as në ikonët e Krishtit, po përpara priftit. Ay është zëvendësi i Perëndis dhe ay e ka këtë pushtet, që i a ka dhënë vetë Krishtit: sa të lidhni mbi dhë, do të jenë të lidhura në qiell; dhe sa të zgjidhni në dhë, do të jenë të zgjidhura në qiell» (Math. 18. 18). Dhe pas Ngjalljes së Tij «merrni Frymë të Shenjtëruar, kujve do të ndjeni mëkatat, do të jenë të mbajtura» (Ioan 20. 22). Këtë pushtet i ua dha. Apostojvet, por dhe episkopëvet pasardhësve të Krishtit. Episkopi cakton nga priftërit atërit shpirtnorë për të ndëgjuar mëkatat e popullit dhe për t' i përgatitur për kungatën e shenjtë.

2. - E kërkon shpirti i ynë: Le të mendojmë vuajtjet dhe shtrëngimet e jetës s' onë. Ndjejmë dhëmbje dhe hidhërim? Ahere ç' kërkon shpirti i juaj? Një njeri të sinqertë, një mik besnik, që t' i thoni ankimin tuaj për të hequr rëndësin, që rëndon zemrën t' uaj. Po ka më të rëndë nga mëkata? Për atë që e ndjen, është e paduruarshme. Për këtë kërkon një njeri me besim, që t' i besojë të fshehtat e tij dhe të lehtësojë ndërgjegjen e tij. Po ka njeri më të respektuar dhe më të besuar nga pnevmatiko, që është ati shpirtnor? Ky si zëvendës i Perëndisë, nuk do të zemërohet, nuk do të qërtojë, por do të bashkohet, do të ngushullojë dhe do të na shërojë. Sa shpirtëra me dhëmbje gjetën në vendin e rrëfimit shërimin e tyre fshihne lotët e tyre!

3. - E kërkon ndërgjegja e jonë. I sëmuri që të bëhet mirë, duhet të thotë gjendjen e tij dhe dhëmbet e tij, dhe pastaj të ndëgjojë këshillat dhe udhëheqjet nga njeku, që e konsullton. Kjo duhet të bëhet dhe me mëkatarin. Të çfaqë plagët e tij dhe pastaj të ndëgjojë barrat dhe mjetet, që të mos rëzohet prapë, që të shërohet plotësisht nga sëmundja e shpirtit. Kush do të bëjë njohtjen e sëmundjes dhe kush do të ndriçojë, do të këshillojë mëkatarin në udhën e Perëndisë? Prifti që është caktuar me rrëfimin; ay do t' a këshillojë dhe do t' i tregojë udhën e shpëtimit. Vetëm ata që kanë bërë rrëfimin kanë dritë përpara tyre dhe ecin me siguri udhën e shpëtimit.

## II

1. - Rrëfimi duhet të bëhet me përlje dhe hidhërim shpirti. Fajtori në gjykatore nuk qesh, as gëzon, por ndjen në shpirtin e tij hidhërim dhe qëndron me përlje. Natyrisht kjo duhet të bëhet edhe më tepër në gjykatoren e rrëfimit, ku mëkatarin ndodhet përpara Perëndisë. Ay që vjen të bëjë rrëfimin dhe ndjen fajet e tij, nuk ngreh shtatin e tij dhe nuk numëron virtutet e tij; po përulet dhe qan e vajton për fajet e tij dhe me krye ulur, si kumerqari, numëron një nga një mëkatat e tij. I numëron me sinqeritet të math dhe pa gjetur shkak, që t' ia hedhin fajin tjetrit. Në rrëfim fajin i a hedhim vehtes duke thënë: unë jam fajtori, tek mua të vijë dënimi. Ahere ndjesa dhe mëshira e Zotit.

2. - Por rrëfimi duhet bërë akoma dhe me vendimin e ndreqjes reale. Kur rrëfehemi heqim mëkatat dhe mohojmë veprat t' ona të liga. Duhet të vendosim, që kurrë mos të bjemë në mëkata. Mos të themi mëkatonj sot dhe rrëfhem nesër. Kush të siguron, se nesër do të kesh dëshirë dhe kohë për pendim. Vendimi ynë të jetë i qëndrueshëm. Kurrë mos të bjemë në mëkatën e mallkuar. Rrëfimi pra duhet të jetë i përlulët, i sinqertë, i qëndrueshëm. Ky është rrëfim shpëtimtar dhe pemëprurës.

\* \* \*

Këtë rrëfim na kërkon Kisha e jonë, që të na japë ndjesën e mëkatavet t' ona. Le të mos ndruajmë të omolgjisim fajet t' ona, sikundër nuk ndruajmë, që të tregojmë plagët t' ona mjekut. Le të vemë në rrëfim pashtytje, me pendim dhe me vendim, që t' i japim fund jetës mëkatare. Krishti na pret që të na japë hirin e Tij dhe të na thot, si kundër i tha ulogut të Kapernaumit të sotshëm «bir, të janë të ndjera mëkatat e tua».

---

## **E DJELË E III E KRESHMËVET**

Shpiegim i Ungjillit (Mark. 8. 34 e 9. 1)

Shpiegim i këtij Ungjilli u bë në të Djelën e Pas Lartësimi

**FJALIM: Për vetmohimin simbas Krishtit.**

**"Kush do, që të më vijë prapa, le të mohojë veten e tij".**

Nuk është pa gojë dhe memec druri i gjithrespektushëm Kryqi i Shpëtimtarit t' onë, që kemi sot përpara. Është simboli i shenjtë i vetmohimit të plotë. Dhe me kurorën prej gjëmbash në krye, me goshtët dhe gjakrat, lëshon zë të fortë dhe lëçit në brezat e njerëzvet vetmohimin e Krishtit t' onë hynor. O! vetmohimi! Është A dhe Ω, fillimi dhe mbarimi, fuqija dhe esenca, mâ e larta përsosuni i Krishterore. Dhe në qoftë se na nxjer Kisha e jonë Kryqin e gjakosur të Zotit, me këtë kërkon të na inspirojë vetmohimin, të na japë fuqi e kuxim për këtë virtut të madh. Po, për vetmohim, sepse këtë na mëson Kryqi ynë i çmuëshëm, atë kërkon dhe nga ne Mbreti i lartë i zemravet t' ona. E ndëgjuat Ungjillin e sotshëm? Zëri i Zotit t' onë bërtiti: "Kush do, që të më vijë prapa, le të mohojë vehten e tij". Doni të bëheni pasuësit e mij? Kini dëshirë të sinqertë të vini prapa meje në udhën e lavdis dhe të triumfit? Mohoni vehten t' uaj, urreni vehten t' uaj. Jo vetëm këtë: vdisni vehten t' uaj. Ky është vetmohimi, që kërkonj nga ju të krishterët e mij.

Edhe do të pyesni nashti: Kërkon të kryqëzohemi dhe ne, sikundër u kryqëzua dhe Ay? Jo. Mos kërkon, që mos të marim ushqim dhe kështu të vdesim nga uria? As këtë,

Mos do që të bëhemi asqitej duke ikur nga kjo botë e kotë? Aspak. Vetmohimi që kërkon nga ne Zoti, është më tepër i brendshëm, i thellë, shpirtnor. Dhe vehtja e jonë, që duhet t' a hedhim, si një robe e ndytë, s' është trupi ynë, as jeta e jonë, as të mirat e jetës. Ja cili është:

1. - Vehtja jonë mëkatore. Nuk jemi të mirë dhe paligësirë, sikundër në fillim na krijoi Krijësi Ynë hyjnor. Jemi mëkatarë, të liq, të prishur. Kemi dyshim. Le të hedhim një sy në jetën t' onë të përditëshme; vërteton këtë gjë të shëmtuar. Ç' shëkojmë në të brendëshmen t' onë? Mendime dhe dëshira mëkatore, qëllime dhe pllane mëkatore, një botë ligësije dhe dinakërije. Ç' shikojmë në jetën t' onë të përditëshme. Prapë mëkatën: sepse gjitha pjesët e trupit t' onë nxitojnë, që t' i shërbejnë mëkatës. Sa shpejtë veshët t' ona ndëgjojnë këngë dhe tregime të ndyta. Sa lehtë lëviz dora jonë në grabitje, në padrejtësi. Sa kënaqet gjuha jonë nëpër folje dhe kritikime. Sa vehtja jonë është e ligë, dinake dhe e prishur. Edhe Zoti ynë thotë: "mohoni vehten e t' uaj" d.m.th. urreni mëkatën, që banon te ju. Luftoni me gjith fuqin t' uaj, që t' a çrënjosni nga shpirtet t' uaja, që të pushojë t' ju drejtë dhe të pushojnë duart dhe veshët dhe syt t' uaja të punojnë mëkatën.

2. - Të kaluarën mëkatore. E shkruara për disa është e bardhë dhe e pa ngjëlëshme, por për të shumtët është e zezë. Kur jeta është e ligë, krijon të kaluar të ligë, me miq të liq, me ndjenja dhe vepra të liga. Kjo e kaluarje nuk shuhet edhe kur mëkatari pendohet. Mbetet në mendje si një e pa ndarë e vehtes s' onë. Mbetet me gjallnin, me kënaqësin që na solli vepra e mëkatës. Dhe me kujtimin e mëkatave të vjetra na ndez dëshirat, hedh vaj në zjarr për të na djegur në flakën e mëkatës. Kur Zoti na thot, të mohojmë vehten t' onë, kupton, që të shuajmë nga mendja ikonat e mëkatave t' ona të vjetra, që mos të na ndezin. Të urrejmë të shkuarjen t' onë, që kur të na vijë në mend, të na shkaktojë të vështirë.

3. - Bota mëkatore. Sepse «bota e tërë është në të ligët» (Joan. 5. 19); dhe «çdo gjë në botë, dëshira e mishit dhe dëshira e syvet dhe egoizma e jetës» (I Joan. 2. 16). Me të vërtetë ç' gjejmë në rugën t' onë? Shëmbulla të mëkatës; syt shikojnë qëndra të këqija, veshët ndëgjojnë shtytje në të ligën. Kur pra Zoti kërkon të mohojmë vehten t' onë, kupton, që duhet të mohojmë botën mëkatore, që është shok i pandarë dhe ushqyës i vehtes s' onë mëkatore. Dhe na thotë, mohoni botën, që u tërheq në mëkatë, largohuni nga njerzit e liq, nga vendet dhe nga mjetet e këqija. Largohuni nga këndimet që ju prishin shpirtin. Largohuni nga qëndrat e pijes, e bixhosit, e paturpësis. Mos afërohuni, as mos ktheni sytë që t' i shikoni. Kështu vdes vehtja jote mëkatore dhe e dobtë. Ja cili është vetmohimi i shenjtë.

\* \* \*

Vllezër. Është dhe një shkallë më e lartë se e vetmohimit, therorija e jetës, vetmohim shumë i lartë. Këtë tregoi i pamëkatshmi Jisuj mbi kryqt; këtë treguan Martyrët e Kishës duke pasuar shëmbullën e Tij. Këtë tregojnë dhe sot vllëzrit t' onë, ku ndiqet Kisha. Sa të lumtur do të ishin dhe ne, në rasë se therorizonim jetën t' onë për dashurin e Krishtit. Por këtë sakrificë nuk na e kërkon për nashti Jisuj. Vetëm mëkatën kërkon të urrejme. Le të luftojmë. Nuk është gjë e pa mundur. Vetëm vendim duhet dhe hiri i Krishtit do të na forcojë në këtë luftë të shenjtë. Ahere të pastër në shpirt nga bota, pasuës besnikë të Tij, luftëtarë dhe ushtarë të Tij trima, do të hyjmë triumfist të kurorëzuar në lavdi të pavdekëshme të Mbretëris së Tij qiellore.

---

## **E DJELË IV E KRESHMËS**

Shpiegim i Ungjillit (Mark. 9. 17-33)

**"Në atë kohë, një njeri erdhi te Jisuj, duke rënë ndër gjunj dhe duke thënë. Mësonjës, prura djalin t' im te ty, i cili ka frymë pa gojë dhe ku e zë, e shqyen atë. Edhe shkumëzon, dhe kërcëllen dhëmbët e tij, dhe thahet. Edhe u thash nxënësve të tu, që t' a nxjerin, por nuk mundën. Edhe Jisuj u përgjegj dhe i tha. O brez i pabesë, gjer kur do të jem me ju, gjer kur do t' ju durojë juve? Bjereni atë te unë. Dhe i a prunë. Edhe mbasi e pa, atçast fryma e shqyeu atë. Dhe mbasi ra përdhe, rukullisesh duke shkumëzuar".**

Ishte pushtuar prej frymës së ligë, që e kishte bërë të djallosurin djal memec dhe shurdh.

Brez të pabesë kupton Iudhenjt, të cilët, përveç disa përjashtimeve nuk besonin te Krisht. Midis atyre ishte dhe ati i të djallosurit, se edhe ay erdhi te Krishti me besën e duhur.

Gjer kur do të jem bashkë me ju, duke mësuar dhe duke bërë të mira. Edhe gjer ku do të durojë pa besimin dhe ashpërsin e zemrës s' uaj?

Posa prunë të djallosurin përpara Krishtit, ahere fryma e ligë, duke mos duruar ndodhjen e Tij, e shqyeu djalin.

**"Jisuj e pyeti atin e tij. Sa kohë ka, që i u bë kjo këtij? Ay i tha, që më vogëli. Edhe shumë herë e hodhi në zjarr dhe në ujëra që t' a humbasë. Po në mund, ndihmona duke të ardhur keq mbi ne. Edhe Jisuj i tha atij. Në qoftë se mund të besoshë, të gjitha janë të mundëshme për atë që beson. Dhe atçast duke thërritur ati i djallit me lotë tha. Besonj, o Zot, ndihmo-më në pabesimin t'**

im".

E pyeti Zoti për këtë, jo se nuk dinte, qysh kur e kishte pushtuar djalin djalli, por që të ndëgjojë gjindja. Edhe të shikojnë të gjithë, që Krishti ka të këtillë fuqi, sa të çlirojë dhe ata, të cilët shumë vjetë i ka pushtuar djalli.

Fryma e ligë shumë herë e kishte hedhur të djallosurin edhe në zjarr edhe në ujëra. Por fuqija e Perëndisë nuk e lejoi djallin të vrasë djalin.

Në qoftë se mund. Nga kjo duket se ati i të djallosurit nuk kishte bindje të plotë në fuqin hyjnore të Shpëtimtarit. Do të thotë, nga besa jotë mvarret shërimi i djalit t' ënd. Në qoftë se mund të besosh me zëmër, ahëre do të shikosh, se për atë që beson të gjitha janë të mundëshme.

**"Kur pa Jisuj që po mblidhesh gjindje, qërtoi frymën e papastër duke i thënë. Frymë memece dhe shurdhë, unë të urdhërojë, dil prej këtij dhe mos hyrë më te ky, dhe duke thërritur dhe dyke shqyer atë shumë, dolli. Dhe u bë si i vdekur, sa shumë thanë, se vdiq. Dhe Jisuj mbasi e zuri prej dore, e ngriti. Dhe djali u ngrit".**

Pa Zoti, që po mblidhesh gjindje. Për gjindjen që të besojë, vendosi Zoti që të shërojë të djallosurin.

Frymat e liga quhen të papastërta, se rrojnë në mëkatë, që i bën shpirtërisht të papastërta.

Po atë frymë të ligë e quan këtu Zoti «pa gojë dhe shurdhë», sepse kishte bërë të djallosurin pa gojë dhe shurdhë.

Dolli fryma e ligë dhe u ngrit djali i shëndoshë.

**"Dhe kur hyri ay në shtëpi, e pyetën nxënësit e tij me vete. Pse neve nuk mundëm t' a nxjerim atë? Edhe u tha atyre Ky lloj nuk mund të dalë me tjetër gjë, veç me falje dhe me agjërim. Dhe që andej shkonin përmes Galilesë dhe nuk donte, që t' a dijë asnjë. Mësonte nxënësit e tij dhe u thoshte. Që i biri njeriut do të dorëzohet në duart të njerzve, dhe do t' a vrasin. Dhe mbasi të vritet, të tretën ditë do të ngjallet".**

Nxënësit e pyetën Zotin. Pse neve nuk mundëm të nxjerim frymën e ligë. Dhe Zoti u përgjegj se këto dalin me anën e faljes dhe të agjërimit.

Shkonin përmes Galilesë, por mos t' a dijë njeri. I parathoshte nxënësve të Tij, ato që do të pësonte në Ierosalim prej Iudhenjvet.

MËSIMI. - Për ata që mundon i ligu nga trupi dhe për ata që lufton nga shpirti, s' ka mbrojtje më e fortë nga Zoti Jisu. Sa frymat e liga janë armiq të rrezikshëm, kaq Zoti njeridashësi është mbrojtës dhe ndihmës.

Të djallosurin djal e shqyente kohë me kohë fryma e ligë. Edhe atje ku zotnon i ligu me anën e mëkatës shumë të këtilla përfunime ngjajnë; d.m.th. turbullim, paqetësi, zemërata, armiqtësira dhe shumë të liga.

«Në qoftë se mund». Kjo është gjuha e pakbesimit. Por i këtillë pakbesim dhe mungesë bindjeje në mirësin dhe në fuqin e Shpëtimtarit Krishtit është e pavlerëshme në të mirat e Tij. Të vyer për dashurin dhe për bekimin e Tij janë ata, që përikin te Ay me besë të nxehtë dhe me devotesë të vërtetë.

Zoti qërton frymën e ligë dhe e ndjek atë. I math Zoti në mirësin e Tij për ata që kërkojnë mëshirën e Tij. Por është dhe i frikshëm në fuqin dhe pushtetin e Tij. Në pushtetin e Tij shaktëron gjithë veprën tyranike të djallit tek i djallosuri, me gjithë atë lehtësi shkatëron dhe pushtimin e të ligut në çdo shpirt, i cili kërkon çlirimin nga mëkata.

Zoti na tregon dy arma me rëndësi kundër djalli. E para është falja. Jo fjalë pas zakonit të Perëndia, por përikje e nxehtë me besë të Ay. E dyta është agjërimi: jo ndryshim ngrënjes, por frenim të trupit. Të dy këta mjete duke stabilizuar në shpirt mbretërin e hirit të Perëndisë, shkatërojnë pushtimin e djallit.

---

## **E DJELË E IV E KRESHMËVET**

Ungjilli Math. 9. 17-31

**FJALIM: Për edukatën Krishterore të djemvet.**

**"Bjereni atë te mua".**

Në qoftë se ka edhe sot prindër, që ankohen, prindër, të cilët qajnë fatkeqësin e tyre, fatkeqësin e djemvet të tyre, shumë herë shkaktarë janë vetë. Sepse nuk përkujdesen t' i u japin ritje të mirë dhe t' i edukojnë djemt e tyre me edukatë Krishterore. Shikoni atin e Ungjillit të sotshëm. Djali i tij është i djallëzuar me frymë pa gojë, prej të cilit shqyhet dhe shkumëzon dhe kërcëllit dhëmbët për të shkaktuar dhimbje në zemrën e

atit dhe mëmës së tij. Por fajën e ka vetë i ati për këtë gjendje të vajtuarshme. Kur e dinte, që Zoti dy vjetë nashti po bën çudira në gjithë Palestinën dhe askujt s' i mohoi dhuratat e Tij, më gjithë këtë ay nuk nxitoi tek Krishti për të kërkuar shërimin e djalit të vet. Por vetëm nashti kur sëmundja arriti në kulm. Edhe nashti jo me besë të patundur, sikundër kuptohet nga fjalët e Krishtit «në qoftë se mund të besosh, të gjitha janë të mundëshme për atë që beson». Ç' dëshmon kjo? Që prindër, të cilët janë të ftohtë ndaj feja dhe tek Krishti, humbasin djemt e tyre dhe prapë kur prindërit udhëheqin djemt e tyre te Krishti e te Kisha, fitojnë dhe shpëtojnë djemt e tyre. Ç' imponohet pra? Rritje dhe edukatë Krishtere të djemvet.

Kur themi edukatë Krishtere nuk përjashtojmë arsimin, as shkencat, as mjeshtërit, që janë të domosdoshme për jetën. Por ajo që do të tregojë djalit të disiplinuar, njerin e mirë tregëtarin dhe mjeshtërin e nderçëm, shkencëtarin e vyer, burrin dhe familjarin e lumtur, nuk është kaq arsimit, as të hollat, as zgjuarsija, por edukimi i shpirtit dhe frika te Perëndia dhe besa e Krishtit. Apost. Pavli porositi prindërit «etër, ushqeni djemt t' uaj me arsim dhe këshilla të Zotit» (Ebr. 6. 4). Edhe Krishti i thotë atit «bjere-ni atë te mua» që t' a shërojë. Ç' do të bëjnë pra prindërit?

1. - Do t' iu mësojnë fjalën dhe dëshirën e Perëndisë. Fjalë pra të mira dhe këshilla Krishtere dhe historira dhidhaktike e të këndëshme e të dobishme është nevojë të ndodhen gjithnjë në gojën e prindërvet për të këshilluar, për të udhëhequr djemt e tyre edhe kur janë të vegjël dhe kur janë të mëdhenj dhe në çdo rasë. Do të thonë ndofta disa prindër: qysh mund t' i mësojmë, kur jemi vetë pa arsim dhe pa edukatë? Përgjegjja është e lehtë. Ç' bëni, kur s' kini bukë t' i u jipni fëmijve? Brithni me mundim që të gjeni. Këtë do të bëni dhe këtu. Do të udhëhiqni djemt t' uaj në Kishë, në predikimet dhe do të merni libra fetare për të kënduar. Me këtë mënyrë do t' i udhëhiqni në udhën e Perëndisë.

2. - Do të jepni shëmbullën e mirë. Sepse ajo vepron, ajo mëson e urtëson shpirtin. Le të jetë djali i vogël, le të duket sikur nuk kupton. Djali psikologjis, shikon e kopijon të mirën, shikon e kopijon të ligën. Kur shikon prindërit të zihen dhe të flasin fjalë të liga, është e pa mundur mos t' i imitojnë dhe të marin udhën e tyre. Shëmbulla është mësim i gjallë, udhëheqja e vërtetë. Duan pra prindërit të zënë vend fjalët dhe të japin pemë këshillat e tyre? Duhet të japin shëmbullën e sjelljes së mirë Krishtere djemvet të tyre. D.m.th. këshillojmë dashurin djemvet, është nevojë më parë t' a kemi. Kërkojmë nga djemt të vërtetën. Duhet t' a thomi më parë vetë. I dënojnë se vjedhin, gënjejnë dhe vlasfimisnin. Nuk do të jetë kaq nevojë për dënim, kur prindërit nuk gënjejnë, nuk vjedhin dhe nuk vlasfimisnin vetë. I shtynë për falje. Duhet të falen dhe të venë vetë në Kishë. Shëmbulla është e tërë, mjerë kur mungon, se është e tepërtë çdo mësim. Shëmbull pra prindër të ndriçme, të gjallë e të shenjtë. Prindërit akoma:

3. - Do të falen me gjith nxehtësinë e shpirtit të tyre me besë të patundur. Do të falen për punën e tyre, për fëmijët e tyre. Edukata Krishtere e fëmijëve nuk është e vogël, është e madhe, më e larta, më fisnike, prandaj dhe është më e vështira. Edhe në qoftë se në të gjitha punët e njeriut duhet ndriçim dhe hiri i Perëndisë, që të venë mbarë, shumë më tepër në këtë punë të lartë e të madhe. Është nevojë që Perëndia të ndriçojë, që të kuptojnë prindërit sa dhe kur dhe me ç' mënyrë do të këshillojnë, do të dënojnë dhe do kontrollojnë djemt e tyre. Perëndia lëvtron shpirtet e fëmijëve dhe prindërit me dënimet, me këshillat dhe me shëmbullën e tyre mbjellin. Po që të mbijë fara e mirë e prindërvet në shpirtin e djalit, duhet që bujku qiellor të dërgojë që lartazi bekimet e Tij, për të korrur prodhim të pasur. Prindër të Krishterë, falja e veçantë të Perëndia për djemt t' uaj, do tu dalë me sukses.

Të Krishter prindër. Familja pret sot bashkëshortët e mirë: socialit pret mbështetësit e tij të zgjedhur, atdheu pret ushtarët trima, atdhetarët dhe nënështetasit ligjëbindës, Kisha e Krishtit pret të Krishterë besnikë dhe ndriçues. Të gjithë këta prej jush presin. Mos rini të paimentuar, por përpiquni me besë, durim dhe dashuri. Nuk jeni vetëm, por është dhe Perëndia me ju. Ai do t' ju ndihmojë, që të mbillni sot farën e mirë dhe të korrni nesër paqen e shtëpijve t' uaja, nderjen e njerzve dhe lavdin e Perëndisë. Amin.

---

## **E DJELË E V E KRESHMËS**

Shpiegim i Ungjillit (Mark. 10. 32-47)

**"Në atë kohë, merr Jisuj të dymbëdhjetë nxënësit e Tij dhe zuri t' i u thotë, sa do t' i ngjanin. Që, ja, ngjitemi në Jerosalim, dhe i biri njeriut do të dërgohet kryepriфтërvet dhe shkronjësvet dhe do t' a ndëshkojnë atë me vdekje, dhe do t' a dorëzojnë ndër kombët dhe do t' a përqeshin, dhe do t' a rrahin, dhe do t' a pështyjnë dhe do t' a vrasin. Dhe të tretën ditë do të ngjallet".**

U parathot Zoti pësimet e Tij, që të mos frikësohen në kohën e pësimevet dhe të humbasin besën të Ai, por të kuptojnë që me dashje u dorëzua për vdekje.

Në kombet, do të thot në duart e pushtimit Romak në Jerosalim.

**"Dhe vijnë pranë Jakovi dhe Joani, bijt e Zavedheut, duke i thënë. Mësonjës, duamë që, atë që të kërkojmë, të na i bësh. Jisuj u tha atyre. Ç' doni që t' ju bëjë? Ata i thanë. Jep-na, që një në të djathtë t' ende dhe tjetri në të majtën t' ende të rimë në lavdin t' ende".**

Djemt e Zevedheut, Joani dhe Jakovi i vijnë pranë Jisujt, që t' i flasin veçanërisht. Dhe kërkojnë të marrin vendet e parë pranë Krishtit, duke pandehur, si gjithë Judhenjt, që Mesia do të themelojë mbretëri të dëshme në botë.

**"Jisuj u thot atyre. Nuk dini ç' kërkon. Mundni të pini potirin, që unë pi, edhe pagëzimin, që unë pagëzohem, të pagëzoheni? Ata i thanë, mundim. Jisuj u tha atyre. Potirin, që unë pi, do t' a pini, edhe pagëzimin, që unë pagëzohem, do të pagëzoheni. Po për të ndenjtur nga e djathta e ime dhe nga e majta e ime, nuk është në dorë t' ime që të japë, po për ata që është bërë gati".**

Nuk dini ç' kërkon. Sepse në Jerosalim do të vdes dhe jo të mbretëroj dhe të lavdërohem, sikundër mbretërit mbi dhe. Prandaj ju duke kërkuar, që të bashlavdëroheni me mua tash në Jerosalim, kërkon një gjë të pa mundëshme. Sa për lavdin e përjetëshme në mbretërin e Perëndisë, ajo nuk jepet me atër. Ajo fitohet me vetmohimin dhe me bindjen deri me vdekje në dëshirën e Perëndisë.

Potir dhe pagëzim kupton pësimet dhe vdekjem mbi kryq, që do të merte pas pak kohë. Kini, thot, kaq vetmohim: sa të pranoni pësimet dhe vdekjen, që unë do të marrë? Këtë duhet të mendoni, dhe jo qysh të rini në Jerosalim nga e djathta ime e nga e majta ime.

Do të provoni dhe ju pësime dhe do të merni vdekjen martyrike. Por vendet nga e djathta ime dhe nga e majta ime, këtu në Jerosalim janë rezervuar për dy keqbërës. Por në mbretërin t' ime të lavdishme vëndet e parë nuk jepen prej meje me hatër, por janë bërë gati për ata, që do të bëhen të vyer me anën e virtutit tyre.

**"Dhe kur dëgjuan të dhjetët filluan të zemërohen për Joanin dhe Jakovin. Jisuj mbasi thërriti ata u tha. Ata që duken të zotërojnë kombet, i pushtojnë ata dhe të mëdhenjt e tyre i urdhërojnë ata. Por nuk do të jetë kështu midis jush. Por ay që do, të bëhet i math midis jush, le të jetë shërbëtori i juaj dhe ay që do, të bëhet i parë, le të jetë shërbëtori i të gjithëve. Sepse dhe i biri njeriut nuk erdhi të shërbehet, por të shërbejë dhe të japë shpirtin e tij shpërblim për të shumët".**

Të dhjetët u zemëruan për kërkesën e Joanit dhe Jakovit, sepse edhe ata dëshironin vendet e parë.

Jisuj u tha. Në botë, ata që duken kryetarë dhe të mëdhenj të kombevet, i pushtojnë dhe i tyranizojnë nënshtetasit e tyre, dhe shërbehen prej tyre. Por midis jush, d.m.th. midis pasuësve e mi nuk do të ngjajë, sikundër ngjan midis kombevet. Nuk do të ndiqni zotërimi dhe nderje të botës, por vetëm nderje dhe lavdi që vjen nga Perëndia.

Dhe do t' a fitoni jo duke pushtuar të tjerët dhe duke u shërbyer prej tyre, por përkundra duke shërbyer ata.

Ay që do të jetë vërtetë i math dhe i lavdëruar në mbretërin e Perëndisë, duhet të jetë shërbëtor i të tjerëve; d.m.th. duhet të ndihmojë të afërmin dhe materialisht edhe shpirtërisht me ato mjete dhe dhurata që ka. Ay që do, që të jetë i pari në mbretërin e Perëndisë, duhet të bëhet shërbëtor i të gjithëve.

Bije shëmbëllë vehten e T'ij. Nuk erdhi që të shërbehet prej nesh Krishti, por të na shërbejë dhe të japë jetën e T'ij shpërblim për shpëtimin t' onë.

MËSIMI. - I di që përpara Zoti pësimet dhe vdekjen e T'ij dhe i parathotë me çdo hollësi. Por nuk frikësohet përpara këtillë vdekjeje. Është kaq dashurija e T'ij për botën, sa mohon dhe jetën e T'ij dhe vjen të thërrorizohet dhe të vdesë, që të shpërndajnë në gjith botën mëshirën, hirin dhe jetën. Mësonjësi parathot pësime dhe përbuzje dhe vdekje, dhe nxënësit e T'ij ëndërrojnë pushtim mbretëror dhe lavdira dhe mëshira. Janë të pushtuar akoma nga mendimet e Judhenjvet dhe dëshirojnë lavdin e kotë nga njerzit. Me të vërtetë atje ku s' ka hyrë mjaftë drita e Ungjillit, lindin lehtësisht gabime për të vërtetën, dhe për veprën e Krishtit Shpëtimtar.

Nxënësve që zihen për kryesira jep Zoti mësimin e lartë të përljes dhe të dashurisë. Do lavdi të vërtetë? Të duash të afërmin dhe puno me përlje për atë. Do lartësi dhe kryesira? Të bëhesh më i fundmi në jetën e tashme dhe do të nderohesh prej Perëndisë me lavdi të vërtetë.

Shëmbullë shume e lartë përljeje dhe dashurije është vetë Zoti. Asnjë nga njerzit s' ka lartësin dhe madhëstin e T'ij, por edhe asnjë nuk u përlul kaq, sa Ay. U përlul dhe vdiq me dashje, që të na lartësojë dhe që të na japë jetë.

---

## **E DJELË E V E KRESHMËVE**

Ungjilli Mark. 10. 32-45

**FJALIM: Për lavdin.**

**"Nuk dini ç' kërkoni".**

Të qënë të ndezur nga lavdija të dy nxënësit Iakovi dhe Ioani kërkojnë nderje dhe protokathedria nga Mësuesi i tyre. «Jepna, i thonë, që një nga të djathtë dhe një nga të majtë t' ende të rijmë në lavdin t' ende». Por në vend të lavdis marin përgjigjen e

Zotit «nuk dini ç' kërkon». Po pse pra? Perëndia nuk krijoi njerin të doj lavdin? Dhe nuk është lavdija dëshira më fisnike e Shpirtit të njeriut? Po qysh Zoti jo vetëm ndaloi, por edhe tallanizoi nxënësit, që kërkuan lavdin? Fjala është e kjartë. Nxënësit nuk kërkuan lavdin e vërtetë dhe të përjetëshme; ata kërkuan madhështira të botës dhe nderje të dheshme. Me idhen që Mësuësi i tyre do të mbretëronte në Ierosalim, sado që i u përshkroi pësimet, kërkojnë të sigurojnë vendet para të mbretëris së Tij. Me një fjale nxënësit kërkuan lavdin e njerzvet. Nga kjo lavdi i shtyn Krishti dhe për këtë lavdi ju përgjegj «nuk dini ç' kërkon».

Po përse? Është keq të ndjekë njeriu lavdin dhe nderjen, mburjet dhe admirimet e njerzvet? E ligë s' është, por një gjë që afëron të ligën. Lavdija e njerzvet është:

1. - E kotë dhe e padobishme: d.m.th. tym dhe ëndërr dhe hije. Sepse edhe në tërë jetën t' onë të ndëgjojmë lavdërime, me të ardhur vdekja të gjitha këto zhduken. Vdekja është armiku më i tmershëm i lavdis së njerzvet. I shpërndan të gjitha, nuk lë në këmbë gjasendi. Ku janë fronet e imperatorvet? Lavdija e Aleksandrit dhe fuqija e Qezarvet? Çdo lavdi e njerzvet thahet si lule bari. U fishk bari dhe lulja ra. Kështu shkon lavdija e botës. Dhe ç' i mbetet ankimi në buzët, që ndoqi hijen, që humbi gjith kohën e vjefshme të jetës së tij në sende qesharake dhe të kota. Prandaj lavdija e njerzvet është e kotë dhe e pa dobishme.

2. - E rrezikëshme dhe e dëmëshme. Po, e dëmshme, jo vetëm për shkuarjen e kotë të jetës, por edhe për dëmin e shpirtit. Nuk është gjë e fshehtë, që lavdija e njerzvet kërkon skondo në besë dhe në moral. Ç' bëjnë burrat - por edhe gratë - që të ndëgjohet emri i tyre dhe të admirohen prej njerzvet? Jepen në lukse dhe ndjekin një jetë të lirë në dëfrime dhe valle të pashiëshme, me njohtje dhe relasione, që s' kanë kaq lidhje me moralin. Ç' bëjnë njerzit që të kenë miq dhe të jenë me të gjith mirë? Bëhen dhe ata besatarë dhe mos besatarë, të ndërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm, që të duken të modernizuar, që të kenë nderjen e njerzvet të botës. Ç' bëjnë njerzit që të ngrihen në një punë zyrtare dhe të zënë një vend të lartë? Nuk ndruajnë të bëjnë padrejtësira për të përmbysur kundërshtarët dhe të përdorin si mjete intrigat dhe gënjeshtren. Farisenjt nuk besuan te Krishti, sado që shihnin çudirat, sepse «dashuruan më tepër lavdin e njerzvet, se të Perëndisë» (Joan 12. 43). I u thoshte sheshazi «qysh mund të besoni, duke marrë lavdi nga njerzit?» (Joan 5. 44). Por ahëre ç' është dëshira për lavdin e njerzvet? Nuk është një mëkatë vdekje prurëse dhe prishje e shpirtit? Ky është shkaku, që u tha bijvet të Zevedheut, se «nuk dini ç' kërkon». Na porosit dhe neve të largohemi nga lavdija e kotë e njerzvet.

Por në qoftë se është nevojë të largohemi nga lavdit e kotë e njerzvet, ja më lartë nga kjo është tjetër lavdi, për të cilën jemi të paracaktuar edhe të cilën duhet t' a dëshirojmë dhe t' a kërkojmë dhe me gjith fuqin t' onë t' a ndjekim është lavdia e

Perëndisë. Lavdia e Perëndisë është:

1. - E vërtetë dhe e përjetëshme. Ajo nuk hidhëron dhe nuk shkakton zënie dhe frikëra e shqetësime; nuk shkakton smira e luftëra të frikëshme, sikundër ngjan me lavdin e njërvet. Lavdia e Perëndisë është që prehë plotësisht dhe mbush me gëzim shpirtin e njeriut. Me më rëndësi se është e pavdekëshme dhe e përjetëshme. Ajo nuk shuhet kurrë. Ka fillim vetëm, kur e merr njeriu, po kurrë s' ka fund. Do të shkojnë miliuna shekuj dhe jo vetëm do të mbetet e papaksuar lavdia e qiellit, por edhe do të shtohet, që të marshoj njeriu nga lavdia në lavdi. Na e thot Zoti, «të drejtët do të shkojnë në jetë të amëshuar» dhe «do të ndriçojnë si dielli në mbretëri të Atit tyre» (Math. 13. 43, 25. 46).

2. - Por lavdia e Perëndisë është akoma e sigurtë, d.m.th. Kur e merr, nuk do t' a humbë, sikundër bëhet shumë herë me lavdin e botës. Punove dhe u mundove? U përulë dhe u vure në përqeshjet e njërvet për këtë lavdi? Pësive padrejtësira dhe ndjekje dhe mohove lavdin e njërvet për lavdin e Perëndisë? Sigurisht do t' a marish si kurorë dhe si shpërblim të mundimevet dhe të durimit t' ënd. Se përpara Perëndisë nuk ka hatëre dhe padrejtësira: në qiell vetëm drejtësi zotëron. Edhe drejtësija triumfon dhe ajo do të japë atë lavdi të lumtur, që e quan Apost. Pavli «kurorë e drejtësis, që do t' a japë gjykatësi i drejtë puntorit të virtutit» (II Tim. 4. 8)

\* \* \*

Gëzohu pra, o i Krishterë! Ti që nuk ngjite në kotësitat e gënjeshtres: ti që nuk ndjekë ëndërra dhe hije, që nuk kërkon lavdërime dhe mburrje prej njërvet; ti që përulë për t' u ngritur, ti që lufton për të mbajtur të paprekur shpirtin nga lavdia shpirtprishëse e kësaj bote të përkohëshme. Gëzohu gëzim të math, se madhështija e jote është e siguruar. Lavdia e pavdekëshme të pret, si besatar i mirë dhe i përulur. Dhashtë Zoti që të gjith ne të bëhemi pjestarë të lavdis së përjetëshme, që t' i parashtrojmë Perëndisë me një shpirt dhe me një zemër nderje dhe falje Zotit t' onë të përmbilavdëruar.

---

## **E DJELË E DAFINËS**

Ungjilli Joan. 12. 1-18

**FJALIM: Për Krishtin si mbret.**

**"Osana! i bekuar është ay që vjen me emrin e Zotit, mbreti i Israilit".**

Pa dyshim e Djela e Dafinës është ajo ditë, që më tepër se çdo ditë tregon titullin

mbretëror të Zotit. Nuk shikoni, se ç' bëhet? Mbledhje vetvetiu e gjith popullit Israil. Me entuziazëm në shpirt, me dafina në duart, me zëra gjer në qiell presin mbretin që vjen. «Osana! i bekuar është ay që vjen me emrin e Zotit, mbreti i Israelit». Edhe Jisuj hyn në qytetin e shenjtë. Po qysh hyn? I pamallëngjyer nga deklaramet e popullit, i ftohtë dhe indiferent në pritjen. Nuk është pra mbret Jisuj? Po, është mbret i përjetshëm dhe i pavdekur, por nuk është mbret i dheshëm dhe i kësaj bote. Në qoftë se mbetet sot i ftohtë në shprehjet e Judhenjve, e bën, se nuk njohtën karakterin e mbretëris së Tij; e presin si mbret të dheshëm.

## I

Por Jisuj është mbret shpirtnor, i zemravet; prandaj dhe karakteristikat e Tij janë të ndryshme nga ato që shquajnë mbretërit e dheut. Mbretërit e dheut shquen nga madhështija e përjetëshme dhe nga fuqija që i rrethon. Po Jisuj është:

1. - Mbret i përulur dhe i qetë. Lind, ritet dhe rron me përulje dhe vobegsi të fundme. Dita e sotme, në të cilën njihet zyrtarisht prej gjindje cilsija e Tij mbretërore, është dita e sotme. Por prapë nuk bën ndonjë tregim mbretëror. Nuk hyjnë me ndonjë karoce madhështore; as i rrethuar prej shërbëtorësh dhe ruajtës. Hyjnë ndënjur në një pulisht gomareje. Dhe kur kërkon të bëjë pasuës, prapë përulje e karakterizon, sepse thirja e Tij është "kush do, që të më vijë prapa". Ishte i drejti, i dashur, i popullit çudibërësi, i biri Dhavidhit, që pritesh. Me sa padurim e prisnin Judhenjt, sa dashuri i treguan sot! Por u dënua me vdekje Kryqi Pse? Sepse nuk radhosi ushtëri, nuk ngriti gjindjen në kryengritje dhe kundërveprim. Prandaj dhe Pilatua, kur ndëgjoji padijen nga goja e Farisenjvet, i tha "pra mbret je ti"; edhe ushtarët, kur e përqeshnin dhe i binin me shuplaka, i thoshnin "gëzohu o mbret i Judhenjvet". Ja sa i përulur prezantohet Krishti, mbreti i Ynë. Po është:

2. - Mbret i pushtetshëm dhe i fuqishëm. Mëson dhe bën çudira në tre vjetë. Por nuk ka pasuës të qendruarshëm. Ata që e presin sot me "Osana" gjer në qiell, nesër do të kthehen në armiqt të Tij, që do të thëresin "ngrie, ngrie, kryqëzoe". Nxënësit e Tij, që janë të singertë, nashti tunden dhe bjenë: njeri e tradhëton, tjetri e mohon, të tjerët shpërndahen nga frika e Judhenjvet dhe e lënë vetëm të tërhiqet në vdekje të frikëshme. Por pikërisht vdekja e Tij tregohet triumfi i Tij i math dhe i përjetshëm.

## II

Kur vdesin mbretërit e dheut, ahëre bije lavdia dhe fuqia e tyre: ahëre zhduket dhe shuhet emri i tyre. Po kur vdes Jisuj, ahëre ngrihet gjindja jo për t' a varrosur, por për të besuar te Ay, që t' a duanë, t' a adhurojnë si mbret i përjetshëm i shpirtëvet të tyre. Shekuj shkojnë dhe Jisuj mbeti si mbret i vetëm i zemravet të njëzvet. Janë me miliona të pa numërta, që e besuan, që e pasojnë. nga ç' do racë dhe gjuhë tërheq Jisuj

besnikë. Nuk dëshmon kjo fuqin dhe pushtetin e Krishtit mbret? Është pra Krishti mbret, i cili nashti mbretëron i pa dukur në zemrat e njërvet, por do të vijë ditë, kur sheshit do të duket me gjith madhësinë e Tij për të gjykuar botën.

Por në qoftë se Krishti është mbreti i ynë, ne duhet të jemi pasuësit e Tij, po pasuës jo për një minutë, por në gjith jetën t' onë, pasuës jo si duamë neve, por si na do Ay. Qysh na do pra mbreti ynë qiellor?

1. - Të përlulet. Si ishte Ay. Turma e Judhenjvet, me gjith entuziazmën, që e pritën sot, nuk deshën të kuptojnë karakterin e përmbibotshëm dhe shpirtnor të mbretëris së Tij, t' a besonin sinqerisht dhe t' i venë pas. Ç' i ndaloi? Egoizma dhe kryelartësija e shpirtit të tyre. Kërkonin te Mesia madhështi të përjashtme dhe pushtet botnor. E mohuan përnjëherësh, sepse nuk gjetën. Mos të lëmë mendimet e kryenaltësis të pushtojnë mendjen t' onë. Zoti i ynë ishte Perëndi me dituri të pa kufizuar dhe lavdi dhe fuqi. Me gjith këtë pranoi përlule të pamasë për neve. Prandaj përlulen e kërkon dhe prej nesh dhe lartëson të përlulet, sepse në shpirt përlule mbin besa dhe virtuti. Por nuk mjafton vetëm kjo, na do:

2. - Të qendruarshëm deri në vdekje. Sigurisht i përlulet nuk do të thotë frikacak dhe i pa qendruarshëm. I përlulet do të thotë të jetë i krishteri qetëdashës dhe i durimshëm, kur i bëjnë padrejtësira dhe e fyejnë, por të qëndrojnë i pafrikshëm përpara frikësimevet dhe i papërkulshëm përpara detyrës. Të tërheqin pra dëfrimet dhe kotësitrat e botës, mos u tërhiq. Të përqeshin dhe tallen, sepse beson dhe fale dhe kungon, mos u frikëso dhe mos u mërzit. Të premtojnë fitime dhe përparime në punën t' ende, nëse shkel ndërgjegjen t' ende dhe u shërben interesave të tyre të paligjshëm, mos prano as me një mënyrë. Të frikësojnë më në fund me ndjekje dhe vdekje, prano-i me kënaqësi për Besën e Krishtit. Deri në vdekje mbeti Ay në dëshirën e Atit të Tij, edhe ne besnik deri në vdekje duhet të jemi.

\* \* \*

O Zot! Mbret i përjetshëm i botës, të njojmë që je mbret dhe i zemravet t' ona. Duamë, o Zot i Tërëshënjtë, të mbetemi besnikë te Ty deri në vdekje dhe në dëshirën T' ende. Por jemi të sëmurë dhe të pafuqishëm. Tundemi lehtë dhe mëkatojmë. Degno të dërgosh nga froni i Mbretësis S' ate qiellore fuqin T' ende të fortë, që të forcojë vullnetin t' onë dhe të qëndrojnë drejtë shpirtit t' onë, që të mbetemi besnikë në gjithë jetën t' onë. Degnjo dhe në këtë javë të Pësimevet të Tua të na inspirosh më tepër besën dhe dashurin te Ty, që të bëhemi të denjë trashëgimtarë të Mbretëris S' ATE të pa vdekëshme. Amin.

---

# E DJELË E VAJAVET

## (SHËN DAFINËS)

Shpiegim i Ungjillit (Joan. 12. 1-18)

Gjashtë ditë përpara Pashkës erdhi Jisuj në Vithani, ku ishte Llazari i vdekur, të cilin e ngriti prej së vdekurish. I bënë pra atij darkë atje, dhe Martha shërbente. Dhe Llazari ishte një nga të bashkëndënjurit. Maria duke marrë një litër myro të çmushëm, leu këmbët e Jisujt dhe i fshiu me flokët e saj këmbët e tij. Dhe shtëpija u mbush nga era e myros. Thotë një nga nxënësit e tij, Judha Simon Iskarioti, i cili kishte për t' a tradhëtuar. Pse kjo myro nuk u shit 300 dinar dhe nuk u dha të vobekve? E tha këtë, jo se i vinte keq për të vobektët, por se ishte vjedhës, dhe kishte kuletën dhe mbante ato që vidheshin".

Judhenjt kremtonin Pashkën për kujtim, që Perëndia i çliroi nga zgjedhja e Egjiptianvet dhe me çudira të mëdha i pruri në tokën e premtuar. Kjo e kremte Iudhaike symbolizonte Pashkën Krishtere, që kremtonte për çlirimin t' onë nga mëkata me anën e Jisu Krishtit.

Vithania ishte një fshat afër Jerosalimit, ku banonte Llazari me motrat e tij Martha dhe Maria.

Maria leu këmbët e Krishtit me myro të çmushëm dhe i fshiu me flokët e saj për të treguar mirënjohësin e saj tek Shpëtimtari, që i kishte ngjahur Llazarin prej së vdekurish.

Judha i thotë. Pse nuk u shit për treqind dinarë dhe të hollat të ndaheshin të vobektëvet? Judha ishte arktari dhe mbante të hollat e nxënësve të Krishtit, dhe mbasi ishte vjedhës, do të gjente rasë për të vjedhur një pjesë të të hollave.

**"I tha Jisuj atij. Lere atë, se e ka ruajtur për ditën e varrimit t' im. Sepse të vobektët i keni gjithnjë me vehten t' uaj, por mua s' më keni gjithnjë. Gjindje e madhe e mori vesh, që ishte atje. Dhe erdhën jo vetëm për Jisun, por edhe për Llazarin që t' a shohin, të cilin e ngriti së vdekurish. U menduan kryepriiftërit, që të vrasin dhe Llazarin, sepse shumë nga Judhenjt vinin për atë dhe besonin te Jisuj".**

Këtë që bëri Maria të me lyejë këmbët e mia, do të me shërbejë për ditën e varrimit t' im, e cila nuk është lark. Sepse Judhenjt kishin zakon t' i lyejnë të vdekurit me myra.

Të vobektët do t' i kini gjithnjë pranë, dhe kini mundësi t' i u bëni të mira, por mua nuk do të më kini trupërisht.

U menduan që të vrasin dhe Llazarin, sepse shumë nga Judhenjt besonin te Krishti nga çudija e ngjalljes së tij.

**"Të nesërmen gjindjen e madhe, që kishte ardhur për të kremten, kur dëgjuan që vjen Jisuj në Jerosalim, muarën dega hurmaje dhe duallën për pritjen e tij dhe thërrisnin. Osana, i bëkuar është ay, që vjen me emrin e Zotit, mbreti i Izraelit. Mbase gjeti Jisuj një pulishtë, ndënji mbi atë, sikundër është shkruar. "Mos ki frikë, bijë e Sionit, Ja, mbreti yt, vjen duke ndënjur mbi pulisht gomarjeje". Këto nuk i kuptuan nxënësit e tij herën e parë. Por kur u lavdërua Jisuj, ahëre u kujtuan, që këto ishin shkruar mbi atë, dhe këto i bënë atij. Dëshmonte pra gjindja, që ishte bashkë me atë, që Llazarin e thërriti nga varri, dhe e ngriti atë së vdekurish; prandaj e priti atë gjindja, se ndëgjoji që e bëri ky këtë çudi".**

Osana, fjalë ebraishte, thirrje gëzimi dhe lavdërimi, përkthehet me fjalën rroftë.

Këto fjalë ishin të profitit Zaharija, i cili paratha hyrjen triumfale të Zotit në Jerosalim. Bijë e Sionit quhet Jerosalemi.

Kur Krishti u ngjallë dhe u ngjit në qiejt dhe u lavdërua, ahëre nxënësit kuptuan, që ajo profiti e Zaharias ishte thënë për Shpëtimtrin.

MËSIMI. - Maria plotë me mirnjohësi për Mësonjësin hyjnor që i ngjalli vllan e saj. Iyen këmbët e Tij me respektim me myro të çmuëshme. Zoti e pranoi çfaqjen e mirënjohësis së Maries. Ashtu prapë pranon dhe çdo vepër adhurimi, që del nga një zemër besnike te Ay dhe që dashuron nomin e Tij.

Kurse Jisuj pranon sakrificën e Maries, Judha zemërohet. Nuk shikon ay devotesën dhe mirënjohësin e gruas, por vetëm llogarit çmimin e myros së çmuëshme. Argjent dashja e tij e ndez, etja e të hollavet e piskon dhe i pa përmbajtur në sulmin e pasionit, kritikon veprën e gruas, dhe e dënon sindonjë shpenzim të çmëndur. Me të vërtetë sa verbon pasioni!

Judha proteston në emërin e dashurisë për të vobektët! Argjent dashës në thellësi, prezantohet në dukje si njeri-dashës. Përkujdeset gjoja për të vobektët, kurse ay kërkon rasë për të rrembyer. Bën me ipokrizi mëshiruesin, kurse ay është një vjedhës i poshtër.

Jisuj vjen në Jerosalim dhe një gjindje e madhe derdhet për pritjen e Tij. E presin me entuziazëm dhe e shoqërojnë në qytetin e shenjtë. Por Zoti pa u trazuar nga kjo lavdi e kotë, ri përlësisht mbi pulisht gomareje. Nuk vjen që të mbretërojë dhe që të lavdërohet, por të çnderohet dhe të vdesë ndën katarën e atyre, që sot e presin me entuziazëm. Vjen që të vdesë jo për ata, që i tregojnë ndjenja të rreme, por për ata që mbeten besnike të Ay, dhe janë gati për të vërtetën të marin pjesë në pësimet e Tij dhe vdekjen e Tij.

---

## **E DJELË E PASHKËS**

Shpiegim i Ungjillit (Joan 1. 1-17)

**"Në fillim ishte fjala, dhe fjala ishte te Perëndia dhe Perëndi ishte fjala. Kjo ishte në fillim te Perëndia. Të gjitha u bënë me anën e saj dhe pa atë s' u bë asgjë, nga ato që u benë. Në atë ishte jetë, dhe jeta është drita e njerzvet dhe drita në errësirë nuk ndriçon, dhe errësira atë nuk e pushtoi."**

Në fillim dhe përpara gjith shekujvet ishte i Biri dhe Fjala e Perëndisë, d.m.th. Fytyra e dytë e Trinis së Shenjtë. Quhet Fjalë, që tregohet se lindja e Saj nga Ati është shpirtnore, sikundër fjala e njeriut lind nga mendja. Akoma, sepse me anën e Saj çfaqet dëshira e Atit, sikundër me anën e fjalës çfaqen mendimet dhe vullneti i njereut.

Fjala ishte dhe është e pandarë dhe e bashkuar gjithnjë me Perëndin dhe Atin qiellor në një qenie dhe në një hyni.

Në fillim dhe përpara gjith shekujvet Fjala ishte dhe është e bashkuar me Atin.

Bota që duket dhe nuk duket, u krijua me anën e birit dhe Fjalës së Perëndisë.

Te Biri dhe Fjala e Perëndisë ishte jeta e vërtetë. Këtë jetë u a komunikon dhe njerzvet, duke ndriçuar ata, që të njohin të vërtetën dhe të mirën.

Errësirë kupton mëkatën. I biri dhe fjala e Perëndisë ndriçon të gjithë, sikundër dhe drita natyrale ndriçon midis errësirës. Por këtë ndriçim nuk e pranuan ata, që kënaqëshin në gënjeshtren dhe në mëkatën.

**"Ka qenë një njeri i dërguar nga Perëndia, që quhesh "Joani". Ky erdhi për dëshmi, që të dëshmojë për dritën, që të besojmë të gjith me anën e atij. Ay nuk ishte drita, por që të dëshmojë për dritën. Ishte drita e vërtetë, që ndriçon çdo njeri, që vjen në botë. Në botë ishte dhe bota me anën e atij u bë, dhe bota**

**atë nuk e njohu. Në të vetat erdhi dhe të tijt nuk e pranuan. Dhe ata që e pranuan, u dha atyre pushtet të bëhen bij Perëndije, që besojnë në emrin e tij, të cilët jo prej gjakrash, as prej dëshire mishi, ose prej dëshire burri, por prej Perëndije lindën".**

Joani ishte pagëzori. Puna e Joanit ishte të pregatiste njerzit në besën e Krishtit dhe të dëshmojë, që Krishti është i Bir i Perëndisë i mishëruar, të cilin paralëçitën Profitët.

Joani s' ishte Mesia dhe drita e botës, sikundër pandehin shumë nga Judhenjt.

Krishti është drita e vërtetë, i cili ndriçon çdo njeri me anën e mësimin të Tij dhe me hirin e Tij.

Krishti ishte në botë, si Perëndi dhe si frymë e pa kufizuar, dhe para se të mishërohesh. Bota që ndodhet në mëkatë, nuk e njoftën dhe nuk e kuptuan atë.

Erdhi Krishti në krijesat e Tij, në njerzit, por ata nuk e pranuan. Atyrve, që e pranuan dhe besuan në emrin e Tij, u dha pushtet të quhen bij të Perëndisë, sepse lindin prej Atit, jo natyrisht dhe mishërisht prej burri, por shpirtërisht me anën e besës dhe pagëzimit me fuqin dhe veprimin e Shpirtit Shenjtë.

**"Edhe Fjala u bë mish, dhe banoi midis nesh (dhe pau me lavdin e tij, lavdi si bir i vetëm lindur nga ati) plotë me hir dhe të vërtetën. Joani dëshmoi për atë dhe thërriti duke thënë. Ky është ay që thashë, ay që vjen prapa meje, lindi para meje, sepse ishte pa para meje. Dhe nga mbushja e tij muarëm në të gjithë, dhe hir për hir. Sepse nomi u dha me anën e Moisiut, hiri dhe e vërteta u dha me anën e Jisu Krishtit".**

Fjala mori mish njerzor, d.m.th. u bë njeri dhe rrojti midis njerzvet.

Lavdin e Krishtin, që kishte si Bir i vetëm lindur prej Atit qiellor dhe të cilën lavdi e panë dhe e admiruan Apostojt në çudirat që bënte, por më tepër në Çpërfytyrimin (Metamorfozë) në malin Thavor, në ngjalljen (Anastasis) dhe në Ngjitjen (Analipsis) e Tij në qiell.

Joani thoshte, se Krishti që do të vijë prapa meje, ka qenë para meje, sepse si Perëndi Krishti ishte edhe para lindjes së Joanit.

Nga Krishti, që ka të tërë Shpirtin e Shenjtë dhe është burim jete, muarëm dhurata shpirtnore të udryshme. Muarëm hir dhe shpëtim me anën e Gjakut të Krishtit, në vend të hirit të vjetër me anën e nomit të Moisiut.

MËSIMI. - Krishti është jeta dhe drita e vërtetë; sepse Ai është e vërteta, e cila është drita shpirtnore dhe jep jetën e vërtetë të lumtur. Prandaj ata ecin vetëm në dritë, që pranojnë të vërtetën e Krishtit dhe e kanë Atë në shpirtin e tyre me anën e porosivet të Tij.

Dritë dhe errësirë janë dy gjëra të kundërta. Në të tillë kundërshtim ndodhen e vërteta me gënjeshtër, virtuti me mëkatën. Kush do gënjeshtër dhe mëkatën, nuk pranon dritën e të vërtetave të Krishtit. Ai që do dritën e Krishtit dhe jetën e vërtetë, duhet të mohojë gënjeshtër dhe mëkatën.

Besnikëvet të Tij u dhuron Zoti pushtet dhe të drejta të pa çmuara. Jo vetëm i pastron nga mëkata, por i tregon dhe bij Perëndije. U jep rilindje shpirtnore dhe hyjnore, lindje të re e të lavdishme, në të cilën Perëndija është Ati i tyre i math dhe ata bijt e Tij të dashur. Sa nderje dhe lavdi!

---

## **E DJELË E PASHKËS**

Ungjilli Joan 1. 1-17

**FJALIM: Për Hyjnin e Krishtit që u Ngjall.**

**"... edhe Perëndija ishte Fjala".**

Kush mund të masë madhësitin dhe lavdin dhe gëzimin e ditës së sotshme? Është me të vërtetë më e ndriçme ditë dhe më e shënjtë e kremte e krishterimit. Sot gëzon qielli, gazëllon dheu, dëfrenë besnikët, dridhen dhemonët. E Djelë e Pashkës.

Është mbretëresha e të kremtevet dhe panagjiri i panagjirëvet. Dhe pse jo? Kremtojmë "vdekësimin e vdekjes, anulimin e Ferrit", Psalim Krishti u ngjall. Jo vetëm këtë, por marim vërtetimin e hyjnis e të Ngjallurit. Në qoftë se varri i zbrazët dishmon ngjarjen e çuditëshme, nga ana tjetër Ungjillori Joan na thotë: është i zbrazët varri, se nuk ishte e mundur kryetari i jetës të përmbahet nga varri, sepse "Perëndi ishte Fjala". Ja themeli i besës s' onë. Po ç' është Perëndia? Këtë le të studjojmë:

1. - Perëndi pa fillim. Joani ne krye të Ungjillit thotë: "në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte te Perëndia dhe Perëndi ishte Fjala". Në fillim të kohës ishte Krishti, d.m.th. përpara se të bëhet kjo bota lëndore, përpara se të forcohet qielli dhe dheu dhe përpara se të ishin kryeengjej dhe engjej ishte Jisuj. Nuk ka qënë kohë që s' ka qënë. Jisuj gjithnjë ka qënë, kjo do të thotë "në fillim". Dhe ç' ka qënë? Si Fjalë e

përjetëshme e mendjes së përjetëshme: si Bir pa fillim i Atit pa fillim, i lindur në mënyrë misterioze përpara gjith jetëvet. Jisuj pra është Perëndi e plotë, si është Ati, Perëndi i Tërëfuqishëm, i Tërëurtë me gjith lavdin e Hyjnis. Vetë Krishti vërtetonte nxënësit e tij "unë dhe Ati një jemi" dhe "ay që ka parë mua, edhe Atin t' im ka parë". E thotë me zë të lartë sot Joani "Fjala ishte Perëndi". Thomaj pas tetë ditësh e omologjisi "Zoti im dhe Perëndia ime". E lëçiste Apost. Pavli "Perëndi mbi të gjitha i bekuar në jetët". Edhe Symboli i Besës "dritë prej drite, Perëndi e vërtetë prej Perëndije të vërtetë". Edhe kur do të pushojë lavdia dhe adhurimi i hyjnis së Tij? Kurrë. Ay që s' ka fillim, s' ka as mbarim. Prandaj thot psalmi "mbretëria jote, mbretëri e gjith jetëvet". Symboli i Besës shton "Edhe mbretëria e ti s' do ketë mbarim".

2. - Perëndi Krijuesë. Bota lëndore, bota shpirtnore e engjejvet dhe e njerzvet mori fillim nga Fjala, nga Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtari Krishti, sikundër thot Joani sot "të gjitha me anën e Tij u bënë dhe pa atë s' u bë asgjë nga ato që u bënë". Krishti pra është krijuesi, prej të cilit u bënë të gjitha. Është pra dhe krijuesi i ynë. Ay na dha qënien dhe jetën, sepse "në atë ishte jeta dhe jeta ishte drita e njerzvet". Por na dha dhe ngjalljen, ngjalljen prej së vdekurish; sepse Fjala pa fillim, që krijoi botën në kohë, në kohërat e fundit u tregua edhe:

3. - Perëndi që u ngjallë. U ngjallë së vdekurish, kur më parë vdiq me dashje për shpëtimin t' onë. Edhe kjo është gëzimi dhe triumfi i jetës s' onë; sepse ramë në mekatë, parajsa humbi dhe na mbeti prishja dhe vdekja; por nuk mbetëm në Ferr, sepse "Fjala u bë mish dhe u tentua nër ne". U bë njeri Perëndia qiellore për të shpëtuar njerin, mveshi mishin t' onë, u kryqëzua dhe vdiq, dhe shkoi në të poshtërtat anët e dheut; shkoi në Ferr dhe anulloi Ferrin dhe vdekësoi vdekjen. U hidhërua Ferri, se e pandehu që do të merte njeri, po përpoqi Perëndi. Edhe Jisuj e ngjall mundës duke liruar të lidhurit dhe tue i ngritur në qiell. U ngjall që t' i dhuroi njerëzvet jetë dhe pavdekësi.

\* \* \*

Le të adhurojmë Jisun që u ngjall së vdekurish.

Është Fjala e Atit, krijuesi i ynë. Zoti dhe Perëndia e jonë. Për neve u mishërua, vdiq dhe u ngjall. Është drita e botës. Kryetari i jetës s' onë. Pra le t' i thërresim: «Ay që u kryqëzua, u varos dhe u ngjall së vdekurish. O Zot! lavdi më Ty».

---

## **E DJELË E SHËN THOMAJT**

Shpiegim i Ungjillit (Joan. 20. 19-30)

**"Kur u ngrys, në ditën e parë të javës, dhe me dyert e mbyllura, ku ishin mbledhur nxënësit, nga frika e Judhenjvet, erdhi Jisuj dhe ndënji në mest dhe u thotë: Paqe mbi ju. Dhe mbasi tha, këtë, u tregoi atyre duart dhe brinjën e tij. U gëzuan pra nxënësit, kur panë Zotin. Jisuj e tha prapë atyre: Paqe mbi ju. Sikundër më ka dërguar Ati, dhe unë po ju dërgoj. Dhe mbasi tha këtë, u fryti atyre duke u thënë: Merni Shpirt të Shenjtë, kujvet do t' u ndjeni mëkatat, do t' i u jenë ndjerë, dhe kujvet do t' u a mbani, do të jenë të mbajtura".**

Ngjallja e Krishtit u bë pas mesnate të se shtunës më të gëdhirë të Djelë. Dukja e Krishti ndër të dhjetë Apostojtë për të cilën bën fjalë këtu Ungjilli, u bë vonë në mbrëmjen e së Djelës. Apostojt kishin mbyllur dyert dhe fshiheshin, mos pësojnë nga Judhenjt, ato që pësoi dhe Mësonjësi i tyre.

Jisuj u jep paqen, d.m.th. qetësin mos turbullimin, gëzimin. U tregoi Apostojvet duart, që kishin shënjën e peronavet, dhe brinjën që ishte shpuar, që të bindëshinl, se Ay ishte Zoti i tyre që u kryqëzua, por u ngjall së vdekurish.

Sikundër më dërgoi Ati në botë, kështu po ju dërgonj në kombet, si Apostojt e mi, që të lëçitni dhe të përhapni Ungjillin.

U jep Shpirt të Shenjtë, d.m.th. fuqi dhe pushtet, që t' u japin njerzvet ndjesë mëkatash në emrin e Krishtit, ose mos të japin ndjesë atyre, që nuk janë të meritueshëm.

**"Thomaj, një nga të dymbëdhjetë, që quhesh Binjak, s' ishte bashkë me ata, kur erdhi Jisuj. I thoshnin atij nxënësit e tjerë: Pamë Zotin. Ay u tha atyre: Po mos të shoh në duart e tij shënjën e peronavet dhe të vë gishtin t' im në shënjën e peronavet dhe të vë dorën t' ime në brinjën e tij, s' kam për të besuar. Pas tetë ditësh prapë ishin mbrenda nxënësit e tij dhe Thomaj bashkë me ata. Vjen Jisuj, duke qenë dyert e mbyllura, dhe ndënji në mest dhe u thotë atyre: Paqe mbi ju. Pastaj i thotë Thomajt. Bjere gjishtin t' ënd këtu dhe shiko duart e mija dhe bjerë dorën t' ënde dhe vere në brinjën t' ime dhe mos u bëj i pabesë, por besatar. U përgjegj Thomaj dhe i tha. Zoti im dhe Perëndija ime. Jisuj i thotë atij. Me qenë se më shikove, Thoma, besove; të lumtur ata që nuk më panë dhe besuan".**

Pas tetë ditësh u duket prapë Jisuj Apostojvet, midis të cilvet ishte dhe Thomaj. Jisuj

thërret Thoman të shikojë vetë me duart e tij shënjat e plagëvet, për të besuar, se vërtet u ngjall Zoti.

Thomaj u bind dhe i thot Krishtit me gëzim. 'Ti je me të vërtetë Zoti im dhe Perëndia ime. Jisuj i thotë, besove, se më pe me syt e tu; por të lumtur janë ata, që besojnë pa më parë.

**"Edhe shumë të tjera çudira bëri Jisuj përpara nxënësve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër. Këto u shkruan, që të besoni, se Jisuj është Krishti i Biri Perëndisë, edhe duke besuar të kini jetë në emrin e Tij".**

Këto çudira shkrova, sa janë të mjafta, që të besoni, se me të vërtetë Krishti është i Biri Perëndisë. Duke besuar dhe duke u bërë pasonjësit e Tij të vërtetë, do të fitoni jetën e amëshuar, të cilën dhuron Perëndia në emrin e Birit të Tij.

MËSIMET. - Të dëshpëruar Apostojt pas vdekjes së Mësonjësit të tyre, të turbulluar dhe plot me frikë, rinin fshehur në një shtëpi me dyert e mbyllura. Por ja, duket midis tyre Zoti i ngjallur së vdekurish dhe u thotë: «paqe mbi ju». U inspiron atyre frikën dhe çqetësimin. O shpirtet të turbulluarë dhe të hidhëruarë! Ejani tek Shpëtimtari me besë dhe do të merni prej Tij qetësim dhe ngushëllim.

Nxënësve të Tij Zoti u jep pushtet të ndjejnë mëkatat e njerzvet. Këtë pushtet u dhanë Apostojt Episkopëvet dhe priftërvet në Kishen Krishtere. Të gjithë këta porosi-marrësit e Krishtit janë të detyruar të japin në emrin e Tij ndjesën e mëkatave, atyre që e kërkojnë me besë dhe pendim të vërtetë. Ata që kërkojnë dhe marrin me anën e Episkopëvet dhe të priftërvet ndjesën me pendim të vërtetë, e kanë marrë nga vetë Krishti.

Dhjetë Apostoj panë dhe ndëgjuanë Zotin të ngjallur. Me gjithë këtë Thomaj nuk do, që të besojë dëshminë e kaqë dëshmitarvet të besueshëm; por do që vetë t' a prekë Zotin me duart e tij. Sa njerës janë në çdo kohë, të cilët besojnë lehtë për çdo gjë tjetër, por tregojnë pabesim të pazhustifikuar kundrejt Krishtit. I bën të pabesë jo mungesa e dëshmimeve bindëse, por gjejnë kënaqësi në gënjeshtëri dhe jo në të vërtetën, në mëkatën dhe jo në virtutin, të cilit mishërimi dhe Mësuës i Math është Zoti.

Zoti lumtëron ata që besojnë pa parë, dhe jo si Thomaj. Të tillë s' kanë nevojë për prova të dukëshme dhe të përjashtme; tërhiqen nga Krishti, si hekuri nga magneti. Sepse pranë Tij gjejnë dritën që kërkojnë, virtutin që dëshirojnë, qetësin dhe lumtërin që dashuron shpirti i tyre.

---

# E DJELË E SHËN THOMAJT.

Ungjilli Joan. 20. 19-31

**FJALIM: Për gëzimin e Ngjalljes.**

**"U gëzuan nxënësit, kur panë Zotin".**

Qysh mos të gëzohen. E kishin parë lartë në kryq, lakuriq dhe të përbuzur të vdesë midis dy kusarësh dhe bashkë me jetën e Mësonjësit shuhësin dhe shpresat e nxënësve. Të fantasnin që do të ngjallësh! U a kishte parathënë me të vërtetë Zoti i tyre, por ata e kishin nxjerë fare nga mendja e tyre. Edhe nashti të dëshpëruar nga mos suksesi i Mësonjësit të tyre dhe të frikësuar nga tërbimi dhe zëmëratat e Judhenjvet, mbyllën në shtëpi. Kur papandehur e shikojnë Mësonjësin e tyre të dashur të gjallë, të lavdëruar me fytyrë të ndritëshme. Qysh mos të gëzojnë? Qysh mos të hudhen nga gëzimi i tyre? "U gëzuan pra nxënësit, kur panë Zotin". Por gëzimi i Ngjalljes është i përgjithshëm, është gëzim i gjith botës. Edhe ne gëzojmë për Ngjalljen e Krishtit, sepse Ngjallja s' është vetëm një ngjarje gazmore të jetës së Zotit t' onë mbi dhe. Ka një kuptim të thellë dhe shumë të madh.

1. - Është prova e Hyjnis së Zotit. Sa njerës kanë rrojtur në këtë botë. Shumë nga këta kanë qënë të tmershëm nga fuqia, nga kuximi, nga zgjuarësija dhe kanë prishur mbretëritra të moçme. Po kush ka mundur vdekjen? Asndonji s' ka shpëtuar nga thonjt e vdekjes. Vetëm Krishti u tregua mundës dhe prishi pushtetin e vdekjes. Shkeli vdekjen dhe fitoi mundje të shkëlqyëshme, sepse Jisuj nuk është vetëm një njeri, por edhe Perëndi. E mundi vdekjen si Perëndi; u ngjallë së vdekurish, si kryetar i jetës; i ngjalli të vdekurit, si Perëndi i Tërëfuqishëm. Prandaj e besojmë si Perëndi, e adhurojmë si Zot. Ngjallja e Tij është provë e pakundërshtuarshme e hyjnis së Tij. Ja përse ngjarja e madhe e Besës s' onë është çeshtje gëzimi.

2. - Është sigurimi i drejtësimi t' onë. Nëve mëkatuam dhe mëkata na bëri armiq të Perënisë dhe bij të zemëratës. Vdekja dhe Ferri, janë shpërblimi dhe trashëgimi i mëkatave t' ona. Por Krishti na mëshiroi, u mëshirua dhe u bë njeri Perëndia e përmiqenushme dhe i ngarkoi mëkatat t' ona i pamëkatshmi. Edhe vdiq mbi kryq, që të bëjë fli jetën e Tij te Ati tij qiellor për të na shpëtuar nga zemëratat hyjnore, për të hapur parajsën dhe të na instalojë në mbretërin e Perëndisë. Por Ati qiellor pranoi theroren e Birit të Tij. Na ndjeu mëkatat t' ona dhe na njofti bij të Tij? Po, prova është Ngjallja e Krishtit. E ngjalli së vdekurish për të treguar, se pranoi theroren e Birit të Tij dhe dhuroi jetën dhe pavdekësin atyre, për të cilët vdiq. Mjerë në qoftë se mbetesh Krishti në Ferr. Do të ishim akoma në pushtetin e mëkatës dhe të zemëratës së Perëndisë. E thot Apostol Pavli "në qoftë se Krishti nuk është ngritur, është e kotë

besa e juaj; akoma jeni në mëkata t' uaja" (I Kor. 15. 17). Por Perëndia e ngriti atë së vdekurish dhe Ngjallja e Tij është sigurimi i ynë për shpëtimin t' onë.

3. - Është garancija e ngjalljes s' onë. Vdesim dhe pllaka e ftohtë jep fund në jetën t' onë të dheshme. Po ç' gjë me këtë? Vdekja është e për kohëshme, është një gjumë, prej të cilit do të zgjohemi "presim ngjalljen e të vdekurvet". Sigurisht do të ngjallemi sepse qysh është e mundur të mbetemi për jetë në varr, kur nuk mbeti Krishti në varr? Krishti është kryet t' onë dhe ne jemi trupi i Tij dhe pjesët e trupit e Tij, sikundër vërteton Apost. Pavli (I Kor. 12. 27). Kur pra kryet u ngjall, sigurisht një ditë do të ngjallemi dhe neve nga verret t' ona. Ngjallja e Krishtit është sigurimi i ngjalljes s' onë. E thotë Apost. Pavli "Krishti është ngritur prej së vdekurish, fillimi i të fjeturve u bë" (I Kor. 15. 20). Nashti Krishti, pastaj njerzit e Krishtit në ardhjen e Tij. Ahere do të trumbetojë trumbeta e kryeengjullit "edhe të vdekurit në Krisht do të ngjallen më parë". Edhe neve do të ngjallemi të lavdëruar; do të marim prapë trupat t' ona, jo të sëmura dhe të prishme, sikurse i japim në varr, do t' i marim të lavdëruara, shpirtnore, qiellore.

Gëzohuni pra popuj dhe ngazëllohuni. Mbani lotët, nzitoni në varret me gëzim dhe shpresë. Le të vijë vdekja në çdo orë, që të dojë. Jisuj zgjidhi dhimbjet e vdekjes. Frika e vdekjes s' është për të krishterët. Kur Krishti u ngjall, ne s' kemi frikë, se është mundësi i vdekjes dhe kryetari i jetës. Kur Krishti u ngjall, do të ngjallemi edhe neve të lumtur. O Zot! U gëzuanë nxënësit, kur të panë të ngritur prej varrit, gëzojmë dhe neve nxënësit e Tu të sotshëm për Ngjalljen T' ende të lëvdëruar, sepse Ngjallja e Jote u bë burim jete për neve.

Gëzojmë dhe bekojmë emrin T' ënd të përmbiymnuar.

Ngjall-na, o Zot, nashti nga veprat e vdekura të mëkatës, që të na ngjallish të lavdëruar në ditën e ardhjes S' ATE, që të lavdërojmë në jetët e jetëvet. Amin.

